



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 JANAR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. JANUARA 2017. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë,
8. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija ministra za obrazovanje, nauku i tehnologiju Arsim Bajrami, na zahtev poslanika Ismail Kurteshi, podržan od 15 poslanika-potpisnika, u vezi organizovanja predškolskog i preduniverzitetskog obrazovanja na Kosovu,
5. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-132 o vozilima,
6. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-134 Nacrt zakona o legalizaciji oružja i predaji malog i lakog oružja, municije i eksplozivnih materijala,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-095 o Akademiji pravosuđa,
8. Parlamentarna rasprava na zahtev poslanika Glauk Konjufca, podržan od 9 (devet) ostalih poslanika u vezi hapšenja aktivista Pokreta “Vetëvendosje”,
9. Formiranje Ad hoc komisije za izbor jednog (1) člana Borda RTK-a.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Rendi i ditës së seancës plenare është përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2017.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, kjo pikë zgjat 30 minuta dhe afati kohor sa mund të diskutojmë është i ditur. Paraprakisht ju njoftoj që nuk do ta toleroj asnjërin ta zgjasë diskutimin, për arsye se kemi shumë pika, të cilat do të na marrin shumë kohë dhe kjo do të vlejë edhe në pikën e interpelancës, ashtu siç thashë, edhe në pikën e debatit që është kërkuar.

Të gjithë e dini hapësirën kohore sa keni, ju kisha lutur që t'i përgatitni fjalimet tuaja në përputhje me hapësirën kohore që jua lejon Rregullorja e Kuvendit për seancë.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë, fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse në Parlamentin e Kosovës ka shumë tema dhe çështje për të diskutuar, unë sot do të ngre një shqetësim timin dhe të shumë qytetarëve të Kosovës sa i përket një reagimi që ka bërë deputeti Gëzim Kelmendi për kryeherin tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe nderimet që iu bënë atij nga presidenti Thaçi.

Duke respektuar të drejtën e çdo personi për të shprehur opinionin e vet, qoftë qytetar apo deputet, por kur ky deputet i Kuvendit të Kosovës është edhe kryetar i një partie politike, të regjistruar sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, me reagimin e tij fyen rëndë dinjitetin e popullit të Kosovës dhe të shqiptarëve në tërësi, duke vënë në pikëpyetje se a ishte në trojet tona Perandoria Osmane pushtuese apo jo? Gëzim Kelmendi reagon dhe gjykon nderimin e presidentit për kryeherin tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeun, me rastin e 541-vjetorit të vdekjes.

Gëzim Kelmendi me këtë rast gjykon me negacion presidentin Thaçi për cilësimin dhe atributin që i jep Perandorisë Osmane si perandori pushtuese. Cilësimi i drejtë, sepse Perandoria Osmane nuk u zgjerua në trojet tona me lule e karamele, por me forcën e shpatës, duke vvarë e masakruar të gjithë ata shqiptarë që nuk iu bindën asaj. Prandaj, zoti Kelmendi, nuk duhet të harroni se identiteti shqiptar ruajti kujtesën e luftës epike të Skënderbeut nga asimilimi i Perandorisë Osmane, po ashtu çdo luftë dhe përpjekje jona për lirinë e shqiptarëve nisi me flamurin dhe kujtesën e Skënderbeut, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, edhe lufta e Adem Jasharit, fitorja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës filloi dhe mbaroi me flamurin e Skënderbeut.

Prandaj, mijëra qytetarë dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u rreshtuan pranë atij flamuri për t'u çliruar nga okupimi serb. Nga e drejta juaj për të dhënë vlerësime të tilla për Perandorinë Osmane apo në mos do të na bindni se topat që rrokullisi Mic Sokoli nuk ishin topa që sillnin vdekje, por ishin topa që mbillnin lule në trojet shqiptare. Por, tendenca juaj, zoti Kelmendi, që të zbehni figurën e kryeheroit kombëtar për të glorifikuar një perandori pushtuese, siç ishte Perandoria Otomane, nuk i kontribuon marrëdhënieve të mira me shtetin turk, ashtu siç pretendoni ju.

Nga e drejta juaj, Gëzim Kelmendi, që shtetin e sotëm turk ta krahasoni me Perandorinë pushtuese Osmane, gjë e cila nuk e bëjnë as vetë turqit. Thirrja në emër të marrëdhënieve të mira me shtetin turk për të tjetërsuar historinë kombëtare veçse krijon një hendek në marrëdhëniet me shtetin turk dhe ju po i kontribuoni kësaj. Miqësia e mirë mes kombeve krijohet me respekt të ndërsjellë të historisë, kulturës dhe dinjitetit të njëri-tjetrit. Sa për dijeninë tuaj, pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, edhe Shqipëria, Greqia, Serbia, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi dhe vetë Turqia ka lindur si një vend i ri me themeluesin e saj, Kemajl Ataturku.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nuredin Ibishi, në emër të grupit.

NUREDIN IBISHI: I nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Qytetarë,

Legjislatura e kaluar lëshoi rastin e duhur që të miratojë amendamentet kushtetuese në plotësim-ndryshimin e kornizës ligjore për FSK-në, pra sipas vendimit të Qeverisë 01/173, datë 4. 3. 2014.

Tani Ministria e FSK-së, në bashkëpunim me Zyrën ligjore të Kryeministrit dhe ministrisë së linjës kanë bërë plotësim-ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Këto projektligje janë shqyrtuar në harmoni edhe me këshilltarët e ekipeve të NATO-s dhe janë mbështetur në Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me

projektligjin bazë të FSK-së janë përgatitur plotësime e ndryshimet edhe të 39 ligjeve që ndërlidhen me Ligjin për FSK-në. Duke pasur parasysh se mjedisi strategjik dhe gjeopolitik në rajon dhe ai global është në ndryshim të vazhdueshëm, edhe se së bashku me të edhe kërcënimet tradicionale të sigurisë, ne po përballemi me një gamë të gjerë të sfidave të reja dhe komplekse të sigurisë të natyrave transnacionale, si terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, përhapja e armëve të vogla, rreziqet nga armët e shkatërrimit në masë, kërcënimet kibernetike me pasoja të shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut.

Nga ajo se edhe vendi ynë mund të përfshihet nga këto rreziqe dhe kërcënime, është e domosdoshme ndërtimi i një sistemi funksional modern të sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë rajonale, globale, por në rend të parë, edhe të stabilitetit dhe sigurisë së Kosovës. Kosova duhet të sigurojë se ka kapacitetin e nevojshëm për të adresuar sfida aktuale dhe për t'u përballur me kërcënimet në të ardhmen. Kosova duhet të ketë aftësi për të mbrojtur integritetin territorial të saj, si dhe të zotërojë mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të saj dhe vlerat e përcaktuara kushtetuese në bashkëpunim me fqinjësi të mirë me vendet tona, domethënë që kufizohemi nën ombrellën e NATO-s, si model i mbrojtjes kolektive, qytetarët e Republikës së Kosovës kanë sigurinë e duhur.

Ne jemi duke e krijuar kushtet e duhura të sigurisë për të vendosur stabilitet afatgjatë, siguri dhe paqe në vend dhe rajon. Pasi që kam edhe kohën shumë të kufizuar, unë do t'u referohem vetëm disa dispozitave kushtetuese që na obligojnë këto ndryshime dhe, në rend të parë, ka të bëjë me nenin 1, pra po flas për Kushtetutën, aktin më të lartë ligjor, ku në nenin 1, paragrafi 3 përcakton se: "Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë pjesë tjetër të ndonjë shteti". Sovraniteti gjithashtu përcaktohet edhe në nenin 126, nuk është përcaktuar edhe misioni dhe detyrat e FSK-së, por ato janë përcaktuar në ligjin bazë për FSK-në.

Me qëllim që unë të jem në dakordancë edhe me propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, ku ajo përcakton në nenin 5 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, edhe nuk e përkufizon nevojën për pajisje në armatim ushtarak për nevojat e mbrojtjes të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, gjithashtu edhe kjo pako nuk e kufizon armatimin për mbrojtjen dhe ngritjen e kapaciteteve për FSK-në. Dhe, krejt në fund, ne si përfaqësues të popullit i rekomandojmë Qeverisë së Kosovës të marrë vendim për miratimin e Projektligjit për FSK-në në plotësim- ndryshimin dhe të sjellë në procedurën parlamentare, duke mos ndryshuar mandatin e FSK-së, duke pasur parasysh se gjithë procesi i përgatitjes në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për FSK-në duhet të bëhet me konsultime, dakordancë, bashkëpunim të plotë me autoritetet e KFOR-it, përfaqësues civilë ndërkombëtarë në Kosovë dhe misionarë të tjerë.

Çështjen e interpretimit të dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me këtë ligj të bëhen në konsultim me Gjykatën Kushtetuese me qëllim përfundimtar të realizimit të planit dhjetëvjeçar të

zhvillimit të FSK-së. Në plotësim-ndryshimet e Ligjit për FSK-në nuk duhet të ndryshohet edhe emri nga Forcat e Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura, as ndryshimi i misionit dhe detyrave esenciale, por duhet të modifikuar organogrami me qëllim të realizimit të objektivave, për ngritjen e kapaciteteve në nivel personal, pajisjen, planifikimin dhe ngritjen e vazhdueshme të buxhetit sipas planit dhjetëvjeçar dhe kjo ngritje e buxhetit ka filluar në vitin 2016-2017, por edhe në këtë vit buxhetor prej 9%. Të bëhet ndryshimi i emrit nga emri i tanishëm Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi që kjo nuk është kategori kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën. Në emër të grupit, a?

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Dy ngjarje që ndodhën në veri të Kosovës gjatë dhjetorit dhe gjatë këtij muaji e dominuan diskutimin shoqëror dhe politik në Kosovë.

Muri i ndërtuar nga Serbia pas urës së lumit Ibër, si dhe treni i nisur nga Beogradi, i cili u zbraps në kufi. Dallimin që ka mundur ta vërejë gjithsecili prej nesh lidhur me këto dy ngjarje ka qenë ky: që për murin pati shumë garë se kush është fajtori dhe faji hidhej sa andej, sa këndej mes figurave politike dhe institucioneve të Kosovës, kurse për trenin pati një konkurrencë shumë të fortë për krekosje dhe se kush do t'i marrë meritat. Nëse asgjë tjetër, zbrapsja e trenit i ka hedhur poshtë dy qëndrime të vazhdueshme të qeverive të pasluftës në Kosovë, e këto janë se së pari nuk kemi kapacitete për të vendosur sundim të ligjit dhe rendit në veri të Kosovës dhe, së dyti, se nëse përpiqemi t'i çojmë Forcat e Sigurisë në veri të Kosovës, atëherë do të na dalë kundër bashkësia ndërkombëtare.

Këto i kam dëgjuar në secilin debat, nga secili zyrtar politik që kam qenë vazhdimisht kur "Vetëvendosja" ka thënë që në veri duhet rend edhe ligj, duhet të dërgohen Forcat e Sigurisë. Rregullisht zyrtarët qeveritarë kanë thënë se nuk na lë bashkësia ndërkombëtare dhe se është rrezik të ketë gjakderdhje. Treni tregoi se mungesa e sundimit të ligjit dhe rendit në veri nuk paska qenë mungesë e gatishmërisë, apo i guximit, apo i profesionalizmit të institucioneve tona të sigurisë, e as nuk paska qenë pengesë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Mungesa jonë atje, si dhe prania e plotë e Serbisë në veri po del që paska qenë më së shumti mungesë e vullnetit dhe e strategjisë nga ana e udhëheqësve të Kosovës. Qëndrimi i NATO-s dhe ai amerikan tregon qartë që zbatimi i ligjit dhe i kushtetutshmërisë në çdo cep të Kosovës nuk pengohet asnjëherë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Tash, pas kësaj, drejtuesit tanë do të na tregojnë, pra pse nuk paska ndodhur ligji dhe rendi në pjesën veriore të Kosovës prej vitit 1999?

Qeveritë dhe institucionet tona në atë pjesë kanë qenë aq të papranishme sa që tash në njëfarë mënyre është krijuar përshtypja sikur ndalesa e një treni të Serbisë në kufi apo rrëzimi i një muri, i cili është vendosur nga Serbia atje, pas urës së lumit Ibër, do ta rregullonte automatikisht

situatën në veri të Kosovës. Kjo nuk është e vërtetë, fatkeqësisht kjo nuk është e vërtetë, do të ishte mirë sikur të ishte kaq e lehtë sikur problemi në veri të ishte një mur dhe ndalja e një treni, por situata në veri rregullohet vetëm atëherë kur të shuhen strukturat e Serbisë dhe të zbatohet ligjshmëria që zhbën krimin e organizuar, i cili është i bashkëlidhur me kontrabandën në veri të Kosovës. Kjo bëhet me një strategji gjithëpërfshirëse nacionale, e jo me aventura krekosëse dhe ad hoc, siç po i shohim ditëve të fundit në Kosovë.

Në anën tjetër, Qeveria jonë po orkestron dhe po koordinon spektakle me Serbinë. Si është e mundshme që muri të mos ndalet, e treni që u nis nga Beogradi të ndalet, apo që treni nga Beogradi të ndalet dhe ai që hyn nga Kraleva dy herë në ditë në Kosovë të mos ndalet? Apo që të ndalet Nikoliqi, e pas dy ditëve të hyjë Gjuriqi pa leje në Kosovë? Apo që të ndalet Gjuriqi, siç ndodh ndonjëherë, por të hyjë pa leje Dikoviqi, që është shefi i Ushtrisë së Serbisë? Apo që të ndalet një tren, e të mos ndalen 400 milionë euro mallra të Serbisë që hyjnë në Kosovë? Apo që të rrëzohet një mur, e të ndërtohet “Zajednica” në Kosovë? Apo si u bë që Telekom i Serbisë hyri me operatorin serb dhe nuk e ndali askush? Si u bë që “Elektrokosmeti” hyri në Kosovë dhe nuk e ndali askush?

Pra, zonja dhe zotërinj, Serbia ose ndalet krejt, ose nuk ndalet! Këto që po i bëni janë taktika të spektakleve dhe aventura krekosëse.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pal Lekaj, në emër të grupit.

PAL LEKAJ: Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Të gjithë ju të pranishëm,
Situata në Kosovë dhe në Ballkan nuk është e qetë. Kushdo që thotë ndryshe, ose është i verbuar, ose dëshiron të mos jetë i sinqertë me qytetarët.

Brenda vetëm pak ditëve kemi kaq shumë sulme të Serbisë në drejtim të Kosovës dhe tendencë për ta cenuar sovranitetin e saj. Këto sulme janë të orkestruara mirë nga Serbia, e kjo po kuptohet pa pasur nevojë për shumë ekspertizë. Ajo që me të drejtë ngre dilema është nëse institucionet e Kosovës janë duke u angazhuar që t’ia prishin këto orkestrime apo tregohen të urta dhe vetëm sa po i ndihmojnë me ose pa vetëdije në realizimin sa më të mirë të këtyre sulmeve ndaj Kosovës.

Qeveria e Kosovës po thotë se e ndalën një tren serb pa leje e me mesazhe tërësisht nacionaliste e luftënxitëse, që tentojnë të hyjnë në territorin e Kosovës. Edhe pse me një luftë deklaratash se kush e bëri i pari e kush i dyti, mirë keni bërë. Por, nuk është se e keni bërë namin, sepse vetëm sa i keni zbatuar ingerencat që jua jep Kushtetuta e Kosovës, e të cilën jo rrallë herë po e anashkaloni, kur është në pyetje Serbia dhe argatët e saj që vijnë e shkojnë nga Kosova si të jenë në livadhet e etërve të tyre.

Siç vepruat, ta zëmë me trenin, pse s'po veproni njëjtë edhe me murin, po qe se dëshironi të jepni mesazhin se Kosova ka zot shtëpie, gjë që deri më tani nuk e keni bërë. Njëjtë duhet të bëni edhe me dialogun me Serbinë, duhet ta ndërpritni këtë lloj të dialogut, derisa Serbia nuk tërhiqet nga kërkesat e saj absurde, që nëpërmjet fletarrestimeve të Interpolit t'i ndjekë çlirimtarët tanë nëpër botë e që nëpërmjet trenave dhe mureve tentoi të rikthehet në Kosovë.

Nuk duhet të ktheheni në atë tavolinë, sepse tash për tash ajo është veç një tavolinë nënshtrimi për Kosovën, nga ku po e copëtoni qenien e shtetit tonë. Nga ajo tavolinë, Serbia po merr zemër për t'ia mësyre prapë Kosovës. Kështu, të paktën, bëjnë nëse i dëgjojmë me vëmendje deklaratat e Nikoliqit të Serbisë.

Ky Kuvend, ne si përfaqësues të popullit, dhe Qeveria e Kosovës, duhet ta thonë qartë e troç, t'ia bëjmë me dije gjithsecilit se e kuptojmë përse u ndal Ramushi në Francë dhe pse ndodhën pastaj të gjitha këto sulme të Serbisë ndaj Kosovës. Prandaj, duke e kuptuar se çdoherë po e sakrifikojmë Ramushin në të tilla raste, ne duhet t'u themi se vazhdimi i ndalimit të ish-kryeministrit dhe kryetarit Haradinaj në Francë, duke ia mohuar të drejtën për t'iu kthyer e shërbyer shtetit të vet, në njërën anë, e tendenca për destabilizim të Kosovës, janë të papranueshme dhe po na dërgojnë drejt një qorrrokaku, nga ku vështirë do të dalim, jo vetëm ne, por i tërë Ballkani.

Serbia po tregohet se është veç një shtet inatçi, me dëshira të rrezikshme, që kanë vetëm një qëllim, mbajtjen në tension të rajonit për pasojë shkatërrimin e të arriturave deri më tash. Nëse ka pasur ndonjëherë diçka të tillë, siç i keni dhënë zor ju qeveritarë, e sidomos zonjës që i është marrë zëri këtyre ditëve, kur në fakt do të duhej të fliste e të sqaronte gjithçka. Po ashtu, duhet bërë me dije gjithsecilit që nëse do të vazhdoni t'ia mbani "zhagun" një shteti grindavec e qëllimkeq, siç është Serbia, duke u ekzekutuar disa shkarravina të montuara e të nënshkruara nga një regjim që në Ballkan ka bërë vetëm luftëra, djegie, masakra e shkatërtime, siç është regjimi i Milosheviqit, atëherë nuk po kuptohet nëse jemi duke i kontribuar paqes, apo jemi duke i fryrë zjarrin në këtë pjesë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Detyrimisht, edhe fjalimi im ka të bëjë po ashtu me situatën në veri.

Kanë kaluar disa ditë, e ende po debatohet për atë se kush ishte ai që e dha urdhrin për aksionin e Policisë në veri të vendit tonë. Kjo qasje juaja po e dëshmon atë se nuk ishte problemi dhe shqetësimi juaj i vetëm hyrja e trenit nga Serbia në vendin tonë, por problemi ishte se cili po del i pari t'ia marrë meritat për ndalimin e trenit. Është shumë interesante kjo qasje juaj, sepse kur ne

kërkojmë llogari nga ju që ishit dhe që jeni të përfshirë në dialog për marrëveshje të dëmshme dhe të cilat dolën të jenë në kundërshtim me Kushtetutën, ju heshtni. Por, edhe kur ne kërkojmë që këto bisedime të jenë transparente, ju sërish heshtni, sepse të gjitha të mirat nga këto bisedime iu kredituan vetëm Serbisë dhe të gjitha pasojat po i bart vendi ynë.

Sot, të nderuar, këtu duhet të shtrohet pyetja, se si erdhi puna deri këtu që të provokohet një situatë e tillë nga Serbia. Kjo për “Nismën” është e qartë se si, por jo edhe për qytetarët.

Kjo situatë, të nderuar qytetarë, erdhi si pasojë e bisedimeve politike të zhvilluara në Bruksel, bisedime jotransparente, bisedime të cilat sjellin shumë dëme për vendin tonë dhe për të ardhmen tuaj dhe, siç po e shihni, bisedime për të cilat kjo Qeveri as nuk shqetësohet dhe as nuk i paraqet para këtij Kuvendi.

A është kjo metoda e Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve me shtetin tonë? Këtë duhet të na e tregojnë të gjithë ata që janë të përfshirë në dialog. Pse ju nuk e theksuat se nuk është problemi tek treni si mjet i udhëtarëve, por heshtët? Sepse trenat nga Serbia vijnë për çdo ditë dhe qarkullojnë pa kurrfarë problemi. Ky provokim nga Serbia nuk është i pari, këtë të gjithë e dimë, sepse për një kohë shumë të shkurtër kishim disa veprime e provokime nga Serbia. E kemi arrestimin e zotit Haradinaj, e kemi murin dhe tash trenin. Murin për të cilin e miratoi ky Kuvend një rezolutë me 29 dhjetor, ku një ndër pikat përmban edhe rrënimin e tij. Pra, është një ultimatim që deri në fund të këtij muaji ai mur të rrënohet, e jo siç po deklarohet këtu, ose më 1 shkurt, ose në Ditën e Pavarësisë. Pra, duhet t’i respektojmë të gjitha dokumentet që nxjerr ky Kuvend.

Por, t’i kthehem edhe një herë temës aktuale, të përfolur këtyre ditëve, trenit. T’u kthehemi edhe disa çështjeve tjera, si operatori i telefonisë së Serbisë, e që kjo situatë e la në harresë, “Elektroprivredën”. Këto të gjitha u harruan, sepse doli muri. E tash, murin e çoi në harresë treni. A do të harrohet tash edhe treni? A do të harrohen edhe fletarrestimet? A u harruan edhe strukturat paralele? Pse, nuk po thoni se ai tren nuk ishte tren i zakonshëm, por ishte një tren i mbështjellë me ikonografi nacionaliste, se problemi ishte te mesazhet, kërcënimet dhe te porosia që bartte me vete ai tren politik i udhëheqësve të Serbisë.

Pse nuk ishit në gjendje t’ia thoshit Serbisë, por edhe të tjerëve, se Kosova kësaj radhe duhej të reagonte, ose t’i humbiste të gjitha ato që i ka arritur pas luftës. Sepse ishte në pyetje Kosova dhe jo pozitat tuaja. Sepse, jo vetëm kjo situatë po e dëshmon atë që e thashë edhe në fillim, se politikanët e sotëm serbë vazhdojnë ta kuptojnë vetëm një gjuhë, gjuhën e forcës, dhe atë e dëshmuan me kërcënimet e bëra edhe me luftë që i bënë. Kjo është normale, që ata nuk e kuptojnë gjuhën e delegacionit tonë, sepse mirësia shkoi deri në përrulje, nga mirësia apo edhe nga nënshtrimi arritën edhe marrëveshje në dëm të shtetit tonë, përrulje e cila po dëmton edhe të ardhmen e qytetarëve tanë, e çka e ka dëmtuar edhe sovranitetin.

Atje ku është biseduar ekskluzivisht për çështje të brendshme të Kosovës, sepse ardhja e trenit e konfirmon këtë, sepse ai tren me vete mbartte edhe rezultatet e bisedimeve, por për të gjithë ju që vrapuat për ta marrë primatin se kush e dha urdhrin për ndalim, aman ju qoftë ndaluni, se na keni lodhur definitivisht, sepse në rast se nuk e keni ditur, janë institucionet dhe organet përgjegjëse të shtetit tonë që e kanë kryer vetëm një detyrë kushtetuese.

Por, këtë tren, mbi të gjitha, e ndali edhe presioni i qytetarëve.

Ajo që nuk shkon dhe që definitivisht na keni irrituar vazhdimisht është qasja juaj që ta personalizoni edhe obligimin kushtetues, pra mbrojtjen e sovranitetit të shtetit. Këtë e kemi obligim, edhe ju, edhe ne.

Pse edhe atëherë nuk e merrni përgjegjësinë dhe primatin që të jepni llogari. Pra, kur ne kërkojmë që ju të paraqisni dhe të raportoni për të gjitha proceset e dialogut me Serbinë? E kemi thënë dhe prapë po e themi: delegacioni ynë në këto bisedime ka shkuar i papërgatitur, ka shkuar pa asnjë agjendë. Pra, kanë shkuar me duar në xhepa, siç e kam thënë edhe më parë, dhe jo vetëm këta të tanishmit, por edhe ata që e kanë filluar këtë dialog.

Nga kjo situatë shpresojmë të kemi marrë një mësim të duhur të gjithë ne dhe t'i dalim zot vendit tonë, sepse me këto sjellje të Serbisë nuk mund të arrihet një qetësi dhe nuk mund edhe ne si Kuvend të jemi të qetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Kam dalë të flas për një çështje me interes të të gjithëve.

Kosova ka dhënë dëshmi se është për barazi të qytetarëve në shtetin e vet. Kosova e pranon se paqja dhe dialogu janë arma e komunikimit, përkatësisht mjeti për zgjidhjen e problemeve me fqinjët. Të drejtat e pakicave te ne janë zgjidhur me Kushtetutë si askund në asnjë shtet tjetër demokratik, madje garantimi i të drejtave të tyre para se Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës, shpeshherë shtetin tonë e bën të varur politikisht, ngase pakica serbe manipulohet politikisht dhe e pengon këtë, madje shpeshherë e bën edhe jofunksional, siç është rasti me formimin e Ushtrisë së Kosovës.

Por, nuk kam dalë këtu para jush për këtë çështje. Kam dalë të flas diçka tjetër, për funksionimin e Kuvendit, nevojat për konsensus nacional dhe për platformë nacionale. Kam dalë të flas për nevojën e dialogut tonë të brendshëm, domosdo ndërmjet pozitës dhe opozitës që na duhet të ekzistojë në çdo situatë, veçmas në këtë fazë të shtetësisë së Kosovës. Kjo e kërkon një

mirëkuptim të problemit dhe qasjes serioze, kërkon shumë dashuri ndaj vendit tonë për t'i kaluar ambiciet personale, grupe dhe ideologjike.

Gjuha parlamentare e Kuvendit të Kosovës nuk i ngjan gjuhës së të zgjedhurve të popullit. Është gjuhë fyese, jo vetëm për ata të cilëve u drejtohet, por edhe për ata që e thonë. Nuk është gjuhë jona, jashtë traditës sonë. Madje kjo gjuhë po përdoret edhe nga gratë parlamentare. Me këtë gjuhë, se ato lejuan, koleget e tyre u drejtohen grave parlamentare, bijave e nënave tona, sado që e dimë që gruaja në Kuvendin e Kosovës, edhe në këtë përqindje, është një e arritur e madhe. Kjo rrugë është trasuar me vështirësi e sakrificatë të gjeneratave dhe hap perspektivë të re jo vetëm të gruas, por edhe të shtetit tonë demokratik.

Kjo gjuhë jointelektuale po përcillet si model komunikimi edhe në familjet tona, në shkolla dhe në vende të punës. Ne jemi shembulli i keq, andaj propozoj, në cilësinë e Ambasadores së Paqes, ta ndryshojmë këtë gjuhë, të formojmë një grup joformal të deputetëve, të cilët do të merrnin iniciativën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Viti 2016 shënoi një kthesë të rëndësishme për vendin tonë në procesin e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian, kthesë që lidhet ngushtë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si një fazë e re kontraktuale në rrugëtimin e Republikës së Kosovës në procesin e integritit evropian.

Kuvendi ynë trajtohet në mënyrë të barabartë me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të këtij procesi.

Nga ajo kohë Qeveria dhe Kuvendi kanë miratuar dhe Planin për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Agjendën e reformave evropiane, dokumente këto që në përpikëri tregojnë veprimet që duhet ndërmarrë çdo institucion në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Me hartimin e planeve dhe agjendave, puna e bërë matet më shpejt dhe më mirë.

Kërkoj, si kryetare e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, që institucionet e vendit të mos neglizhojnë afatet e përmbushjes së detyrimeve nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, gjë që akoma duhet punë të përbashkët, sa i përket agjendës evropiane, pozitë dhe opozitë.

Kuvendi i Kosovës, si institucion i vetëm i zgjedhur me votën e qytetarëve të vendit, i cili e ka miratuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, në njërin nga seancat e tij, i bie pjesa për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, pra të Planit kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Agjendës së reformave evropiane.

Pra, edhe pse komisionet parlamentare kanë shënuar rritje në lidhje me raportimin e ministrave në komisionet gjegjëse, e kjo ishte një rezultat, numër i vogël sa i përket projektligjeve, por kjo nuk është arsye që ministrat gjegjëse sa i përket edhe raportimeve të Planit për Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të jenë më të përgjegjshëm dhe të vijnë në komisionet parlamentare dhe të informojnë deputetët, ne dhe të gjithë qytetarët sa i përket zbatimit të tij.

Megjithatë, besoj se komisionet parlamentare në vitin 2017 duhet t'i bashkërendojnë aktivitetet dhe të ftojnë më shpesh ministrat që të raportojnë në zbatimin e dispozitave të MSA-s, e njëkohësisht edhe të Agjendës së reformave evropiane, që së fundi është lansuar edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

E them këtë, sepse integritet evropian nuk janë vetëm detyrë e Komisionit Parlamentar për Integritet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës është shterur dhe kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Kjo pikë, siç e dini, zgjat 60 minuta. Sipas vendimeve të mëparshme, të paraqiturit që s'e kanë marrë fjalën sot, janë në radhë për të marrë fjalën në seancën e ardhshme.

Pra, po fillojmë. Janë 37 pyetje dhe nëse arrijmë për t'i kryer për 60 minuta, i kryejmë, e nëse jo, i lëmë për seancën e ardhshme.

Pyetja e parë është e deputetit Nezir Çoçaj për ministrin Ferat Shala. Zoti Çoçaj, mund ta merrni fjalën! Ministri s'është këtu.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra të kabinetit qeveritar,

Pyetja ime ka të bëjë me shfrytëzimin dhe eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në tërë territorin e Kosovës, që është shndërruar në një fenomen të zakonshëm dhe fatkeqësisht për çdo vit e më shumë po degradon lumenjtë tanë.

Për ta parandaluar këtë dukuri, në vitin 2011 Qeveria e Kosovës ka nxjerrë një vendim që e sanksionon këtë lloj degradimi në lumenjtë tanë.

Në këtë kontekst, një nga lumenjtë më të dëmtuar nga ky fenomen pa dyshim se është Drini i Bardhë, i gjatë 122 kilometra dhe ka një vend përcaktues në estetikën natyrore të Rrafshit të Dukagjinit dhe përveç rëndësisë gjeografike të tij, shkatërrimi i hovshëm i shtratit të lumit dhe devijimeve të tij po reflekton në ekosistemin përkatës, dëmtimin e tokave pjellore, furnizimin me ujë dhe rreziqet e vërshimeve.

Bazuar në raportet mbi gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës, dokumente këto që përgatiten dhe publikohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, krahasuar me vitin 2009, kur në Drinin e Bardhë ishin dëmtuar dhe degraduar 861 hektarë sipërfaqe, në vitin 2012 ky degradim është shtrirë edhe më shumë dhe ka kapluar 1 011 hektarë.

Zona më e degraduar e Drinit të Bardhë dhe që vazhdon të degradohet gjendet në sektorin që fillon nga Kramoviku, deri në fshatin Gjonaj, ndërsa në lumin Erenik pjesa më e dëmtuar është sektori që fillon prej fshatit Korenicë deri te Ura e Tabakëve.

Këto shifra janë alarmante nëse bazohemi në faktin se ky degradim vazhdimisht është duke u përhapur. Besoj se ministri apo kryeministri më dëgjon, pyetja ka të bëjë me sa vijon:

I nderuar ministër,

Cilat janë masat dhe veprimet aktuale që ka ndërmarrë ministria juaj dhe mekanizmat vartës të ministrisë suaj për të parandaluar këtë degradim të Drinit të Bardhë dhe kur pritet një vendim qeveritar të zbatohet dhe të gjitha ato subjekte...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë fjalën e ka deputeti Çoçaj, pyetje për ministrin Bajrami. Ministri Shala nuk është këtu.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Pyetja ka të bëjë me çerdhet publike në Kosovë. Shumë qytete të Kosovës nuk kanë çerdhe publike dhe detyrimisht numri i madh i fëmijëve edukohen nëpër institucione edukative private.

Në planin e Qeverisë është paraparë që në mungesë të objekteve, të bëhet shndërrimi i shtëpive private në institucione edukative. Kjo, zoti ministër, nuk ka ndodhur akoma.

Sa i përket çerdheve private, numri i madh i tyre janë të palicencuara dhe të paakredituara nga MASHT-i.

Nga vizita disa prej tyre në Prizren dhe nga takimet e tjera rezulton se numër i konsiderueshëm i stafit të çerdheve private nuk ka përgatitje profesionale të duhur dhe, më e rënda, nuk kanë as zhvillim profesional të nevojshëm. Ndërsa, përkushtimi i tyre për punë ishte jashtëzakonisht i madh dhe shprehnin interesim për të mbajtur trajnime të ndryshme që do të ndikonin në edukimin e mirëfilltë të fëmijëve.

I nderuar ministër, pyetja ime ka të bëjë me sa vijon:

-Kur do të filloni të mbani trajnime profesionale me edukatorët e çerdheve private, si dhe të shpërndani dokumentet dhe materialet e botuara na MASHT-i dhe institucionet relevante? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën për t'u përgjigjur.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar deputet Çoçaj,

Duke ju falënderuar për pyetjen e parashtruar, më lejoni të jap përgjigjen në pyetjen tuaj.

Gjithëpërfshirja në arsimin parafillor dhe arsimin parashkollor është një prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Arsimit dhe ky prioritet do të realizohet në tri segmente.

E para, duke rritur numrin e çerdheve publike;

E dyta, duke finalizuar kurrikulën për grupmoshat 0 deri 6;

Dhe, e treta, duke investuar në përgatitjen e mirë të edukatorëve apo mësimdhënësve për këtë moshë.

Pa dyshim se investimet në gjithëpërfshirje dhe fëmijët në moshë të hershme është një garanci për ndërtimin e cilësisë në sistemin arsimor, dhe më lejoni t'ju informoj se qysh tash Fakulteti i

Edukimit ka përfunduar kurrikulën për përgatitjen e edukatorëve për arsimin parafillor dhe parashkollor.

Ministria e Arsimit është duke finalizuar kurrikulën e re për nivelin 0 deri 6, dhe sivjet kemi ndarë fonde për ndërtimin e 15 çerdheve publike që pa dyshim do të mundësojë të kemi kapacitete sa më të mëdha për gjithëpërfshirje, në mënyrë që në fazë të mëvonshme, kur të krijojmë kapacitete, ndoshta ta bëjmë edhe të obligueshëm arsimin parafillor, sidomos për moshën 3 deri 6.

Sivjet Ministria e Arsimit ka arritur të licencojë më tepër se 60 çerdhe dhe jemi në proces të licencimit edhe të çerdheve të tjera, të cilat veprojnë akoma pa licencë. Departamentet përkatëse i kanë vizituar këto çerdhe, i kanë njoftuar me kushte dhe u kanë dhënë afat brenda të cilit duhet të marrin licencë dhe jemi plotësisht duke i monitoruar.

Gjithashtu, me ndihmën e Caritas-it zviceran kemi arritur t'i pajisim 150 çerdhe me përmbajtje të caktuara argëtuese dhe shkollore dhe po zhvillojmë një program të veçantë profesional të trajnimit të edukatorëve aktualë që janë në sistemin e çerdheve, por me Fakultetin e Edukimit po punojmë që ky program për mësimdhënës parafillorë dhe parashkollorë të përgatitë mësimdhënës të specializuar për nivelin parafillor dhe parashkollor, në mënyrë që edukimi bazik të merret në këtë moshë, sepse siç do të diskutojmë gjatë ditës, do të shohim se është shumë i rëndësishëm ky nivel i edukimit, sepse fëmijët tanë në moshë të hershme duhet të kenë edukim minimal dhe pastaj të ndërtojnë karrierën në arsimin parauniversitar dhe pa dyshim se investimet në këtë fazë janë shumë të rëndësishme dhe ky është një prioritet edhe me Strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Çoçaj?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Pjesa e dytë e pyetjes ka të bëjë me shpërndarjen e dokumenteve dhe materialeve që janë botuar nga MASHT-i dhe organizatat e tjera relevante.

Kur do të shpërndahen këto materiale që do të ndikojnë shumë në përgatitjen profesionale të vetë edukatorëve që janë në proces?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Të nderuar deputetë,

Ato materiale tanimë janë në të gjitha çerdhet e licencuara. Ne e kemi vendosur një kontroll të plotë të gjendjes në çerdhe dhe pothuaj se Departamenti për Arsimin Parafillor është plotësisht

në kontakt. Pra, janë shpërndarë këto materiale, por për ne prioritet shumë me rëndësi është që gjatë këtij viti të përfundojë tërësisht kurrikula, që të jemi të vetëdijshëm se çfarë edukimi duhet t'u ofrojmë fëmijëve në këtë moshë të hershme, gjithmonë duke pasur parasysh moshën e tyre, duke pasur parasysh se në këtë moshë më shumë përmbajtja arsimore duhet të jetë argëtuese se sa ndonjë ngarkesë teorike.

Prandaj, ju garantoj dhe siguroj se në Ministrinë e Arsimit po punohet shumë seriozisht që vërtet të kemi standarde sa më të larta në këtë fazë të hershme të edukimit në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Ministri s'është këtu. A dëshironi të bëni pyetjen?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe pse ministri nuk është i pranishëm, kemi të bëjmë me një pyetje parlamentare që daton që nga shtatori dhe nuk ka gjetur hapësirë dhe kohë për t'u përgjigjur. Unë po e parashtoj pyetjen dhe shpresoj që ministri është marrë me këtë çështje, që ka të bëjë me interesin e qytetarëve dhe të një bashkëpunimi të proklamuar ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Çështja ka të bëjë që Qeveria e Kosovës dhe Doganat e Kosovës kanë bërë marrëveshje bashkëpunimi me Qeverinë e Shqipërisë dhe Doganat e Shqipërisë për tregti të lirë dhe lehtësi doganore.

Ka pasur disa paraqitje publike dhe proklamime sa u përket marrëveshjeve me Republikën e Shqipërisë, por përkundër kësaj, qytetarët tanë, të cilët kalojnë transit nëpër Republikën e Shqipërisë me mall apo automjete që kanë për ta zhdoganuar në Republikën e Kosovës detyrohen të paguajnë për kalim transit nëpër Shqipëri shpedicionin dhe skanerin.

Qytetarët tanë paguajnë për skaner në doganë 5 euro për mall në vlerën prej 1 000 euro dhe 22 euro për mall në vlerën mbi 1 000 euro, shërbim të cilin e paguajnë, por nuk e marrin. Në fakt, është vetëm si gjobë për qytetarët tanë.

Gjithashtu, në pagesën e transitit dhe shpedicionit qytetarëve tanë u vështirësohet kalimi nëpër Shqipëri në raport me vendet e tjera fqinja, kur destinacioni i mallit për zhdoganim është Kosova.

Prandaj, i nderuar ministër, pyetja është si vijon: A mund të na sqaroni përse qytetarët tanë duhet ta paguajnë transitin, shpedicionin dhe skanerin në Shqipëri, kur malli ka për destinacion Kosovën dhe janë bërë aq shumë proklamime sa u përket lehtësive ndërmjet dy qeverive tona dhe Doganave të Kosovës e Doganave të Shqipërisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, prapë pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Zoti Rrahmani s'është këtu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe kjo pyetje daton gjithashtu nga muaji shtator për ministrin Rrahmani, por nga atëherë ministri nuk ka gjetur kohë që t'i përgjigjet kësaj pyetje dhe sigurisht që edhe vetë ai i ka ngritur duart e tij nga Shëndetësia, sepse nuk është duke u marrë me të, prandaj edhe gjendja është e tillë në shëndetësinë e Kosovës.

Një pyetje i drejtohet ministrit Rrahmani: Gjendja në Shëndetësinë e Kosovës vazhdon të jetë e rënduar, përveç mungesave të furnizimeve me barëra, tani janë paraqitur mungesa në furnizimet me ushqim. Deri më tani ka pasur vështirësi me barëra, por falë ndërhyrjes së ministrit, meqë i është marrë buxheti Qendrës Klinike Universitare dhe spitaleve rajonale, tani pacientët dhe spitalet kanë vështirësi që të furnizojnë pacientët edhe me ushqim. Me keq nuk ka se ku shkon!

Prandaj, e pyes zotin Rrahmani se me projektbuxhetin e vitit 2016 dhe me atë të vitit 2017 tani ia ka marrë buxhetin SHSKUK-së dhe e ka kaluar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe AFSH-së, dhe e pyes për këto mungesa në barëra dhe ushqime se sa e ndien veten përgjegjës dhe duke e ndier veten përgjegjës sigurisht që as nuk mund të vijë që të paraqitet në Kuvendin e Republikës së Kosovës para qytetarëve dhe deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Këtë pyetje e kam parashtruar më 31 tetor 2016, dhe nuk e kuptoj se si ende nuk kemi përgjigje sa i përket të njëjtës.

Më 10 tetor 2016, si dhe më 21 tetor 2016, pra brenda 10 ditëve si pasojë e aksidenteve në rrugën magjistrale Prishtinë - Pejë, më saktësisht në pjesën mes fshatrave Miradi e Ulët dhe Vragoli të Fushë-Kosovës e kanë humbur jetën dy persona si pasojë e plagëve të marra nga shtypja me makinë, njëra 15 vjeçe dhe tjetra 62. Në këtë pjesë të rrugës gjendet stacioni i autobusëve dhe banorët për t'u kthyer në fshat janë të detyruar që ta kalojnë rrugën përmes veturave. Nuk ka mbikalim, as nënkallim, e as ndonjë semafor që qytetarëve t'ua mundësojë ta kalojnë rrugën lirshëm.

Prej se është lëshuar rruga në qarkullim, sipas banorëve të atjeshëm, 10 persona e kanë humbur jetën si pasojë e shtypjes nga makinat. Dhe, pyetja ime është: A jeni të informuar për gjendjen e sigurisë në këtë rrugë, e cila kalon nëpërmes një zone të banuar dhe çka ka ndërmarrë Ministria juaj në lidhje me këtë?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Haxhiu,

Më 4 nëntor 2016, Ministria e Infrastrukturës e ka pranuar një kërkesë nga Komuna e Fushë-Kosovës për ofrimin e një zgjidhjeje për banorët e fshatit Vragoli. Me ta marrë kërkesën, zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës janë takuar me kryetarin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës, e pas takimit së bashku e kemi vizituar edhe lokacionin në fshatin Vragoli.

Ministria e Infrastrukturës edhe më herët ka qenë e gatshme të vendosë një semaforë vetëm për këmbësorë, mirëpo kërkesat e banorëve të fshatit Vragoli dhe të komunës së Fushë Kosovës janë që semaforët të mos vendosen vetëm për kalim të këmbësorëve, por edhe për automjete.

Andaj, duke e marrë parasysh kërkesën e Komunës së Fushë-Kosovës, Ministria e Infrastrukturës e ka formuar një komision, i cili në bashkëpunim me zyrtarët e Komunës do të ofrojë një zgjidhje për banorët e fshatit Vragoli, mirëpo zgjidhja e ofruar duhet të shqyrtohet apo të analizohet thellë, meqenëse kemi të bëjmë me rrugë nacionale dhe të mos ofrohet zgjidhje, në njërin anë, ndërsa, në anën tjetër, anë të krijohet një pikë e zezë apo vend për aksidente eventuale, duke e marrë parasysh se numrin e madh të automjeteve që qarkullojnë në këtë aks rrugor, që sipas numërimit të trafikut është 41 500 automjete brenda 24 orëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Zoti ministër, a keni ndonjë plan të qartë, të detajuar se kur do të përfundojë kjo zgjidhje, për faktin se siç po deklaroni ju, por edhe siç i kemi dëgjuar edhe banorët, mund të vdesin edhe shumë qytetarë të tjerë, në ndërkohë ju do të mbeteni nëpër takime duke diskutuar, qoftë me nivelin lokal, qoftë me nivelin qendror.

Pra, e di që po ju qeshet, por s'është për t'u qeshur për shkak se qytetarët po vdesin, janë 10 që kanë vdekur vetëm për një periudhë tepër të shkurtër. Pra, po më intereson të di nëse ka një afat kohor se kur do të bëhet zgjidhja për ata qytetarë të Republikës?

KRYESUESI: Në rregull, atëherë! Ministri nuk ka përgjigje. Deputetja Luljeta Veselaj-Gutja, pyetje për ministrin Avdullah Hoti. Ministri s'është këtu!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit!

Ministri nuk është këtu, por unë pyetjen e kam proceduar më 1. 11. 2016 dhe do ta lexoj.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, neni 6 - beneficionet e veçanta, paragrafi 4 - lirim nga tatimi në pronë, i cili është e drejtë ta realizojnë familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civilë të luftës, familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike, pyetja konkrete për ministrin është:

Pse nuk po zbatohet Ligji për lirim nga tatimi në pronë për kategoritë e lartcekura sipas nenit 6, paragrafi 4, respektivisht për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Abrashi. Ministri s'qenka këtu! Zoti Ymeri dëshironi ta bëni pyetjen? Zoti Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pozita sociale e pensionistëve aktualë të Kosovës nuk është e kënaqshme përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të Qeverisë së Kosovës që nëpërmjet reformës dhe skemës së re pensionale t'ua përmirësojë gjendjen duke i ngritur pensionet, ngritje e cila nuk është e mjaftueshme, sepse nuk i përmbush kërkesat dhe nevojat elementare të pensionistëve, sidomos të atyre familjeve që e kanë burim të vetëm pensionin e pensionistit.

Mirëpo, politika sociale është e varur nga zhvillimi ekonomik më i hovshëm i vendit, prandaj kërkohet një strategji zhvillimore për një zhvillim të harmonizuar ekonomiko-social, sepse problemet sociale janë pengesë e zhvillimit në përgjithësi. Në bazë të Ligjit për skema sociale të financuar nga shteti, dhe nenit 16, ministri merr vendim për ndalesa të pensioneve të familjarëve të dëshmorëve dhe martirëve dhe kategorive të tjera, të cilët kanë marrë dy lloj pensionesh: pensionistët kontributdhënës apo pensionistët përfitues të pensioneve të pleqërisë i marrin këto pensione si rezultat i kontributit dhe si e drejtë që fitojnë me këtë ligj, kurse pensionet tjera për djalin dëshmor apo martir, për vajzën dëshmore apo martire, e marrin si të drejtë që u takon sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjet e tyre.

Pyetja ime ka të bëjë me këtë: Kur mund ta sjellë ministri këtë ligj për ndryshim apo plotësim në mënyrë që të gjejmë një formë adekuate që këto pensione të mos u ndalen këtyre familjeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kimete Bytyqi, pyetje për ministrin Bajrami. Zonja Bytyqi, e keni fjalën.

KYMETE BYTYQI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Studentët nga Kosova që i kanë përfunduar studimet në Universitetin privat në Shqipëri dhe jo vetëm, ende të posadiplomuarit përballen me vështirësitë e nostrifikimit të diplomave në vendin tonë. Atëherë, zoti ministër, ju keni theksuar se e keni nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për njohjen reciproke dhe të nostrifikimit të këtyre diplomave, çka keni ndërmarrë konkretisht duke pas parasysh se na vijnë ankesa për mosnostrifikimin e këtyre diplomave.

KRYESUESI: Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Bytyqi,

Më lejoni të ju informoj që pas 10 vjetëve ne kemi filluar pranimin e kërkesave për njohje dhe nostrifikim të diplomave të arritura në institucionet private të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ne e kemi një marrëveshje ndërshtetërore të nënshkruar me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë dhe pastaj mbi bazën e asaj marrëveshjeje unë kam sjellë udhëzimin administrativ, i cili ka bërë të mundshëm aplikimin për herë të parë pas dhjetë vjetëve të studentëve kosovarë që i kanë përfunduar studimet në të gjitha nivelet. Më lejoni të ju informoj se ne e kemi caktuar një bazë të mirë ndërshtetërore se si do të jenë diplomat në mënyrë reciproke dhe kjo njohje bazohet në parimin cilado diplomë e arsimit të lartë që njihet nga autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë është valide dhe njihet edhe në Kosovë dhe anasjelltas.

Ky është parimi që ne kemi përcaktuar dhe më lejoni të ju njoftoj se nga momenti kur unë e kam sjellë udhëzimin administrativ kemi marrë më shumë se 500 aplikacione të studentëve tanë që kryesisht i kanë përfunduar studimet në universitetet private, ato të gjitha janë trajtuar dhe mund të themi se tani i kemi diplomat e para në të gjitha nivelet, nivelin e doktoraturës, të studimeve master të njohura, të nostrifikuara, asnjë kërkesë që vjen në Ministri të Arsimit nuk pret, ato procedohen sipas rregullave ndërkombëtare të zyrës "NARIC", ato dërgohen menjëherë tek institucioni përkatës i arsimit të lartë, zhvillohen procedurat dhe në momentin e zhvillimit të procedurave ne bëjmë njohjen, ekuivalencën dhe nostrifikimin e diplomave.

Tani, e nderuar deputete, siç e dini problemi pak është vështirësuar, sepse në Republikën e Shqipërisë kryeministri Edi Rama ka mbyllur më shumë se 18 institucione private të arsimit të lartë, ku kryesisht kanë gravituar studentë shqiptarë dhe kjo pak e ka vështirësuar edhe punën

tonë, por edhe procedurat tona, por ju siguroj që në këtë drejtim ne nuk do të vendosim asnjë pengesë, do të marrim në miratim dhe aprovim cilindo diplomë, e cila siç thashë njihet nga autoriteti, e kemi një bashkëpunim në baza ditore me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, kemi kontakte ditore dhe jemi vërtet duke zhvilluar të gjitha procedurat dhe mund të them që asnjë kërkesë nuk do të presë në momentin kur kryhen të gjitha procedurat e parapara për njohje, ekuivalencë dhe nostrifikim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shtesë, zonja Bytyqi? Po! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

KYMETE BYTYQI: Atëherë, zoti ministër, a keni ndonjë afat të precizuar, a është gjashtë muaj apo një vit, dy vjet? Ju keni thënë më herët se brenda një muaji do ta marrim një udhëzim administrativ dhe në bazë të atij udhëzimi administrativ do të bëhet njohja e këtyre nostrifikimeve të atyre diplomave të studentëve tanë që i kanë kryer pra studimet jashtë vendit.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete, më shumë se gjashtë muaj ka kur udhëzimi administrativ ka hyrë në fuqi dhe ju mund ta shihni edhe në ueb-faqen e ministrisë dhe mbi bazën e udhëzimit administrativ kemi filluar që t'i marrim aplikacionet.

Kemi marrë më shumë se 500 aplikacione, tani ky proces nuk zhvillohet për fushatën, ky proces duhet të jetë i rregullt dhe ne duhet t'i respektojmë të gjitha procedurat. Ju siguroj se nuk ka asnjë ngecje nga Ministria e Arsimit, ngecje kemi kryesisht në kthimin e përgjigjeve. Ta keni parasysh se për çdo gradë që fitohet në Shqipëri ne duhet të marrim konfirmimin e institucionit që e ka dhënë atë, duhet të marrim patjetër edhe konfirmimin e agjencisë përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe në momentin kur kompletohet lënda, pra nuk është fjala një muaj, në momentin kur kompletohet lënda, ne pa shtyrje e zgjedhim atë lëndë, sepse nga 2 mijë lëndë kemi arritur ta zvogëlojmë numrin në vetëm 500 lëndë në këto dy vjetët e fundit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Lahi Brahimaj, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit!

Pyetja është për ministrin e Transportit, për urën e Rakovinës. Kjo pyetje është bërë më 10 nëntor, gati se edhe i ka skaduar afati, por po e prek në pika të shkurtra.

Këtë urë, ministër e keni ndaluar njëherë për transport, tokat janë dëmtuar, aty më nuk është duke u punuar, çka keni bërë në këtë drejtim?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

Deputet Brahimaj,

Ministria e Infrastrukturës, siç e dini, në qershor 2015 e ka përfunduar sanimin e urës sipas projektit të hartuar më herët. Me këtë rast është bërë sanimi i tri shtyllave të mesit...

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, ju kisha lutur ose uluni në seancë, ose rrini, ose nëse keni biseda dilni jashtë salle!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Sanimi i themeleve të këtyre shtyllave është bërë me pilot të tipit...

Në themelet e shtyllave të parë dhe tretë janë injektuar nga dhjetë pilotë, ndërsa në themelin e shtyllës së dytë janë injektuar 24 pilotë. Gjatë reshjeve të pandërprera të shiut që ndodhën në nëntor të vitit të kaluar, niveli i ujit në lumin Drin u ngrit në mënyrë të konsiderueshme dhe erdhi deri te gërryerja e shtratit të lumit. Gjithashtu, rrjedhja e lumit e ka ndërruar kahun dhe ka bërë gërryerjen nën fundamentin e shtyllës së parë dhe pjesërisht edhe në shtyllat dytë dhe të tretë. Duhet të theksohet se me projektin e sanimit nuk është përfshirë rregullimi dhe mbrojtja e brigjeve të lumit dhe rregullimi i shtratit të lumit para dhe pas lumit për shkak se janë kompetencë e Ministrisë së Ambientit.

Ministria e Infrastrukturës e ka përcjellë rregullisht gjendjen e urës së Rakovinës para dhe pas vërshimeve të nëntorit 2016. Për këtë qëllim është caktuar një komision profesional për të dhënë një zgjidhje teknike, për ta sanuar urën e cila edhe e ka propozuar zgjidhjen teknike, megjithatë për shkak të kushteve atmosferike dhe procedurave të prokurimit nuk ka mundur të realizohet propozimi në tërësi, por Ministria e Infrastrukturës e ka caktuar një menaxher përgjegjës për ta përcjellë gjendjen e ujit, gjendjen e urës dhe marrjen e aktiviteteve të domosdoshme për mbrojtjen e themeleve të shtyllës së parë dhe të dytë nëpërmjet operatorit të mirëmbajtjes regjionale të Gjakovës.

Aktivitetet që janë ndërmarrë janë në rend të parë vendosja e materialit guror përreth fundamentit të shtyllës së dytë, me qëllim të parandalimit të gërryerjes së shtratit të lumit dhe përreth fundamentit të kësaj shtylle që e keni parë të gjithë, si dhe pastrimi apo largimi i materialeve të ndryshme përreth shtyllës së dytë. Përcjellja e gjendjes së urës bëhet në baza ditore, nga menaxheri i caktuar i MI-së kurse sanimi i plotë i mbrojtjes së fundamenteve të urës dhe shtratit të lumit para dhe pas urës do të bëhet pas sezonit dimëror, gjegjësisht në pranverë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. Asnjëri s'janë këtu.

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Lutfi Zharku, ka dy pyetje besoj që është e gatshme, të dy janë këtu. Zonja Haxhiu, e keni fjalën. Regjia, fjalën zonjës Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Ne jemi të gatshëm, por gatishmëria juaj nuk ka qenë. Pyetjet janë bërë në nëntor dhe ju nuk na keni lejuar që t'i bëjmë pyetjet, pikërisht ju. Pra, unë kam dy pyetje për ministrin Zharku, njëra ka të bëjë me rrugën që lidh fshatrat Smolicë-Berjah-Nivokaz, dhe lidh Junikut, pra komunën e Gjakovës dhe komunën e Junikut, në fakt kjo pyetje është bërë në muajin nëntor megjithatë pyetja ka qenë se çka ju si ministri keni planifikuar, a keni planifikuar mjete për këtë rrugë. E kemi parë në buxhet që nuk ka mjete dhe ju nuk keni planifikuar, pra për këtë rrugë duke e ditur edhe rëndësinë e kësaj rruge, por në fakt sot çka u thoni ju ministër banorëve të kësaj ane duke e ditur rëndësinë e kësaj rruge, pra sipas rëndësisë së saj kjo rrugë ndoshta ishte dashur të shtrohet në mermer e jo në asfalt, por edhe 18 vjet pas luftës nuk keni paraparë asnjë cent as në këtë vit, as vitin tjetër, tek në vitin 2019 një shumë simbolike.

Çka u thoni pra ju sot banorëve të anës së Rekës së Keqe?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

E nderuar deputete Haxhiu,

Me rishikimin e buxhetit të vitit 2016, në tabelën 3. 2. të buxhetit ka hyrë edhe projekti i ndërtimit të rrugës Junik-Nivokaz. Projekti i rrugës kalon nëpër fshatrat që i përmendët Berjah deri në fshatin Smolicë, Ministria e Infrastrukturës e ka pranuar projektin nga Komuna e Junikut më 9 gusht të vitit 2016, mirëpo projekti i dorëzuar nga Komuna e Junikut nuk ka qenë i kompletuar dhe nuk i ka përmbajtur të dhënat e nevojshme për tenderim dhe i njëjti është kthyer për plotësim te kompania projektuese dhe pas plotësimit të projektit Ministria e Infrastrukturës i ka iniciuar procedurat e prokurimit, publikimi nga Ministria e Infrastrukturës është bërë më 21 nëntor, kurse hapja e ofertave është bërë më 26 dhjetor dhe tash jemi në procedurën e vlerësimit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Haxhiu, keni pyetje shtesë? Fjalën zonjës Haxhiu, regjia!

TEUTA HAXHIU: Po, ministër. Tani është diçka tjetër, Komuna e Gjakovës, komuniteti i asaj ane ka dorëzuar një projekt, njëherë komuniteti, njëherë nga Komuna e Gjakovës.

Tani ju e keni ndarë një shumë simbolike 50 mijë euro për Komunën e Junikut, por jo për projektin për të cilin unë po flas. Pra, ky projekt është planifikuar tek më 2019 me buxhetin që kaloi pra në muajin dhjetor, një shumë simbolike. Tani po flasim për dy projekte, në këtë rast lidhet Komuna e Junikut me Komunën e Gjakovës, por projekti është tjetër, në Komunën e Junikut ju keni qit 50 mijë euro që është një shumë simbolike. A keni diçka konkretisht për projektin, pra që është i dërguar nga Komuna e Gjakovës kohë më parë dhe komuniteti i Rekës së Keqe, që fillon pra nga Smolica deri në Nivokaz.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: E nderuar deputete,
Sipas informatave që unë kam, projekti Junik-Nivokaz kalon nëpër Berjah, deri në fshatin Smolicë, që domethënë është i përfshirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Keni një pyetje të dytë, zonja deputete Haxhiu, prapë për ministrin Zharku.

TEUTA HAXHIU: Nejse, ministër megjithatë Nivokaz-Junik është një distancë shumë e shkurtër, kurse fshatrat tjera janë krejt diku tjetër, por megjithatë edhe pse nuk jeni i asaj ane mirë është t'i dini, pra të paktën kur ju vjen një projekt se cilat janë ato fshatra.

Tani unë e kam një pyetje tjetër, çështja është rruga kryesore në fshatin Demjan, fshati më i madh i Komunës së Gjakovës me rreth 6 mijë banorë, që është arteria kryesore e lidhjes së fshatit me lagjet: Shehu, Maroshi, Muhadër, Pnish, Ramahmat. Ekziston një marrëveshje mes të ministrisë dhe Komunës së Gjakovës për bashkëfinancim pra të kësaj rruge. A jeni në dijeni pra ju ministër nëse vazhdon të zbatohet kjo marrëveshje dhe deri ku kanë shkuar punimet për këtë rrugë?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Zharku, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Nënkyetar,
Ministra, deputetë të nderuar,
Deputete Haxhiu,
Sa i përket asaj vërejtjes besoj se mundohem t'i di krejt fshatrat e Kosovës edhe pse është e pamundur, por besoj që do të bëjë përpjekje që t'i di të gjitha rrugët.

Ministria e Infrastrukturës gjatë këtij viti e ka realizuar projektin e asfaltimit të rrugës në fshatin Demjan 3, lagjja Shehu vlera e projektit ka qenë 148 mijë e 730 euro, kurse në gjatësi prej 1.9 km, kurse projekti siç e dini është realizuar në tërësi. Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Gjakovës, më 8 qershor e kanë nënshkruar memorandumimin për financimin e projektit asfaltimi i rrugës në fshatin Demjan-Marosh Dedaj, kjo rrugë kalon në lagjet Maroshi dhe Muhadër.

Procedurat e prokurimit për këtë projekt i ka kryer Komuna e Gjakovës qysh në vitin 2013, gjatë po besojë sa ka qenë kryetar deputeti Lekaj, ndërsa Ministria e Infrastrukturës sipas memorandumit të cekur më lartë do të mbështetë Komunën e Gjakovës me mjete financiare në vlerë prej 850 mijë euro, duke filluar nga viti 2016 që e kemi deri në vitin 2018. Në buxhetin e vitit 2017, Ministria e Infrastrukturës e ka të përfshirë projektin Demjan-Pnish, dhe kur përfshihet edhe lagjja Rahmahmat në vlerë prej 400 mijë euro.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

TEUTA HAXHIU: Ministër, nga informatat që i kam nga banorët e asaj ane, kjo rrugë domethënë ka filluar, punimet janë ndërprerë dhe ka ardhur në një gjendje shumë më të keqe se sa kur kanë filluar punimet. Gjendja i është vështirësuar jo vetëm banorëve, por nxënësve të 4 shkollave që gravitojnë në atë anë. Pra, do të rifillojnë punimet, meqë tash jemi edhe në dimër dhe kur do të rifillojnë, sepse marrëveshja është arritur, siç e përmendët, në vitin 2016. Ju e keni, në fakt ministria, ajo marrëveshje pra bashkë me komunën e Gjakovës e ka përkeqësuar gjendjen shumë më keq, se sa para se të fillojë germimi, ose fillimi i punimeve. A do të fillojë, a do të rifillojë dhe kur?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: E nderuar deputete, Në parim me memorandumet e mirëkuptimit të gjitha përgjegjësitë sa i përket zbatimit të projektit, procedurat e tenderimit e të gjitha të tjerat i marrin komunat. Ne vetëm emërojmë një zyrtar mbikëqyrës apo monitorues projektesh, që fillimi i punimeve, përfundimi, e tjera... varen nga komuna e Gjakovës, jo nga ministria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Fikrim Damka, pyetje për ministrin Kujtim Shala. Zoti Damka, e keni fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Restaurimi i kalasë e cila gjendet në Prizren ende vazhdon. Në bazë të dëshmive të vjetra është vërejtur se ka mangësi brenda kalasë. Në këtë kuadër qytetarët e Prizrenit duke organizuar një petition e duke mbledhur të gjitha provat me shkrim dhe vizuale në këtë. Kanë kërkuar që ky projekt të realizohet në bazë të dëshmive të vjetra nga ana e Ministrisë së Kulturës.

Kërkohet që në kalanë e Prizrenit, xhamia dhe Sahatkulla të përdoret vetëm si një simbol i strukturës kulturore. Pyetja konkrete: Para fillimit të këtij projekti a e keni ditur që përpara në Kalanë e Prizrenit ka ekzistuar xhamia dhe Sahatkulla? Cila është arsyeja që pengon ndërtimin e xhamisë dhe Sahatkullës në Kalanë e Prizrenit?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar deputet,

Përpos këtyre, ka edhe evidenca për një kishë, por ju duhet ta keni parasysh që kalaja e Prizrenit përpos një aset nën mbrojtje, është dhe lokalitet arkeologjik dhe trajtohet plotësisht ndryshe.

E dyta, Ministria e Kulturës nuk harton projekte të asaj natyre, por institucionet publike nacionale të cilat janë të specializuara. E treta, s'mund të bëhet projekt total për lokalitetet arkeologjike, sepse këto bëhen faza-faza, varësisht se si ecin gërmimet me karakter arkeologjik, që do të thotë me karakter të studimit.

Deri më tani janë zhvilluar dy faza. E para, në bazë të një vendimi të vitit 2013, ndërkaq e dyta në bazë të një vendimi të vitit 2014. Nëse është e nevojshme, unë mund të specifikoj punimet që nënkuptojnë këto faza. Nëse ju do ta kërkonit si shtesë, ndërkaq për problemin që po ngrini specifikisht, Ministria e Kulturës ka marrë edhe një shkresë nga Bashkësia Islame dhe ne i kemi kthyer përgjigje me datë 12 maj 2016. Domethënë, kemi shpjeguar procedurën dhe procedura është kjo. Domethënë, në përputhje me Ligjin për qendrën historike të Prizrenit, çdo kërkesë duhet t'i adresohet Qendrës Rajonale të Trashëgimisë në Prizren dhe pastaj Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, gjegjësisht komisionit që shqyrton dhe vlerëson projektet. Përtej kësaj..., do të thotë kjo është një procedurë ligjore, standarde që rregullohet me ligj dhe përtej kësaj çdo aktivitet tjetër, sidomos aktivitetet e natyrës politike janë plotësisht të panevojshme. Kjo është çështje ligjore dhe profesionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Damka?

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, nënkryetar!

Zot ministër,

Nuk ka asnjë dëshmi, që figuron atje që ka pasur ndonjë kishë, po dëshmitë i keni themelet atje të xhamisë, e cila është edhe me dimensionet 9 metra edhe me 7 metra e 25 centimetra, ashtu që dëshmia për xhami ekziston prej viteve e viteve, edhe në fotografi i keni edhe dëshmitë e themeleve. Ju po thoni që aty nuk do të ndërtohet diçka tjetër rast arkeologjik, po aty është ndërtuar disa ndërtesa, të cilat deri tani nuk kanë ekzistuar brenda kalasë. Edhe ato e prishin edhe pamjen e kalasë edhe pamjen arkeologjike.

Në një anë nuk figurojnë dhe nuk e jepni pëlqimin për ndërtimin e një xhamie, e cila po thoni se nuk është arkeologjike, e në anën tjetër po ndërtoni ndërtesa të cilat nuk kanë qenë e as nuk kanë figuruar në atë kala.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Jo, ndërtesa ka qenë aty, është ndërtesa e administratës osmane, është ribërë në ato parametra, por ju duhet të keni parasysh, në lokalitetet arkeologjike lejohet ndërtimi i vizitatoriumeve dhe i muzeve si ky, sepse ky s'është objekt administrate, është kryer në një muze për ekspozimin e gjetjeve që do të bëhen në lokalitetin arkeologjik, ndërkaq pas legjislacionit të Kosovës dhe të konventave ndërkombëtare në lokalitete arkeologjike nuk lejohet ndërtimi i objekteve religjioze. Do të thotë, kisha... ka evidenca edhe për atë, kisha e xhamia janë të një kategorie, ndërkaq Sahatkulla është e një kategorie tjetër. Po, për të gjitha këto, së pari duhet të bëhen studime, duhet të kryhen gërmimet arkeologjike dhe pastaj në bazë të rezultateve të këtyre mund të bëhen kërkesa shtesë dhe të shqyrtohen. Do të thotë, në këtë fazë ka një vendim për fazën e dytë të punimeve në bazë të një projekti të plotë dhe s'mund të ndërhyhet, duhet të finalizohet, ky do të finalizohet deri në pranverë, pastaj do të kalojmë tek faza e tretë dhe do të shohim, se çfarë mund të përfshihet dhe çfarë jo, gjithmonë në bazë të Ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Thënë të drejtën, unë pyetjet parlamentare që i kisha parashtruar për ministrin kanë qenë në tetor dhe unë i kam bartur seancë pas seance, kështu që konsideroj se tashmë u ka humbur aktualiteti. Në një nga pyetjet parlamentare që kisha për ministrin Hyseni ka qenë, se kur do të pajiset Policia e Republikës së Kosovës me helikopterë, duke pasur parasysh që Policia e Republikës së Kosovës ka të gjitha kapacitetet dhe të drejtat për tu pajisur me helikopter.

Këtë pyetje e kam bërë në tetor, do të thotë më 10 tetor, për shkak se kam dashur që t'i paraprij shqyrtimit të buxhetit, ose projektbuxhetit, për vitin 2017 dhe konsideroj, se meqë tashmë veç ka kaluar buxheti për vitin 2017 nuk di sa do të jetë relevante. Ndoshta, e vetmja arsye pse mund të flasim sot për këtë pyetje, është për shkak se tashmë po dihet qartë nevoja e domosdoshme që Policia e Republikës së Kosovës të pajiset me helikopterë.

Prandaj, nëse ministri ka përgjigje për këtë pyetje, unë do ta falënderoja. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Zonja deputete Musliu, faleminderit për pyetjen!

Përgjigja do të ishte e njëjtë edhe në tetor, siç është sot. Kryeministri në konsultim me ministrat përkatës të resorëve të sigurisë, tashmë ka krijuar një grup i cili është duke ndërtuar elaboratin

për pajisje jo vetëm të Policisë së Kosovës, por edhe të institucioneve tjera me helikopterë është e domosdoshme. Prandaj, do të gjenden edhe financat edhe buxheti edhe do të kryhet kjo punë brenda një afati sa më të shkurtër. Jemi duke punuar shumë seriozisht, që kjo të kryhet sa më shpejt.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti ministër!

Unë konsideroj që edhe pse kanë kaluar ndoshta, afatet e rregullta të ndarjes, ose të planifikimit të buxhetit, unë si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës konsideroj se edhe kolegët tjerë deputetë, çdo nismë që do të vijë ose çdo propozim që do të vijë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për pajisjen e Policisë së Kosovës me helikopterë dhe pajisje të tjera të nevojshme për të kryer punët e tyre, ne do t'i mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Natyrisht, se e vlerësoj shumë këtë përkushtim dhe përkrahje. Ju siguroj, zonja deputete, edhe juve edhe të gjithë deputetët tjerë, që ka forma alternative të hulumtimit dhe gjetjes së financave, prandaj kjo punë nuk do të mbetet pa u kryer për shkak të financave.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Edhe unë këtë pyetje ia kam drejtuar kryeministrin në tetor, kështu që këto pyetje që i shkruajmë tash, po më duket se do të mbesin për legjislacionin e ardhshëm.

Zoti kryeministër,

Qeveria e Republikës së Kosovës më 19 dhjetor të vitit 2014 i pati propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë Projektligjin që ka të bëjë me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Në maj të vitit 2015, kur Projektligji duhej të kalonte në leximin e dytë, në emër të Qeverisë, zëvendëskryeministri i atëhershëm, zoti Shala e tërhoqi projektligjin me arsyetimin, se duhet të bëhet një korrigjim i vogël në pastrim të shpejt dhe pastaj shpejt do të kthehet në Kuvend.

Dihet se Komisioni për Mandate gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ka vlerësuar se është e nevojshme të bëhet kufizimi shtesë për zyrtarët e lartë. Lidhur me këtë komisioni vendosi, që zyrtarëve të lartë tu ndalohej ushtrimi i më shumë se një funksioni.

Pyetja ka qenë, zoti kryeministër, pse e tërhoqët ligjin, pse po e vononi kthimin dhe kur do të kthehet ky projektligj në Kuvend për miratim, kurse arsyeja dihet, sepse shumica jush i keni nga dy-tre vende të punës dhe është konflikt i madh i interesit, me kryeministrin, me ministrat dhe me ata që janë të zotët t'i mbajnë edhe nga pesë vende të punës, derisa në Kosovë papunësia është problemi kryesor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ISMAJL KURTESHI: Këtë pyetje ia kam drejtuar ministrit më 1 nëntor.

Zoti ministër, 18 studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Gjilanit, përmes konkursit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, të shpallur më 2 shtator 2016 janë pranuar në studime master, por të njëjtëve nuk u është lejuar regjistrimi me arsyetimin se duhet tu nënshtrohen provimeve diferencuese, pasi t'i kenë ndjekur ligjëratat në dy semestra, vetëm pse nuk i kanë kryer studimet në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, këta studentë janë trajtuar njësoj si studentët e kolegjeve private dhe atyre që kanë studiuar programe tjera.

Studentët kanë kërkuar sqarim nga fakulteti, por ende nuk kanë marrë përgjigje. Në ndërkohë ata po i ndjekin ligjëratat në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës, pa qenë të sigurt se çfarë do të ndodhë me ta.

Zoti ministër,

Pse po lejohen diferencime në bazë të regjioneve të studentëve dhe çka do të ndërmerrni për korrigjimin e kësaj padrejtësie të madhe?

KRYESUESI: Ministri, Arsim Bajrami.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Kurteshi,

Më lejoni të ju informoj, se kemi bërë një hulumtim të rastit, sepse rasti ka më shumë se dy muaj që është parashtruar si pyetje parlamentare dhe më lejoni, t'ua jap një përgjigje pozitive dhe ju lus që t'ua përcillni edhe studentëve, megjithëse ata e kanë marrë.

Ka pasur një keqkuptim tek zyrtarët e Fakultetit Ekonomik dhe ne menjëherë kemi intervenuar tek autoritetet e Universitetit të Prishtinës, sepse cilado diplomë e dhënë nga cilido universitet publik, por tani edhe nga kolegjet private duhet të pranohet nga të gjitha institucionet dhe ky është një mobilitet i brendshëm, që duhet në të sigurojmë karshi edhe synimeve tona për deklaratën e Bolonjës.

Kështu që, këta studentë tani janë regjistruar. Sekretari i universitetit më ka informuar që janë regjistruar dhe ata jo vetëm që po e vijojnë, por kanë filluar edhe të përgatisin punime seminarike dhe provime dhe do të jenë krejtësisht të barabartë.

Përtej universiteteve publike ne kemi shkuar edhe një hap përtej dhe ka këtu mjaftë mësimdhënës që e dinë këtë çështje, për herë të parë sivjet është lejuar kalimi nga studime themelore në studime master nga kolegjet private tek universitetet publike. Jemi të detyruar këtë ta bëjmë sipas Kushtetutës, sepse Kushtetuta jonë garanton konkurrencën e lirë dhe të gjitha institucionet private dhe publike janë të barabarta para ligjit. Në anën tjetër, pa marrë parasysh se një program i studimeve, qoftë studimeve themelore apo master i ka apo s'i ka lëndët e njëjta, evaluimi i diplomës bëhet në bazë të numrit të kredive dhe cilado diplomë që arrin numrin 180, përkatësisht 240 kredi, ajo është një diplomë e përfundimit të studimeve themelore dhe ajo pranohet pa marrë parasysh nëse lëndët nuk janë të njëjta, sepse ne kemi shumë studentë tanë që po shkojnë në Vjenë e në vende tjera, dhe po u njihen diplomat, ma marrë parasysh që lëndët nuk janë të njëjta. Pra, nuk ka provime diferenciale dhe këta studentë do të jenë krejtësisht të barabartë në studimet e tyre master.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë kam pasur një pyetje dhe me muaj po zhagitet, nganjëherë edhe në pyetjet e mëhershme nuk kemi marrë përgjigje.

Fjala ka qenë për mosrespektimin e pushtetit qendror nga pushtetet lokale, është fjala për një vendim të Kuvendit Komunal të Prizrenit, i cili përkundër sugjerimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ambientit, që kanë bërë shkelje ligjore, ata kanë vazhduar të mos i respektojnë vendimet e qeverisë qendrore. Domethënë, kjo diskrepancë dhe ky konflikt midis dy pushteteve, natyrisht se është shqetësim dhe unë në këtë rast meqë ka avancuar mosrespektimi i institucioneve, kohëve të fundit po mendoj se kryeministri duhet të mendojë drejt dhe në përputhje edhe me ligjet dhe Kushtetutën e vendit, funksionimin e subjektit politik Lista serpska, e cila për mendimin tim, si kali i Trojës brenda institucioneve të republikës dhe vetë Republikës, është në kundërshtim me përcaktimin kushtetues të vendit dhe është momenti i fundit, që Qeveria dhe instancat tjera të marrin masa që këtë subjekt politik ta çregjistrojnë, sepse veprimtaria e saj është në kundërshtim me, siç thash, ligjet dhe Kushtetutën e vendit dhe gjuha urrejtëse që përdorin ata fut një konflikt midis nacionaliteteve dhe një gjuhë që fut konflikte edhe ndërfaqetare.

Prandaj, ne në funksion të bërjes së shtetit dhe të tregimit për ata që ende nuk e njohin shtetin e Kosovës, duhet të sillemi ashtu siç e meritojnë dhe siç e kërkojnë ligjet e vendit.

Përndryshe, unë mendoj se Lista serpska...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

HAXHI SHALA: Edhe pse ka qenë një pyetje para një muaj e më shumë, po e them sot, edhe pse s'qenka ministri këtu.

Kemi gjendjen e rëndë të invalidëve, Qeveria dhe ministri juaj, zoti Abrashi, nuk ka sjellë asnjë rezultat pozitiv për pjesën më të ndjeshme të shoqërisë sonë, invalidët e luftës.

Neglizhenca e mosformimit të një komisioni për përcaktimin e shkallës së invalidëve të luftës ka rezultuar që një pjesë e madhe e invalidëve të luftës të mbesin që një vit pa asnjë të hyrë nga buxheti në buxhetin e tyre familjar, kur dihet se Komisioni për Verifikimin e veteranëve dhe invalidëve të luftës që një kohë të gjatë ka kryer punën në verifikimin e këtyre kategorive deri më tash, sipas informatave që kemi, një pjesë e veteranëve janë duke u paguar nga Qeveria, kurse pjesa tjetër më e ndjeshme e shoqërisë, siç janë invalidët e luftës dhe disa familjarë të dëshmorëve ende nuk gëzojnë të drejtën e tyre të garantuar me ligj.

Njëkohësisht, edhe kërkesat që janë drejtuar nga Shoqata e Invalidëve të Luftës nuk kanë gjetur përkrahjen e realizimit të kërkesës rreth blerjes së protezave për invalidët e luftës.

Pyetja për ministrin, kur formohet Komisioni për përcaktimin e shkallës së invalidëve të luftës së UÇK-së? Kur fillon pagesa e tyre dhe kur do të realizohet kërkesa e shoqatave të invalidëve të luftës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mufera Shinik, pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

2013 yılında Kosova ile Türkiye arasında imzalanan Serbest Ticaret Anlaşması, Türkiye Büyük Millet Meclisinden geçmesine rağmen, Kosova Meclisine hanüz gelmemiştir.

Sayın Bakan, bu gelmemelik sebebini açıklar mısınız?

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Zonja ministre, urdhëroni!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar ministra,

Po përgjigjem në pyetjen që ma ke dërguar me shkrim, sepse nuk pata përkthim, kërkoj falje për këtë.

Është fjala, me sa kuptoj, për marrëveshjen e tregtisë së lirë me Turqinë. Siç jeni në dijeni, kjo marrëveshje, jemi në dijeni të gjithë, është nënshkruar në Ankara në mes të palës kosovare dhe asaj turke më 27 shtator të vitit 2013.

Kjo marrëveshje është dërguar tek Ministria e Punëve të Jashtme më 18 shtator të vitit 2014, para se unë ta marr mandatin, që ka qenë më 9 dhjetor të vitit 2014. Marrëveshje gjendet tanimë në zyrën e presidentit të Republikës së Kosovës, andaj besoj se në këtë pyetje mund të ju përgjigjet Ministria e Punëve të Jashtme, ose zyra e presidentit.

Ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë në fillim të mandatit kemi konsultuar asociacionet e biznesit, kemi kuptuar që nënshkrimi i marrëveshjes është bërë nën presion të kohës, ka qenë vetëm oda amerikane e Kosovës, e cila ka dhënë komentet e saj para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërkohë që nuk është pritur që të merren komentet nga asnjë asociacion i biznesit në Kosovë. Ka disa biznese kosovare, të cilat janë kundër marrëveshjes, sepse mendojnë që me nënshkrimin dhe me hyrjen në fuqi të saj, në fakt, ato do të dëmtohen.

Më lejoni të ju them, që në vitin 2015 Turqia në Kosovë ka eksportuar 253 milionë, domethënë importi ynë nga Turqia ndërkohë që ne kemi arritur të eksportojmë në Turqi vetëm 9 milionë. Ndoshta, për shkak edhe të kritikave nga asociacionet e biznesit, ne nuk e kemi shtyrë si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë ratifikimin e kësaj, më duhet të jem e sinqertë se asnjëherë nuk kam bërë kërkesë që kjo marrëveshje të ratifikohet, por assesi nuk kam kërkuar anulimin e saj, sepse nuk është nën kompetencën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, pyetje shtesë? Nuk ka! Atëherë, deputeti Daut Haradinaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Pyetjen e kam bërë vitin e kaluar, gjegjësisht tash e dy muaj dhe i jam drejtuar kryeministrit, pse nuk po e hartojmë një ligj të thjeshtë, i cili i jep mandat shtesë FSK-së, meqenëse situata në rajon është shumë e ndjeshme dhe atë përgjigje nuk e kam marrë, por dorën në zemër, ka pasur gatishmëri dhe bashkëpunim në këtë drejtim.

Por, për të mos e lexuar unë pyetjen, po ju them se Ligji për forcat e sigurisë së Kosovës është ndërruar disa herë dhe unë kam marrë modele këtu, për t'ua dëshmuar se sa e thjeshtë është me u ndërrua një ligj. Për shembull, në vitin 2008, kur ka qenë në pyetje se kush e emëron ministrin, është ardhur në seancë me 3-4 nene, ose në fakt, vetëm me dy nene dhe është ndërruar, për shembull 2 nenet, të cilat i japin mandat se kush e emëron ministrin e Forcave të Sigurisë.

Kur vjen në pyetje, sot e dëgjova edhe deputetin, kolegun Nuredin Ibishi, kur vjen në pyetje për t'ia ndërruar misionin FSK-së, që e kemi Ligjin për forcat e sigurisë së Kosovës nuk kërkohet asgjë më shumë, asgjë më pak, vetëm të vihen 3 nene në Parlamentin e Kosovës, t'i rritim kapacitetet, të rritet buxheti dhe asnjë gjë më shumë.

Shumë shtete të NATO-s, që kanë kapacitete të fuqishme ushtarake nuk quhen Ushtria e filan shtetit, nuk ka nevojë dhe nuk është e domosdoshme t'i ndërrohet emri, mjafton t'i ndërrohen kapacitetet dhe misionet, me dy nene të thjeshta. E di që Qeveria ka gatishmëri, por nëse është e vërtetë çfarë tha Nuredin Ibishi, atëherë ne si deputetë dhe si komision do ta procedojmë këtë ligj në afatin sa më të shpejtë, nëse koalicioni qeverisës ka vullnet dhe gatishmëri për t'i dhënë përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Bajrami,

Pas rezultateve nga PISA kemi parë gatishmërinë tuaj dhe të Qeverisë, të kryeministrit Mustafa, pra për hapa konkretë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Personalisht, më intereson të di se çfarë konkretisht përmban kjo platformë? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Murtezi,

Faleminderit shumë, edhe pse edhe pak minuta ne do të hyjmë në interpelancë dhe do të kemi shumë më shumë hapësirë për të diskutuar për gjendjen në arsimin parauniversitar, por edhe për reflektimin që e ka pasur testi ndërkombëtar PISA 2015.

E nderuar deputete,

Siç ju kujtohet nga fillimi i adresimit tim në Kuvend, në fillim të marrjes së mandatit, kam deklaruar se niveli i cilësisë në arsim akoma është në nivel të ulët dhe ne na duhet të punojmë shumë që vërtet të fillojmë rimëkëmbjen e sistemit arsimor dhe vetëm 2-3 muaj para marrjes së mandatit ne kemi organizuar këtë vlerësim ndërkombëtar PISA, për të parë një rishikim të gjendjes në arsim, do të thosha për dy dekadat e fundit apo për periudhën nga viti '90 deri më tani.

Tani çështja e kredibilitetit të PISA-s te ne fare nuk diskutohet, por siç e dini, shumë shtete kanë akoma rezerva dhe vetëm 72 shtete kanë pranuar të maten me këtë vlerësim ndërkombëtar dhe

mendoj që është mirë që Kosova ka hyrë në këtë sistem dhe ne nuk kemi pritur fare publikimin e rezultateve 18 muaj prapa, por nga fillimi i mandatit jemi koncentruar kryesisht në ngritjen e cilësisë dhe jam i sigurt se gjendja reale aktuale sot po të mbahet PISA është shumë më e mirë, por jo akoma në nivelin e kënaqshëm.

Ne nga viti 2015 kemi filluar me miratimin e të gjitha strategjive, legjislacionit, dokumentet për të cilat do të informoj në interpelancë, në mënyrë që të shënojmë një ngritje të cilësisë, kurse si reflektim i menjëhershëm pas daljes së rezultateve, vetëm një ditë pas daljes së rezultateve Qeveria ka miratuar planin strategjik për zhvillimin e sistemit arsimor 2017-2021, i cili është plan detal dhe që parasheh ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe i cili përcillet edhe me veprime e masa konkrete për të gjitha nivelet e arsimit.

Gjithashtu, menjëherë unë kam formuar edhe grupin kombëtar për përgatitjen e planit aksionar apo të veprimit për PISA 2018, sepse ne do të aplikojmë sërish, përsëri aplikimi është vullnetar, që të matemi në PISA 2018, sepse dëshirojmë të shohim efektivitetin e politikave arsimore gjatë këtij mandati qeveritar.

Natyrisht se nuk presim ndonjë rezultat spektakular, por jemi më se të sigurt se puna që është bërë gjatë këtyre dy vjetëve dhe puna që do të bëhet në vijim, do të japë një rezultat, do të japë një shpresë të ndërtimit gradual të cilësisë, sepse i kemi të gjitha kapacitetet dhe të gjitha mundësitë ta bëjmë këtë.

Pra, ky moment ka qenë ndoshta edhe një moment i vetëdijesimit kombëtar, shtetëror dhe është jashtëzakonisht mirë që për PISA po diskutohet në çdo familje, po diskutohet në çdo institucion dhe ka një vullnet të mirë edhe për ngritjen e buxhetit, ndoshta edhe për vendosjen e arsimit dhe edukimit si prioritet kryesor, sepse një arsim cilësor, një edukim cilësor është kusht edhe për zhvillimin ekonomik dhe ne do të ofrojmë një bashkëpunim të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja nuk ka pyetje shtesë. Prapë deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Zharku,

Infrastruktura rrugore në shërbim të arsimit nuk është e nivelit të duhur. Kemi parë disa herë reportazhe që flasin për zona të ndryshme rurale, ku mësimdhënësit e kanë shumë të vështirë dhe janë në kushte shumë të vështira atmosferike thuaja se edhe të pamundur për realizimin e procesit mësimor, përkatësisht udhëtimin deri te vendi i punës.

I nderuar ministër,

Më intereson të di a ka ndonjë memorandum bashkëpunimi mes Ministrisë që ju e drejtoni dhe Ministrisë së Arsimit, ose drejtorive komunale të arsimit për zhvillim të infrastrukturës rrugore në viset rurale me qëllim të mbarëvajtjes dhe realizimit të procesit mësimor? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Zharku.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

E nderuar deputete Demi-Murtezi,

Edhe përkundër faktit se nuk ka memorandum bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Arsimit ose drejtorive komunale të arsimit për zhvillimin e infrastrukturës rrugore, Ministria e Infrastrukturës, në kontinuitet ka përkrahur kuvendet komunale në përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe lokale.

Kjo përkrahje është realizuar në kuadër të memorandumit të mirëkuptimit si pjesë e programit të projekteve të bashkëfinancimit në shumicën e kuvendeve komunale.

Prioritetet e projekteve, qofshin ato projekte lokale, urbane apo rrugë lokale të reja, janë caktuar nga ana e kuvendeve komunale dhe Ministria e Infrastrukturës ka dhënë përkrahje teknike dhe financiare për realizimin e këtyre projekteve, ku janë të përfshira natyrisht edhe trotualet apo rrugët e reja.

Pavarësisht se Ministria e Infrastrukturës nuk ka kompetencë për rrugët urbane e lokale, çështja e sigurisë rrugore dhe qasjes së papenguar për qytetarët e Republikës së Kosovës mbetet prioritet i Ministrisë, e cila në kuadër të kapaciteteve teknike e financiare ka përkrahur dhe vazhdon të përkrahë kuvendet komunale në përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor dhe të sigurisë rrugore në përgjithësi.

KRYESUESI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Labinotë Demi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: I nderuar ministër,

Më lejoni që me këtë rast të përmend vetëm një shembull dhe shpresoj se do ta keni parasysh në rishikimin e buxhetit ose në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Bëhet fjalë për dy punëtorë të shkollës fillore në fshatin Makresh të Ulët të komunës së Novo-Bërdos, të cilët vitin e kaluar, bashkë me një përcjellës të tyre kanë qenë në rrezik të humbin jetën për shkak se rruga është e paasfaltuar, është rrugë e vështirë të tejkalohet jo vetëm kur ka borë, por edhe kur ka shi, bëhet një rrugë e rrëshqitshme. Ndërkohë që shohim se aty mungojnë

vetëm 4,5 kilometra asfalt. Do të thotë, nga Makreshi i Epërm në Makreshin e Poshtëm dhe bëhet fjalë për një rrugë të shkurtër, që është mjaft e rrezikshme, e në ndërkohë dhe në vazhdimësi e rrezikon jetën jo vetëm të punëdhënësve, me këtë rast unë po i përmend ata, por e vështirëson në përgjithësi procesin e arsimit, meqë i përmenda si rast, por edhe në përgjithësi jetën e qytetarëve.

Pra, pa dashur ta paragjykoj kryetarin e komunës për shkak të përkatësisë kombëtare që ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: E nderuar deputete,

Sa për informatën tuaj, me nënkryetarin e komunës, Bajrush Ymeri, javën e kaluar jemi takuar dhe e ka ngritur çështjen e rrugës së Makreshit. Kemi biseduar nëse mund ta përfshijmë në kuadër të projektit që është sivjet në ndërtimin e rrugëve komunale të Novo-Bërdës, por që nuk mund të premtojmë se mund të kryhet gjatë këtij viti, por nëse mund ta shtimë, të shpallim procedura të tenderimit sivjet dhe në vitin e ardhshëm të kryhet.

KRYESUESI: Faleminderit! Pasi kemi kohë, edhe një pyetje ta shtrojmë, i thërras deputetët të hyjnë në sallë, sepse do të vazhdojmë me rendin e rregullt të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministren Edita Tahiri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me marrëveshjen e Brukselit për telekomunikacionin Kosova ka fituar kodin telefonik +383, e cila ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2016.

Ky lajm bëri jehonë në mediat e shkruara dhe elektronike. Nga ministrja për Dialog u tha në një konferencë për shtyp se është një arritje e madhe, ditë e veçantë dhe historike për shtetin e Kosovës.

Po ashtu, mediat në Serbi, duke iu referuar autoriteteve serbe, shtrirjen e kodit serb në Kosovë e kanë konsideruar si historike.

Në anën tjetër, lexova deklaratën e shefit për komunikim e media në selinë e ITU-s në Gjenevë, Dimitri Leger, i cili për agjencinë e lajmeve “Presheva jonë” tha: “Mund t’ ju konfirmoj se në emër të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit se ky kod nuk është dhënë nga ITU-ja”.

Sipas zyrtares së ITU-s në Gjenevë, nëse ky kod qenka dhënë nga ITU-ja, pse atëherë Prishtina zyrtare nuk bëri marrëveshje me ITU-në në Gjenevë, por me Beogradin.

Këtë deklaratë e bazon duke iu referuar deklaratave të Edita Tahirit për medie në Kosovë, të cilat kanë shkruar se kodi u është dhënë nga ITU-ja.

Pyetja ime ka qenë: Zonja ministre, cila është e vërteta e kësaj marrëveshjeje, sepse edhe për Kosovën, edhe për Serbinë, është cilësuar si historike?

Dhe nëse kjo për dy shtetet është historike, atëherë cili është fituesi? Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, për pyetjet që mbeten do të provohet të merren përgjigje në seancën e radhës, sepse është harxhuar koha e paraparë me Rregullore.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Ju lus, më jepni numrin e deputetëve! Deputetët le të ulen! Të pranishëm janë 61 deputetë.

Pyes nëse keni vërejtje për procesverbalet e seancave të mbajtura më 20, 22, 23, 24, 29 dhe 30 dhjetor 2016?

Nëse s'ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave të mbajtura më 20, 22, 23, 24, 29 dhe 30 dhjetor 2016.

4. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Arsim Bajrami, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur nga 15 deputetë nënshkrues, lidhur me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë

Deputeti Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, profesor Arsim Bajrami, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatjen deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, sipas nenit 44.7 të Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit ministri Arsim Bajrami paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutave.

Koha e ndarë për diskutim, sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve, pa grup parlamentar, është si vijon:

- Grupi Parlamentar i PDK-së 35 deputetë, 52 minuta, minus 6 minuta për fjalimin e ministrit, që i bie se i kanë 46 minuta.
- Grupi Parlamentar i LDK-së 33 deputetë, 50 minuta, minus 6 minuta që i jep për ministrin, i ka 44 minuta.
- Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, 16 deputetë, 24 minuta.
- Grupi LS, 11 deputetë, 16 minuta, minus 2 minuta që i kanë për ministrin, i kanë 14 minuta.
- Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, 8 deputetë, 12 minuta.
- Grupi “Nisma” 6 deputetë, 9 minuta,
- Grupi “6+”, 6 deputetë, 9 minuta, minus 1 minutë për ministrin, i kanë 8 minuta, dhe
- Grupi parlamentar - ose 5 deputetë pa grup, i ka 8 minuta.

Atëherë, e ftoj deputetin Ismajl Kurteshi nga Lëvizja “Vetëvendosje”, në cilësinë e propozuesit të interpelancës, ta marrë fjalën, 10 minuta.

ISMAJL KURTESHI: Deputetë të nderuar,
Ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sado që lajmi i publikuar më 6 dhjetor 2016 se Kosova është radhitur e fundit në mesin e 72 vendeve që kanë marrë pjesë në testin ndërkombëtar të PISA-s e ka shqetësuar opinionin dhe për njohësit e gjendjes në arsim kjo nuk ka qenë ndonjë befasi.

Testi i PISA-s ka zbuluar se 77% e nxënësve të testuar nuk kanë qenë të aftë ta kaptojnë dhe ta interpretojnë drejt atë që e lexojnë, dhe pa këtë aftësi është e pamundur të arrihet çfarëdo qoftë në cilëndo fushë të jetës.

Kjo gjendje që vjen si pasojë e mungesës së angazhimit të duhur në fushën e arsimit të të gjitha qeverive të pasluftës, ndërhyrjes së politikanëve në fushën e arsimit për përfitime politike, personale ose grupore, për vota ose blerje të përkohshme të qetësisë sociale, kjo gjendje është edhe rezultat i bartjes së kompetencave nga profesionistët nëpër shkolla në duar të politikanëve, si për shembull, kryetarëve të komunës, e të tjerë.

Në këtë gjendje ka ndikuar edhe përfshirja e një numri të vogël të fëmijëve në çerdhe dhe arsim parashkollor, si dhe programi jociësor, kuadri shpesh i papërgatitur si duhet, mungesa e teksteve

adekuate, vlerësimi i brendshëm joreal, mungesa e disiplinës dhe llogaridhënies, mungesa e hapësirave shkollore, mungesa e kabineteve, laboratorëve dhe mungesa e hapësirës për aktivitete të lira.

Zhdukja e institucionit të përgjegjesisë dhe mungesa e motivimit, e monitorimit, e dallimit të punëtorëve nga të papunët dhe e vlerësimit real ka ndikuar në rënien e cilësisë në arsim.

Kriteret e ulëta për pranimin në fakultetet publike, pranimi dhe kalueshmëria pothuajse pa kriterë në kolegjet private, ku studentët pranohen edhe disa muaj pas fillimit zyrtar të vitit akademik, ku në vlerësimin e tyre ndikim të madh kanë edhe pronarët e kolegjeve, të cilët kolegjet i kanë biznese, përfundojnë me cilësi të ulët.

Nuk janë të rralla rastet kur në procesin mësimor janë identifikuar mësimdhënës me diploma të falsifikuara, por nuk dihet ndonjë rast që ndonjëri nga ta është dënuar për këtë çështje.

Në shkollat me mësim në gjuhën serbe në Kosovë hapur përdoren tekste shkollore antikushtetuese e kompetentët heshtin, edhe pse ligji i obligon që këto tekste t'i ndalojnë.

Për këtë gjendje fajin e bartin edhe shumë aktorë që kanë punuar në fushën e arsimit gjatë viteve të pasluftës, por përgjegjësi e veçantë bie mbi qeveritë, drejtoritë komunale të arsimit, udhëheqjet komunale dhe drejtorë të shkollave, të cilat nuk kanë punuar mjaftueshëm ose nuk kanë ditur të punojnë si duhet për të arritur rezultate të mira.

Kjo situatë, e bazuar në vlerësimin e PISA-s, duhet të na shërbejë si një moment kur ne të gjithë e kuptojmë se cilësia në arsim nuk arrihet me vlerësime joreale të nxënësve, as me deklarata pompoze të ministrave, as me strategji të kushtueshme e që nuk prodhojnë rezultate të kënaqshme, as me kurrikula që pa i përdorur po fillojmë t'i ndryshojmë, as me tekste të papërshtatshme shkollore, as me universitete të fushatave elektorale e kolegje me licenca të dyshimta.

Për të dalë nga kjo situatë, prindërit duhet të bashkëpunojnë shumë më shumë se në të kaluarën me mësimdhënësit. Prindërit nuk duhet të kërkojnë nga mësimdhënësit nota më të larta për fëmijët e tyre, por duhet të kërkojnë llogari nga mësimdhënësit nëse fëmijët e tyre nuk e dinë tabelën e shumëzimit, nëse fëmijët e tyre nuk dinë të lexojnë, nëse nuk është mbajtur ora e fundit e mësimin, nëse mësimi praktik nuk organizohet si duhet, nëse arsimtarët nuk mbajnë orë kujdestarie dhe mbledhje me prind.

Mësimdhënësit duhet të kuptojnë se orari i tyre i punës është 40 orë në javë e jo 2-3 orë në ditë, siç mendojnë disa nga ta.

Ata duhet t'i rifunksionalizojnë aktivitetet profesionale. Ata e kanë për obligim t'i motivojnë, t'i mësojnë dhe t'i edukojnë nxënësit, t'i vlerësojnë realisht, e jo të falin nota për të mbuluar mospunën e tyre, sepse interesimi i nxënësit dhe suksesi në mësim varet kryesisht nga puna dhe sjellja e mësuesit.

Qeveria e Kosovës nuk guxon të kursejë buxhet në dëm të cilësisë në arsim, por as ta keqpërdorë atë, duke shtruar darka e dreka për përfitime elektorale.

Synim i Qeverisë duhet të jetë ngritja e cilësisë, furnizimi i shkollave me mjete pune, krijimi i kushteve për mësim tërëditor, e të tjera.

Drejtoritë e shkollave, drejtoritë komunale të arsimit dhe Ministria e Arsimit duhet të sigurojnë respektimin e kriterëve të punësimit bazuar në aftësitë profesionale, kurse mësimeve të rinj në të ardhmen duhet të kalojnë së paku 1 vit në punë provuese, para se të fitojnë statusin e mësimeve të rregullt.

Inspektorët e arsimit dhe mekanizmat e tjerë profesionalë duhet të përcjellin punën në secilën hallkë të arsimit, të vlerësojnë atë me profesionalizëm dhe pa anime.

Tekstet shkollore duhet të rikonceptohen, kurse tekstet antikushetuese duhet të largohen nga shkollat tona. Nxënësit duhet të orientohen bazuar në aftësitë e tyre personale dhe nevojën e tregut të punës.

Më në fund, vërtet duhet të fillojmë me mësim praktik në shkolla profesionale, që realisht na mungon.

Infrastruktura ligjore duhet t'i përcaktojë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e secilës hallkë në sistemin e arsimit.

Shkollës duhet t'i kthehen kompetencat dhe përgjegjësitë. Drejtorët duhet të emërohen nga Këshilli i shkollës, kurse personeli tjetër nga drejtori, por drejtori dhe mësimeve duhet të jenë përgjegjës për suksesin e nxënësve.

Ata duhet të kuptojnë se nuk ka vend të garantuar të punës dhe as paga të njëjta për të gjithë.

Hapja e çerdheve duhet të bëhet prioritet nacional, kurse hapja e paraleleve parafillore duhet të ndodhë në të gjitha shkollat e Kosovës.

Për nxënësit me aftësi të veçanta dhe për ata që janë më të dobët në mësim, duhet të organizohet mësim shtesë.

Orët e kujdestarisë dhe mbledhjet me prind duhet të jenë obligative, aktivitetet kulturore dhe edukative duhet të jenë pjesë përbërëse e punës në shkolla.

Praktika e përcjelljes së nxënësve nga një klasë në tjetrën, pa nxënien e njohurive të parapara, duhet të rishqyrtohet. Vlerësimi i jashtëm dhe ai i brendshëm nuk guxon të dallojë mes vete.

Për nxjerrjen e arsimit nga kjo gjendje e rëndë nevojitet angazhim i të gjitha institucioneve të shtetit. Ministria e Arsimit, bashkë me drejtoritë e arsimit dhe ekspertët e fushës së arsimit, duhet ta bëjnë një plan operacional me detyra të përcaktuara mirë, me përgjegjës konkretë dhe afate të sakta kohore, kurse politikëbërësit që e sollën arsimin në këtë gjendje me politikat e tyre të gabuara, duhet t'i lirojnë pozitën e tyre.

Edhe analizat dhe përvojat e huaja, sidomos bashkëpunimi me Shqipërinë, është i domosdoshëm.

Ne duhet të bashkëpunojmë dhe të kërkojmë mbështetje profesionale nga çdo vend mik, por shkollën shqipe nuk mund ta bëjmë si duhet pa i bashkuar energjitë dhe dijet e kombit. Kjo është detyrë jona, të cilën s'mund ta delegojmë askund tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash e ftoj ministrin Arsim Bajramin që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e shtruar për interpelancë. Zoti ministër, kohën e keni të plotë!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Kurteshi,

Më lejoni që në fillim t'i shpreh falënderim grupit që ka nisur këtë interpelancë dhe të ofroj një bashkëpunim të plotë në diskutimet që do t'i kemi në vazhdim, deri në përfundimin e debatit dhe miratimin e një rezolute. I ftoj deputetë, në fillim të kësaj legjislature, që arsimit dhe edukimi të jenë në agjenda të rregullta të Kuvendit dhe të jemi të gatshëm si Ministri dhe Qeveri që për çdo 3 muaj të vijmë në Kuvend e të bisedojmë, sepse definitivisht arsimit dhe edukimi duhen të jenë prioritet kryesor kombëtar, duhet të kemi politika kombëtare, për shkak se cilido progres apo avancim në sistemin e arsimit dhe edukimit është një sukses për shtetin e Kosovës, është një kusht për zhvillimin ekonomik dhe mundësi e mirë që të rinjve tanë t'u krijojmë edhe perspektivë të përgjithshme.

Diskutimi im do të zgjasë 20 minuta. Falënderoj shumë grupet parlamentare që më kanë dhënë kohë shtesë edhe për përmbylljen e këtij debati dhe më lejoni që të shkoj pikë për pikë me këtë diskutim dhe të prezantoj, do të thotë, një pako, një program, një kornizë të një programi kombëtar për edukim dhe të jemi të gatshëm në momentin e duhur ta sjellim edhe në Kuvend dhe

ai të bëhet një dokument afatgjatë dhe të tregojë masat që ka ndërmarrë Ministria e Arsimit që 2 vjet, jo vetëm si reflektim ndaj vlerësimit të PISA-s, sepse testi PISA ka ndodhur vetëm 3 muaj pas fillimit të këtij mandati, por në kontinuitet, në pajtim me deklaratimet tona prej fillimit që ngritja e cilësisë në sistemin arsimor është një prioritet kombëtar. Do të filloj të prezantoj këto masa apo këto veprime, janë gjithsej 10 shtylla, në të cilat do të ndalem dhe do të veçoj dhe angazhimet dhe përkushtimet që i kemi bërë dhe sfidat që na presin, duke ofruar gjithmonë një bashkëpunim të plotë.

Shtylla e parë e një sistemi të suksesshëm arsimor fillon pikërisht te moshat e hershme dhe objektivi numër një është gjithëpërfshirja në arsimin parafillor dhe parashkollor, sepse akoma jemi larg standardeve ndërkombëtare sa i përket përfshirjes së fëmijëve tanë, sidomos në grup moshat prej 3 deri në moshën 6-vjeçare, për shkak se mungojnë kapacitetet dhe ne duhet të rrisim investimet për një gjithëpërfshirje, në mënyrë që në një të ardhme jo fort të largët të sjellim këtu edhe ligjin, me të cilin përfshirja e fëmijëve prej moshës deri 6-vjeçar bëhet e obligueshme, siç e kemi të obliguar arsimin parauniversitar deri në klasën e 9-të.

Kështu kanë vepruar edhe shumë shtete dhe ne duhet t'i ngremë kapacitetet dhe është lajm i mirë që edhe me votën tuaj, deputetë të nderuar, sivjet do të ndërtojmë 15 kopshte publike edhe me ndihmën e fondit të IPO-s. Ne jemi në përfundim të kurrikulës për moshat 3 deri 6-vjeçar. Kemi dizajnuar programe të veçanta brenda Universitetit të Prishtinës, përkatësisht Fakultetit të Edukimit, për përgatitjen e edukatorëve, kemi një mbështetje të madhe të donatorëve për të punuar me trajnimin e mësimitdhënësve për këtë grupmoshë dhe jemi duke i pajisur 150 kopshte me pajisje argëtuese, në mënyrë që fëmijët e kësaj moshe të mos kenë vetëm mësim, por të kenë edhe argëtim që të ndërtojnë personalitetin.

Në kontekstin e PISA-s edukimi në moshë të hershme është kyç, sepse në këtë moshë fëmijëve tanë duhet t'u japim njohuritë minimale për jetën, për shoqërinë, për botën, për shtetin, për natyrën, në mënyrë që ata herët të kenë njohuritë minimale dhe pastaj gjatë arsimit parauniversitar të ndërtojnë sa më shumë shkathtësi, sepse ajo çfarë na tha PISA, na tha që kanë munguar shkathtësitë e nxënësve tonë, kanë munguar kompetencat dhe aftësitë e zgjidhjes së situatave konkrete në jetën e përditshme.

Shtylla e dytë e këtij programi që ne po e zbatojmë që dy vjet është kurrikula, sepse PISA 2015 reflektoi kurrikulën e vjetër, e bazuar kryesisht në mësim teorik, në një mësimdhënie memorizuese dhe ne nga viti 2011 kemi filluar me kurrikulën e re evropiane, e cila tërësisht bazohet në kompetenca dhe në shkathtësi. Në vitin 2013 është zgjeruar kjo kurrikulë në 95 shkolla dhe në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti ne kemi filluar shtrirjen e kurrikulës së re në nivel kombëtar. Nga 1 shtatori kurrikula do të fillohet të zbatohet në nivel kombëtar, sipas një udhërrëfyese apo sipas një agjende që kemi përcaktuar. Çfarë, në të vërtetë, të nderuar deputetë, është kurrikula e re? Është një rishikim substancial i komplet sistemit

arsimor. Gjithmonë derisa jemi te kurrikula, programet mësimore, lëndë, kurrikula është komplekse dhe ka dhjetë komponentë dhe ajo tenton ta transformojë tërësisht shkollën tonë parauniversitare për ta bërë një shkollë praktike dhe për të përgatitur nxënës që nesër do të mund të kyçen lehtë në arsimin e mesëm dhe në arsimin universitar, një kurrikulë që bazohet në tri shtylla kryesore:

E para, ndërrimin e balancës apo baraspeshës mes mësimin teorik edhe mësimin praktik dhe kurrikula e re zvogëlon për 50% vëllimin e mësimin teorik dhe për 50% ngrit mësimin praktik. Elementi i dytë i kurrikulës është përgatitja e mirë e mësimdhënësve, pra mësimdhënësit, të cilët do të punojnë me kapacitete profesionale dhe pedagogjike për të ofruar një mësimdhënie çfarë u duhet nxënësve tonë, për t'i liruar nxënësit nga përmbajtje që asnjëherë nuk do t'u duhen në jetë dhe për t'u dhënë nxënësve aftësi kreative, aftësi të gjykimit kreativ dhe aftësi e ndërtimit të personalitetit.

Tri gjëra kemi bërë sa i përket standardizimit të mësimdhënies dhe po bëjmë, sepse procesi është në vazhdim. E para, ne kemi nevojë që në nivel kombëtar ta standardizojmë mësimdhënien, sepse jemi të sigurt se mësimdhënia nuk është e njëjtë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe, në këtë drejtim, Ministria e Arsimit nëpërmjet kurrikulës së re, nëpërmjet programeve të reja, nëpërmjet teksteve të reja po vendos standarde unike të mësimdhënies. Sivjet kemi filluar në 13 shkolla të Republikës së Kosovës të pilotojmë edhe mësimdhënien digjitale, procesi po shkon jashtëzakonisht mirë dhe posa të marrim këtë raport ne ndoshta edhe do ta licencojmë mësimdhënien digjitale, ku po marr një shembull: një orë që do të zgjasë 45 minuta, në tërë Republikën e Kosovës, 15 minutat e para çdo mësimdhënësi i Republikës së Kosovës do ta shpjegojë një njësi mësimore në mënyrë unike në tërë Republikën e Kosovës nëpërmjet mësimin digjital online, 15 minutat e dytë mësimdhënësi do të zhvillojë interaktivitet dhe do të krijojë shkathtësi, kompetenca, debat dhe aftësi kreative të nxënësit dhe 15 minutat e mbetur do të ketë një punë grupore të nxënësve, ku ne pretendojmë që t'i ndërrojmë edhe pamjet e klasave që nga klasat klasike të kalojmë në klasat me tavolina debatuese.

Shumë është me rëndësi edhe standardizimi i vlerësimit të mësimdhënies. Ne kemi nevojë të kemi standarde unike se si do të bëhet notimi i nxënësve në Republikën e Kosovës, jo vetëm në testin e maturës, në testin e ndërmjetshëm, jo vetëm në testin PISA, po si ata do të notohen gjatë gjithë vitit shkollor. Kam nënshkruar udhëzimin administrativ, me të cilin secili mësimdhënësi duhet të zbatojë standardet unike të notimit, në mënyrë që notimi të bëhet në bazë të meritave dhe në mënyrë që notimi të shprehë gjendjen reale në sistemin arsimor.

Jemi të sigurt se kurrikula e re është një mundësi e re, kemi arritur që këtë kurrikulë tani ta shtrijmë në secilën shkollë, jemi duke zhvilluar takime me të gjithë mësimdhënësit nëpër qytete, nëpër komuna dhe kurrikula është pranuar mirë. Ka qenë afati kur kemi marrë vërejtje të mësimdhënësve, është rishikuar dhe të gjitha vërejtjet që janë dhënë nga mësimdhënësit, nga

drejtorët e shkollave janë akceptuar dhe ky është një proces, i cili deri në vitin 2021 do të shtrihet në 1 mijë e 100 shkolla dhe jemi të sigurt se do të shënojë një ngritje të dukshme të cilësisë.

Shtylla e tretë, të nderuar deputetë, për të cilën dëshiroj të ndaj mendimet bashkë me ju është problematika e teksteve mësimore, sepse së fundi, vlen parimi se nxënësit janë të atillë çfarë ne u ofrojmë tekste. Po ashtu, e pranoj se nga viti 2001 ka pasur një sistem jo gjithmonë të mirë të teksteve dhe për herë të parë vitin e kaluar, pas 15 vjetëve ne kemi filluar një proces të rishikimit të teksteve dhe kemi nevojë për tekste shumë më cilësore.

Sa i përket problematikës së teksteve shkollore po punojmë në tri drejtime dhe do t'ju mbajmë të informuar rregullisht për progresin në këtë drejtim. E para, ajo çfarë ka filluar dhe do të rezultojë me tre muajt e parë të këtij viti është standardizimi i teksteve të shkencave të natyrës, duke sjellë në Kosovë tekste unike me standarde ndërkombëtare, sepse definitivisht matematika, fizika, kimia dhe biologjia janë lëndë universale dhe ato lëndë duhet të jenë standarde me të gjitha shtetet dhe ne gjatë këtij viti do të kemi marrëveshje me shtete respektive: me Gjermaninë, Britaninë e Madhe dhe me shumë shtete të tjera që të sjellim tekste me standarde të Kembrixhit, të Pirsonit, me standarde të larta dhe jemi në rrugë të mirë dhe ky është hapi i parë. Në fazën e parë po shkojmë që tekstet e shkencave të natyrës të bëhen universale, ato nuk kanë çka të zbulojnë, ato duhet të përkthehen mirë, të adoptohen mirë dhe secili tekst do të përmbajë edhe manualin për mësimdhënës, për mënyrën e shtjellimit të atij teksti.

Nxënësit tanë shpejt do të kenë tekste shumë më të holla, shumë më të mira, shumë më logjike dhe shumë më të qarta, sepse padrejtësisht kemi qenë deri tash ndoshta edhe të padrejtë me nxënës, duke u dhënë edhe përmbajtje që asnjëherë nuk u duhen në jetë, sidomos në shkencat shoqërore. Duhet ta pranojmë dhe të jemi kritik nganjëherë i kemi ngarkuar edhe tekstet shkollore me elementet e romantizmit nacional, me elementet e ideologjisë. Fëmijët tanë kanë nevojë sot për një edukim cilësor, për një edukim që atyre u mundëson të ndërtojnë personalitetin dhe të bëhen pjesëtar të dobishëm.

Reforma e dytë sa i përket teksteve do të jetë promovimi hap pas hapi i tekstit digjital. Ne sivjet gjatë këtij viti do të promovojmë portalin kombëtar shtetëror, “e-edukimi”, ku do të fillojë dalëngadalë të kalojmë nga teksti manual, klasik, në atë digjital dhe kjo do të mundësojë padyshim edhe zvogëlimin e problemit të çantave të rënda, por do të mundësojë edhe qasjen më të lehtë të nxënësve në tekstin digjital, sepse fëmijët tanë përgjithësisht janë shumë të hapur dhe kanë treguar shkathtësi në përdorimin e teknologjisë së informacionit.

Elementi i tretë është rishikimi permanent i teksteve çdo vit shkollor, jo një herë në 15 vjet, sepse pas 15 vjetëve vetëm vitin e kaluar ne i kemi rishikuar të gjitha tekstet e arsimit parashkollor dhe ato janë ndryshuar në shkallë prej 1% deri në 50%. Por, dëshirojmë që çdo vit shkollor ne t'i rishikojmë tekstet ekzistuese, në mënyrë që të jemi të sigurt se ato tekste përmbajnë përmbajtje

çfarë u duhet nxënësve tonë. Te disa lëndë të shkencave shoqërore ne duhet të pretendojmë që të kemi tekste unike me Republikën e Shqipërisë dhe pas abetares, pretendimet tona janë që të kemi edhe një gjeografi dhe histori të përbashkët, ku jemi duke punuar me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë që të formojmë grupet punuese dhe të shkojmë edhe në këtë drejtim.

Shtylla e katërt e ngritjes së cilësisë në sistemin arsimor padyshim është përballja me epokën e digjitalizimit apo modernizimi i sistemit arsimor. Jemi duke jetuar në kohën e teknologjive të informacionit, ku të nderuar kolegë, interneti nuk po bëhet më alternativë, por po bëhet një mjet i domosdoshëm për mësimdhënie moderne. Ne po punojmë që ky proces tranzicioni, kalimi nga mësimdhënia klasike, sidomos në arsimin parauniversitar nga mësimdhënësi, i cili mjet konkretizimi ka pasur dërrasën e zezë, shpuzën dhe shkumësin, në një mësimdhënës i cili përdor internetin dhe jep mësimdhënie nëpërmjet internetit të bëhet me një tranzicion të kujdesshëm, duke rritur kapacitetet e mësimdhënësve për fushën e teknologjisë së informacionit, duke pajisur shkollat tona me pajisje të teknologjisë së informacionit, duke promovuar sa më shumë produkte të teknologjisë së informacionit.

Sivjet, siç e thashë, do të promovohet portali “E-edukimi”, i cili përmban të gjitha komponentët, përfshirë nga ditari elektronik, teksti elektronik, mësimdhënia elektronike, debati elektronik, lidhja mes shkollës dhe prindërve, komunikimi mes shkollës dhe prindërve, ku padyshim që ky proces është një proces i cili mund të realizohet me sukses në Republikën e Kosovës, sepse edhe shtrirja e internetit në shkollat tona është mbi nivelin rajonal, për të mos themi një nivel evropian dhe i kemi të gjitha mundësitë që në këtë fushë të kemi progres. Është një fushë, e cila fuqishëm po mbështetet nga donatorët ndërkombëtarë dhe ne sivjet në muajin qershor apo kur Qeveria të jetë gati, do të organizojmë një konferencë kombëtare të donatorëve, për të krijuar një fond kombëtar për arsim, i cili do të mundësojë lehtësimin e këtij procesi të modernizimit dhe digjitalizimit të shkollave.

Të nderuar deputetë, më lejoni të flas për shtyllën e pestë, që është kryesorja: mekanizimi i ngritjes së cilësisë në shkollë. Sepse, Qeveria në të kaluarën ka punuar shumë në komponentë kryesore. Sistemi arsimor ka qenë i shkatërruar, i goditur shumë rëndë dhe ne kemi kaluar dhe një dekadë në përpjekje për mbijetesë. Në vitet ‘90-‘99, nesër unë do të pres të gjithë pronarët e shtëpive shkolla për të shprehur falënderimin, ne një dekadë kemi pasur preokupim mbijetesën dhe kjo ka qenë mbijetesë edhe politike, por edhe të sistemit të edukimit. Dhe, mund të them që pasluftës komplet sistemi arsimor ka qenë rëndë i goditur dhe Qeveria në dy mandatet e kaluara ka bërë një punë shumë të madhe në rindërtimin e sistemit arsimor, kemi ndërtuar me qindra shkolla, madje edhe shkolla evropiane, kemi përmirësuar dukshëm pozitën materiale të mësimdhënësve tanë, janë ndërtuar kornizat e një reforme të mirë, por duhet të jemi kritik, nuk është punuar sa duhet në komponentin e ngritjes së cilësisë në tërë sistemin arsimor.

Sot po diskutojmë për arsimin parauniversitar, por ju lus që sa më shpejt të kemi një debat edhe për arsimin e lartë, sepse duhet ta shohim sistemin arsimor në tërësi, jo si diçka të shkëputur.

Çfarë kemi bërë për ta ngritur cilësinë? Fillimisht janë miratuar dy dokumente kombëtare, strategjike dhe falënderoj të gjitha partitë politike që kanë dërguar ekspertët e tyre në grupet punuese të Ministrisë së Arsimit dhe është një model i një qasjeje gjithëpërfshirëse, sepse politikat arsimore janë politika kombëtare, nuk janë politika partiake dhe pothuajse secila parti politike edhe mbi bazën e kërkesës që u kam dërguar kryetarëve të partive politike kanë ofruar ekspertë që janë kyçur në të gjitha proceset e vendimmarrjes në sistemin arsimor.

Kemi miratuar strategjinë kombëtare për ngritjen e cilësisë, në vitin e kaluar dhe vetëm një ditë pas vlerësimit ndërkombëtar PISA, Qeveria ka miratuar planin strategjik për zhvillimin e arsimit në periudhën 2017-2021. Cili është koncepti ynë për ta ngritur cilësinë? Natyrisht, të nderuar deputetë, cilësia duhet të rritet dhe të ndërtohet brenda shkollave. Nuk do të mjaftojnë rezolutat tona të mira, strategjitë tona në qoftë se brenda shkollës nuk e kemi çelësin se si ta motivojmë shkollën si një familje që ajo të ngritë cilësinë dhe strategjia për ngritjen e cilësisë nisët pikërisht nga shkolla si familje, duke i dhënë përgjegjësinë kryesore drejtorit të shkollë, koordinatorit për cilësi, të gjithë mësimitdhënësve, duke faktorizuar prindërit si aksionarë të shkollës, sepse te rezultati Pisa edhe prindërit kanë një rol shumë të rëndësishëm.

Kemi shkuar në nivelin e parë, ku shkolla duhet të jetë plotësisht autonome, llogaridhënie, ku secili mësimitdhënës në shkollë duhet të jetë i motivuar dhe duhet të fillojë të vetëvlerësojë veten dhe të kemi edhe vlerësimin e performansës në shkollë si tërësi. Niveli i dytë i ngritjes së cilësisë do të jetë rritja e kapaciteteve në nivelin komunal, sepse në bazë të ligjeve ekzistuese komplet arsimit parauniversitar është përgjegjësi e nivelit komunal, komplet. Ministria e Arsimit ka për obligim vetëm të sigurojë ligj të mirë, buxhet të mjaftueshëm dhe të sigurojë kurrikulë dhe tekste. Dhe, kemi kërkuar në nivelin komunal që të diskutojmë bashkë me Parlamentin çështjen e depolitizimit të shkollave, sepse e tha edhe kolegu Kurteshi, problemi kryesor me politizimin e shkollave është në nivelin komunal, ku ne duhet ta pranojmë se ky politizim është evident në nivel kombëtar dhe manifestohet kryesisht në përzgjedhjen e drejtorëve, menaxherëve dhe të mësimitdhënësve. Kjo kompetencë është vërtet e decentralizuar me ligjin aktual, por si institucione, si Qeveri, si Kuvend duhet ta diskutojmë në një të ardhme jo fort të largët, shumë shpejt, a do ta mbajmë këtë sistem, apo këtë sistem duhet ta marrim në dorë dhe ta bartim te një agjenci krejtësisht e pavarur edhe nga Qeveria, në mënyrë që drejtorët, menaxherët të zgjidhen me kriteret pedagogjike, profesionale, me meritat dhe jo pas cilido cikël të zgjedhjeve komunale të kemi atakime të drejtorëve, menaxherëve dhe ne, bashkë me ju, do ta diskutojmë me komisionin parlamentar që të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë.

Një gjë shumë e re është se ne kemi ofruar një kornizë kombëtare të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve. Tani, të nderuar deputetë, profesioni i mësimitdhënësit në Republikën e Kosovës është ndër tri profesionet më të kërkuara në tregun e punës, sidomos te mësimitdhënësit në arsimin parauniversitar dhe pa dyshim që kjo është edhe si rezultat i politikave në të kaluarën që ka ngritur dukshëm pozitën materiale të mësimitdhënësve dhe tani ka ardhur koha që ne t'i

mbështesim mësimdhënësit e Republikës së Kosovës, të punojnë më shumë për të përmirësuar pozitën, por të kërkojmë një sistem të llogaridhënies.

Çfarë ka bërë Ministria e Arsimit? Ne kemi zhvilluar projektin evropian “Ndërtimi i karrierës gjatë gjithë jetës” dhe po fillojmë që të bisedojmë me mësimdhënësit, të fillojmë me procesin e gradimit të mësimdhënësit, që mësimdhënësit të avancohen në arsimin parauniversitar sipas performansës, cilësisë, që të stimulojmë mësimdhënësit të ngritin karrierën, ata do të fillojnë si mësimdhënës fillestar, në momentin kur kryen Fakultetin e Edukimit, por ata çdo tri-katër vjet duhet të licencohen dhe duhet të arrijnë grada deri te mësimdhënësi ekselent apo te mësimdhënësi mentor dhe ne po punojmë që t’ua krijojmë këtë sistem të ngritjes së karrierës nëpërmjet vlerësimeve, licencimit, përmbledhjes së pikave, testeve periodike të shkathtësive të mësimdhënësve, pse jo edhe nëpërmjet një procesi të stimulimit në paga.

Pra, duhet ta krijojmë edhe një stimulim që mësimdhënësit të stimulohen për t’i ngritur pagat. Kështu që vërtet po punojmë me secilin mësimdhënës të Republikës së Kosovës për t’i dhënë mbështetje. Unë kam takuar pas testit PISA mësimdhënësit e disa shkollave dhe u kam thënë që të mos ndjehen aspak të ofenduar, por të ndjehen përgjegjës, të mobilizuar që ne të punojmë sa më shumë që PISA 2018 të shënojë një progres dhe të tregojë se ne mund të ngremë një sistem cilësor të arsimit.

Kështu që puna me mësimdhënës do të jetë një punë permanente, do të fillojmë që të bëjmë vlerësimin e mësimdhënësve, edhe me një Inspektorat të reformuar, kompetent, me një Inspektorat që nuk do të ketë qasje represive, por më shumë qasje këshillëdhënëse. Më lejoni, të nderuar kolegë, të prezantoj shtyllën e gjashtë të ndryshimeve që ne po bëjmë dhe që është edhe një trend evropian: përshtatja komplet e sistemit arsimor nevojave të tregut të punës. Në të kaluarën nuk ka pasur gjithmonë planifikime të qëlluara dhe adekuate për sistemin arsimor. Dhe, sot në kushte moderne, arsimi nuk është asgjë tjetër veçse ekonomi dhe arsimi duhet t’u përshtatet tërësisht nevojave të tregut të punës.

Ministria e Arsimit ka dy vjet që po zhvillon projekte të mëdha me Bashkimin Evropian, projekte këto që kanë për qëllim përshtatjen e plotë të sistemit parauniversitar, e sidomos të arsimit të lartë, me nevojat e tregut të punës. Kemi filluar implementimin e një projekti të madh evropian, i cili do të tregojë se cilat janë gjasat e punësimit në Republikën e Kosovës në nivel kombëtar dhe nivel komunal në pesë vjetët e ardhshme. Dhe, varësisht nga ky studim, i cili është në zhvillim dhe ka rezultatet e para, ne do të orientojmë programet në shkollat tona, sidomos në shkollat e mesme dhe ajo çfarë po dihet qysh tash, ne kemi mbingarkesë në disa drejtime dhe kemi deficit apo mungesë kuadro në disa drejtime të reja, sidomos në sferën e teknologjisë së informacionit.

Ky proces do të përfshijë edhe arsimin e lartë dhe do të mundësojë një proces të profilizimit të plotë. Në të ardhmen, të nderuar deputetë, Ministria e Arsimit do të përfaqësojë politikën që asnjë

program i ri në shkollat tona profesionale, në universitet nuk do të lejohet të hapet pa klauzolën e punësimit të nxënësve dhe studentëve. Dëshirojmë ta dimë që ai profil universitar apo parauniversitar do të sigurojë treg punësimi, sepse ne kemi lansuar brendin “Arsim për punësim” dhe pikërisht ky projekt po na mundëson që ne të shohim se cilat drejtime dhe të punojmë shumë me shkollat tona profesionale, të rrisim angazhimin për shkollat profesionale, të ndërrojmë mentalitetin edhe prindëror, i cili në të kaluarën ka qenë që vetëm nxënësit e zgjuar duhet të shkojnë në gjimnaze, kurse që nxënësit që s’kanë inteligjencë duhet të shkojnë në drejtime profesionale. Nuk është ky trend evropian, trendi evropian shkon drejt shkollave profesionale, drejt shkencave të aplikuara dhe ky projekt do të na mundësojë vërtet që ne të kemi një orientim të qëlluar që arsimin ta lidhim me ekonominë dhe njerëzit tanë të mos presin për punësim, por në moshë të hershme të ndërtojnë karrierën.

Do të fillojmë bashkë me Qeverinë zvicerane shumë shpejt ndërtimin e të ashtuquajturit “Test të planifikimit të karrierës” dhe do ta fillojmë në klasën e pestë për t’i parë shkathtësitë e nxënësve dhe për t’u mundësuar që ata të orientohen drejt fushave ku tregojnë shkathtësi.

Fusha e shtatë, padyshim është reformimi i Inspektoratit të Arsimit dhe tani e kemi ligjin e kaluar në leximin e parë, tani është në debat në Komisionin e Arsimit, ky është një ligj jetik për Ministrinë e Arsimit, për Qeverinë e Kosovës, që të kemi një inspektorat kompetent, kredibil, profesional dhe të besueshëm në opinion, një inspektorat i cili do të jetë një monitorues i mirë i gjendjes në arsim, do të jetë një ofruar i këshillave dhe ndihmës në sistemin arsimor, në mënyrë që vërtet të kemi një sistem të llogaridhënies, një sistem të përmirësimit të defekteve në proces, një sistem të një pasqyre të vërtetë të gjendjes arsimore.

Kështu që unë ju ftoj edhe nga kjo paraqitje komisionin parlamentar që të punojmë bashkë që ky ligj sa më shpejt të vijë. Komisioni parlamentar tani ka bërë një agjendë për këtë ligj dhe ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në këtë sferë. Edhe pse nuk është temë sot e kësaj interpelance arsimit i lartë, sepse tema e kësaj kryesisht është arsimit para fillor, parashkollor dhe parauniversitar, por në paraqitjen e deputetit Kurteshi u prekën edhe segmentet e arsimit të lartë, më lejoni që t’ju prezantoj tri shtylla se si e shohim ne zhvillimin e arsimit të lartë në pesë vjetët e ardhshme, apo të bëj një rezymë të asaj çfarë përmban FSAK-u, apo Plani strategjik të arsimit i lartë.

Tani, të nderuar kolegë, kemi shtatë universitete publike dhe kemi një numër të konsiderueshëm të kolegjeve private, ato janë ekzistuese, nuk ka tash kohë për debate a janë shumë a janë pak, por tani është koha për debatin se si këto institucione të shndërrohen në institucione të mirëfillta akademike dhe si t’i orientojmë kah nevojat çfarë i duhen Kosovës.

Hapi i parë që ka bërë Ministria e Arsimit tek arsimit i lartë është fillimi i procesit të specializimit të universiteteve publike dhe të përshtatjes së programeve të këtyre universiteteve nevojave të

tregut të punës, në mënyrë që të mos kemi përsëritje të programeve, në mënyrë që këto universitete në këto qytete të mëdha të lidhen me nevojat e zhvillimit regjional dhe ekonomik të atyre komunave. Ky është një proces pesëvjeçar, ku secili universitetit duhet ta gjejë veten dhe nuk do të lejojmë të kemi 20 fakultete ekonomike, 20 fakultete të drejtësisë apo 20 fakultete të shkencave shoqërore, e të kemi mungesë të fakulteteve për drejtime të caktuara.

Siç kemi mundur, të nderuar kolegë, ta përcillni, ne nëpërmjet mekanizmave që posedojmë si ministri, Agjencisë Kosovare për Akreditim, vetëm këto dy vjet kemi shkurtuar 71 programe akademike. Pra, nuk po shkojmë tani në logjikën e sasisë, masës, por po shkojmë te logjika e cilësisë dhe ky trend do të vazhdojë. I është bërë e ditur të gjitha universiteteve publike dhe kolegjeve private që ato të mos vrapojnë drejt programeve tjera apo masivizimit, por t'i mbërrijmë standardet për t'i stabilizuar programet ekzistuese dhe 71 programe janë mbyllur, shumica prej tyre të universiteteve publike, sepse nuk kanë arritur standarde dhe ne jemi këmbëngulës që do të vazhdojmë plotësisht që këto standarde t'i mbajmë dhe t'i ngremë.

Çështja e dytë kemi vendosur parimin e meritave në arsimin e lartë dhe, të nderuar deputetë, këto dy vjet s'keni dëgjuar për pranime përtej normave, edhe pse e kemi zvogëluar për 30% numrin e studentëve. Nuk keni dëgjuar as në medie, as nuk keni hasur as në raste praktike për pranim jashtë meritave. Ky është një standard shumë i rëndësishëm. Është një standard i munguar, por shumë i rëndësishëm, se të gjitha universitetet do të pranojnë aq studentë sa kërkohet, e kemi zvogëluar, dhe ata do të pranohen mbi bazën e meritave në të gjitha nivelet.

Ju them sinqerisht, me plot përgjegjësi, këto dy vjet nuk kam marrë asnjë ankesë në zyrën time nga asnjë institucion, asnjë prind, apo nga dikush për pranim jashtë meritave. Natyrisht, kërkesat janë shumë më të mëdha për studentë, por ne po udhëheqim politika të reduktimit dhe të ngritjes së standardeve sa u përket pranimeve dhe orientimeve.

Çështja e tretë tek arsimit i lartë është çështja e financimit. Si do ta financojmë arsimin e lartë? A do të jetë një arsim i lartë vetëm një konsumues i parasë publike, apo do të jetë edhe një prodhues i parasë publike? Këtu ka shumë profesorë dhe shumë prej tyre i dinë edhe praktikatat e universiteteve ndërkombëtare, ku universitetet janë promotorë të zhvillimit ekonomik, lidhen me ekonomi, janë partnerë të ekonomive dhe kjo neve na mungon. Ju e dini se ne edhe ashtu kemi shumë pak buxhet dhe mezi po i mbajmë në mbijetesë disa universitete të reja publike. Dhe, ne kemi nevojë ta ndërrojmë qasjen se si do t'i financojmë.

Ne duhet ta financojmë arsimin parauniversitar, sepse ai është i obligueshëm, duhet t'i ndihmojmë institucionet e arsimit të lartë, sepse kemi nevojë, por ato duhet të gjejnë format komplementare, suplementare, të financimit. Ato duhet të lidhen me ekonomi, me industri, që të gjenerojnë dhe në të ardhmen ju them se Ministria e Arsimit po e zhvillon një projekt të financimit, ku universitetet publike do të financohen në proporcion me performansën e tyre. Ato

që janë cilësore do të financohen plotësisht nga buxheti brenda interesit publik që e ka shteti. Për shembull, nuk do të financojmë gjithmonë 700 studentë në ekonomi, por do të financojmë 300, aq sa i duhen shtetit, pjesën tjetër universiteti duhet ta gjenerojë nëpërmjet lidhjeve me biznesin, nëpërmjet programeve dhe përmes komponentit të hulumtimit praktik.

Mund të them, të nderuar kolegë, se situata e përgjithshme në universitet e ka një trend pozitiv dhe e ka një trend stabiliteti në këto dy vjet. E dini, se në të kaluarën edhe në Parlament është diskutuar shpesh për problemet në universitet, por universiteti i është kthyer vetvetes. Është larg medie dhe ka filluar njëlloj konkurrence. Ne duhet të punojmë shumë me sektorin privat, që sektori privat vërtet të përqendrohet tërësisht në funksionin akademik, në funksionin e ofrimit të shërbimeve të veta dhe të ndalet ai komponenti që nganjëherë është shumë i shprehur, komponenti fitimprurës, që është manifestuar te kolegjet private.

Tani, të nderuar kolegë, arsimit është një fushë, do të thosha, që e paraqet preokupimin kryesor kombëtar. Dhe, unë ju ftoj që vërtet ky debat të jetë fillimi i një debati të rregullt, të vazhdueshëm. Do të propozoja që të kemi debat në çdo tre muaj për arsim, për shëndetësi... Kjo është diçka që i duhet shtetit të Kosovës dhe ky debat të jetë konkret dhe të përcillet me ngritje të buxhetit, të ngrihet me përgjegjësi të politikëbërësve, të ngrihet me llogaridhënie të çdokujt që është në sistemin arsimor, të mos përshkruhet me një defetizëm, sepse s'ia kemi borxh gjysmës së popullsisë që të vijmë në situatë defetiste. Është e vërtetë që vlerësimi PISA na ka gjetur pak të papërgatitur si shoqëri, por mendoj se ka qenë i nevojshëm. Ka qenë e nevojshme pas njëzet vjetësh fillim të këtij mandati ta kemi një rishikim, ta kemi një matje, ta shohim ku jemi dhe ta shohim progresin që po e bëjmë në të ardhmen. Kështu që, pas këtij vlerësimi ne kemi ndërmarrë hapa konkretë, hapa të caktuar, e kemi formuar menjëherë një grup prej ekspertëve më të mirë arsimorë në Republikën e Kosovës, kryesisht ekspertë të pavarur. Kemi ftuar ekspertë ndërkombëtarë dhe ata tani janë në grupin e Ministrisë së Arsimit, që po e përgatit planin e veprimit për PISA 2018, sepse jam i sigurt, të nderuar kolegë, që gjendja e arsimit nuk është aq e keqe sa tregon PISA. Por, tregon se s'kemi qenë sa duhet syçelë. Dhe, çfarë do të bëjmë? Më 2017-tën do t'i bëjmë të gjitha përgatitjet për PISA 2018.

Ministria e Arsimit do ta organizojë edhe një kampanjë, duke përfshirë edhe simulimin e PISA, 2018. Nuk kemi nevojë të na gjejë të papërgatitur PISA, por ne në vjeshtën e këtij viti do ta simulojmë vetë PISA 2018 për të parë se si dukemi. Dhe, unë ju ftoj që të punojmë në tri segmente. E kam thënë edhe në Qeveri, po e them edhe në Kuvend, nuk mund ta bëjë Qeveria po qe se nuk e ka edhe përkrahjen e Kuvendit, që arsimit dhe edukimi të shpallet prioriteti numër një në nivel kombëtar. Kjo është shumë e domosdoshme, sepse nuk do të kemi ekonomi, nuk do të kemi mirëqenie, nuk do të kemi punësim pa arsim cilësor.

Çështja e dytë, që ta rritim buxhetin për arsim.

Çështja e tretë, ta vendosim një parim të llogaridhënies në krejt sistemin arsimor dhe ta kemi një qasje kombëtare ndaj sistemit arsimor, të mos kemi një qasje partiake, sepse secili prej nesh kemi fëmijë, kemi anëtarë të familjes dhe cilido përmirësim i sistemit arsimor është një gjë e mirë për vendin tonë dhe është një garanci e progresit, sepse ne kemi një rini që aspak nuk ngec nga kolegët e saj në rajon, një rini mjaft inteligjente dhe ne kemi obligim ndaj këtyre të rinjve, më shumë se gjysma e popullsisë është në sistemin e edukimit, që t'ua ofrojmë një edukim cilësor, në mënyrë që duke krijuar edukim cilësor krijojmë familje të forta, krijojmë shtet të përparuar dhe krijojmë një perspektivë evropiane për vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash do ta paraqesin fjalën e vet kryetarët, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka sjellë një listë, dhe për këtë temë do të flasë Bekim Haxhiu. Është mirë që edhe të tjerët ta paraqesin me një letër se cili flet në emër të grupit. Ministri tha, diskutim konkret, në fund.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të ju informoj se ne anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim në Kuvendin e Kosovës, pas rezultateve të testit PISA kishim rënë dakord në mënyrë unanime që ta organizojmë një debat parlamentar për arsimin dhe parashtruesi i kësaj interpelance të sotme, zoti Ismajl Kurteshi, ishte i po të njëjtit mendim me ne. Por, si duket, subjekti i tij politik vendosi që kjo të vazhdojë si interpelancë parlamentare, ndoshta për qëllime politike, por sido që të jetë mendoj se arsimi është një çështje që duhet të na bashkojë, jo të na ndajë, sepse po flasim për arsimimin e të gjithë qytetarëve, pa dallime partie politike, pa dallime fetare, a sociale.

Uroj që në fund të interpelancës vërtet të jemi unikë për të ardhmen e arsimit, për objektivat se kah duhet të orientohet ai, të gjithë së bashku të punojmë në ngritjen e cilësisë në arsim, pasi arsimi është shtylla themelore e një shoqërie të shëndoshë.

Arsimi shqip në Kosovë është ngritur me shumë mund e sakrificë. Ishin pikërisht mësimdhënësit shqiptarë që e organizuan arsimin paralel dhe e organizuan mësimin në shtëpi-shkolla. Prandaj, sa herë flasim për arsimin nën okupim dhe arsimin në përgjithësi, e kemi për detyrë që ta shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë ata mësimdhënës që në kohë shumë të vështira, pa pagesë, e mbajtën gjallë arsimin dhe jetën institucionale në Kosovë.

Pas luftës së fundit, arsimi në Kosovë ishte në gjendje të rëndë, sidomos duke pasur parasysh infrastrukturën e shkatërruar dhe mësimin në shumë ndërime. Qeveria e Kosovës, e mbështetur nga qeveritë e shteteve përkatëse, donatorët, si dhe mësimdhënësit kanë dhënë kontribut të

jashtëzakonshëm në riorganizimin dhe rimëkëmbjen e arsimit në kushte emergjente të pasluftës, sepse gjatë luftës së fundit ishin djegur e shkatërruar rreth 300 shkolla, ndërsa deri në vitin 2007 ishin rinovuar 46 dhe ndërtuar 39 objekte shkollore. Deri në vitin 2007 në Kosovë ende kishte shkolla, ku mësimi mbahej në kontejnerë, vetëm në Drenicë ishin 8 të tilla.

Nga viti 2008, pas ardhjes së Partisë Demokratike në qeverisje të vendit, i është kushtuar rëndësi e veçantë përmirësimit të infrastrukturës shkollore dhe përmirësimit të kushteve të mësimdhënësve me qëllim të rritjes së cilësisë. Nga viti 2008 deri në vitin 2016, nga Ministria e Arsimit janë ndërtuar 126 dhe janë rinovuar 19 objekte shkollore, ndërsa në bashkëpunim me komunat dhe donatorët, nga viti 2008 deri në vitin 2016 janë ndërtuar gjithsej 260 objekte të reja shkollore. Deri në vitin 2007, me gjithë donacionet ndërkombëtare, kushtet infrastrukturore nëpër shkolla linin për të dëshiruar pagat për mësimdhënës që ishin në nivelin e asistencës sociale. Është e evidente se nga viti 2008, pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike, ka një përmirësim të dukshëm të infrastrukturës shkollore dhe ngritje të pagave për mësimdhënës në të gjitha nivelet.

Është menduar se kjo do të ndikonte në ngritjen e cilësisë në arsim, por, si duket, kalimi nga sistemi tradicional i mësimdhënies dhe reformat e implementuara nuk i kanë dhënë rezultatet e dëshiruara. Kosova është kyçur në reformim të sistemit arsimor, po si duket nuk ka arritur që ta implementojë si duhet, jemi kyçur si në procesin e Bolonjës, ashtu edhe në procesin e Kopenhagës për arsimim dhe aftësim profesional, si dhe në reformat në arsimin fillor, të cilat ende po vazhdojnë.

Për reformimin e arsimit dhe avancimin e tij u kyçën edhe shumë organizata joqeveritare dhe donatorë të ndryshëm, por rezultatet sërish nuk janë ato të dëshiruara.

Të nderuar kolegë deputetë,

Arsimi në Kosovë mbetet i ndikuar politikisht, pa përjashtim, në të gjitha komunat e Kosovës, prandaj kërkojmë që këtë çështje ta rregullojmë me ligj për ta eliminuar ndikimin politik në emërimin e stafit edukativ dhe menaxhues të shkollave. Ne jemi në trajtim të ligjit për Inspektoratin, andaj kërkoj që ky ligj të plotësohet edhe me rregullimin e çështjes për menaxhuesit e shkollave.

Drejtorët e shkollave dhe këshillat e prindërve duhet të jenë monitoruesit dhe mbikëqyrja e parë të mësimdhënies dhe cilësisë në arsim. Shkalla e dytë e mbikëqyrjes duhet të jenë inspektorët e arsimit dhe pastaj mbikëqyrja tjetër të realizohet nëpërmjet testeve të brendshme dhe të jashtme.

Me gjithë mbështetjen e Qeverisë përkatëse dhe donacioneve në arsim, rezultatet e fundit të testit PISA janë dëshpëruese, të cilat Kosovën e rangojnë ndër vendet e fundit dhe kjo na e bën të qartë dhe na jep sinjal se diçka nuk është duke funksionuar në sistemin tonë të arsimit. Kjo ka të bëjë,

në radhë të parë, me dikasterin qeveritar të arsimit, si dhe me donatorët, të cilët kanë mbështetur sektorë dhe nivele të ndryshme të arsimit. Rezultatet e PISA-s si dhe, në përgjithësi, sistemi i arsimit, vetvetiu ngrehin disa çështje, si në vijim:

- A është kurrikula cilësore dhe si po implementohet ajo nëpër shkolla?
- A është kredibil vlerësimi i brendshëm?
- A është i besueshëm dhe a po administrohet në mënyrë profesionale vlerësimi i jashtëm?
- Cilat politika duhet të hartohen dhe cilat masa duhet të ndërmerren për sigurimin e cilësisë?
- A duhet të bëhet vlerësimi i performansës së mësimdhënësve?
- Në cilën bazë bëhet rekrutimi i menaxhmentin të shkollës, me preferenca politike apo në bazë të përgatitjeve profesionale dhe kompetencave të tyre menaxhuese?

Edhe pse PISA na rangoi gati në fund, duhet thënë se ky test organizohet vetëm në 70 vende të botës, pasi jo të gjitha shtetet marrin pjesë në testin PISA, sepse ky test konsiderohet si një lloj pasqyre e arsimit të atij shteti dhe jo të gjithë dëshirojnë ta shohin atë.

Unë e falënderoj ministrin Arsim Bajrami për vënien e arsimit shqip në Kosovë para pasqyrës. Me këtë test e pamë ku jemi, si jemi, me të mirat dhe të metat, na i tregoi defektet që i kemi dhe zgjoi vëmendjen shumë me rëndësi të të gjithëve, se duhet ta rregullojmë dhe përmirësojmë arsimin tonë. Të kuptohemi drejt, nuk është vend para pasqyrës vetëm Ministria e Arsimit apo Qeveria, apo drejtoritë komunale të arsimit, por të gjithë jemi vënë para kësaj pasqyre.

Nuk mund ta pretendojmë një sistem të shëndoshë të arsimit pa një bashkëpunim të mësimdhënësve, të nxënësve dhe të prindërve. Pa një bashkëpunim dhe interaktivitet mësimdhënës - nxënës - prindër dhe anasjelltas, nuk mund të presim ngritje të cilësisë në arsim. Ky interaktivitet dhe bashkëpunim është esencial në ngritjen e cilësisë.

Qeveria ka kryer një pjesë të detyrave të saj me përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e pagave për mësimdhënës, por po shihet se kjo nuk është e mjaftueshme për ta pasur një arsim më të mirë, sepse për të duhet edhe një angazhim i të gjithëve, sepse për të pasur një arsim më të mirë duhet edhe një bashkëpunim i rëndësishëm i këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit.

Gjithashtu, integrimi i teknologjisë informative në sistemin arsimor, përkatësisht krijimi i platformave për digjitalizimin e përmbajtjeve mësimore duhet të parashihet në programet shkollore. Kjo do të ndikonte edhe në zvogëlimin e peshës së çantave shkollore, një problem i ngritur në vazhdimësi nga ana ime, por që nuk ka gjetur ende zgjidhjen e duhur.

Janë shumë faktorë që po ndikojnë në cilësinë e arsimit. Ne do të duhej të shkonim nga zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër klasa, që në disa shkolla e tejkalon dyfishin sipas standardeve mësimore. Nuk mund të implementohet një kurrikulë mësimore, e marrë model nga

vendet evropiane, kur në klasë ka nga 18 deri në 20 nxënës, në formën e njëjtë në klasat tona, ku numri i nxënësve është 36 deri në 38, e nganjëherë edhe mbi 40.

Digjitalizimi i maturës dhe provimi shtetëror për profesione të rregulluara do të ishte në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim. Nuk mund të pretendojmë arsim cilësor pa investimet në shkencë dhe inovacion. Edhe pse me ligjin përkatës për shkencë parashihet që të ndahen 0,7% e buxhetit të shtetit, një gjë e tillë në planifikimet buxhetore të deritanishme nuk është respektuar, e as nuk është respektuar në buxhetin e vitit 2017. Prandaj, kërkoj një vëmendje dhe një kërkesë të shtuar të vetë Ministrisë së Arsimit dhe të gjithë deputetëve që kjo të respektohet, sepse do të ishte në shërbim të shkencës dhe të arsimit.

Prandaj, për ta ngritur cilësinë e arsimit propozoj që të ndërmerren masat e propozuara më lart, duke përfshirë edhe rritjen e buxhetit për arsim dhe shkencë në Kosovë. Duke investuar në arsim ne investojmë në zhvillimin ekonomik, investojmë në të ardhmen e fëmijëve tanë, investojmë në të ardhmen e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do t'i referohem pikërisht raportit PISA, i cili është publikuar para dy-tri javë ditësh.

Edhe përkundër investimeve të shumta që janë drejtuar nga sektori i arsimit, që nga paslufta e në vazhdimësi, vlerësojmë se fokusi i shoqërisë, i Qeverisë dhe i të gjitha institucioneve duhet të jetë më i madh në ngritjen e cilësisë dhe zhvillimit të arsimit në vendin tonë. Pra, i tërë sistemi arsimor ka nevojë për një ngritje substanciale të cilësisë, për një ngritje më të mirë në fushën e arsimit.

Programi për vlerësim ndërkombëtar të nxënësve PISA është një studim ndërkombëtar i arsimit që i vlerëson kompetencat e nxënësve 15-vjeçar në lexim, matematikë dhe shkencë. Rezultatet e pjesëmarrjes së parë të Kosovës në PISA 2015 nuk janë të mira dhe konfirmojnë mendimin ekzistues të shumë aktorëve të arsimit në vend se cilësia e arsimit në vend duhet të përmirësohet. Por, edhe sa u përket aspekteve të tjera të cilësisë së arsimit, rezultatet e PISA-s tregojnë mangësitë serioze në fushën e arsimit, përfshirë edhe fushën e mësimdhënies.

Pra, nevojiten reforma arsimore gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për ta sjellë vendin në një rrugë drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Sfidat kryesore për vitet në vijim do të jetë përmirësimi

i arritshmërisë së të gjithë nxënësve, duke e vendosur fokusin në mësimin e orientuar drejt kompetencave dhe kurrikulës së orientuar.

Prioritetet kryesore të Ministrisë së Arsimit mendoj që duhet të jenë: ngritja e cilësisë, dhënia e përgjegjësisë së plotë të shkollave dhe të krijohen të gjitha mundësitë që të punojë mekanizmi në shkolla. Të mundësohet një tranzicion nga një mësim klasik në atë modern. Aktualisht, Ministria e Arsimit e ka filluar këtë tranzicion me një pilot-projekt në 13 shkolla dhe mendoj që duhet të vazhdohet me këtë projekt edhe nëpër shkollat tjera.

Të bëhet rishikimi i teksteve, puna praktike, lidhja e shkollës me biznese, të bëhet faktorizimi i prindërve, duke përfshirë edhe skemat e financimit.

Të bëhet licencimi i mësimit në çdo katër vjet. Të bëhet depolitizimi, u tha edhe nga ministri dhe nga parafolësit këtu, se politizimi në shkolla është evident, prandaj mendoj që Ministria e Arsimit duhet ta themelojë një trupë profesionale, të pavarur, nga pedagogët, që kjo trupë profesionale të bëjë edhe përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave fillore dhe po ashtu, të shkollave të mesme.

Po ashtu do të ishte mirë që Ministria e Arsimit të kërkojë nga Kuvendi i Kosovës, e theksoi edhe vetë ministri këtu, që çështja e arsimit të jetë si pikë e rendit të ditës, që çdo tre muaj ditë të diskutohet, të debatohet në këtë Kuvend, pra t'i jepet prioritet kësaj fushe.

Të themelohet një fond prej disa miliona dollarësh dhe ky fond të mbështetet prej donatorëve dhe nga Qeveria e Kosovës, dhe ky fond nuk duhet të përdoret për pagat e mësimit në shkollë, por për trajnime që do të ndikojnë në mësimit në ngritjen e cilësisë së arsimit, në përgjithësi.

Të rishikohet legjislacioni i arsimit, në përgjithësi. Ne si komision kemi qenë disa herë, e kemi monitoruar pjesën më të madhe të ligjeve dhe i kemi disa ligje që janë të pajtimshme dhe nëse nuk ka implementim, atëherë mbetet nga Ministria e Arsimit dhe njëkohësisht nga komisioni ynë që ky legjislacion të rishikohet dhe të silllet në Kuvend për rishikim ose posedim tjetër.

Po ashtu, dihet mirëfilli që kemi programe dualiste, edhe në universitetet publike, e po ashtu edhe në kolegjet private dhe mendoj se këto programe duhet të rishikohen nga Ministria e Arsimit dhe t'u vihet prioritet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Arsimi duhet të bëhet prioritet kombëtar në të gjitha nivelet e Qeverisë, shoqërisë dhe botës akademike. Politika gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme duhet të zhvillohet më tej në të gjitha nivelet. Për më tepër, prioriteti i arsimit ka nevojë për një bazë të fortë dhe një konsensus

ndërpartiak dhe interes i të gjithëve duhet të jetë fokusi në përmirësimin e arritshmërisë dhe të cilësisë. Koherenca në vendimmarrje dhe në zbatimin e reformave mund të arrihet vetëm nëpërmjet politikave koherente, transparencës, llogaridhënies dhe kornizës ligjore të harmonizuar mirë.

Pra, krejt në fund, rezultatet e PISA-s 2015 e përmbajnë një mesazh dhe mision të rëndësishëm. Ekziston nevoja urgjente për përmirësimin e performancës të sektorit të arsimit, për pajisjen e gjeneratave të reja me aftësi dhe kompetenca të nevojshme për ta zotëruar jetën e tyre në Evropë dhe më gjerë. Për ta arritur këtë duhet të punojmë bashkërisht të gjitha palët e interesit në shoqëri, të gjitha partitë politike dhe organizatat qeveritare, sektori privat dhe shoqëria civile.

Unë mendoj që gjatë kësaj interpelance do të ketë diskutime dhe po ashtu do të ketë edhe rekomandime nga deputetët dhe po ashtu kërkoj edhe nga iniciuesi i këtij debati dhe nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që pas përfundimit të interpelancës, të dakordohemi bashkërisht për rekomandimet që do të dalin dhe nga kjo interpelancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Morina! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, flet deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Rezultatet e PISA-s dhe arritshmëria e nxënësve në lexim treguan që Kosova me 146 pikë nën mesataren e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim është ndër vendet e fundit, në një gjendje alarmante. Meqë 40 pikë janë sa një vit shkollimi, i bie që maturanti ynë, pra ai që e ka përfunduar shkollën e mesme të lartë është i nivelit të atij që madje ende nuk e ka përfunduar as shkollën e mesme të ulët te vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Kështu, 68% e nxënësve të Kosovës nuk e arrijnë nivelin 2 në shkallën e përgjithshme të shkencës, 77% në atë të leximit e 78% në atë të matematikës. Pra, përfaqësisht $\frac{3}{4}$ -at e nxënësve tanë nuk i kanë njohuritë themelore. Nxënësit nga Kosova treguan rezultate fort të dobëta në testin PISA krahasuar pothuajse me të gjitha vendet tjera. Dihet se vetëm 13% të buxhetit për arsim në Kosovë ndahet për shpenzimet operative, ndërkohë që mesatarja e vendeve të OBEZH-it është 22% me buxhete shumë më të larta se sa ky yni.

Është e qartë se Qeveria në vitet e fundit, po edhe në përgjithësi pas lufte, investimin në arsim e sheh shumë më tepër investim në pagat e rritura në fushata elektorale për arsimtarët, sesa në aftësinë e mësimdhënies, që do të duhej të përkthehet edhe në mësimnxënie.

Raporti PISA thotë që në shkolla me klimë më të mirë disiplinore, nxënësit prirën të arrijnë arritshmëri më të lartë. Kjo do të thotë se ka një ambient shpërqëndruar negativ, në të cilin

paradoksalisht disiplina dhe rregulli nuk e rritin thjesht produktivitetin dhe efikasitetin, por ato madje edhe e izolojnë pozitivisht prej ndikimeve të jashtme. Sa më shumë disiplinë dhe rregull në shkolla, arritshmëria aq më e lartë. Pra, kjo tregon se sa më shumë që nxënësi ndahet e izolohet, aq më mirë është, se ka diçka në sistem, e në shoqëri në përgjithësi, që nuk është vetvetiu, por prej politikave të Qeverisë është e tillë çfarë është, që ndikon negativisht te nxënësit.

E dëgjuam ministrin këtu duke u lavdëruar qysh mungesa e ankesave nga prindërit për pranime a vlerësime sipas meritës është një gjë me të cilën ai lavdërohet. Pra, tha se mungojnë ankesat.

Mirëpo, për bindjen time kjo nuk është dëshmi që nuk ka pakënaqësi, por më parë është dëshmi që kjo pakënaqësi është e shoqëruar me mungesën e shpresës se ankesa ndryshon diçka. Kjo më shumë i bie se njerëzit nuk ankohen për shkak se ministri është i pashpresë për ankesat e tyre. Është ngjashëm sikurse njerëzit e papunë që nuk shkojnë të regjistrohen si të papunë, pse të regjistrohesh si i papunë kur nuk ka shpresë se me një regjistrim të tillë ta gjejë vendin e punës.

Më tutje, krijoi përshtypjen ministri se progresi në arsim e dije në njëfarë mënyre sigurohet me progres në teknologjinë e komunikimit dhe transmetimit të dijes. Unë nuk jam fare i bindur në këtë gjë. Nuk mendoj se teknologjia e avancuar nënkupton edhe progres në dije, në mësimdhënie e në mësimnxënie.

Është e mundshme, s'është aspak e thënë. Dhe është gabim të krijohet imazhi se kalimi prej shkumësit në dërrasë të zezë te kompjuteri është njëfarë garancie e dijes më të madhe. Sigurisht se jo.

Mandej tha që PISA na zuri të papërgatitur. Pra, ministri Bajrami konsideron se rezultatet e PISA-s, në fakt, nuk paraqesin mungesën tonë të dijes, por mungesën tonë të vigjilencës për testin e PISA-s. Kjo i bie njësoj sikurse një student i dobët, pasi nuk ka mësuar dhe ka rënë në provim, thotë se, defekti im është se nuk u përgatita për provimin duke i zgjedhur detyrat apo duke u përgjigjur në pyetjet në afatet e mëhershme të provimit.

Ju e dini se ka student që mësojnë duke lexuar libra dhe ka të tjerë që mësojnë duke u kufizuar në afatet e provimeve, qofshin probleme matematikore, ta zëmë, ose pyetje për temat e lëndës përkatëse.

Dhe, ministri tha që në vitin 2018 nuk do të jemi të papërgatitur. Ama ky është skepticizëm i ministrit që PISA na ka treguar të vërtetën. Pra, ky po beson se PISA nuk na ka treguar të vërtetën. E ka treguar të vërtetën për mungesën e vigjilencës, jo mungesën e dijes, e unë mendoj se po nuk u trajtua rezultati i PISA-s si shpërfaqje e mungesës së mësimin dhe dijes, kurrë nuk do të mund të rregullojmë arsimin në vendin tonë.

Por, edhe më thelbësore se krejt këto, unë besoj që duhet ta kuptojmë se arsimiti nuk ka më resurse që të rregullohet brenda vetvetes. Flasim për klasë më të vogla, më të mëdha, flasim për metoda të reja, mirëpo unë besoj se arsimiti nuk mund të shpëtohet nga brenda. Arsimiti duhet të shpëtohet prej jashtë.

Kjo do të thotë se pyetje e vërtetë është cila është transidentalja e arsimit, cila është pika jashtë arsimit, e cila e shpëton arsimin. Dhe, unë mendoj që ky është plani zhvillimor nacional. Pa u kuptuar arsimiti si pjesë përbërëse e zhvillimit shoqëror e kombëtar, nuk mund ta gjemë zgjidhjen e duhur.

Në vitet e 90-ta në Kosovë përfundimisht është shkëputur arsimiti nga ekonomia për shkak të apartheitit të imponuar prej okupimit serb. Pas çlirimit, pas vitit 1999, arsimiti dhe ekonomia nuk janë rilidhur dhe sot e kësaj dite nuk janë të lidhur.

Kur ka ardhur UNMIK-u në Kosovë ka thënë: “Ju qenkeni të papunë dhe jeni të pakualifikuar. Ju duhet të jeni të kualifikuar, si të papunë, në mënyrë që të vijnë investimet e huaja dhe ju të aplikoni dijeni tuaj”.

Siç ishim në situatën ku shumica nuk kishim diploma, u bënë që të gjithë me nga 2-3 diploma prej universiteteve e kolegjeve private, që na dolën si kërpuha pas shiut.

Dhe, a e dini çfarë ndodhi? Nuk erdhën investimet e huaja. Sepse 90% e investimeve të huaja direkte në botë shkojnë në vendet tashmë të zhvilluara. Nuk bëhesh ti me arsimin tënd atraktiv për investime të huaja. Por, është e kundërta, me zhvillimin tënd ti bëhesh atraktiv për investime të huaja që ta rrisin këtë zhvillim.

Është gabim të mendohet se ne kualifikohemi në papunësinë tonë dhe bëhemi atraktivë për investime të huaja. Kjo tezë ka rënë, sidomos prej krizës globale financiare të vitit 2008. Nuk ekziston më kjo tezë. Sepse, nëse ne pajisemi të gjithë me diploma, ata që janë më të mirë do të ikin nga Kosova, siç edhe ka ndodhur. Ndodh rrjedhja e trurit.

Në jetën e një individi, arsimiti dhe punësimi janë në marrëdhënie diakronike. Një herë ndodh arsimimi, pastaj punësimi.

Mirëpo, në jetën e një shoqërie është e kundërta. Nuk shkon një herë arsimimi e pastaj punësimi, por këto shkojnë në mënyrë sinkrone, jo diakrone. Pra, jo në mënyrë diakronike, por sinkronike, bashkërisht, duhet një plan zhvillimor nacional që arsimin dhe punësimin i trajton njëkohësisht.

Pra, ajo çka vlen për jetën e individit, nuk vlen për jetën e një shoqërie. Ky është gabimi i madh në orientimin e kësaj Qeverie. Këta mund të gjejnë metoda e mënyra të reja, por kot ti gjen mënyra të reja në shtegun e gabuar.

Nëse je nisur në tren për Ferizaj, mos fol për shpejtësinë, nëse ke gënjyer, ke thënë po shkojmë në Pejë. Pra, këta kanë hipur në tren të gabuar.

Ky është problemi, orientimin e kanë gabim. Kot flet për shpejtësinë ti kur orientimin e ke gabuar. Digjitalizo gjithë ditën, orientimin e ke gabim.

Pra, duhet plani zhvillimor nacional që arsimin dhe punësimin, arsimin dhe ekonominë i lidh bashkë. Këto i mungojnë Kosovës. Dhe, për derisa të mungojë kjo, do të kemi edhe kësi arsimit edhe këso ekonomie.

Për fund, unë besoj, ashtu sikur që tha ministri se nuk bën ta trajtojmë arsimin parafillor të ndarë prej atij universitar e anasjelltas, në fakt është më thellë se kaq.

Ne nuk duhet ta trajtojmë arsimin të ndarë prej ekonomisë. E, në Kosovë, nuk ka një plan të tërë, i cili e trajton arsimin në këtë mënyrë.

Pra, pika e cila ndodhet jashtë arsimit dhe e shpëton arsimin është plani zhvillimor nacional që e konsideron arsimin dhe ekonominë të lidhura me njëra-tjetrën dhe pjesë të një arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të filloj fjalën, të cilën e kam përgatitur, më duhet patjetër të ndalem në disa çështje, të cilat i preku ministri i Arsimit.

Në radhë të parë, brenga e të gjithë neve është vendosja si prioritet, të mos them i fundit, i kësaj Qeverie, i arsimit. Kush do të duhej ta vendoste këtë prioritet, për derisa gjatë gjithë kohës në fushata si partitë, PDK-ja dhe LDK-ja, vazhdimisht e proklamoni se arsimit do të jetë ndër prioritetet kryesore. Në fakt, kush do ta vendoste, përderisa edhe ministri Bajrami është ministër i kësaj Qeverie, të PDK-së dhe LDK-së.

Buxheti. Vërtet vendosja prioritet apo jo, tregon edhe një herë se sa është ndarë buxheti. E kush do të duhej ta ndante buxhetin për arsim, pos këtyre dy partive në pushtet, sepse para së gjithash i kanë numrat, sado që ne si deputetë individualisht kemi përmendur sa herë që buxheti për arsim është vërtet shumë, shumë i paktë.

Një çështje që vërtet është shqetësim, e që u përmend edhe Ligji i arsimit të lartë. Po e përmend, sepse sot ne e kemi këtu çështjen për arsimin parauniversitar, por megjithatë edhe ministri Bajrami e përmendi arsimin e lartë. Edhe unë e kam përmendur disa herë, edhe sot, por e kam edhe për të ardhmen një pyetje parlamentare për ministrin se nuk e dimë sot si është tërhequr Ligji për arsimin e lartë?

Ligji për arsimin e lartë në Kuvendin e Republikës së Kosovës është tërhequr në mënyrën më të pazakontë që mund të tërhiqet një ligj, as në bazë të Rregullores dhe për asnjë gjë, thjesht nuk e dimë ne si deputetë se ku është ai ligj, e që nuk është paraparë as tani në sesionin pranveror, pra në programin që e kemi para veti si Komision.

Pastaj, kur është periudha e mësimdhënësve të viteve të 90-ta, ligji asnjëherë nuk erdhi në Kuvend, sado që premtimet kanë qenë qoftë prej LDK-së, e PDK-së, edhe në mandatin e kaluar, edhe në këtë mandat, edhe nga ministri Bajrami qysh në muajin nëntor na ka thënë se do të vijë ligji dhe, edhe tash ai ligj nuk është kurrkund. Pra, punëtorëve të viteve të 90-ta nuk u njihet kontributi i tyre.

Është mirë, sikur që e përmendi edhe ministri, se do të presë në takim pronarët e shtëpive shkolla dhe vërtet është mirë që për momentin ministri mund t'u ndajë mirënjohje, por mirënjohjet e tyre janë të përjetshme, sepse e kanë dhënë atë që vërtet pakkush ka mund të bëjë.

Megjithatë, sot kur flasim për arsimin parauniversitar dhe vlerësimi i fundit ndërkombëtar PISA dëshmoi më së miri se gjendja e arsimit në Kosovë nuk është aspak e mirë. Dhe, natyrisht se për këtë konfirmim pothuajse u pajtuam të gjithë, sepse vërtet sado e dhembshme që të jetë, ajo është e vërtetë dhe nuk ndryshohet me fjalë.

Prandaj, duke qenë kështu, mendoj se është koha e fundit që institucionet përgjegjëse në vend dhe të gjithë ne bashkërisht të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm në funksion të konsolidimit të sistemit të arsimit dhe ngritjes së cilësisë arsimore.

Kjo kërkon punë dhe angazhim të madh, kërkon përkushtim dhe profesionalizëm. Në Kosovë përgjegjësit kryesorë për të zgjidhur problemet esenciale, me të cilat përballet sot arsimi, natyrisht se është Ministria e Arsimit.

Mirëpo, edhe pyetja ime është: Pse pikërisht ky vit i shpallur nga Ministria e Arsimit si vit i cilësisë, na doli të jetë e kundërta? Ministria e Arsimit dhe strukturat e saj duhet të ndryshojnë qasjen në udhëheqjen e arsimit në përgjithësi, duke filluar nga arsimi fillor, po edhe arsimi i mesëm i lartë.

Mësimdhënësit duhet të vlerësohen, por jo të gjithë njëloj. Duhet të stimulohen edhe me ngritje pagash mësimdhënësit e suksesshëm. Dhe, mësimdhënësit që kanë probleme shëndetësore, e fatkeqësisht nuk është numër i vogël, apo të natyrave të ndryshme, duhet të kenë edhe një mësimdhënës asistent deri në daljen e parakohshme në pension.

Përfshirja vazhdon të mbetet një problem i madh, sidomos në arsimin parashkollor, pra çerdhe, kopshte dhe arsimit parashkollor. Tha ministri se ndoshta dhe shpresojmë që në këtë vit të kemi rezultate në këtë drejtim. Nuk kemi, pra, përfshirje të plotë as në arsimin e detyruar, edhe pse sipas ligjit, është i obliguar.

Sa i përket arsimit të mesëm të lartë, po ashtu kemi probleme serioze dhe se shkalla e përfshirjes në këtë segment është më e vogla në regjion.

Te legjislacioni, përkundër paralajmërimit të ministrit Bajrami, që e përmenda edhe më herët, se do të bëhen ndryshime substanciale në këtë drejtim, kjo nuk po ndodh.

Vazhdimisht e kemi përmendur se Ligji për arsimin në komuna dhe Ligji për vetëqeverisje lokale është bazamenti që u jepet e drejta kryetarëve të komunave të emërojnë drejtorët e arsimit, në radhë të parë, të shkollave që vërtet është ndërhyrje direkte e politikës në procesin e arsimit.

Pastaj, korniza e re e kurrikulës së Kosovës... ish-ministri Hoxhaj që vjen prej PDK-së, sepse ministrat në vazhdimësi, edhe ministri paraprak, edhe ministri aktual, të gjithë janë nga Partia Demokratike e Kosovës dhe nuk mund të themi se duhet ta hedhim fajin që nga periudha e paraluftës atje.

Ai kishte premtuar se korniza e re do të zbatohet në fillim të vitit 2011/2012. Tani kemi hyrë në vitin 2017 dhe kjo kornizë ende po pilotohet. Rezultatet e pilotimit kanë dëshmuar se kjo kornizë e mbështetur në kompetenca nuk mund të zbatohet në shkolla, të cilat punojnë në dy e tri ndërrime.

Dhe, për kushtet elementare për zhvillimin e procesit mësimor. U përmend edhe më herët, vërtet nxënësit që në paralele janë 45, nuk mund të themi se do të bëhet një arsim dhe mësim cilësor.

Te rishikimi i teksteve. U përmend edhe dje, në një takim që e kishim me ekspertë, se rishikimi i teksteve më tepër është bërë në mënyrën teknike, dhe jo në përmbajtje. Sado që Ministria e Arsimit vazhdimisht po e thotë se është bërë rishikimi në rreth mbi 80%, por nga ekspertët, e unë nuk jam eksperte në këtë fushë dhe s'e kam parë rishikimin e tyre, por nga ekspertët është thënë se vetëm teknikisht janë rishikuar ato tekste dhe asgjë nuk ka ndryshuar në përmbajtje.

Tani, nëse ne kemi edhe pika të tjera, që është vlerësimi, ashtu sikur që thanë parafolësit, vlerësimi paraqet një pikë shumë të dobët të sistemit të arsimit dhe këtë vërtet e konfirmoi edhe një herë testi PISA.

Depolitizimi. Ne duhet të largojmë politikën nga arsimi, sepse është mënyra më e mirë që profesionalizmi të mbizotërojë, e jo politika. Dhe, nëse vazhdojmë me politika të tilla arsimore, joefektive, me politizim dhe partizim të skajshëm, rezultatet e testit PISA në vitin 2018 dyshoj se do të jenë prapë të njëjta. Pra, ndër rekomandimet që ne i kemi, është edhe Kuvendi i Kosovës si organ më i lartë legjislativ urgjentisht duhet të formojë një komision të ekspertëve nga të gjitha subjektet politike, shoqëria civile e ekspertët ndërkombëtarë, për të siguruar një strategji dalëse nga kjo amulli.

Ne normalisht që nuk mund t'i ikim asaj, se vërtet çdoherë, nëse shikohet Raporti i Progresit që nga viti 2008, vit pas viti cilësia e arsimit është nevojë urgjente për përmirësim në të gjitha segmentet.

Ndër fushat që do të duhej të ndërhyhej, sipas meje është që duhet të ndërhyhet në plan-programe të reja, të cilat vërtet nuk janë dhe ka vjet që ato nuk kanë ndryshuar fare. Vlerësimi i mësimdhënësve, pra të bëhet me shkallëzim, që e përmenda edhe pak më herët.

Riorganizimi i mësimdhënësve në shkollimin fillor. Duhet bërë analiza dhe vlerësime të sakta dhe një riorganizim i tillë të ndodhë.

Tekstet shkollore kanë vërtet pasaktësi. Janë shumë të mbingarkuara dhe nuk nxisin mendimin kritik. Dhe, po ashtu tekstet mësimore nuk janë të konceptuara në përputhje me filozofinë e kurrikulës së re të Kosovës.

U përmend digjitalizimi. Është shumë i nevojshëm, por vërtet është shqetësim, sipas meje, sepse nëse në shkolla nuk ka kompjuterë dhe nxënësit nuk mund të takohen një herë me kompjuter në një kabinet, ku do të duhej të kishte kompjuter, dhe le mësimdhënësit që vetëm në zyrën e drejtorit ka ndonjë kompjuter dhe mësimdhënësit nuk kanë kompjuter, dhe të gjithë atë përvojë që e kanë marrë edhe nga trajnimet, për çka janë dhënë miliona euro për Programin ECDL dhe Ministria e Arsimit asnjëherë nuk e ka monitoruar, dhe sado që janë shpenzuar diku rreth 12 000 000 euro, ato njohuri që janë marrë asnjëherë nuk kanë pasur ku t'i aplikojnë dhe normalisht se diçka teorike që nuk praktikohet, mund të harrohet.

Prandaj, të gjitha këto masa dhe veprime duhet filluar t'i ndërmarrim menjëherë, nëse duam të sigurojmë një arsim cilësor.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Nëse ta mundëson grupi, vazhdo, s'ka problem! E ke minutazhin e grupit, deri në fund e harxhon, por të keni parasysh se ndoshta do të flasë edhe dikush tjetër.

TEUTA HAXHIU: Nganjëherë numrat janë vetëm sasi, por të tjerët janë cilësi. Prandaj duhet të merren masa e veprime të nevojshme dhe menjëherë, nëse duam të sigurojmë një arsim cilësor për të ardhmen e vendit.

Nuk do të kemi kurrë shtet të mirëfilltë në shërbim të qytetarëve, ku do të funksiononin të gjithë mekanizmat shtetërorë si tërësi pa cilësi arsimore.

Dhe, në fund, rekomandimet të cilat i ka Lëvizja "Vetëvendosje", ne do t'i kemi rekomandimet tona, e ndër to do të jetë edhe respektimi i plotë i Kontratës Kolektive, të proklamuar e të nënshkruar me eufori nga ministra e ish-ministra, e cila nuk po zbatohet në tërësi, por edhe disa rekomandime të tjera, siç është edhe Ligji për periudhën e viteve të 90-ta, të cilat do të tentojmë t'i harmonizojmë edhe me grupet e tjera.

Unë e falënderoj edhe një herë iniciuesin e kësaj interpelance, është shumë me rëndësi të kemi debate, siç e tha ministri, por është mirë që të kemi debate dhe të tregojmë rezultate, e jo të mbajmë minutazh gjysmë ore apo 40 minuta dhe të mos themi kurrëgjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Shala, në emër të "Nismës".

(Ndërrhyrje: Në emër të grupit...)

Shukrije Bytyqi: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjendja në arsim që është e vështirë, u tha edhe nga parafolësit dhe nga ekspertët, po hapa konkretë nuk shihen.

Ne e dimë se prej koalicionit të tanishëm aktual është premtuar shumë se do të zhvillohet arsimi dhe prioritet le të jetë arsimi gjatë kësaj qeverisjeje, por në realitet, gjatë kësaj qeverisjeje arsimi vetëm sa ka degraduar.

Pra, pse pikërisht ky vit, i shpallur nga Ministria e Arsimit si vit cilësor, po dështon, po shihet e kundërta. Do të thotë, kisha dashur të kemi një përgjigje nga ministri që të dihen cilat janë defektet që nga marrja e mandatit të tij, për çka që në fillim është bërë shumë bujë për të se ky vit do të jetë vit i cilësisë, do të jetë vit i reformave, e në realitet, e patëm edhe rezultatin e dobët dhe nuk po shohim ndonjë zhvillim konkret.

Mendoj se defektet kryesore për këtë gjendje në arsim janë nga Ministria e Arsimit. Dhe, për t'i zgjidhur problemet që sa vijnë e rëndohen në sistemin arsimor, nuk mjafton vetëm të analizohet e programohet, por edhe të veprohet konkretisht.

MASHT-i ka përqaftuar dhe pranuar reforma të sistemit arsimor, duke mos bërë asnjë analizë. Do të thotë, prej pas luftës ne kemi marrë disa reforma dhe asnjëherë s'është bërë ndonjë analizë. Dhe reformat janë të mira kur analizohen, respektohen dhe menaxhohen mirë, por edhe kur krijohen kushtet dhe pastaj të fillojë reformimi.

Nëpër shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës punojnë numër i madh i mësimitdhënësve të pakualifikuar, të padiplomuar dhe kjo lë për të dëshiruar. Asnjë hap nuk është marrë për këtë gjendje, do të thotë, përgjithësisht një numër shumë i madh i mësimitdhënësve në shkollat tona, edhe në arsimin fillor, edhe në arsimin e mesëm, janë të padiplomuar.

E kemi vlerësimin e jashtëm, që bëjnë testet e arritshmërisë për klasat e nënta, ose në edukimin fillor dhe testin e maturës.

Ndikimi i shoqërisë dhe presioni i madh ka bërë që shoqëria jonë të nxitet për rezultate, e ka bërë efekte të kundërta, duke mos arritur dëshirën dhe interesin për të mësuar, por vetëm duke u interesuar sa për të pasur një diplomë. Pra, gjithçka është kthyer në një diplomë dhe jo në dije.

Reforma e testit të maturës, e cila me konceptimin e saj, shumë bashkëkohor, synoi të vinte në baraspeshë me vlera të secilit, u kthye në të kundërtën dhe si rezultat të pakujdesisë, keqadministrimit, dëshira për t'u bërë human si nga mësimitdhënësit, si nga administratorët, por edhe të tjerët.

Do të thotë këtë dështim të testit të arritshmërisë dhe testit të maturës e ka pranuar edhe vetë Ministria e Arsimit, por realisht hapa konkretë për këtë nuk ka.

Problematika të bujshme dhe shqetësuese sa herë që fillon viti shkollor janë tekstet, janë çantat e stërngarkuara të nxënësve, që bëhen vetëm sa për përfitime materiale dhe përfitime klanore. Do të thotë cilësia e teksteve është jo e kënaqshme, e gjithashtu edhe përmbajtja, që ka mangësi edhe në aspektin pedagogjik.

Për miratimin e teksteve është mirë të zbatohet një procedurë më e hapur, më transparente, duke përfshirë edhe mësuesit si zbatues të njohjes së mirë të programeve dhe problematikave shkollore.

Kështu, mund të shmanget çdo ndikim i jashtëm dhe monopol i dëmshëm.

Viteve të fundit është shumë me rëndësi pyetja se çfarë po bëjmë ne me mësuesit këto vite?

Kjo pyetje do shumë përgjigje dhe do të lakohej shumë nëse do të shohim manipulimet e politikës me mësuesit. Mësuesit, me dashje ose pa dashje, janë bërë pre e fushatave elektorale.

Duke qenë se arsimi është ndër sektorët shtetëror të punësimit, politika e ka shfrytëzuar këtë mundësi për të krijuar përfitime elektorale. Ndikimi i saj ka bërë që edhe një mësues i thjeshtë të mos e ndiejë veten të qetë kur vjen shtatori, por të presë me ankth emërimet, lëvizjet, lakimet dhe problematikat e tjera. Do të thotë, këtë e kemi për çdo vit shkollor anekënd Kosovës.

Tjetër shqetësim është se mësuesi ndoshta është i vetmi profesion që ka mbetur të vlerësohet si në komunizëm, do të thotë të gjithë të barabartë. Nuk bëhet vlerësim, nuk dihet kush është mësues më i mirë, kush është mësues më pak i mirë, se mësues të keq nuk ka.

Do të thotë nuk kemi një analizë të mirëfilltë të mësuesit, dhe mësuesit e mirë më nuk kanë vullnet shumë të madh të angazhohen e të rikualifikohen, kur gjithçka varet prej politikës dhe nuk vlerësohet mësuesi, paguhen të gjithë njëjtë, sikur ai që punon mirë, si ai që s'punon mirë.

Vetëm për kënaqësi, kur për punë, dhe jo përgjegjësi të barabartë të gjithë mësuesit paguhen njësoj, sipas asaj skeme që është absurde, skemë që ka funksionuar vetëm në socializëm për kategorizimin e mësuesve sipas vjetërsisë, kur dihet se të jesh më i vjetër në punë nuk do të thotë se je më i miri.

Kjo ka bërë që të gjitha reformat, ndryshimet dhe zhvillimet në arsim të përcillen me indiferentizëm nga një pjesë e mësuesve, pasi që për ta mjafton të kenë në diplomë, një mik, një njohës e kështu me radhë dhe pozicioni i tyre dhe paga nuk do të ndryshojë.

Kjo praktikë duhet ndaluar, sepse po krijon probleme serioze në arsim. Mësuesi si çdo profesion, duhet motivuar, të rritë profesionalizmin e tij, por nga ana tjetër, duhet vlerësuar, analizuar dhe duhet të mos i shkelet e drejta e tij për ndryshime të errëta politike.

Duke u ndalur te zhvillimet e arsimit, mund të themi përmendsh se më tepër është bërë bujë në infrastrukturë, ku shumica e shkollave, si në vende urbane si në ato jurbane, e kanë një infrastrukturë të mirë shkollore, por nuk kanë mjete konkretizimi, nuk kanë praktikë. Gjithashtu është bërë numri i madh i nxënësve në klasë.

Tjetër problematikë në arsim është edhe legjislacioni. Legjislacioni në arsim është i mangët, është i përpiluar në favore politike, në kundërshtim me ligje të tjera që prekin arsimin, udhëzimet administrative në MASHT nxirren për teke të dikujt dhe qejfe të dikujt, nuk respektohen ose nuk nxirren udhëzimet administrative për atë që duhet. Ne kemi rast që brenda dy javëve ndoshta i nxjerr dy udhëzime administrative, që për mua është shumë absurde.

Ajo që neve na nxiti reagimin më të madh e që ne duhet njëherë e përgjithmonë të ndalemi dhe të shohim se ku jemi, është rezultati i dobët i testit PISA.

Në vitin 2015 është mbajtur testi ndërkombëtar PISA në shumë vende ndërkombëtare, ndër to edhe në Republikën e Kosovës, që ka treguar rezultat të dobët në këtë test. Shtrohet pyetja, cilët janë faktorët? Kur flasim për faktorët duhet të jemi shumë realë, domethënë mund të flasim për dy faktorë: faktorët përgjegjës ligjorë dhe faktorët përgjegjës moralë, e në këtë rast përgjegjës më të madh janë faktorët ligjorë.

Faktor përgjegjës ligjorë së pari do të ndalemi, për arsye se ata i bëjnë politikat. Këta faktorë, para se të përmendi disa nga ta, duhet të saktësoj se faktori me përgjegjësinë më të lartë është MASHT-i dhe Qeveria e Kosovës. MASHT-i themi për arsye duke filluar nga politika e arsimit jo të mirëfilltë, te politika që nuk sjellin cilësi në arsim, duke e përgatitur së pari legjislaturën, kuadrin arsimor, infrastrukturën shkollore e tjerë.

Nëse ndalemi te programet që përgatisin mësimdhënës për ciklin fillor, së pari duhet të kenë prioritet lëndët bazë shkrim-leximin. Nëse dalim dhe e shohim se kush përgatit mësimdhënës, përgatit Fakulteti i Edukimit, që është bërë një monopol. Domethënë, programi fillor në universitetin tonë është program për mësimdhënës të ciklit prej 1 deri 5, dhe programi pedagogjik, që nuk ka të bëjë me këtë nivel fillor. Dhe, çka bën MASHT-i? Nxjerr udhëzim administrativ, që i jep të drejtë të punojnë në arsimin fillor edhe pedagogët. Domethënë pedagogët nuk e kryejnë punën e tyre pedagogjike, por janë mësimdhënës. Rreth 30% e kuadrin mësimdhënës në ciklin fillor janë pedagogë, që ata është mirë të ndihmojnë mësuesin në aspektin pedagogjik, e jo të jenë mësimdhënës.

Tjetër shqetësim çka është? Ne e dimë se kolegjet private nuk janë të akredituara për mësimdhënës, e ne na janë mbushur shkollat me mësimdhënës të kolegjeve private dhe ata janë të dalluar se cilët kanë të drejtë. Domethënë nxirret udhëzimi administrativ, vlen për filan kolegjin që ai ka të drejtë të përgatisë mësimdhënës. Këto pra janë shqetësime shumë të mëdha që ne duhet t'i kemi prioritet të gjithë.

Pastaj, rënia e cilësisë së arsimit edhe në universitetin publik, meqë shumë studentë përfundojnë studimet falë interesave politike, klanore, nepotiste, mijëra të rinj të diplomuar e në realitet ata nuk e gjejnë askund veten në tregun e punës.

Faktorë tjerë përgjegjës unë i shoh të gjithë, duke filluar prej drejtorive të arsimit, drejtorëve të shkollave, mësimdhënësit, por edhe prindërit, që lejojnë që gjithsecili ose kujt t'i teket ta mësojë fëmijën e tyre. Domethënë, folëm për kuadrin që lë për të dëshiruar. Infrastruktura shkollore, në aspektin e infrastrukturës, MASHT-i ka shpreh interesim shumë të mirë, domethënë është mirë që janë bërë disa shkolla, por ato janë bërë më tepër për tenderomani, ato objekte shkollore, dhe

ato shkolla përgjithësisht gati nuk janë duke i plotësuar kushtet për një arsim cilësor, se thamë që mungojnë edhe mjetet e konkretizimit, hapësirat për punë laboratorike.

Tjetër çka është shqetësim? Ne tani e kemi në shqyrtim Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor. Ne do të kishim qenë shumë të kënaqur sikur të jetë një organ i pavarur, por Ministria e Arsimit dhe Qeveria jonë ka dëshmuar që te ne nuk ka të pavarur. E kemi një agjenci të arsimit profesional që ka krijuar një monopol, i ka marrë disa shkolla mbi udhëheqje, ua ka marrë edhe buxhetin, i cakton mësimdhënësit sipas tekeve tyre, domethënë nuk ka treguar ndonjë rezultat. Inspektorati, 90% i ka joprofesionistë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ke më kohë, e ke shpenzuar krejt kohën e grupit parlamentar! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Mufera Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Sayın Başkan Vekili,

Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri

Bugün okul öncesi ve Üniversite öncesi eğitim tartışılıyor. Bakanın konuşmasında toplulukların eğitimiyle ilgili hiçbir kelime konuşmaması bizleri derinden üzmüştür. Bence Kosova'daki genel eğitim ile birlikte topluluk dillerindeki eğitime değinmek gerek.

Bu durumda Kosova'daki Türkçe eğitimden bahsetmek istiyorum.

Kreşlerden başlayarak sıkıntıları varlığı göze batmaktadır.

Anaokullarına baktığımızda her okulun anasınıfının olmayışı ve var olanlarının da yer darlığı yüzünden dersin akışı engellenmektedir.

Diğer dillerdeki anasınıfının donanımı Bakanlık yada Belediyeler tarafından sağlanırken, Türkçe eğitim sağlanan sınıflarda sadece TİKA ve MEHMETÇİK tarafından donanımı sağlanmaktadır. Anaokullarının araç gereçleri hiçbir şekilde KEBT Bakanlığı tarafından sağlanmamaktadır.

İlkokul I. kademe ders kitapları olması yetersiz kalıyor, çünkü ne iş defteri ne de yardımcı ders kitapları mevcut değil.

Aynı zamanda öğretmenlerin el kitapları yok.

İlkokul II. kademe aynı şekilde ders kitapları dışında az önce saydığım yardımcı ders kitaplarıyla birlikte Haritalar, Küre ,Elementlerin Perodik Cetveli, Biyoloji ve diğer derslere ait Resim ve Çizimlerin olmayışı kaliteli derslerin yapılmasını engellemektedir.

Matematik - Fizik - Kimya - Biyoloji - Teknoloji dersleri Laboratuarların olmayışı derslerin yıllardır alışıla gelmiş şekilde kuru - kuruya geçmesine sebep olmaktadır.

Liselerdeki Eğitim durumu çok daha vahim durumdadır. Kitapların olmayışı derslerin normal akışını engellemektedir. İlkokullardaki bütün sıkıntılar Liselerde de yaşanmaktadır.

Ders kitaplarının ve araç ile gereçlerin olmayışı Türkçe Eğitim gören öğrencilerimizin

- Çocuk Hakları,

- İnsan Hakları ve

- Topluluk Hakları ihlal edilerek, yasal ve anayasal hakları da çiğnenmektedir.

Okullardaki yazılı bildirimlerin, uyarıların, gelen evrakların diğer dillerle birlikte Türkçenin kullanımına da saygı duyulmasının gerektiğini vurgulamak isityorum.

- Okullarda Pedagog, Psikolog ve Rehber öğretmen olmalı,

- Çalışamaz halde olan öğretmenlere malüllük emekliliğe ayrılma imkanı yaratmak gerek,

- KEBT Bakanlığı Türk öğretmenlerine Türk dilinde Eğitim seminerleri düzenlemeli,

- Yıllardır vurguladığımızın çantaların ağırlığından öğrenciler kurtulmalı. Okullara ek dolaplar yapılarak, öğrencilerin çanta taşımaktan fiziki yapısını bozmasını engellememiz gerekir,

- Eğitim müdürlüklerine Türkçe tercüman sağlanmalı,

- Türkçe eğitim yapılan okullarda müdür ya da müdür yardımcılarının atanmaları ve varolan Müdürlerin Türkçe ve Boşnakça kursa tabi tutulması gerek,

- Kosova genelinde Türkçe Eğitim müfettişinin olması gerekli,

- KEBT Bakanlığında Türkçe Eğitim Masasının kurulması ile birlikte Eğitimin kalitesinin artacağına inanmaktayız.

- Arnavutluk'ta ortak ders kitaplar ve ortak alfabeyi planlarken, Kosova müfredatıyla çalışan topluluk öğrencileri için stratejiniz nedir?

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Të nderuar,

Pa dyshim që debati i sotëm për arsimin është ndër debatet më të rëndësishme për faktin që arsimi është prej pjesëve më të rëndësishme në shoqërinë tonë, është fundament i edukimit të brezave të rinj dhe shoqërisë kosovare, në përgjithësi.

Janë shumë faktorë, të cilët kanë bërë që arsimi të jetë i fundosur, të jetë me rezultate jo të mira, kemi edhe një pasqyrë së fundmi të rezultatit të PISA-s, që paraqet pasqyrën e gjendjes së arsimet në Kosovë. Mendoj që janë shumë faktorë që kanë ndikuar që arsimi të jetë në këtë gjendje, ndër ta pa dyshim është ndikimi i politikës, apo më mirë të themi i disa politikanëve, të cilët kanë ndikuar në arsim, të cilët në momente të caktuara nuk kanë ngurruar, ndoshta edhe diplomë universitare, ndoshta tituj shkencorë të marrin pa e parë fare fakultetin me sy.

Raste të tilla kemi fatkeqësisht edhe në Parlamentin e Kosovës, ku politikanë të tillë me diplomë të kontestuar universitare japin edhe mësim në Fakultetin e Mjekësisë, e aktakuza e tillë e ngritur është nga Prokuroria e EULEX-it, e cila e ka dorëzuar lëndën në Prokurorinë Speciale. Fjalën konkrete e kam për deputetin e Kuvendit të Kosovës Bekim Haxhiu, i cili para pak çastesh më citoi në shumë kritika, por e kam të pamundur t'i përgjigjem për faktin se deputeti Bekim Haxhiu e ka një aktakuzë nga Prokuroria e EULEX-it për diplomën e kontestuar universitare. Do të thotë nuk e pranon legjitimitetin, e akuzon që ka falsifikuar atë diplomë dhe unë për vete e kam të pamundur t'i përgjigjem për kritikën që m'i drejtoi pak çaste më parë për faktin se e di një gjë nuk ka diplomë universitare, sipas EULEX-it. Ndërsa, unë nuk e di a ka edhe shkollë të mesme, kurse kritikën që i drejtoi ndaj meje për një periudhë parahistorike mbi 400-vjeçare është një temë shumë e ndjeshme dhe mendoj që kapaciteti i tij nuk di a do ta përballojë përgjigjen time. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me zonjën Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Paraprakisht ndiej obligim moral që t'i falënderohem iniciuesit për interpelancë dhe gjithashtu e falënderoj edhe ministrin e Arsimit që i shpalosi në mënyrë detaje angazhimet dhe objektivat që janë bërë në Ministrinë e Arsimit kohëve të fundit dhe synimet për të ardhmen, me të vetmin qëllim që të kemi gjenerata të edukuara mirë, të ditura dhe të gatshme për tregun e punës.

Asaj çfarë tha ministri nuk mund t'i heqim asnjë pikë e asnjë presje, por çka kërkohet të bëjmë ne si institucione, në rend të parë si Kuvend, pastaj si Qeveri dhe si shoqëri në tërësi? Është se duhet përkrahur, duhet ndihmuar dhe duhet të interesohemi që në këto angazhime, në realizimin e këtyre synimeve, vërtet të ndihmojmë që të kyçen ekspertët, duke filluar nga niveli parafillor e deri te niveli universitar.

Fëmijët tanë, sikur edhe ne në të kaluarën, mësimet e para, shprehjet e para i marrin në familje, dhe unë mendoj që ne si institucione po bëjmë pak që të ruhet institucioni më i fuqishëm i një shoqërie, institucioni i familjes, që fëmijët t'i marrin hapat e parë të dijes në familje të shëndosha. Dhe, qasja ndaj institucionit të familjes për të kaluar pastaj qasja në institucionet e dijes në formë të organizuar nëpër shkolla, kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë neve, pavarësisht se ku jemi, sa veprojmë, si veprojmë dhe çka bëjmë.

Që gjendjen në arsim ta cilësojmë të mirë apo jo të mirë, të keqe apo shumë të keqe, kjo varet gjithmonë nga ajo se nga cili kënd i qasemi analizës dhe vijmë në përfundim për mendimin tonë se kemi gjendje jo të mirë, apo të mirë. Realisht të gjithë pajtohemi në një pikë, ku kërkohet investim në arsim, investim në të gjitha fushat që ndërliken me edukimin dhe mësimin e

fëmijëve në shkollimin parauniversitar. Ajo çka unë mendoj është se kemi ende pengesa ligjore. E para, decentralizimi i arsimit në komuna - deri më tash u është dhënë mundësi komunave, udhëheqjeve komunale që në njëfarë forme ta vënë në lojë mësimdhënien dhe një pyetje e thjeshtë është: kur një mësimdhënës për nëntë muaj rresht, sa është në procesin e mësimdhënies, është me ethe se me përfundimin e vitit shkollor do t'i shpallet konkursi dhe nuk e di nëse do t'i vazhdohet kontrata e punës, domosdoshmërisht se sado mësimdhënës profesional të jetë, kur vepron nën ndikimin e etheve për vazhdimin e kontratës së punës apo jo, ai nuk do të mund të jetë mjaftueshëm rezultativ në punën me fëmijë.

Vendosja e drejtorëve duke mos i respektuar udhëzimet administrative pa asnjë vlerësim të performansës, vetëm pse ndërrojnë udhëheqjet komunale në zgjedhje dhe duhet t'i ndërrojnë drejtorët, vetëm pse një grup është më i fuqishëm pranë kryetarëve të komunave dhe duhet edhe gjatë mandatit katërvjeçar të udhëheqjeve të komunave t'i ndërrojnë drejtorët, kjo shkakton në një formë destabilizim në menaxhimin e shkollës dhe në procesin e mësimdhënies nëpër shkolla. Për të mos i numëruar të gjithë faktorët, të cilët po ndikojnë dhe për të cilët jemi të gjithë bashkë bashkëfajtorë, unë do të ndalem në faktin e ligjëvënies siç e përmenda në fillim, do të thotë të legjislacionit, se menaxherët nëpër shkolla, inspektoratet duhet ta njohin mirë ligjin, duhet të rishikohet edhe njëherë infrastruktura ligjore dhe të eliminohen të gjitha mundësitë e interpretimit të shumëfishtë të një dispozite ligjore apo udhëzimi administrativ, dhe më pastaj zgjidhja duke u thirrur në ligj të bëhet sipas interesave për raste të caktuara.

Do të thotë nuk kemi një unifikim të vlerësimit në aspektin e rrafshit ligjor për raste të njëjta. Çështja tjetër, shumica e të punësuarve janë në sektorin privat. Sektori privat vepron në mënyrë jo të formalizuar. Aty nuk respektohet as Ligji i punës, dhe çfarë kujdesi mund të ketë një prind në raport me fëmijën e tij për zënien e dijes në shkollë, apo për sjelljen e tij jashtë shkollës, kur ai punon shtatë ditë në javë nga 10 orë, kur ai as në ditët e festës nuk është në shtëpi që t'i përkushtohet me një kujdes të shtuar fëmijës së tij gjatë shkollimit parauniversitar, kur për çdo veprim të atij fëmije edhe ligjërisht është përgjegjës vetë prindi.

Ajo që unë mendoj se duhet ndihmuar në realizimin e këtyre objektivave, çka u tha nga ministri dhe që mjaft jemi të përafuar me përgatitje, është se ministri e ka përmendur edhe këtu në këtë Kuvend dhe duhet edhe ne si deputetë t'i japim mbështetje, por edhe Qeveria, që ta nxjerrim ligjin, apo ta hartojmë dhe aprovojmë ligjin për pensionim të parakohshëm të mësimdhënësve. Pse? Kemi mësues dhe shumë mësimdhënës që me vështirësi, dikush më të mëdha e dikush më të vogla, ka arritur t'i mbijetojë vitet e '90-ta në procesin e mësimdhënies. Puna e tyre është për t'u lavdëruar, për t'u pranuar dhe për t'u njohur nga institucionet, por varësisht nga krizat që kanë kaluar familjet e tyre dhe vetë ata gjatë procesit të mësimdhënies, kjo kanë ndikuar mjaft në shëndetin e tyre, në dobësimin e tyre shëndetësor dhe ata e kanë të vështirë të pranojnë njohuri të reja në aspektin e metodologjisë së mësimdhënies.

Por, e kemi edhe kategorinë tjetër të mësimitdhënësve, të cilët nuk kanë arritur mjaftueshëm të inkorporohen në sistemin e ri të mësimitdhënies dhe kanë mbetur me mentalitetin e së kaluarës dhe absolutisht nuk e pranojnë zhvillimin e mendimit kritik, interaktivitetin e mësimitdhënies, por ende vazhdojnë me metodologjinë e vjetër mësuesi ciceron - ligjëron, fëmija dëgjon dhe në fund fëmija duhet të përgjigjet saktë. Këto metodologji tashmë nuk janë të pranueshme në kohën bashkëkohore dhe për këtë arsye duhet që patjetër ta kemi ligjin për pensionim të parakohshëm të mësimitdhënësve dhe i kemi dy të mira: përfitim të nxënësve dhe mundësinë e punësimit të kuadrove të reja, që jam e bindur që janë mjaftueshëm të përgatitura.

Çështja e PISA-s që po përmendet këtu, ne duhet ta marrim këtë si moment shumë të rëndësishëm dhe ta vlerësojmë nga këndi pozitiv, mendoj unë, sepse sa më herët të mund ta vërtetojmë gjendjen tonë faktike, mundësinë e shprehjes së asaj çka ne mësojmë, aftësinë dhe gatishmërinë e nxënësit, që në një moment të caktuar mund të intervistohet, mund t'i nënshtrohet ndonjë pyetësori për një çështje të caktuar, ne më herët i ndërmarrim veprimet për ta korrigjuar vetveten.

Rezultati i PISA-s nuk është rezultat negativ, që nxënësit tanë nuk dinë, sepse po kësi nxënës që shkollohen këtu dalin të shkëlqyeshëm në universitete anekënd botës, madje edhe sigurojnë vende pune në vendet më të zhvilluara të botës dhe po të ishin aq të dobët nuk do t'ia arrinin. Por, ky është një rezultat i të gjithë neve si shoqëri. Pse? Në kohën kur është lansuar projekti PISA në Kosovë nuk kemi arritur që ta përgatisim mendimin e përgjithshëm shoqëror, opinionin e përgjithshëm shoqëror se tash ne do të vlerësohemi nga dikush, që në mënyrë objektive do të na i japë rezultatet tona.

Dhe, për të mos e zgjatur më shumë, unë edhe një herë e përsëris se çdo vlerësim pavarësisht a na jep rezultate pozitive apo negative, ne duhet t'i pranojmë si shoqëri, t'i pranojmë në adresë të duhur dhe t'i qasemi zgjidhjes së tyre pozitive, sepse sa më herët t'i vërejmë defektet tona, aq më herët i përmirësojmë ato dhe bëhemi të gatshëm që të garojmë edhe në raste si në testin PISA me vendet ku arsimit është i zhvilluar dhe niveli i shoqërisë është më i përgatitur pro dinamikës së zhvillimit të përgjithshëm të globalizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Melihate Tërmkollli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, ne sot e dëgjuam një fjalë goxha të gjatë nga ministri, nuk ishte bile as ligjëratë, se po të kishte qenë ligjëratë kishim mësuar diçka, por ishte njëfarë demagogjie e pafund e krejt asaj çka tha, sepse nuk tha kurrëgjë lidhur me temën për të cilën ne jemi thirrur sot këtu për të diskutuar dhe ndoshta ta gjejmë ndonjë zgjidhje.

Në fakt, një pjesë e madhe të fjalës ia kushtoi edhe arsimit të lartë, që ne nuk e kemi temë sot arsimin e lartë, ndoshta një ditë tjetër do të duhej ta kemi vërtet arsimin e lartë. Por, veç sa për t'ia përkujtuar një objektiv për arsimin e lartë, që është dhënë nga Qeveria e nga ministria, se jemi të interesuar dhe po bëjmë çmos që ta kthejmë trurin në Kosovë, me demokraci ata që shkollohen jashtë për t'i kthyer në Kosovë, Ministria e Arsimit, për shembull për nostrifikim të diplomave, ua ka bërë çmimin nga 20 euro në 50 euro. Ky është kontributi i ministrisë për ta kthyer trurin në Kosovë!

E tash, t'u kthehemi temave për të cilat po diskutojmë. Në fakt, problemi mendoj se është te politika arsimore në Kosovë, dhe jo veç politika arsimore, por politika në përgjithësi, sepse politika arsimore është rrudhë, është reduktuar në menaxhim teknik të arsimit, dhe jo në politikë arsimore. Tha dikush këtu se nxënësit kanë treguar rezultate të dobëta në PISA. Absolutisht jo! Mendoj që rezultat të dobët ka treguar politika arsimore në Kosovë, jo nxënësit tonë. Nëse dikush është më i pafajshëm në këtë rezultat, janë pikërisht nxënësit tanë.

Në fakt, ministri tha se në qoftë se, pas 2-3 muaj sa kanë dalë këto rezultate, nëse sot bëhet një test tjetër, atëherë rezultati do të dalë më i mirë. Nuk e di ministri a po na mendon aq injorantë këtu krejt deputetët, apo krejt qytetarët e Kosovës. Vërtet aq injorantë jemi ne që të mos e dimë se çfarë paska ndodhur për 2-3 muaj? Çka ka ndodhur në këtë vend, çka ka ndodhur me arsimin e Kosovës, një zhvillim pozitiv, që për një dy-tre muaj po u dashka me... që paskemi rezultate më të mira, se sa ato që i patëm para dy-tre muajsh. Kjo është një diçka shumë absurde, të cilën nuk e di ministri si ka mundësi ta thotë. Edhe prioritet nuk e ka Qeveria prioritet arsimin, po madje as Ministria e Arsimit nuk e ka prioritet arsimin e kjo është edhe më e keqe dhe këtu qëndron problemi më i madh. As vetë Ministria e Arsimit nuk e ka prioritet arsimin, cilësinë e arsimit edhe krejt atë çfarë zhvillohet me arsimin.

Unë e di që keni bërë shumë fjalë, shumë fjalë janë bërë, jo keni bërë, po kemi bërë të gjithë, edhe më herët, në rezultatet e mëhershme, e tjerë..., se vazhdimisht kur ka probleme ne kthehemi e themi "jo, po më herët ato qeveritë, ministrat e mëhershme kanë pasur probleme..." aty e gjejmë mbështetjen gjithmonë a. Eh po tash, nëse është ashtu, pse ka nevojë atëherë për ministër, e tjerë?... Në fakt, ne kemi bërë zhurmë aq të madhe kur janë ndërtuar disa shkolla, kur një ministër krejt një mandat ia ka kushtuar veç ndërtimit të shkollave dhe kemi thënë se është ministri më i mirë në Kosovë.

A është ndërtimi i shkollave, sigurisht se është shumë i rëndësishëm, po merrni shikoni, gjysma e atyre shkollave janë jofunksionale. Edhe ato që janë funksionale, pas një muaji, pas dy muajsh, rrjedh uji, bëhet aty... nuk mund nxënësi të hyjë hiç nëpër shkolla, e tjerë...

Do të fokusohem në nja dy çështje. Ndoshta, sot pak më shumë minuta po marr, se gjithnjë nga dy-tre, kështu që sot keni pak durim, se gjithnjë nga dy-tre minuta i marr, nuk marr më shumë kohë.

Ne kemi një numër tepër të madh të lëndëve, janë nga katër-pesëmbëdhjetë lëndë, nuk e di a keni marrë ndonjë shembull diku tjetër në Botë, qysh... sa i përket cilësisë së arsimit. A mundet një nxënës dhjetëvjeçar, njëmbëdhjetë a dymbëdhjetëvjeçar me nga katër-pesëmbëdhjetë, për shembull, ose pesë-gjashtëmbëdhjetë lëndë mësimore? Përmbajtja e lëndëve, merrni shikoni në shumicën e rasteve përmbajtja e atyre lëndëve është jashtë kohës. S'po flas për këto, ndoshta ekzakte që janë e tjera... , po sidomos në këtë pjesën shoqërore të arsimit e tjera, janë jashtë kohës. Madje, ka edhe gabime të mëdha, të cilat i kemi përmendur edhe vitin e kaluar edhe më herët dhe që asnjëri prej atyre gabimeve nuk është evituar. Kjo është esenca e arsimit.

Qysh po do të presësh rezultate të mira, kur i tregon që një ngjarje historike, ose një definicion i caktuar është kështu, kur ia thua gabim edhe ai me ta dhënë atje në test rezultatin pozitiv. S'ka shans! Këto janë gabime esenciale, janë gabime të cilat nuk u evituan edhe më tutje. Është njëfarë mësymje euforike për gjoja një digjitalizim dhe përdorim të teknologjisë nëpër shkolla. Natyrisht, që ne s'jemi kundër digjitalizimit, teknologjisë e tjera, por kjo farë mësymje euforike, disi në emër të modernizimit e tjerë, kur në fakt ne kemi arsimin ku mungojnë gjërat më elementare. Merrni, shikoni të gjitha shkollat, shikoni numrin e nxënësve nëpër klasë, merrni shikoni sa ndërrime mbahet mësimi. Po flasim për digjitalizim, kur edhe më tutje ke shkolla me tri ndërrime, e tjerë. Shikoni çfarë higjiene kemi nëpër klasë, nëpër shkolla, çfarë ambienti u kemi krijuar nxënësve, për të qenë më të suksesshëm. Edhe në këtë kontekst të digjitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë, përderisa bota e zhvilluar është e orientuar kah avancimi i aspektit human, ne kemi filluar që lëndët, siç janë për shembull filozofia e logjika e të tjerë... në disa shkolla të mesme, me i heq nga programi mësimor, sepse gjithçka humane po duam ta shndërrojmë në teknologji. Në botë, në fakt është e kundërta. Në botë përpjekjet jashtëzakonisht të mëdha janë se si të humanizohet, si të ndërtohet njeriu, e jo thjesht përdorimi i teknologjisë.

Edhe tash, kërkoj përgjigje nga ministri për këtë çështje. Krejt në fund, pas rezultateve debakël të PISA-s ministri i bëri dy gjëra shumë të rëndësishme. Ndoshta, është dashur të japë dorëheqje, ndoshta pa ndoshta, është dashur të japë dorëheqje, por në fakt ishte më i avancuar edhe i bëri dy gjëra shumë të rëndësishme.

E para, të nesërmen e nxori njëfarë platforme a strategjie, që nuk di se ku ka qenë e fshehur, prej nga e ka nxjerrë atë strategji, që gjoja me kundërvu se ne kemi strategji, platformë e këto rezultate s'janë, e tjerë... dhe e miratuan në Qeveri po më duket, a nuk e di... edhe e dyta, si shpërblim për krejt këto rezultate të PISA-s u shpall "doktor honoris kausa" në një universitet. Kjo ishte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MUTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë e deputete,
Të nderuar qytetarë,

Gjendja e arsimit ose cilësisë së arsimit në Kosovë ka qenë gjithmonë alarmante dhe ne e kemi ditur që gjendja nuk është mirë, por testi i PISA-s vërtetoi se gjendja është edhe më e keqe se sa që kemi menduar.

Nëse shikojmë testin jemi të fundit me logjikë shkencore, matematikë e lexim. Nëse marrim parasysh se ¼-a e qytetarëve të Kosovës janë me arsim formal, kjo paraqet një problematikë shumë të madhe nga se e ardhmja e Kosovës është në rrezik për shkak të këtyre rezultateve, për shkak të cilësisë së ulët në arsim.

Arsyet për këtë janë të shumta, por çështja kyçe është që partitë në pushtet në 17 vjetët e fundit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave i kanë parë si hambarë votash dhe janë sjellë ashtu. Nëpër kalkulime afatshkurta për zgjedhje, domethënë për zgjedhje dhe kalkulime afatshkurta politik jemi duke e shkatërruar të ardhmen e vendit tonë.

Nëse shikojmë trendin e ekonomive globale, shumica e vendeve që janë në zhvillim janë të bazuara në inovacionin teknologjik, ku shkolla nxënësve duhet tua japë kreativitetin, vetiniciativën, autonominë personale, mendimin kritik logjik, mendimin jashtë kornizave standarde, pra mendimin që mundëson inovacion dhe mendimin për zgjedhjen e problemeve të vjetra me mënyra të reja.

Nëse shikojmë arsimin në Kosovë e bën plotësisht të kundërtën. Në hulumtimet në psikologji, hulumtimet e fundit, del që fëmijët e porsalindur, kur lindin i kanë dy gjëra themelore të lindura apo gjenetike, e para është kërkesa për siguri, pra mundohen të gjejnë komfort afër personit ose prindit dhe e dyta është instinkti i kureshtjes, ose eksplorimit. Domethënë, fëmija i porsalindur dëshiron të njohë ambientin dhe të gjithë fëmijët, faktikisht, marrin kënaqësi nga procesi i të mësuarit. Edhe ne, si njerëz të rritur, kur mësojmë gjëra të reja ndjejmë njëfarë kënaqësie, e cila është instinkte, pra është e bazuar në gjenet tona.

Por, çfarë bëjnë shkollat tona? Domethënë, nëse shikojmë në statistikat të cilat janë të botuara nga organizata të ndryshme të cilat punojnë në Kosovë, faktikisht unë i mora disa statistika nga organizata Save The Children, e cila ka bërë një hulumtim në Kosovë, del që 76%-shi i fëmijëve nëpër shkollat tona gjatë vitit të fundit, ose në shkollat fillore, kanë parë dikë duke u goditur apo duke u grushtuar, 20% nuk ndihen të sigurt as në klasat e tyre e përqindja është shumë e lartë nëpër korridore apo në shkollë në përgjithësi. 40%-shi i fëmijëve në shkollat fillore nuk dinë se ku të ankohen, ose kur janë të kërcënuar apo përjetojnë dhunë.

Pra, kjo është gjendja e fëmijëve në shkollat tona dhe fëmijët nëpër shkollat tona ndjehen të pasigurt, prandaj edhe nuk e duan shkollën, prandaj edhe nuk e duan mësimin dhe nuk duan të shkojnë në shkollë shumica e tyre.

Njashtu nëpër shkollat në Kosovë mësimdhënësit dekurajojnë motivimin e brendshëm apo fëmijëve nuk u mundësohet bashkëveprimi gjatë mësimin, nuk u mundësohet debati, diskutimi. Në shumicën e rasteve mendimi kritik është i dënuar, nuk është i preferuar nga mësimdhënësit.

Dhe në fund, kjo na jep që fëmijët të mos kenë vetiniciativë dhe nuk kërkojnë perspektiva të ndryshme, mësimdhënësit nëpër shumë shkolla kërkojnë vetëm bindje dhe konformizëm. Pra, duke pamundësuar mendimin kritik, duke pamundësuar debatin dhe duke pasur një shkollë e cila nuk është e sigurt, ky sistem krijon fëmijë që nuk e duan shkollën, nuk e duan leximin, nuk e duan dijen. Në vend të kënaqësisë së brendshme nga mësimi i gjërave të reja, krijohen individë që motivohen vetëm nga nota, vetëm nga diploma, vetëm nga gradat.

Prandaj, kemi shumë nota të larta nëpër shkolla, por sukcesi i tyre është i ulët kur po vijnë provimet e maturës. Diploma të shumta pa dije dhe pa aftësi, bile kemi edhe doktorë shkence, që nuk dinë as shkrim e lexim. Por, çfarë duhet bërë? Duhet të zbatojmë ligjet, unë besoj. Nëse shikojmë ligjet, ato janë shumë të mira në shumë aspekte, sidomos në këtë të arsimit. Si për shembull, ligji kërkon që të mos ketë dhunë nëpër shkolla, pra mësimdhënësit të mos përdorin dhunën, as fizike, as psikologjike, por ne jemi dëshmitarë që në shumë shkolla kemi shumë raste që dalin nëpër medie, rastet e dhunës nëpër shkolla.

Ligji kërkon që të ketë psikologë dhe pedagogë në çdo shkollë të Kosovës, por nëse shikojmë implementimin shohim se në shumicën e shkollave nuk ka as psikologë e as pedagogë. Është tragjedi kur para disa kohësh në Rahovec një fëmijë 13 vjeçar bëri vetëvrasje, ndërsa në shkollë nuk ka psikolog e psikologët shëtisin rrugëve pa punë. Ligji kërkon që një pjesë e buxhetit, ose 0,7% e buxhetit të Kosovës të ndahet për hulumtime dhe zhvillim, ndërsa kjo ndarje është pothuajse zero.

Strategjia për arsim, e cila u bë vitin e kaluar, kërkon 20 milionë për vitin e ardhshëm, domethënë për vitin e parë për investime në arsim, ndërsa buxheti i vitit 2017 ka pasur 0 euro për implementimin e strategjisë.

Unë, së fundi, vetëm dëshiroj të them edhe një herë, shpresoj se në të ardhmen do të kemi arsimin si prioritet, nga se pa arsim nuk kemi të ardhme, në një ekonomi e cila bazohet në inovacion apo ekonominë ose zhvillimet e fundit globale dhe duhet të ndahemi nga tenderomania, e cila ka bërë që në 17 vjetët e fundit kemi vetëm investime në asfalt dhe beton dhe këto investime t'i drejtojmë kah njeriu, nga se njeriu është faktori kryesor në ekonominë e së ardhmes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Niveli i arsimit në Kosovë nuk është i kënaqshëm, por institucionet e vendit të vetmin ngushëllim po e gjejnë, sepse as në vendet e rajonit nuk është mirë dhe kjo nuk është në rregull. Këtë më së miri e dëshmon rezultati në testin PISA, ku kemi dalë një vend në fund, i treti prej fundit, por dhe rezultati në testin e maturës, ku vetëm 45% të nxënësve e kalojnë këtë test të maturës.

Përgjegjësinë për këtë e ka Ministria e Arsimit. Të gjithë ne e dimë që sistemi arsimor në Kosovë është në krizë të thellë, por çështja është se si të dalim nga kjo krizë. Pse, pikërisht ky vit ka qenë i shpallur nga Ministria e Arsimit si vit i cilësisë, po dëshmon të kundërtën dhe po rezulton sikurse në vitet tjera në vijim. Mendoj, që defektet kryesore janë pikërisht tek Ministria e Arsimit dhe strukturat e saj. Ajo duhet të ndryshojë qasjen që ka në udhëheqjen e sistemit arsimor, për t'i zgjidhur problemet që sa vijnë e rëndohen në sistemin arsimor. Nuk mjafton vetëm të analizohet dhe proklamohet, por edhe të veprohet konkretisht. Edhe ministria jonë, si shumica e ministrive të shteteve të tjera evropiane ka përqafuar dhe pranuar reformat në sistemin arsimor, po ky sistem reformimi si duket...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Qerim Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani ministre,

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Obrazovanje svakako je jedna od najvažnijih stvari uopšte u svim državama pa normalno i u nas.

Obrazovanje na bosanskom jeziku za Bošnjake Kosova je temelj opstanka ove nacionalne zajednice na Kosovu. Bošnjaci Kosova, da još jednom podsetim sve nas i sve građane Kosova, su u sistemu obrazovanja na bosanskom jeziku, koji je u ustavnom zakonskom i programskom okviru Republike Kosova.

Bošnjaci Kosova su posle ulaska KFOR-a, odnosno oslobođenja Kosova od srpskog režima, odlučili samostalno da izvrše tranziciju nastave, koja je na silu prevedena od srpskohrvatskog na srpski jezik, u bivšim režimima, na bosanskom jeziku imali su punu podršku u avgustu 1999 godine od privremene vlade Kosova i tadašnjeg kasnije UNMIK administracije. Bošnjaci Kosova su uz pomoć privremene vlade Kosova i pomoć UNMIK-a uvezle udžbenike iz Bosne i Hercegovine i izvršili pravu tranziciju nastave na bosanskom jeziku. Na žalost, svih ovih godina

Bošnjaci Kosova, odnosno nastava na bosanskom jeziku se suočava sa nizom problema, koje ne može da reši ni vlada Kosova, a ni mi koji predstavljamo našu zajednicu u institucije sistema.

Mislimo da nedostaje malo političke volje. Također, mislimo da ima mnogo obećanja a malo realizacije. Obrazovanje na bosanskom jeziku je funkcionalno obrazovanje u sistemu Republike Kosova. Uzmimo samo u ozbiljnost, uvaženi ministre, jer vjerujem da to niste namerno uradili, ali vi niste nijednom rečju spomenuli obrazovanje na bosanskom i turskom jeziku u vašem ekspezu. Nemojte zaboraviti da danas Bošnjaka i turska djeca u Prizrenu zajedno sa albanskom decom i u opštini Prizren i opštini Peć i opštini Istok, i ovde u Prištini idu u časno sa albanskom decom zajedno u škole, u sve osnovne škole i u mnogim srednjim školama. Ovo je za nas veliki uspeh, ovo je uspeh veliki za državu Kosova.

I s tim u vezi s obzirom da ne znamo koliko je ta moja minutaža a vidim da ističe, ja ću još jednom spomenuti da sve uradite da rešite nedostatak udžbenika obrazovanja na bosanskom jeziku, da i sve druge probleme koji nas prate godinama konačno počnu da se rešavaju. A da ste ih rešavali, ne možete vi lično da ih rešite, jer vi ste ipak ministar, jačajte vašu službu u ministarstvu, u kojoj trenutno nemate nijednog zaposlenog Bošnjaka koji treba da se bavi ovim administrativnim problemima...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Xhevahire IzmaKu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht e përshëndes iniciativën për debatin e sotëm.

Në Republikën e Kosovës niveli i arsimit parauniversitar rregullohet me ligje të veçanta, Ligjin për arsimin parauniversitar, Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për arsim në komuna dhe Ligjin për arsim dhe aftësim profesional. Me këto ligje përcaktohet mënyra e organizimit të sistemit arsimor parauniversitar dhe ndahen saktësisht kompetencat në mes të MASHT dhe komunës dhe, po qe se i shikojmë në detaje këto ligje, komunat kanë kompetenca të zgjeruara dhe ekskluzive të organizimit të arsimit parauniversitar.

Cilësia në arsim varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga cilësia e stafit mësimdhënës dhe nëse ky staf nuk është i përgatitur mirë, kjo do të reflektohet sigurisht drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë rrugëtimit të shtetit tonë, fazat nëpër të cilat ka kaluar shoqëria jonë para luftës së fundit dhe marrë parasysh vakumin institucional të krijuar në të

gjitha mënyrat e organizimit të jetës, sidomos në organizimin e arsimit nëpër shtëpitë shkolla, sigurisht se kanë krijuar faktorë që kanë determinuar një gjendje me ngecje të tillë.

Megjithëse, ne si komb arritëm mbijetesën e popullit tonë, gjegjësisht edhe mbijetesën e arsimit shqip, kjo ngecje në arsimin normal detyrimisht ka reflektuar edhe në përgatitjen e krijimit të kuadrove cilësore dhe në ofrimin e kushteve optimale për nxënësit tanë. Është e vërtetuar se ngecjet në arsim janë me pasoja afatgjate, prandaj edhe disa vite mund të presim që gjendja në arsim do të ndikohet nga ngecje që kemi pasur në kohën e paraluftës. Po ashtu, duhet të kemi parasysh që megjithëse reformat në sistemin arsimor, që kanë mundur të bëhen në vendin tonë, pra pas lufte, ato kanë kërkuar edhe njerëz të reformuar e që ka qenë e pamundur të gjendet një armatë e mësimdhënësve, të cilët mund t'i bënin këto reforma.

Pra, mund të themi se nuk kemi qenë në një hap me të njëjtat, reformat dhe përgatitjen e stafit mësimdhënës që t'i realizojë këto reforma. Edhe kjo ka reflektuar në cilësinë dhe gjendjen e përgjithshme të sistemit arsimor e që mund të themi se nuk është e kënaqshme. Pra, mund të kuptojmë se sistemi arsimor në përgjithësi është komplet dhe përveç kushteve të infrastrukturës adekuate, kërkon ligje dhe strategji konform zhvillimit të nevojave të kohës, po ashtu kërkon mësimdhënës të përgatitur me njohuri dhe metodologji të reja të kësaj mësimdhënieje.

Sado që ligjet dhe strategjitë janë moderne, nëse nuk kemi njerëz që zbatojnë këto ligje dhe strategji, njerëz të cilët dinë të transmetojnë këto njohuri, atëherë rezultatet janë të pamjaftueshme. Janë evidente dhe të dukshme investimet në arsim nga ana e MASHT, gjegjësisht Qeverisë. Pra, janë ndërtuar shumë shkolla të reja dhe rinovuar, po ashtu shumëfish. Pagat e mësimdhënësve tani janë më të lartat në vendet e rajonit. Janë hartuar po ashtu, shumë dokumente strategjike, janë bërë trajnime, janë zhvilluar trajnime profesionale dhe licencim të mësimdhënësve dhe administratorëve të arsimit, duke u bazuar të gjitha në standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Mirëpo, edhe pse janë bërë të gjitha këto investime gjendja në arsim po mbetet ende për tu dëshiruar. Pse kjo gjendje, pra?

A duhet ta preokupojë kjo gjendje vetëm Ministrinë e Arsimit apo ndryshe thënë, a është fajtorë vetëm Ministria e Arsimit për këtë gjendje? Natyrisht, se jo! Arsimimi duhet të jetë preokupim i të gjithë shoqërisë, i të gjithë sektorëve politikë, Kuvendit, Qeverisë qendrore, pushteteve lokale, institucioneve të arsimit të lartë dhe parauniversitar, e pse jo edhe prindërve dhe familjes, si qeliza elementare e shoqërisë, prej nga nis edukimi i fëmijës. Nxënësit, atë që mësojnë në klasë apo shkollë, duhet ta mësojnë apo përsërisin në shtëpi, prandaj rol të rëndësishëm këtu ka edhe familja, sepse shoqëria në përgjithësi duhet të investojë edhe mjete, edhe mund, edhe kujdes, nëse dëshirojmë të kemi një arsim cilësor.

Më lejoni të them vetëm pak fjalë rreth rezultatit të PISA-s. Programi PISA teston aftësinë e nxënësve për të aplikuar njohuritë e fituara në shkollë në situatat e jetës reale. Në testin e fundit

të organizuar në vitin 2015, vendi ynë është renditur në vendin e 68-të në matematikë dhe shkencë dhe në vendin e 69-të në lexim, nga 70 vende pjesëmarrëse.

Ky rezultat na ka bërë të ndjehemi shumë keq dhe ka pasur reagime nga më të ndryshmet, duke filluar prej neve deputetëve dhe politikanëve të tjerë, por edhe ekspertëve, prindërve, qytetarëve. Pa u thelluar në natyrën e organizimit të këtij testi, mënyrën e përzgjedhjes së nxënësve, lëndëve që janë testuar nxënësit, fajtorë për këtë rezultat dhe shënjestër e sulmeve gjithë kësaj kohe ka qenë ministri dhe Ministria e Arsimit.

Meqenëse, ndikimi kryesor në organizimin praktik dhe mbarëvajtjen e arsimit parauniversitar e kanë pushtetet lokale, ku “ministër” janë kryetari i komunës dhe drejtori komunal i arsimit, askush nuk u dëgjua të drejtë gishtin në fajësimin nga pushteti lokal, as nga ne, as nga opinioni publik. Meqenëse, kryetari i komunës dhe drejtori komunal i arsimit bëjnë përzgjedhjen prej punëtorit teknik e deri te drejtori i shkollës nuk mund të fajësohet ministri dhe ministria, aq sa të kërkohet të nxirren para gjyqit. Pra, janë mekanizma të tjerë që mund të lëvizë ministria, që do të ndikojnë tërthorazi në ngritjen e cilësisë dhe mbarëvajtjen e mësimin nëpër shkolla tona, por ato veprime, tek e fundit, do të ndaleshin tek mësimdhënësi dhe do zbatoheshin nga ai mësimdhënësi, i cili po zgjidhet, shumicën e herëve, nga kryetari i komunës, ndërsa ne e dimë shumë mirë se si zgjidhen edhe mësimdhënësit e tjerë, në përgjithësi.

Prandaj, të nderuar kolegë, uroj që rezultati i PISA-s të jetë një mësim i mirë për të gjithë ne, në mënyrë që të jemi në funksion të përmirësimit të gjendjes në arsim në të gjitha nivelet, duke filluar nga ai parashkollor e deri tek arsimi i lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të respektuar ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Arsimi është një prej resorëve më të rëndësishëm të çdo shoqërie. Përmes tij shoqëritë dhe kombet u bartin qytetarëve të tyre dijen, kulturën, trashëgiminë natyrore, kulturore, vlera përmes së cilave shkon përpara shoqëria.

Arsimi është resor, që jo vetëm i prinë shoqërisë, po edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Sistemet e arsimit, edhe pse janë të ndryshme, të përhershme, nuk tregojnë paqëndrueshmëri, përkundrazi ato shërbejnë për t'u përshtatur sa më mirë ndryshimeve të shoqërisë. Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto 17 vjetët e luftës kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mundet me transformimet ekonomike, politike e sociale në vendin tonë, por edhe me ato në nivelin global.

Këto ndryshime, duke mos qenë të hulumtuara dhe duke qenë se bëheshin në një terren shumë pak të favorshëm nga gjendja në të cilën sistemi ynë arsimor vinte dhe nga një politizim i tejskajshëm, jo gjithmonë kanë dhënë frytet e duhura dhe janë perceptuar shpesh nga ne si eksperimente. Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, por kur ky eksperimentim kalon caqet hapësinore dhe kohore, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht në ta.

Jemi munduar të kopjojmë e kinse të implementojmë reformat e sistemeve të ndryshme arsimore (kanadeze, austriake, finlandeze e tjera), por për tërë këto vite të pasluftës, dhe çka kemi bërë. Vetëm është eksperimentuar edhe në organizim jofunksional të institucioneve arsimore dhe me përcjelljen joadekuate financiare dhe kështu kemi bërë eksperimente edhe me nxënës, me studentë, por edhe me mësuesit tanë.

Duke qenë se intensiteti i reformave ka qenë i madh dhe koha e kryerjes së tyre relativisht e shkurtër janë vënë re dhe po dalin në pah shumë problematika, siç është rasti i kurrikulave. Është e kuptueshme që vetëm në një reformim të tillë problemet nuk mund të zgjidhen përnjëherë. Kështu dolën në pah problematika, të cilat në disa raste nëse nuk trajtohen me seriozitetin e duhur, do të lënë pasojë të rënda në arsimimin e brezave.

Reforma në arsim ka përfshirë legjislativonin, kurrikulat, infrastrukturën, por për fat të keq, ende nuk ka një reformë ose ende nuk është vënë në zbatim një reformë e resurseve njerëzore, do të thotë i kuadrit dhe i emërimeve në arsim.

Reformimi ka filluar me kalimin në sistemin 9-vjeçar, arsimimin e mesëm të lartë, në gjimnaze e shkolla profesionale, maturën shtetërore, reformat në nivelin universitar sipas Kartës së Bolonjës dhe atë, pavarësisht saj, sa kemi qenë të përgatitur për këto reforma, shtrohet një pyetje e veçantë.

Nëse synimi dhe arritja kryesore e kurrikulës së re dhe reformës që ka qenë ndryshimi i konceptit në arsim, pra vënia e nxënësit në qendër, kjo jo nga të gjithë mësuesit është kuptuar drejt, ose është kuptuar në mënyrë sipërfaqësore: të vendosësh nxënësit në qendër të mësimit, nuk do të thotë të mjaftohesh duke përdorur disa teknika e teknologji mësimesi që në literaturën pedagogjike njihen si teknika të të mësuarit me nxënësin në qendër, por duhet të ndryshohet mendësia e mësimit, duhet ndryshuar këndvështrimi.

Ndikimi i shoqërisë dhe presioni i madh që bën shoqëria jonë për të nxitur rritjen e rezultateve ka bërë efekte të kundërta, duke mos rritur dëshirën e interesimin për të mësuar, por për të pasur një diplomë. Pra, gjithçka është kthyer në kërkesën për një diplomë dhe jo për dije.

Matura shtetërore, e cila synoi të vinte në baraspeshë vlerat e secilit, u kthyen në të kundërtën e saj, si rezultat i një keqmenaxhimi ose keqadministrimi të saj.

Cilësia e dobët e teksteve shkollore dhe, mbi të gjitha, përmbajtja e tyre, mënyra e hartimit dhe përzgjedhja e tyre, u kthyen në një problem tjetër që e shoqëroi arsimin gjatë këtyre viteve të transicionit.

Mësimdhënësi është aktori kryesor dhe faktor i rëndësishëm që i materializon reformat. Por çfarë është bërë për mësuesin në këto 17 vjetët e fundit? Kjo pyetje do të merrte shumë përgjigje, por për hir të së vërtetës duhet të themi se për mësimdhënësit nuk është bërë aq sa duhet, është bërë fare pak ose fare hiq.

Stimulimi i tyre për punën që e bëjnë është njëri nga faktorët qenësor në rezultatet dhe performansën, të cilën e tregojnë ata dhe në këtë aspekt mësimdhënësit janë lënë në harresë nga shoqëria.

Një tjetër aspekt që lidhet me përgatitjen e mësuesve ka të bëjë me të rinjtë dhe studentët, të cilët e zgjedhin këtë profesion. Universitetet dhe fakultetet tona duhet të krijojnë ura bashkëpunimi për t'u dhënë këtyre të rinjve aftësi dhe shprehi të nevojshme, pasi njohuritë dhe dijenitë i marrin gjatë studimeve, por jo të veprohet si te ne që është vepruar në drejtim të koncentrimit dhe krijimit të një monopoli brenda vetëm një njësie akademike për të nxjerrë kuadro për arsim, edhe pse nuk i ka kapacitetet as për së afërmi ta bëjë këtë mision.

Kësisoj, nga këtu do të kërkoja nga ministri i Arsimit që në mënyrë sa më të shpejtë të nxisë ose iniciojë amendamentimin e Ligjit të arsimit parauniversitar dhe të gjitha auto udhëzime administrative, të cilat kanë dalë në suaza të këtij ligji, në mënyrë që të bëhet një reformë e thuktë në aspektin e këtij niveli arsimor.

Sot, një drejtues shkolle apo drejtorja e saj, pothuajse nuk kanë asnjë kompetencë për sa i përket administrimit të shkollave. Një drejtor shkolle nuk mund të menaxhojë mjediset shkollore sipas interesave të shkollës dhe komunitetit, sepse në radhë të parë, shkolla nuk ka asnjë buxhet dhe, edhe pse ekzistojnë ligje dhe rregullore për transformimin e këtyre kompetencave nëpër drejtorin të shkollës, këtë nuk e bëjnë në shumicën e rasteve drejtorët komunalë të arsimit, duke shkelur ligjin që i rregullon këto marrëdhënie, me të vetmin qëllim që të ruajë ndikimin politik mbi shkollat dhe menaxhmentin e tyre.

Do të ishte më mirë sikur testi PISA të realizohet shumë më herët, shumë vjet më parë, sepse këto debate do të realizoheshin më herët, e ndoshta gjer më tani nga masat e ndërmarra do të kishin ndonjë efekt pozitiv dhe do të na zgjonin nga gjumi i thellë në të cilin ndodhim. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

ABDYL IMERI: Të nderuar të pranishëm,

Arsimi është njëra nga fushat më të rëndësishme të jetës shoqërore të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Nëpërmjet arsimit, shoqëritë dhe kombet ua transmetojnë pjesëtarëve të tyre dijen, kulturën, trashëgiminë kulturore, vlerat nëpërmjet të cilave shoqëria shkon përpara.

Shikuar nga perspektiva e kaluar në tërësi, zhvillimi i arsimit në Kosovë ka kaluar nëpër periudha të ndryshme, te cilat nuk kanë qenë të lehta, më rënie dhe ngritje nëpër etapa të caktuara. Pas vitit 1970 shënohet një demokratizim, një konsolidim dhe një depolitizim në një masë të madhe i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, kur planprogramet arsimore zhvillohen nga ekspertët kosovarë, arsimi merr një dimension të ri shoqëror dhe kombëtar në luftë për dije dhe liri. Pas vitit 1980 e kemi një dekadë të rikthimit të ndikimit të politikës në arsim, humbja e orientimit arsimor të institucioneve, ndjekja dhe përjashtimi nga puna i ekspertëve dhe mësimitdhënësve, zbatimi i politikës antiarsimore dhe antinjerëzore të pushtetit serb, deri në dëbimin me dhunë të nxënësve, studentëve dhe mësimitdhënësve nga institucionet arsimore. Për të vazhduar nga viti 1991 me krijimin e sistemit të pavarur demokratik arsimor dhe ruajtjen e vazhdimësisë së punës së institucioneve arsimore dhe procesit arsimor nën okupim, e cilësuar si periudha e organizimit dhe mbijetesës së arsimit shqip.

Sistemi i arsimit vihet në lëvizje të themelimit të shtetit të ri të Kosovës. Zhvillimi i planprogrameve dhe botimi i teksteve mësimore të reja pa ndikime ideologjike dhe politike dhe me platformë të arsimit kombëtar. Nuk është zhvilluar ndonjë filozofi e veçantë orientuese arsimore, por është shënuar një vullnet i paparë për punë të mësimitdhënësve, në kushte të rënda të okupimit, në shtëpitë-shkolla. Gjatë periudhës së luftës shumë nga mësimitdhënësit, studentët e nxënësit në moshën më madhore u radhitën në radhët e UÇK-së, për të kontribuar për liri e çlirim. Në historinë tonë më të re të luftës së UÇK-së, kemi dëshmorë e martirë nga radhët e mësimitdhënësve, studentëve dhe nxënësve që e kanë fituar përjetësinë dhe kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori, e të cilët ne duhet t'i kujtojmë me pietet e krenari. Ata që e patën fatin të mbijetojnë, pas lufte, nga shtatori i vitit '99 iu kthyen punës nëpër institucione arsimore, kurse studentët studimeve në universitet e nxënësit nëpër shkolla.

Kosova kishte nevojë për një reformë të thellë si në çdo fushë, edhe në fushën e sistemit të arsimit në të gjitha nivelet për t'i përmbushur të gjitha nevojat dhe kërkesat shoqërisë sonë në përgjithësi për dije, shkathtësi e aftësi profesionale dhe kulturë, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, si dhe zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, të bazuara në standardet më të avancuara për t'i përmbushur objektivat mësimore. Gjatë këtyre viteve e deri sot nga donatorë të ndryshëm, e në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit janë harxhuar mjete të mëdha materiale për trajnime të ndryshme dhe te shumta të trupit arsimor, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të shumta se si zhvillohet arsimi nga vendet e

ndryshme, cilat janë praktikat dhe kurrikulat më të mira me qëllim që mësimdhënia dhe mësimnxënia të jenë në nivelin më të lartë.

Nëse synimi dhe arritja kryesore e trajnimeve e kurrikulës së re dhe reformës ka qenë ndryshimi i konceptimit në arsim, pra vënia në qendër e nxënësit, shtrohet pyetja a është kuptuar kjo drejt, ose është kuptuar në mënyrë sipërfaqësore? Ta vendosësh nxënësin në qendër të mësimin nuk do të thotë të mjaftohesh duke përdorur disa teknika mësimdhënieje që në literaturën pedagogjike njihen si “teknika të të mësuarit me nxënësin në qendër”, por duhet të ndryshohet mendësia e mësimdhënies, duhet ndryshuar këndvështrimi. Mësimi dhe shkolla duhet t’i shërbejë nxënësit dhe nëse kjo nuk arrihet misioni mund të quhet i parealizuar, për të mos thënë i dështuar.

Shpeshherë më ka rënë të dëgjoj nga shumë mësimdhënës se po bëhen eksperimente me arsimin në Kosovë. Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, nëse sjell diçka pozitive, por kur ky eksperimentim kalon caqet hapësinore dhe kohore, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht.

Ministër, prandaj është mirë të shikohet edhe në këtë drejtim nëse janë arritur objektivat me këto trajnime dhe a janë të suksesshme.

Nga Qeveria e Kosovës, nga viti 2008 janë bërë investime të shumta në ndërtimin e objekteve shkollore, me qëllim të krijimit të hapësirave të mjaftueshme bashkëkohore për zhvillim normal të procesit mësimor në mjediset shkollore. Po ashtu kemi pasur ngritje të pagave të mësimdhënësve, me qëllim që ata ta kenë një pagë të dinjitetshme dhe me pagën e tyre t’i mbajnë familjet e tyre.

Ne duhet ta pranojmë realitetin, ka pasur zhvillime të shumta pozitive në sistemin e arsimit përgjatë këtyre viteve, mirëpo nuk është arritur objektivi kryesor, do të thotë cilësia në arsim. Për këtë na tregojnë rezultatet e Organizatës Ndërkombëtare për Vlerësimin e Nxënësve - PISA, që është brengosëse për të gjithë ne, dhe problemet që ka shpërfaqur duhet të merren seriozisht nga institucionet e Kosovës, si dhe duhet të merren masa me qëllim të përmirësimit të cilësisë, në mënyrë që nxënësit tanë të kenë aftësi dhe njohuri të mjaftueshme dhe në testin e ardhshëm të PISA-s të arrijnë rezultate pozitive.

Testi i PISA-s duhet të na hapë sytë të gjithëve, Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet arsimin, Ministria e Arsimit duhet t’i identifikojë dhe t’i listojë një nga një të gjitha problemet në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet: duke filluar nga infrastruktura, pajisja e shkollave me kabinete, në mënyrë që nxënësit tanë të kenë njohuri edhe praktike dhe jo vetëm teorike, sepse aftësohen për të menduar në mënyrë kritike e për të qenë në gjendje t’i zbatojnë njohuritë që marrin gjatë shkollimit.

Largimi i politikës nga shkolla, punësimi i atyre që kanë përgatitje adekuata, duke u dhënë përparësi atyre që e kanë notën mesatare më të lartë, zgjidhja e menaxherëve të shkollave që kanë aftësi menaxhuese, krijimi i kushteve më të mira për mësimdhënësit, e në të njëjtën kohë duke kërkuar nga ata punë dhe cilësi, krijimi i kushteve për inspektorë, në mënyrë që t'i inspektojnë shkollat, e pse jo edhe procesin mësimor nëpër shkolla, duke krijuar mekanizma realë vlerësues.

Po ashtu duhet vepruar edhe me nivelin e arsimit universitar, sepse as këtu nuk është gjendja siç e dëshirojmë.

Të gjitha këto duhet të bëhen me qëllim që nxënësit tanë dhe ata që i përfundojnë studimet universitare të jenë të për afërt dhe të krahasueshëm me bashkëmoshatarët e tyre nëpër botë, e po ashtu të jenë konkurrues në tregun e punës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Është shndërruar gati një fenomen që sa herë një çështje shqetësuese dhe serioze për qytetarët e Republikës së Kosovës nxirret në Kuvend, të kemi një reagim nga deputetët e koalicionit qeverisës, i cili është ose të cilët janë edhe më të zëshëm, e nganjëherë duken edhe më të shqetësuar për këto probleme, për këto kriza, siç është kriza e arsimit, sikurse kjo nuk ka asnjë lidhje me pushtetin të cilit i takojnë, ose me kolegët e tyre në Qeveri.

Pra, hapet një temë siç është sot arsimit dhe kritika vjen nga pushteti, e këta tingëllojnë edhe më të ashpër se sa zërat ose deputetët e opozitës.

Është fare lehtë të konstatohet gjendja e sotme në universitet dhe në sistemin arsimor parauniversitar. Mjafton një e dhënë nga matjet, nga rezultatet e PISA-s, pra që 80% ose mbi 80% e nxënësve në moshën 15-vjeçare janë analfabetë funksionalë. Pra, të tillë që mund të lexojnë e të shkruajnë, por nuk kuptojnë atë që e shkruajnë. Pra, pa një bazë të domosdoshme për të përfituar dije të reja.

Shkaqet janë të shumta dhe shumë nga to u përmendën, nuk dua të zgjatem këtu të flas për secilën prej tyre.

Natyrisht se partizimi i sistemit arsimor e degjeneroi mbi të gjitha këtë fushë, pra tërë sistemin arsimor, duke përfshirë edhe atë universitar.

E dëgjova dhe do të ndalem pak nga disa gjëra që i përmendi ministri Bajrami. Tha që, bile një nga konkluzionet ishte që të mos ketë qasje partiake, e pikërisht është qasja partiake e subjektit të cilit ai i takon dhe partnerit në koalicion që e ka sjellë arsimin në këtë gjendje në të cilën ndodhet sot.

Tha se duhet të ketë një pako masash, e përmendi kurrikulën, kush ka kontakt me arsimtarët e sistemit parauniversitar. Të gjithë e dimë se kokëçarja më e madhe nga viti 2011 janë këto kurrikula, të cilat nuk janë aspak të përshtatshme sipas përshtypjes së tyre dhe, çka është me rëndësishme, nuk janë as në përputhshmëri me tekstet shkollore aktuale.

U fol për mësimin digjital, çfarë kuptimi mund të ketë mësimi digjital kur nga një hulumtim i GIZ-it i kemi mbi 40% të mësimdhënësve në shkolla fillore dhe të mesme që nuk kanë kompetenca për lëndët që ata i mbajnë dhe për të cilat janë përgjegjës. Çfarë dobie do të kishte digjitalizimi kur mësimdhënësit, produkt i partizimit, i cili u përmend shpesh, nuk janë kompetentë për ato që duhet t'i zotërojnë.

Tekstet ka mbi 10 vjet që janë ndryshuar vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Universitetet nuk mund të shkëputen si hallkë e domosdoshme që e kanë sjellë situatën aty ku jemi.

Ministri tha që tani universitetet janë dhe s'kemi çka të bëjmë, e nëse ne si shoqëri e vlerësojmë, nëse është interes kombëtar i pashmangshëm arsimit për të ardhmen e vendit, pse të mos mbyllem këto nëse nuk i shërbejnë arsimit dhe nëse prodhojnë vetëm diploma dhe studentë, të diplomuar të paaftë.

Të gjitha këto universitete, besoj qytetarët e kujtojnë, janë themeluar në prag të fushatave zgjedhore. Pra, këto nuk kanë qenë asnjëherë në shërbim të interesave dhe nevojave të Republikës së Kosovës, por vetëm të partive, sidomos të këtyre dy partive në pushtet.

Unë nuk mund të pranoj atë konstatim që po e dëgjoj nga të gjithë, ose nga shumica e deputetëve të koalicionit qeverisës, që fajtorë jemi të gjithë. Është bërë e zakonshme tanimë që për çdo problem, i cili rrjedh si pasojë e papërgjegjësisë së pushteteve në vijueshmëri të këtij koalicioni të madh, të shmangen ose të krijohet njëfarë ideje e një faji të përgjithshëm, mirëpo të gjithë qytetarët e kanë të qartë, e besoj edhe punëtorët e arsimit, se përgjegjësia bie, mbi të gjitha, mbi këtë Qeveri, por edhe ato paraprake që natyrisht janë udhëhequr dhe ky dikaster është udhëhequr nga këta njerëz dhe e kanë sjellë këtë situatë në të cilën ndodhemi dhe e cila, u konstatua edhe dje në tryezën, të cilën ne si grup parlamentar e organizuam, nuk kërkon inovacione të reja, nuk kërkon digjitalizim, kërkon vetëm vullnet politik për një ndryshim rrënjësor dhe të domosdoshëm për sistemin e arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Agim Aliu e ka fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër, zoti Arsim Bajrami,

Të nderuar deputetë,

Arsimi me të drejtë konsiderohet njëra ndër shtyllat më të rëndësishme të një shoqërie, të një kombi, sepse të gjitha kuadrat e fushave profilizohen nga arsimi dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme jetike për një vend varen pikërisht nga ai.

Gjendja e përgjithshme në arsim nuk është për t'u kërenuar, por nuk është edhe aq keq sa thuhet e shkruhet në opinion dhe në media.

Megjithatë, duhet ndërmarrë diçka që kjo gjendje e sotme në arsim të ecën më përpara, të jetë edhe më e suksesshme, veçmas në sferën e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Dihet se infrastruktura shkollore ka ndryshuar dukshëm në gjithë territorin e Republikës sonë, kemi krijuar hapësira bukur të mira për një sistemim të nxënësve nëpër klasa sipas standardeve të kohës. Të pakta janë ato shkolla që punojnë në 3 ndërrime, kryesisht punojnë në 2, por kemi një numër të caktuar shkollash që mësimin e zhvillojnë vetëm në një ndërrim.

Prandaj, konsideroj se ky duhet të ishte synimi ynë në të ardhmen, ashtu siç veprohet gjithandej Evropës.

Por, më parë Ministria e Arsimit duhet të përpilojë programin mësimor për qëndrimin tregëtor të nxënësve në shkolla, duhet përmbushur edhe obligimet e tjera përcjellëse që duhet t'i plotësojë shkolla në këtë formë të mësimin.

Ministria e Arsimit, së bashku me drejtoritë e arsimit, duhet të bashkëpunojnë seriozisht në mënyrë që të bëhet depolitizimi i arsimit në arsimimin parauniversitar.

Mendoj se me ndërrimin e qeverive lokale më së shumti po pëson arsimi, sepse po punësohen kryesisht njerëz të afërt me pushtetin, pavarësisht se një numër i tyre nuk e kanë përgatitjen profesionale për mësimdhënie. Kjo mënyrë e veprimin po lë pasoja të pariparueshme te nxënësit në udhëtimin e tyre të dijes.

Gjithashtu mendoj se tek inspektoratet regjionale duhet të bëhet një ndryshim imediat i punës së tyre, përndryshe, ashtu siç janë duke funksionuar tani për tani, janë pak të angazhuar në të mirë të ngritjes së cilësisë në arsim. Inspektorët rajonalë të arsimit duhet t'i zbatojnë vendimet e tyre konform ligjeve të arsimit në fuqi, e assesi të frymojnë e veprojnë sipas dëshirës dhe vullneteve të qeverive lokale.

Duhet të shtohet patjetër numri i inspektorëve dhe të rritet besimi i qytetarëve për punën në zbatimin e ligjeve nga Ministria e Arsimit.

Ministria e Arsimit duhet të jetë më këmbëngulëse në zbatueshmërinë dhe të qëndrojë prapa ligjeve dhe udhëzimeve administrative që i ka miratuar si propozues nga ana e Kuvendit.

Tashmë zërat qytetarë sipas të cilëve drejtoritë e arsimit po punësojnë mësimdhënës pa konkurs, duke shpërfillur kriteret, duke mos zbatuar vendimet e fituara të palëve në konkurs nga ankimimet janë në shtim e sipër dhe nuk e di se cilat janë masat që i ka ndërmarrë Ministria e Arsimit, duke ditur se ka mekanizma për të vepruar në këtë drejtim.

Veprimi në këtë drejtim është tepër i domosdoshëm, sepse, në të kundërtën, do të vazhdojë degradimi.

Ministria e Arsimit dhe drejtoritë komunale të arsimit duhet të punojnë bashkë që shkollat të pajisen me laboratorë e kabinete, sepse mësimi kabinetik është kërkesë dhe domosdoshmëri për një investim sa më cilësor.

Duhet shtuar kopshtet dhe çerdhet nëpër komuna tona për t'u përgjigjur kërkesave të shumta, por të drejta të qytetarëve tanë në raport me kohën në të cilën ne po jetojmë.

Testi i arritshmërisë do të duhej të ketë organizim edhe më të mirë, sepse po e përcakton fatin e një të riu apo të reje në shkollimin e mëtutjeshëm.

Ndërsa, për testin e maturës, për t'i hequr të gjitha dilemat e manipulimeve dhe për ta vlerësuar saktë dijen e secilit maturant, testi duhet të kryhet në mënyrë elektronike dhe tek atëherë mund të flasim për një vlerësim real dhe pa i hyrë në hak askujt.

Mendoj se një decentralizim më i madh i drejtorive të arsimit në çështjet buxhetore, mbikëqyrjen kadrovike e të tjera, do të ishte në të mirë të procesit edukativo-arsimor.

Ndërsa, drejtoritë e arsimit le të jenë një lloj auditori me kompetenca edhe ndëshkuese për ato shkolla që u shmangen ligjeve dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga Ministria e Arsimit.

Arsimin nuk duhet ta kuptojmë si ent social apo si ent punësimi, për ndryshe, disa drejtorë janë duke e keqpërdorur pozitën e tyre dhe sigurisht edhe “me bekimin e eprorëve të tyre” janë duke i shndërruar institucionet arsimore në ente të tilla dhe nëse vazhdohet kështu, përfundimisht arsimi ynë do të degradohet dhe sigurisht se pasojat do t'i kemi në dekadat e ardhshme.

Prandaj, përtej rezultateve dhe sukseseve që janë shënuar, por duke parë edhe të gjitha këto degradime të vazhdueshme, si dhe rezultatet e fundit të vlerësimit konsideroj se është e domosdoshme që të pamundësojmë ndërhyrjet politike në arsim në të gjitha nivelet.

Është i nevojshëm një rishikim i gjithmbarshëm i pakos ligjore, që ka të bëjë me arsimin, të analizohen rezultatet e reformave të deritanishme të bëra në arsim si dhe nga kjo të nxirren planet dhe strategjitë për reformat në të ardhmen.

Në fund, mendoj se sado që bëjmë për të mirën e arsimit në përgjithësi, asnjëherë nuk do të mund të bëjmë krejt atë që duhet dhe krejt atë që është e merituar për arsimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kymete Bytyqi... Pra, zonja Tërmmkollli, replikë!

MELIHATE TËRMMKOLLI: Po dua ta përmend një emër këtu, deputetin Driton Çausi. Ka disa seanca që po mbajmë këtu dhe vazhdimisht... E unë mendova që është një rastësi, por po shoh se nuk është kjo rastësi. Sikur ka njëfarë aversioni pse flasim këtu edhe deputetët që janë deputetë të partive që janë në pushtet.

Driton, po dua të drejtohem direkt, mësoje rolin e parlamentit dhe të deputetëve në Parlamentin e Kosovës, pavarësisht çfarë partie politike i takojnë.

E drejta e debatit, e bile edhe e kundërshtimeve, nuk është e drejtë ekskluzive që i takon vetëm opozitës. Dhe, thënë të drejtën, po të kishim mbetur vetëm në opozitë, shumë probleme, të mos ishte kontributi i madh i deputetëve të pozitës, bash s'kishit bërë asgjë. Bash hiq, s'kishit bërë!

Edhe një. Arsimi, çështje politike! Po, politike, merreni Komunën e Prishtinës, këqyrni, po edhe komunat e tjera, hiq nuk janë më mirë, por nuk është hiq mirë as Komuna e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Unë përshëndes këtë iniciativë, kjo iniciativë do të ishte mirë të merret më herët, por megjithatë, prapë nuk është vonë.

Ministri më herët e ceku se ne krenohemi që kemi ngritje këto dy vjetët e fundit në cilësi të arsimit, por rezultatet e PISA-s e vërteton të kundërtën, zoti ministër. Dhe, nuk e di si krenoheni me këto rezultate?

Unë kam diçka konkrete këtu si rekomandim, sepse disa i përmendën këtu që të kemi shtesë në arsim, mirëpo unë do ta jap si rekomandim, që të mos e zgjasim, sepse kanë folur edhe kolegët e mi.

Rekomandimi im është: Pensionimi i mësimdhënësve të jetë i parakohshëm, për shkak të gjendjes shëndetësore. Pra, të mos pritët moshën 65-vjeçare, por siç e kanë edhe shërbyesit civilë, të shkojnë 2 vjet para kohe. Mirëpo, ne i kemi edhe disa, që nuk mund të jenë shumë, pra disa arsimtarë që kanë gjendje të rëndë psikike, me ta çka të bëjmë ne?

Krejt esenca është aty. Pra, po më duket se nuk po ju shqetëson, por kjo është shqetësuese.

E kisha cekur edhe një rekomandim: që këta persona të marrin 70% të pagës dhe ta gëzojnë, nëse shkojnë para kohës në pension, siç e kanë edhe shërbyesit civilë. Unë kaq kisha, këtë rekomandim. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu, që i ka edhe 2 minuta.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Unë do të isha koncentruar në tri çështje, që janë praktike dhe do të kishin ndikuar ndoshta pozitivisht në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Nën një, është çështja e testit të maturës. Zoti ministër, ju e dini se suksesi i një nxënësi për t'u regjistruar në fakultet, nga 100 pikë që do t'i ketë, 20 pikë duhet t'i ketë shkolla e mesme, suksesi në testin e maturës 50 pikë dhe suksesi në testin pranues 30 pikë.

Unë mendoj se kjo është gabim, zoti ministër, për arsye se nëse një nxënës për 4 vjet performon me sukses të mirë dhe i merr vetëm 20 pikë, ndërsa në testin e maturës i merr 50 pikë, kjo po ndikon shumë negativisht, sepse automatikisht dhënia 50 pikë testit të maturës po ndikon që edhe shkolla, duke dashur të tregohet më e suksesshme në testin e maturës, po e manipulon testin, duke u dhënë nxënësve të cilët po regjistrohen pastaj në fakultet dhe nxënësit e dobët, që kanë performuar 4 vjet dobët dhe po i bën 50 pikë test të maturës, duke manipuluar testin e maturës, ai po arrin të regjistrohet në fakultet, ndërkaq nxënësit e mirë që kanë pasur nota mesatare, të themi, i merr vetëm 20 pikë të testit të maturës, por ai nuk bën përpjekje për të vjedhur testin e maturës, ai nuk po arrin të regjistrohet në fakultet.

Mendoj se duhet të jetë e kundërta. T'i japim rëndësi suksesit 4-vjeçar sa e arrin nxënësi dhe jo testit të maturës, sepse kjo po e dëmton edhe nivelin pasuniversitar.

Çështja tjetër, zotëri ministër, që kishte me qenë me interes, është ky trekëndëshi i bashkëpunimit prindër-nxënës dhe mësimdhënës. Në Kosovë shumë pak praktikohet kjo çështje.

Ka modele, kemi shembull, Austria, ku secili nxënës që mungon menjëherë me një SMS lajmërohet prindi se fëmija nuk është në shkollë. Një shembull konkret: në qoftë se një shkollë i ka 1 000 nxënës dhe një SMS kushton 2 centë, atëherë për një semestër bëhen 1 000 mungesa, paramendoni 20 euro kushton që secili prind të informohet se fëmija nuk është shkollë. Dhe, në qoftë se secila klasë e ka një telefon dhe listën e prindërve, dhe në momentin që mësuesi, mësimsdhënësi hyn në klasë dhe çon SMS se fëmija nuk është në shkollë, automatikisht prindi informohet se fëmija i tij është diku jashtë shkolle. Me këtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Raif Qela e ka fjalën.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër Bajrami,

Duke e konsideruar interpelancën parlamentare më tepër si komunikim ndërmjet deputetëve dhe ministrave të resorëve përkatës lidhur me çështje të caktuara, po i drejtohem zotit ministër:

Zoti ministër,

- Duke pasur parasysh se problemet me cilësinë e dobët të arsimit në Kosovë janë shtresuar që disa dekada, probleme të cilat i shpërfaqti tani edhe testi PISA;

- Duke pasur parasysh se ky problem nuk i faturohet dhe nuk i përket vetëm një individi, një grupi a një partie;

- Duke pasur parasysh se riparimi i disa prej këtyre problemeve kërkon konsensus të përgjithshëm shoqëror, por edhe vullnet politik, veçanërisht për riparimin e atyre problemeve të cilat janë shkaktuar prej pasojave që sjell nepotizmi në zgjedhjen e punonjësve dhe drejtuesve të arsimit, duke i pasur parasysh të gjitha këto, çka do të ndërmerrni ju si ministër edhe Qeveria, në mënyrë që të arrihet ky konsensus shoqëror dhe kështu të krijohen kushtet që të përmirësohet gjendja në cilësinë e arsimit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zoti ministër Bajrami,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sigurisht që është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe normalisht që duhet të japim sadopak kontributin tonë për gjendjen në arsimin parauniversitar dhe unë normalisht që flas prej këndit të komunitetit egjiptian-ashkali dhe pozicionin e tyre në këtë sistem.

Përpos projektit PISA dhe rezultateve të këtij projekti, unë te kjo çështje i referohem edhe Raportit të Progresit, ku parashihen rezultatet dhe është një pasqyrë e gjendjes aktuale të komunitetit egjiptian dhe ashkali në procesin e arsimimit parauniversitar. Unë, zotin ministër e falënderoj paraprakisht për bashkëpunimin dhe qasjen e tij proaktive në zgjidhjen e shumë çështjeve, të cilat vërtet e ndryshojnë gjendjen e komuniteteve tona, por kjo është shumë pak nga ajo sa duhet të bëhet.

Po i numëroj disa prej defekteve, të cilat janë paraparë edhe në Raportin e Progresit, por edhe nga gjendja në të cilën vërtet ne e kemi identifikuar. Komunitetet egjiptian dhe ashkalinj të shkëputura nga procesi i arsimimit parafillor dhe kjo normalisht që është një shkëputje e rëndësishme për vazhdimin në mënyrë që të jenë në proces, në përputhje dhe në vijë të barabartë edhe me bashkënxënësit e tjerë. Kjo sigurisht bëhet për arsye të gjendjes ekonomike dhe kushteve të cilat janë të parapara dhe në këtë aspekt duhet të shikojmë ndryshim të gjendjes, në mënyrë që të kemi një situatë të barabartë.

Mosimplementimi i nenit 9, i cili e parasheh mësimin parafillor si mësim të obligueshëm, e që është shumë i rëndësishëm për ne, për shkak që statistikën flasin për një braktisje jashtëzakonisht jo të dëshirueshme të procesit mësimor dhe po konsiderohet se nuk ka një mekanizëm ligjor, i cili do t'i detyronte prindërit, në radhë të parë, mësimdhënësit dhe mekanizmat e tjerë, të cilët do t'i detyronin që nxënësit të kthehen në shkollë. Nga praktika e viteve të kaluara po flas se nxënësit kanë braktisur procesin e obligueshëm mësimor, ndërsa ata akoma nuk janë kthyer në shkollë.

Nuk është realizuar asnjë mekanizëm, nuk është implementuar asnjë mekanizëm, pavarësisht kërkesës sonë të vazhdueshme që këta nxënës të kthehen në shkollë. Për ne është shumë e nevojshme, ngritja e nivelit të arsimimit është shumë e nevojshme për ne si komunitet, për shkak se e shohim jetik në ndryshimin edhe të gjendjes sonë ekonomike dhe do të ishte shumë ideale që edhe mësimi i mesëm të jetë i obligueshëm, për shkak se nxënësit tanë do të obligoheshin që të jenë të paktën deri në nivelin e mesëm dhe ndryshimi i gjendjes të kalojë nga një nivel i ulët në nivelin e mesëm, e kjo është shumë e rëndësishme për ne.

Vitin e kaluar kemi marrë pjesë në një strategji për ngritjen e cilësisë të zhvillimit në Mal të Zi, kemi qenë bashkë me ministrinë dhe ka qenë jashtëzakonisht punëtori e rëndësishme. Aty patëm propozuar, pati dalë si konkludim që në kurrikulën mësimore të parashihet edhe përbërja e komuniteteve në Kosovë, domethënë vlerat e tyre, historiku i tyre, kultura e tyre, në mënyrë që nxënësi që nga fillorja të njoftohen me këto komunitete në mënyrë që të relativizohen raportet mes fëmijëve në radhë të parë, në mënyrë që të mos ketë paragjykime dhe më tutje. Domethënë, unë mendoj që qysh në procesin fillor është mirë që secili nga nxënësit të njoftohet me popujt e tjerë dhe aq më tepër kjo të pasqyrohet si diversitet dhe pasuri dhe te nxënësit të krijohen raporte jashtëzakonisht të mira, sepse aty pasqyrohen vlerat, historiku, kulturat, cilado qofshin ato.

Mbështetja financiare sigurisht se është shumë e nevojshme. Ministri ka bërë në këtë proces, të falënderoj për bursat e javës së fundit, ku u ndanë për një numër të konsiderueshëm nxënësish e shkollave të mesme. Vërtet është bërë një punë e mirë, por nuk është e mjaftueshme, zoti ministër, sepse janë dhënë për një grup të caktuar të nxënësve dhe kjo nuk është e mjaftueshme, sepse nuk e ndryshon në tërësi gjendjen e nxënësve dhe mendoj që ishte dashur një program më zhvillimor, më i arsyeshëm, në mënyrë që këto familje, të cilat pa marrë parasysh cilës etni i takojnë, edhe shqiptarëve, të cilët s'kanë mundësi, t'u mundësohet dërgimi i fëmijëve në shkollë.

Është edhe një dukuri, një lidhje e ngushtë mes ministrisë dhe DKA-së për transportin e nxënësve mbi 4 km dhe zakonisht, edhe për këtë arsye fëmijët tanë e braktisin procesin mësimor, sepse nuk bëhet. Ehe një çështje shumë e rëndësishme, fëmijët të cilët kanë qenë refugjatë, kanë qenë të larguar në migrim e kthimi i tyre tani po ndodh, ata e kanë një shkoputje në procesin mësimor dhe është shumë e rëndësishme që të krijohet një lidhje e ngushtë në mes të ministrisë dhe DKA-ve që të ketë një nxënie të procesit mësimor dhe e di që ka edhe udhëzime administrative, të cilat janë efektive, por duhet të jenë në praktikë.

Janë siguruar kuota për nivelin universitar, por nuk mendoj që kjo është e mjaftueshme, edhe pse vërtet këtë vit kanë pasur efekt shumë të mirë, derisa në nivelin e mesëm nuk e kemi një mundësi të tillë. Domethënë, do të duhej të shikojmë mundësitë që në radhë të parë, nga fillorja, nga shkolla e mesme deri në universitet ta kemi një lidhje të mundësisë të barabartë ose të dhënies së mundësisë shtesë. Unë nuk jam ithtar i diskriminimeve, por jam ithtar i diskriminimit pozitiv, sidomos në fushën e arsimit, sepse me këtë rast nuk humb asgjë Kosova, por pasurohet, sepse nuk kemi marrë rezultate të tilla, sepse sigurisht në testin PISA ka mundur të kenë qenë edhe nxënës nga komuniteti im dhe nuk do të dëshiroja që këto rezultate të jenë vërtet.

Dhe, e fundit, zoti ministër, akoma në shkollat tona raportohen dhe deklarohen nxënës, të cilët, nuk e dua fjalën “diskriminim”, por po përjashtohen nga mundësitë e barabarta. Domethënë lihen anash në bankat e fundit shkollore, trajtohen me një sy tjetër nga nxënësit dhe vërtet nga këtu do të bëja thirrje që secili mësimitdhënës ta trajtojë secilin fëmijë njëjtë dhe të mos bëjë dallime, sidomos në klasë dhe në trajtimin e rasteve kur një fëmijë i duket më ndryshe, duket më i varfër, duket më i veshur ndryshe dhe nëse ne arrijmë bashkarish që ta kemi një nivel të tillë të barabartë të trajtimit të fëmijëve nga mësuesit, atëherë do të ndryshojë gjendja. Unë kërkoj falje, jam i gatshëm të bashkëpunoj në këtë aspekt dhe të falënderoj për mundësinë dhe normalisht që do të bashkëpunojmë ngushtë mbi këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Përshëndetje, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë dy vjetëve të shkuara është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e arsimit, si dhe përmbushjen dhe realizimin e objektivave, programeve dhe projekteve në arsim si pjesë e dokumenteve strategjike të MASHT-it.

Ministri e përmendi se është hartuar plani strategjik për arsim në Kosovë për periudhën e viteve 2017-2021, po ashtu e dimë se ka filluar zbatimin e strategjisë për sigurimin e cilësisë për arsim parauniversitar në Kosovë për vitin 2016-2020, e cila strategji parasheh masa konkrete për përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit. Vlen të përmendet hartimi i planit të veprimit kundër braktisjes, korniza monitoruese e planit kundër braktisjes, e tjerë, e tjerë. Unë do të ndalesha tek arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.

Përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta gjithashtu ka qenë njëri ndër prioritetet e MASHT-it, kështu janë hartuar parametrat e financimit për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe është financuar programi, mësimdhënia bazuar në fushat e aktiviteteve. Gjatë vitit 2016 janë themeluar 14 ekipe vlerësuese, ndërsa në 14 komuna të tjera kanë vlerësuar gjithsej 397 fëmijë nxënës. Janë hartuar standarde të profesionit dhe kurrikula për ata që punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta, janë hartuar standardet për dy profile, janë përgatitur dhe akredituar edhe dy programe të trajnimit për gjuhën e shenjave dhe programi për shkrimin e Brajtit, si dhe është rishikuar dokumenti “Plani individual i arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuar”.

Ne e dimë se politikat e MASHT-it janë të orientuar nga parimi gjithëpërfshirës. Shumë shtete në botë e zbatojnë këtë parim, por sistemi i mbështetjes, nga i cili kushtëzohet gjithëpërfshirja, mbetet sfida për të gjithë. Shumica e shkollave në Kosovë janë të gatshme për gjithë përfshirje, vetëdijesimi dhe ngritja e kapacitetit të drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin e Ligjit parauniversitar për gjithëpërfshirje është arritur, vetëm se duhet ende shumë për të bërë rreth punësimit të mësimdhënësve mbështetës në shkolla, edukatorëve, si dhe asistentëve për fëmijët me sindromin Down.

Po ashtu, vlen të përmendet edhe roli i OJQ-ve në zhvillimin e proceseve arsimore. Kontributi i tyre është i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm, sidomos në sistemin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, ku dihet se ofrimi i shërbimeve të nevojshme varet kryesisht nga mundësitë për investime financiare. Është e pamohueshme roli i UNICEF-it, UNHCR-së, “Save the children”, “Down Syndrom”, “Syri Vizion” e të tjerë, në mbështetjen e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. MASHT-i, Drejtoria Komunale e Arsimit kanë qenë përfituese nga projektet e shumta të realizuara në bashkëpunim me këto organizata. Andaj, mbështetja e mëtejshme e OJQ-ve është një mundësi për realizimin e politikave të parapara për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Po ashtu, është i nevojshëm sigurimi i shërbimeve për mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta, sepse është standard që duhet të plotësohet për të realizuar të drejtat e barabarta në sistemin arsimor gjithëpërfshirës. Duhet të bëhet kthimi i pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, sepse ishte një gabim i bërë në emër të reformës, sepse ky shërbim është i nevojshëm. Po ashtu, duhet të rikthehet edhe ora e kujdestarisë dhe të futet si normë për të eliminuar dukuritë që ndodhin në institucione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Ne në Kosovës sikur na befason gjithçka kur marrim vërejtje nga Raporti i Progresit, kur renditemi keq nga monitorimet e institucioneve ndërkombëtare e tjera, e tjera. Nganjëherë me reagimet që bëhen nga ana e politikanëve, gazetarëve, shoqërisë civile sikur po u gëzohemi gjërave jo të mira dhe në këto raste mjafton që t'ia hedhim fajin dikujt dhe kjo është esenca e të gjithave. Nuk bëjmë atë që duhet bërë që të hulumtojnë dhe të analizojnë pse po vlerësohemi keq.

Edhe në rastin e testit PISA, të entuziazmuar për t'ia hedhur fajin dikujt, nuk janë bërë analizat e duhura për të hyrë në esencën e problemit të arsimit në Kosovë. Duke u marrë të gjithë me çështje të mëdha, tash gati dy vjet me demarkacion dhe asociacion, të cilat u bënë kauza politike nga opozita për të përfutur politikisht, sikur kemi lënë anash çështjet që kanë të bëjnë me jetën e qytetarit. Nuk jemi marrë thjesht sa duhet as ne në Kuvend me çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit, duke e ditur se arsimit është një nga faktorët më të rëndësishëm që reflekton në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në vend.

Nuk mund të themi se nuk ka të arritura në arsim nëse ndalemi dhe analizojmë ku kemi filluar pasluftës dhe ku jemi tani, ka të arritura të shumta, por a është bërë mjaftë atëherë kjo lë për të dëshiruar. Ka të arritura në zhvillimin e reformave, në fushën e legjislacionit, në infrastrukturën shkollore, por kemi nevojë të madhe për zhvillimin e arsimit që t'u përshtatet nevojave të tregut dhe për përmirësimin e cilësisë në arsim. Të gjithë e kemi ditur se cilësia në arsim është thelbësore për zhvillimin e kapaciteteve humane, është bazë për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, në veçanti për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ashtu siç e kemi ditur që cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur, thjesht është sfidë përpara nesh.

Asnjë debat nuk e kemi bërë në këtë mandat se ku jemi me arsimin, si është gjendja në shëndetësi, si dhe në çfarë niveli është zhvillimi ekonomik i vendit.

Ne kemi buxhet jo të mjaftueshëm bazuar në nevojat që ka vendi. Por, duhet ta vëmë në prioritet arsimin kur e dimë që jemi vendi me popullatë më të re në Evropë. Në buxhetin e këtij viti

Ministrisë së Arsimit i është zvogëluar buxheti për 414 487 euro, kurse ne përballemi me problemin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministër Bajrami, në qoftë se e dëshiron fjalën, sepse debati është kryer.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që edhe njëherë të falënderoj të gjitha grupet parlamentare për këtë debat shumë konstruktiv, në mënyrë të veçantë falënderoj iniciuesin, zotin Ismajl Kurteshi dhe Grupin “Vetëvendosje” për kritika shumë konstruktive.

Mendoj se ky ka qenë një nga debatet më të mira kohët e fundit që kemi pasur në Parlament, uroj që këto debate të mos përfundojnë, uroj që gjendja në arsim dhe në edukim të jetë një pikë e rregullt e rendit të ditës së kësaj legjislature. Mendoj se kjo do të tregonte një seriozitet dhe do të mirëpritej nga qytetarët, sepse diskutimi për edukimin është diskutim esencial. Do të sqaroj vetëm 2-3 gjëra, nuk do të merrem me asnjë polemikë, sepse absolutisht të gjitha diskutimet ishin konstruktive. Gjendja në arsim është akoma shumë komplekse, dëshiroj të theksoj se ne sot kemi diskutuar për PISA-n, por kjo ka ndodhur në muajin prill të vitit 2015, sot jemi në 2017-ën. Do t'i shikojmë politikat e këtij mandati në vitin 2018, dhe absolutisht nuk kemi iluzione që kemi bërë punë të madhe. Ne do të jemi jashtëzakonisht të kënaqur në qoftë se do ta nisim një proces gradual të ngritjes së cilësisë dhe ky do të ishte misioni më i mirë i shtetit tonë, sepse do të trasonim një rrugë për të ardhmen.

Natyrisht këtë duhet ta bëjmë si shtet, si shoqëri, jo si Qeveri, jo si parti politike dhe procesi, siç tha edhe deputeti Qelaj, mendoj se ke një apel dhe një thirrje shumë konstruktive, shumë humane, si ta bëjmë arsimin një proces kombëtar, një proces shoqëror, si të bashkohemi së paku rreth edukimit. Meqenëse s'kemi mundur të merremi vesh rreth disa çështje, për të cilat është normale në një demokraci pluraliste që të kemi mendime të kundërta, që të kemi edhe oponentë, atëherë arsimi dhe edukimi duhet të jetë diçka që duhet të na bashkojë. Pse? Ne nuk do t'i bëjmë shërbim partive tona politike, por fëmijëve tanë dhe të ardhmes tonë dhe Ministria e Arsimit është e gatshme për këtë proces. Jemi shumë të kënaqur që kemi pasur një përgjigje pozitive të gjitha partive politike në vendimmarrje, të gjitha komisionet për hartimin e ligjeve unë kam kyçur ekspertë edhe të pavarur, por edhe ekspertë të partive politike dhe do ta ndjekim këtë proces. Nuk ju premtojmë që do të mund të bëjmë gjëra të mëdha, por ju premtojmë dhe jemi të sigurt se një proces pozitiv do ta nisim, ka një vetëdijësim, ky debat është vetëdijësim, ky debat vlerësohet shumë nga partnerët evropianë, sepse shumë shtete pas PISA-s kanë rënë në një stres. Po, edhe ne kemi pasur një stres, mendoj se kemi bërë shumë mirë, kam bërë shumë mirë

që tre muaj pas mandatit e kam organizuar këtë test. Është dashur perceptcionet e publikut t'i shohim edhe ne nuk do ta kontestojmë këtë rezultat dhe askush në Ministrinë e Arsimit nuk do t'i fajësojë nxënësit. Nxënësit s'kanë faj, nxënësit janë të atillë çfarë janë politikat arsimore, por le të jetë ky moment i diskutimit edhe i zhgënjimit, edhe i dëshpërimit ndoshta kombëtar për PISA-n, një moment i vetëdijesimit dhe mobilizimit për të gjithë.

Absolutisht këtu sukcesi është i të gjithëve, nuk është sukses i një ministri, i një partie politike, i një koalicioni, është sukses i një familje, i një shoqërie, i një shteti dhe unë edhe njëherë po përfundoj diskutimin me mbështetjen e plotë të debatit, do ta mbështesim cilindo rezolutë, mendoj se edhe drafti fillestar i rezolutës është i mirë, pashë edhe vullnet te partitë politike që të harmonizohet, kjo rezolutë për neve duhet të jetë e detyrueshme, nuk do të jetë një letër më tepër dhe ne do t'i nënshtrohemi plotësisht kësaj rezolute dhe ju ftoj, e ftoj edhe Kryesinë e Kuvendit që debati për arsim të mos përfundojë vetëm me një interpelancë për sot, por të jetë një debat tremujor që ne të raportojmë çfarë kemi bërë. Jemi në rrugë të mirë, ju siguroj, të nderuar deputetë, nuk po mungon përkushtimi në Ministrinë e Arsimit, nuk po mungon as kompetenca, sepse po i plotësojmë kompetencat si ministri me ekspertizë të jashtme. E dini se arsimi është fusha që po mbështetet më së shumti nga donatorët dhe ata sidomos po e mbështesin tash pas rezultatit PISA dhe jam i sigurt që ky debat i shëndetshëm që ishte sot do të na mundësojë që të kemi më shumë mbështetje, sepse pas pavarësisë dhe pas agjendave politike, nuk ka gjë më të shenjtë dhe më prioritare për Republikën e Kosovës si një vend i të rinjve, si një vend ku më shumë se gjysma e popullsisë janë nën 25 vjeç, se sa të krijosh një edukim cilësor.

Ne mund ta bëjmë këtë, ne kemi detyrim ta bëjmë këtë, sepse e kemi më tepër se gjysmën e popullsisë në edukim, kemi të gjitha kapacitetet, kapaciteti kryesor janë fëmijët tanë, janë studentët tanë, janë mësimitdhënësit tanë dhe ne duhet t'i mbështesim, duhet të kërkojmë llogaridhënie që vërtet një proces i stabilizimit, fillimisht proces i stabilizimit, pastaj proces i rimëkëmbjes graduale, ngritjes graduale. Ministria e Arsimit është e sigurt se në vitin 2018 ne do të kemi progres, progres jo shumë të madh, por do të kemi një progres dhe do ta zëmë hapin fillimisht me shtetet e rajonit dhe pastaj do të kemi një rrugë të trasuar të ngritjes graduale të procesit që të bëhemi vërtet një shoqëri e cila investon në dije, investon në të rinj, një shoqëri e cila nesër do të jetë plotësisht e barabartë me të gjitha shtetet evropiane.

Edhe njëherë më lejoni në emër tim, dhe në emër të Ministrisë, por edhe të Qeverisë të falënderoj të gjitha partitë politike për këtë debat shumë konstruktiv dhe të uroj që ju të harmonizoni një rezolutë të përbashkët, e cila do të jetë një platformë e mirë, një bazë e mirë. Ne e kemi një bashkëpunim të shkëlqyer me komisionin parlamentar, me Parlamentin, kam pasur më shumë se 70 pyetje parlamentare dhe në 65 prej tyre jam përgjigjur dhe raportime, dhe dëshirojmë që me Parlamentin t'i bëjmë këto përmirësime graduale, këto rishikime graduale, gjendja ka evoluar për të mirë. Kemi indikacione nga shkollat, nga mësimitdhënësit, nga familja që ata po e ndiejnë ndryshimin në arsim dhe ju ftoj që këtë mision ta bëjmë bashkë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Unë i pashë reagimet e disave që janë paraqitur, por kohën duhet ta përpjesëtoni në grup parlamentar dhe do të ishte mirë që t'i sillni listat me minutazhin që ju takon, kush sa do të duhej të marrë. Unë nuk kam kurrfarë matësi të kohës, përveç hapësirës kohore që e kanë grupet parlamentare.

Tani është fjala e ushtruesit të kërkesës, zotit Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Zoti nënkryetar!

Në konsultim me grupet parlamentare, Grupet Parlamentare të PDK-së, LDK-së, Aleancës dhe "Nismës" kanë kërkuar që ne të konsultohemi me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve dhe nxjerrjes të një rezolute të përbashkët. Prandaj, ju kisha lutur juve dhe deputetët që ta kenë parasysh këtë kërkesë, unë e konsideroj të arsyeshme dhe një çështje që jam i obliguar t'ia them ministrit: ministër, pas përgjigjes suaj në lidhje me regjistrimin e studentëve më janë paraqitur katër studente nga Gjilani: Kaltrina Shabani, Florina Sylja, Doruntina Ajvazi dhe Hanëmije Leci dhe thonë se ato nuk janë regjistruar, prandaj është mirë që ju këtë çështje ta shihni.

Kurse, sa i përket Komunës së Prishtinës, pranimi në punë bëhet me kritere, këtë e di edhe LDK-ja, përveç ndonjë përjashtimi, siç është çështja e zonjës Tërmkolli, prandaj është problem i mosinformimit, zonja Tërmkolli ose po e mbani mend Prishtinën e para tre vjetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Atëherë, do të thotë kërkesa juaj ishte të mos e qesim në votim, por të presim derisa të harmonizohet teksti, a është kjo? Po, pauzën po e jap deri në orën 16:15 minuta dhe pastaj kthehem në seancë. Zoti Bajrami i ka dy fjalë.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Kisha dashur vetëm një minutë mirëkuptim, dëshiroj t'u kërkoj ndjesë dhe falje deputetëve të komuniteteve joshumicë, për shkak se në fjalimin tim bazë harrova të përmend. Dëshiroj t'i siguroj se jemi duke punuar bashkë me ta dhe besoj që edhe ata janë të vetëdijshëm që kemi bërë mjaft progres sa i përket ofrimit të arsimit në gjuhën e tyre.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: E vazhdojmë seancën dhe derisa të përgatitet teksti i projektrezolutës, ne vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për automjete

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ia rekomandon Kuvendit miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Zharku, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për automjete është ligji i tretë dhe i fundit, i cili del nga Ligji për sigurinë në komunikacion, nëpërmjet të cilit përmbyllet cikli i ligjeve, të cilat e rregullojnë sigurinë në komunikacionin rrugor.

Siç e dini, tanimë janë në fuqi Ligji për patentëshoferë dhe Ligji për rregullat në trafikun rrugor. Ky ligj ka për qëllim ngritjen e sigurisë në komunikacion, mbrojtjen e ambientit nga ndotja e shkaktuar nga automjetet, duke u mbështetur dhe harmonizuar me legjislacionin evropian që e rregullon këtë fushë.

Me Projektligjin për automjete rregullohet miratimi i automjeteve, kontrollimi teknik i automjeteve, si dhe regjistrimi i automjeteve. Nëpërmjet miratimit të automjeteve sigurohen automjete të sigurta, si nga ana e aspektit të pjesëmarrjes në komunikacion, po ashtu edhe me qëllim të ruajtjes së ambientit. Me rastin e importit të automjeteve kontrollohet miratimi i tipit, homologimi për secilin automjet dhe vetëm automjete që kanë miratim evropian mund të regjistrohen.

Kontrollit të miratimit i nënshtrohen të gjitha automjetet që importohen. Automjetet e reja kontrollohen me qëllim të verifikimit të kushteve teknike, të cilat duhet të plotësohen nga aspekti i sigurisë dhe i ruajtjes së ambientit, kurse automjetet e vjetra kontrollohen me qëllim të verifikimit të kriterëve teknike, që duhet të arrihen në mbështetje të rregulloreve, të cilat i kemi në fuqi.

Ky projektligj është gjithëpërfshirës dhe janë precizuar procedurat për miratim, kushte dhe veprime që duhet të ndërmerren në rast se nuk janë përmbushur kriteret në tërësi, si dhe në cilat raste refuzohet miratimi.

Projektligji në mënyrë shprehimore përcakton se nuk ka kufizime sa i përket numrit të subjekteve që autorizohen për ofrimin e shërbimit të homologimit. Po ashtu, është rritur kontrolli dhe niveli i përgjegjësisë nga institucionet, të cilat e ofrojnë shërbimin e miratimit duke paraparë gjoba prej 10 mijë deri në 15 mijë euro, si dhe humbjen e të drejtës së ofrimit të këtij shërbimi, në rast mosrespektimi të ligjit.

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të rritjes së sigurisë në rrugë, rëndësi e veçantë i është kushtuar kontrollimit teknik të automjeteve si proces i cili i paraprinë të drejtës për regjistrimin e automjeteve. Ligji përcakton këto lloje të kontrollimit teknik: kontrollimin teknik periodik, kontrollimin e jashtëzakonshëm, i cili mund të jetë me vendim të Policisë dhe kontrollim mobil në rrugë.

Projektligji rregullon edhe kushtet e subjekteve, të cilat merren me ofrimin e shërbimit të kontrollimit teknik. Me qëllim të krijimit të lehtësirave për ofrim të shërbimeve, qendrat e kontrollimit teknik licencën e kanë me periudhë të pakufizuar, me kusht që gjatë tërë kohës i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj. Në rast të mangësive i pezullohet licenca deri në plotësimin e kushteve.

Ky projektligj ofron kontroll më të rreptë ndaj subjekteve të papërgjegjshme dhe stimulon subjektet, të cilat shërbimin e besuar e kryejnë me përgjegjësi dhe korrektësi.

Kontrollimi teknik periodik është kontrollim, që kryhet në periudha të rregullta vjetore e që zakonisht i paraprinë regjistrimit të automjeteve.

Kontrollimi teknik i jashtëzakonshëm konsiderohet rasti, kur Policia në mënyrë të pavarur dhe në mbështetje të dyshimit të bazuar e dërgon automjetin në kontrollim teknik.

Me këtë projektligj risi kemi kontrollimin teknik mobil në rrugë, shërbim i cili nuk ka qenë i rregulluar me ligjin aktual në fuqi. Me kërkesën e Komisionit Evropian, ky shërbim është harmonizuar me direktivën 2014/47/EU. Përmes këtij shërbimi kontrollohet gjendja teknike e çastit e automjeteve pjesëmarrëse në komunikacion, si dhe kualiteti i shërbimeve të ofruara nga qendrat e kontrollimit teknik. Me qëllim të mënjanimin të keqpërdorimeve, projektligji i përcakton kushtet minimale të cilat duhet të përmbushen para se automjeti t'i nënshtrohet kontrollimi teknik mobil.

Me rastin e kontrollimit teknik të automjeteve është bërë klasifikimi i mangësive, ato që janë të vogla, që s'kanë efekt të rëndësishëm në sigurinë e automjetit, ose ndikimit në mjedis dhe mospërputhjeve tjera të vogla, mangësi të mëdha që mund të dëmtojnë sigurinë e automjetit, ose kanë ndikim në mjedis, ose vënë përdoruesit e tjerë të rrugës në rrezik apo edhe mospërputhje tjera më të rëndësishme dhe mangësi të rrezikshme, që përbën një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë rrugore, ose që kanë një ndikim në mjedis.

Ndarja e tillë e mangësive të konstatuara me rastin e kontrollimit teknik të automjeteve siguron pjesëmarrje të sigurt të automjeteve në komunikacionin rrugor, rrit nivelin e përgjegjësisë së subjekteve të autorizuara për ofrimin e shërbimit për kontrollin teknik, me qëllim të përmirësimit dhe ruajtjes së sigurisë rrugore, e që nënkupton zvogëlimin e aksidenteve në përgjithësi, e me fokus të veçantë tek ato me fatalitet.

Projektligji rregullon procedurat e regjistrimit, vazhdimin të regjistrimit, pezullimit të përkohshëm dhe automjeteve që kanë dalë prej përdorimit, automjetet të cilat janë në gjendje të rregullt teknike dhe plotësojnë kushtet për qarkullim në rrugë dhe automjetet që kanë dalë prej përdorimit.

Me ligjin në fuqi nuk është e rregulluar çështja e automjeteve, të cilat kanë dalë prej përdorimit si shkak i vjetërsisë apo aksidenteve të rënda dhe të cilat janë bërë të papërdorshme. Projektligji e rregullon procedurën për subjektet të cilat do të merren me grumbullimin e automjeteve e të cilat kanë dalë prej përdorimit, si dhe obligimet e pronarit që ka vendosur që automjetin e vet ta nxjerrë jashtë përdorimit.

Të nderuar deputetë,

Shkeljet e parapara në këtë projektligj paraqesin kundërvajtje dhe sanksionohen me gjoba. Me rastin e shqiptimit të gjobave në projektligj parashihen tri nivele: personi apo zyrtari që kryen shkeljen; personi përgjegjës në subjektin juridik apo udhëheqësi, si dhe vetë subjekti juridik. Kjo formë e shqiptimit të dënimeve në tri nivele ka për qëllim rritjen e përgjegjësisë së subjekteve, të cilat janë të autorizuara nga ministria për ofrim të shërbimeve që parashihen me këtë projektligj dhe me synim të qartë ngritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve për qytetarë.

Siç u përmend më lart, ky projektligj bart më vete risi, të cilat më herët nuk kanë qenë të rregulluara, e të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e procedurave administrative për ofrues të shërbimeve në këtë fushë, ngritjen e sigurisë në komunikacion dhe ruajtjen e ambientit, siç janë licenca me afat të pakufizuar, respektimi i plotë i vendimit të Qeverisë për fillimin e procedurave, për eliminimin e monopoleve, kontrollimin teknik mobil në rrugë dhe rregullimin e procedurës për automjete, që kanë dalë prej përdorimi e që ka për qëllim primar ruajtjen e ambientit nga ndotja.

Përmes këtij ligji është tentuar që të evitohen mangësi të cilat kanë qenë prezent në ligjin ekzistues për siguri në komunikacionin rrugor, duke e bërë harmonizimin me direktivat dhe praktikatat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian në këtë fushë, me qëllim të krijimit të standardeve që sigurojnë ruajtjen e ambientit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hap debatin lidhur me projektligjin. E ftoj deputetin, zotin Fatmir Rexhepi, që në emër të Komisionit Funkcional ta paraqesë raportin e komisionit.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Komisioni Funkcional në parim e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe ka nxjerrë rekomandimet apo vlerësimet në parim, duke u nisur nga fakti se rëndësia e madhe që ka ky projektligj, në mënyrë të veçantë nxjerrja e këtij projektligji nga paketa e projektligjeve të tjera, na ka krijuar një mundësi më të madhe që gjatë shqyrtimit dhe procedimit parlamentar deri në leximin e dytë, pra të bëjmë ato plotësime dhe ndryshime në mënyrë që të kemi përmirësime të caktuara apo të theksuara në përmbajtjen e këtij projektligji e të cilat janë me interes të jashtëzakonshëm, ose të veçantë, sidomos ato të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë apo kanë impakt në përmirësimin e gjendjes në trafik, të sigurisë më të madhe për njerëzit dhe jetën e njerëzve, si dhe në ruajtjen apo përmirësimin e ambientit, krahasuar me periudhën e kaluar.

Po ashtu, besojmë që në debatet e mëtuftjeshme do të kemi kujdes të veçantë në kushtet e regjistrimit apo kriteret e kontrollimit teknik, të cilat u përmendën këtu edhe nga ministri, për të gjitha rregullat që janë aty, qoftë kontrollimet e rregullta vjetore, periodike apo kontrollimet mobile, të cilat mund të dalin kohë pas kohe në mënyrë që të ndikohet drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së automjeteve gjatë qarkullimit në komunikacion.

Po ashtu, kujdes të veçantë do të kemi edhe për autorizimet dhe rregullat e lëshimit në komunikacion, do të bashkëpunojmë si komision dhe do të shohim, se cilat do të jenë praktikatat e vendeve të tjera, gjithnjë duke pasur parasysh edhe specifikat që i ka Kosova si një vend me dendësi në trafikun që ka, për kriteret më të mira që kishte me u vendos brenda këtij projektligji në funksion të përmirësimit dhe ndryshimeve a plotësimeve të caktuara, si dhe kushtet po ashtu që ka të bëjnë me daljen e automjeteve nga përdorimi. Çfarë duhet të jenë ato realisht, që i përgjigjen vendit tonë, standardeve dhe rregullave të tjera, që implementohen sot në vendet e Bashkimit evropian dhe cilat do të ishin ato që po ashtu krijojnë kushte më të mira në mirëmbajtjen, por edhe në kriteret për automjete, që përdoren në Kosovë.

Po ashtu, jemi të interesuar të shohim edhe mundësinë e kushteve të importimit dhe vjetërsisë së automjeteve. Nëse, na lejohet që në projektligj ta përcaktojmë, ose kodifikojmë afatin e

importimit të automjeteve, ne do ta kemi gjatë debateve dhe të shohim se a është e drejtë e jona ta vendosim këtë projektligj afatin për veturat se çfarë vjetërsie mund të kenë gjatë importit të tyre. Ngjashëm do të shqyrtojmë, me shumë peshë besoj, një ndër çështjet më të rëndësishme që duhet të shihet në këtë projektligj edhe çështja e homologimit të veturave, automjeteve përgjithësisht, sepse të shohim modelet dhe praktikat më të mira edhe në vendet tjera, se a duhet të ekzistojë edhe më tutje homologimi për automjetet e prodhuara në vendet e Bashkimit Evropian. Cila është arsyeja që të ekzistojë? Cila është arsyeja që shpenzojmë para, apo të vendosim një kodifikim të ri, një amendament në projektligj, që të mos ketë fare homologim për këto, ndërsa homologimi të vlejë për vendet tjera, të cilat vijnë nga vendet aziatike apo nga vendet që nuk janë në kuadër të standardeve që u përgjigjen, qoftë kahes së lëvizjes, siç është Britania apo vendet tjera, në vendin tonë. Pra, do ta shohim edhe këtë mundësi dhe mendojmë që duhet t'i përshtatet, në mënyrë që homologimi të mos ekzistojë për këto produkte.

Po ashtu, rëndësi të veçantë brenda ligjit ka se do t'i kushtojmë kujdes edhe masave të tjera që janë cekur në ligj, me një vështrim të veçantë lidhur me gjobat, dënimet, kategorizimet, sepse ka shumë punë në këtë e të cilat do të kenë një impakt të drejtpërdrejtë si tek subjektet, si te qytetari e te... krejt çështje që përcjellin këto masa.

Në fund, ne e përkrahim në parim. Si grup i punës, në kuadër të komisionit do të organizojmë debatin publik me të gjitha grupet e interesit, në mënyrë që këtij projektligji me rekomandimet t'i japim një përmbajtje të vërtetë, deri në leximin e dytë t'i përkthejmë ato në amendamente dhe ta përgatisim për leximin e dytë duke marrë parasysh edhe debatin parlamentar. Prandaj, ne e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Shala-Berisha.

SALA SHALA-BERISHA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje Kabinet qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë e deputete,

Ju të pranishëm,

Para nesh e kemi në shqyrtim të parë Projektligjin për automjete. Ky projektligj është në kuadër të pakos ligjore, që ka dalë nga ndryshimi i Ligjit për siguri në komunikacion, nga i cili ligj kanë dalë tri ligje, siç është Ligji për patentë shofer, Ligji për rregullat e trafikut rrugor dhe tani kemi Projektligjin për automjete.

Ndryshimi i Ligjit për siguri në komunikacion rrugor ka mundësuar harmonizimin e dispozitave me rregullat dhe direktivat e Bashkimit Evropian për çështje që kanë të bëjnë me kushtet, të cilat do t'i plotësojnë mjetet me rastin e importit, regjistrimin e mjeteve dhe kushtet që duhet t'i

plotësojë mjeti, me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe të përmirësimit të sigurisë në trafikun rrugor.

Shumica prej çështjeve që kam pasur në plan t'i cek këtu i tha edhe ministri edhe kolegu nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, pra ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta mbështesim në parim këtë ligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit në çështje të caktuara, sepse ky ligj ka nevojë të përmirësohet, të ndryshohet edhe në aspektin gjuhësor edhe në atë përmbajtjesor. Kontributin tonë do ta japim gjatë asaj faze. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Berisha-Shala. Fjalën e ka zoti Blerim Grainca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

BLERIM GRAINCA: Deputetë,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës mendon se ky ligj është i një rëndësie të veçantë dhe është një përmbyllje, një pako, e ligjeve që kanë ardhur nga Ministria për Infrastrukturë.

Ne e kemi shqyrtuar me kujdes përmbajtjen e ligjit dhe mendojmë, se është një ligj që ofron, përveç një sigurie në komunikacion dhe sigurisë për qytetarët, përveç impakteve që ka në koston e jetesës së tyre, po ashtu ka edhe impakt në ambientin dhe kushtet e jetesës, ndotjen e ambientit, në përgjithësi.

Megjithatë, Lidhja Demokratike mendon se ky ligj duhet të plotësohet në vazhdim dhe nëpërmjet anëtarëve të saj në Komisionin për Zhvillim Ekonomik do të angazhohet, që në këtë ligj disa nene të tij të ndryshojnë, të fuqizohen edhe më shumë e veçanërisht ato që lidhen me kontrollet teknike, duke fuqizuar edhe më shumë rolin e kontrolleve teknike dhe nevojën që ato të aplikohen edhe më shumë edhe më shpesh, por veçanërisht kontrollet mobile që janë në rrugë. Theks i veçantë është qëndrimi i Lidhjes Demokratike, se në Komisionin për Zhvillim do të angazhohemi që me ligj të rregullohet çështja e homologimit, gjegjësisht të mos kemi nevojë për homologim të automjeteve, sepse mendojmë se nuk ka nevojë të homologohen automjetet që vijnë nga tregu i Evropës dhe shiten në Evropë.

Në këtë rast angazhohemi që në Komisionin për Zhvillim ekonomik t'i sjellim amendamentet e nevojshme, në mënyrë që ligji të jetë më përmbajtjesor dhe kështu t'i plotësojë të gjitha nevojat dhe kërkesat edhe të qytetarëve, po edhe të... në mënyrë që kjo fushë të rregullohet më mirë me ligj.

Prandaj, Lidhja Demokratike në parim do ta votojë këtë ligj në lexim të parë dhe gjatë leximit të dytë do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet këtë projektligj. Kontributin dhe vërejtjet tona do t’i japim gjatë kohës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrustem Berisha, në emër të AAK-së, e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe i kemi vërejtjet tona për çështje të caktuara. Në parim e përkrahim ligjin, ndërsa kontributin tonë do ta japim në mes dy leximeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Nisma”, zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues.

Edhe Grupi Parlamentar Nisma në parim e mbështet Projektligjin për automjetet dhe natyrisht, në mes dy leximeve do të japim kontributin tonë përmes anëtarit tonë në komisionin adekuat lidhur me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”-i nuk është paraqitur, është dakord. Zoti Raif Qela ka kërkuar fjalën.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Sot po e shqyrtojmë Projektligjin për automjete, njërin prej projektligjeve shumë të rëndësishme për sigurinë në trafikun rrugor.

Ky është njëri prej tri ligjeve nga pakoja e ligjeve, që ka dalë prej Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe është shumë mirë që është proceduar, sepse është dashur të plotësohen disa prej mangësive që janë vërejtur në ligjin e kaluar. Si të tillë, projektligjin duhet ta mbështesim, mirëpo projektligji ka disa prej problemeve, që unë do të përpiqem t’i theksoj kalimthi.

Duhet të rregullohet si duhet, sa më mirë që të jetë e mundur, së pari kontrolli teknik, sepse kjo ka nxjerrë vazhdimisht probleme edhe me pasoja në sigurinë e trafikut edhe me pasoja në njerëz. Lidhur me homologimin, po ashtu ka probleme që tashmë janë bërë publike. Vjetërsimi i automjeteve, vjetërsia e automjeteve të importuara duhet të rregullohet një herë e përgjithmonë. Nuk kemi më arsye që bërllokun e Evropës ta sjellim në Kosovë. Ka qenë gabim vendimi i Qeverisë që të hiqet kufizimi në vitet e caktuara, siç ka qenë më përpara. Mendoj se kjo punë duhet të rregullohet me ligj e jo t’i lihet Qeverisë. Të gjitha këto janë çështje, që mund të përmirësohen.

Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri, të cilit unë i përkas, unë kam votuar kundër. Edhe sot vota ime do të jetë kundër për një arsye tjetër.

Me propozimin e komisionit ky Kuvend i ka rekomanduar Qeverisë që ligjet që sillen këtu të përgatiten mirë teknikisht, në mënyrë që të mos ketë probleme teknike me to, që tu përmbahen udhëzimeve se si procedohen projektligjet, në që të mos ketë në to gabime teknike, drejtshkrimore e sintaksore. Edhe ky ligj, si edhe disa ligje tjera, i kanë një mori gabimesh, bën vaki edhe njëmijë, si edhe projektligji i kaluar.

Si shenjë revolte ndaj asaj, se janë të pakujdesshëm unë votën time sot do ta jap kundër. Faleminderit!

KRYESEUSI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur për të diskutuar për projektligjin. Të shoh a kemi kuorum, më duket se s'kemi kuorum për vota.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij. Procedimi i mëtejshëm është si vijon:

Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zoti Skender Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar ministra,

Më lejoni, që sot të prezantoj para jush Projektligjin për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, si dhe municioneve dhe mjeteve eksplozive, ligj ky i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Deri më 31 dhjetor 2014 sipas anketimit për armët e vogla, është vlerësuar se ka pasur rreth 260 mijë armë të paligjshme në duar të personave civilë në Republikën e Kosovës. Kjo tregon se ka pasur zvogëlim të madh që nga vlerësimi i fundit i kryer në vitin 2007, kur numri i armëve në posedim të paligjshëm ka qenë 310 mijë deri në 240 mijë. Po, gjithashtu kjo tregon sërish, se përafërsisht edhe sot çdo i shtati qytetar në Republikën e Kosovës posedon armë të paligjshme.

Policia e Kosovës çdo vit konfiskon rreth 1 500 armë, numër ky jo i mjaftueshëm për zvogëlimin rapid të numrit të armëve në posedim ilegal. Prandaj, konsiderojmë që përmes amnistisë dhe legalizimit për një periudhë të caktuar kohore, qytetarët mund të dorëzojnë armët e tyre të paligjshme dhe ato që mund të legalizohen u nënshtrohen procedurave ligjore.

Kjo, po ashtu, ndikon në fuqizimin e prioritetit strategjik të Qeverisë numër 2 për sundimin e Ligjit dhe shtetin e së drejtës, pjesë e planit vjetor të punës së Qeverisë e po ashtu edhe pjesë e objektivave në planin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Për krijimin e një ambienti të sigurt për qytetarët e vendit është vlerësuar si e domosdoshme që kjo çështje, pra legalizimi i armëve dhe dorëzimi i armëve të vogla dhe të lehta, si dhe municionit dhe mjeteve eksplozive, përfundimisht të rregullohet me ligj.

Pra, me këtë projektligj përcaktohen të drejtat për persona fizikë dhe juridikë për legalizimin të armëve dhe dorëzimin e tyre vullnetar, si dhe municioneve dhe mjeteve tjera eksplozive që janë në posedim të paligjshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat përkatëse, opinioni për vlerësim dhe ndikim buxhetor nga Ministria e Financave, si dhe opinioni ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji dhe domosdonë e krijimit, përkatësisht kompletimit të kornizës ligjore për kontrollin e armëve dhe të municioneve, ju ftoj që sot në parim ta përkrahni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional, e ftoj zotin Daut Haradinaj ta paraqesë raportin e komisionit. Atëherë, zoti Shurdhaj e merr fjalën.

FATMIR SHURDHAJ: I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2016 shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve të vogla e të lehta, municionet dhe mjetet eksplozive dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve të vogla dhe të lehta, municione e mjete eksplozive.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare e shqyrtoi projektligjin dhe Kuvendit i paraqiti raport me rekomandime.

Komisioni, pas shqyrtimit të parë në parim të Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve të vogla, të lehta, municionet dhe mjetet eksplozive, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhjen plenare, si dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin e tij në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla e të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Duke pasur parasysh vitin që lamë pas Kosova është tronditur nga vrasje të shumta, të një numri të madh të humbjes së jetëve, konsiderojmë që ky ligj është më se i domosdoshëm dhe të gjitha rekomandimet tona do t'i japim nëpërmjet anëtarëve të Partisë Demokratike në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë që ky ligj të jetë sa më i përshtatshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe njëherësh ftojme qytetarët e Republikës së Kosovës të marrin këtë ligj shumë seriozisht dhe ta shfrytëzojnë pozitivisht për sigurinë e tyre në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e ka zoti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim do ta votojë projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes", fjalën e ka zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe e sheh me kujdes këtë projektligj. Dua të konstatoj edhe një herë se ky është derivat i Ligjit bazik për armët, ku në nenin 34 të Ligjit bazik për armët thuhet: “Legalizimi dhe dorëzimi i armëve rregullohet me një ligj të veçantë”, prandaj është edhe kontribut i Komisionit për Siguri, i cili e ka bërë shtytjen dhe sensibilizimin e mjaftueshëm që Ministria e Punëve të Brendshme ta sjellë këtë projektligj tash në Parlament, një projektligj, i cili ndoshta mund të konsiderohet si derivat i Ligjit bazik për armët.

Normalisht, si gjithmonë, edhe kësaj radhe Qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme gjatë procedimit dhe gjatë draftimit të projektligjeve krijojnë një sërë gabimesh, të cilat neve na dalin si punë për t’i korrigjuar gjatë procedimit dhe kohës së amendamentimit ndërmjet dy leximeve.

Janë disa vërejtje teknike që janë parë këtu dhe mendoj që grupi punues do t’i rregullojë në pamje të parë, siç janë vërejtjet teknike, për shembull, të konsolidohen termat, sepse diku përdoret QKK, është fjala për Qendrën Koordinuese Shtetërore, e diku QKSH.

Sidoqoftë, ky është një aspekt teknik, por prapëseprapë është një pasqyrim i një pune jo të mjaftueshme dhe serioze të atyre që i draftojnë këto projektligje.

Po ashtu, edhe sa i përket fushëveprimit, që është i paraparë në nenin 2, duhet të qartësohet më mirë, sepse për momentin lë hapësira të mëdha interpretimi.

Kurse, vërejtjet substanciale që i parasheh ky ligj janë se në këtë ligj, qysh në titull, përdoret një term i ri që nuk gjendet në Ligjin bazik për armët, për shembull, “mjete eksploziv”, si term nuk përcaktohet definicioni, askund, e as në ligjin bazik dhe duhet të shihej edhe një herë, e po ashtu, ndoshta do të duhej edhe në aspektin teknik, por edhe juridik të përcaktohet kjo më mirë siç është përcaktuar këtu në projektligj. Pra, meqë është term i ri, duhet të përcaktohet definicioni i saktë i tij.

Pastaj, neni 3 përcakton se “personi juridik i licencuar është person juridik i licencuar për tregtim, riparim, çaktivizim dhe prodhim të armëve sipas Ligjit bazik për armët”.

Mirëpo, askund, e as në ligjin në fjalë e as në projektligjin për armët nuk përcaktohet saktë se për çfarë entiteti bëhet fjalë: “personi juridik i licencuar”.

Për krejt çka dimë ne, mund të jetë një kompani e regjistruar si SHPK, e cila ka licencë kudo nëpër botë për prodhimin e armëve dhe që ka hapur një seli në Kosovë. Prandaj, duhet të përcaktohet edhe më saktë se çfarë nënkupton “personi juridik i licencuar” në këtë rast dhe, ne e

dimë se çka është menduar, pra duhet të mos lihet hapësirë për interpretim dhe hapësirë që mund të përdoren edhe në të ardhmen, eventualisht për ta keqpërdorur këtë projektligj.

Po ashtu, edhe te neni 4 duhet sqaruar edhe një herë afatet më mirë apo të përcaktohen më mirë.

Pastaj, të përcaktohet nëse neni 374 i Kodit Penal të Kosovës do të pezullohet edhe gjatë periudhës së ankesës dhe nëse po, deri në çfarë faze, deri në çfarë mënyre, që do të thotë, ankimi të bëhet sipas procedurave nga Ligji për armët, që është i përcaktuar atje në nenin 7 të atij ligji.

Të përcaktohen saktë përbërja dhe kompetencat e QKK-së, në mënyrë që të evitohen çfarëdo lloj keqpërdorimi të këtij organi apo eventualisht monopolizimi i tij.

Në ligj thuhet se “do të përcaktohet me akt nënligjor”, por kjo nuk ka kuptim, sepse akti nënligjor mund të përmbajë çfarëdo dhe s’ka nevojë fare të aprovohet tash nga deputetët, prandaj mendoj që grupi punues do ta shohë edhe një herë në aspektin juridik dhe në aspektin teknik se si do ta procedojë më tutje.

Prandaj përbërja, mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve dhe kompetencat duhet të përcaktohen me ligj, siç është paraparë këtu në nenin 10.

Pra, sipas këtij ligji, nuk do të duhej t’i lihet hapësirë monopolizimit të këtij procesi dhe nuk do të duhej që ky proces, thjesht, të monopolizohet duke u lënë komplet në duar të Qendrës Koordinuese të Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje”, duke parë këtë si të domosdoshme, duke parë edhe si të nevojshme për ta plotësuar infrastrukturën ligjore që e mbulon këtë fushëveprim, e mbështesim në parim dhe të gjitha vërejtjet tona dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DUAT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë se vendet e rajonit e kanë praktikuar një ligj të ngjashëm dhe mendoj që edhe Kosova ka nevojë për një ligj të tillë dhe për ta bërë më të qartë edhe për opinionin publik, sepse dyshoj qysh tha Ganimetja, mos po ia çojnë Skendës nesër krejt armët e Kosovës e ia lënë te dera, prandaj të mos nguten, se është në lexim të parë dhe pason leximi i dytë.

Megjithatë, ka vërejtje, siç e tha edhe Selimi, por gjithsesi, meqenëse është në lexim të parë, është më se e domosdoshme të marrë përkrahje të deputetëve.

Në shumicën e vendeve të rajonit edhe janë stimuluar njerëzit të cilët kanë hequr dorë prej armëve ilegale, por meqenëse Kosova kapacitetet buxhetore i ka kështu çfarë janë, atëherë të paktën të hiqet masa ndëshkuese e të gjithë atyre që kanë vullnet të heqin dorë prej armëve ilegale. Pra, e mira e këtij ligji duhet të shihet në këtë aspekt.

Në të njëjtën kohë, po ashtu për opinionin publik, meqenëse ne jemi një vend i dalë prej lufte dhe kuptohet fare mirë se janë rreth 300 000 armë ilegale në Kosovë, ky ligj po ashtu nënkupton edhe legalizimin e tyre, që nënkupton shteti e di çfarë lloji të armës posedon dikush dhe, nëse është një trofe, mund të mbyllet ajo, dhe i ka njëqindmijë forma të cilat vetë ligji duhet t'i respektojë, por në të njëjtën kohë ato armë, në rast se dikush i përdor, shteti apo organet e rendit e kanë shumë lehtë ta identifikojnë personin i cili e ka kryer ndonjë vepër të caktuar.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do t'i japë përkrahje, por jam i bindur se edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, në emër të "Nismës", e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu edhe ne në parim e mbështesim këtë ligj. Natyrisht se kemi pasur debate edhe në Komisionin për Siguri. Janë evidente lëshimet fillestare, mirëpo jemi pajtuar që të silltet në Kuvend për t'i dhënë mundësi të miratohet në parim dhe të japim kontributin tonë në këtë fushë, e cila është bukur e ndjeshme.

Çështja e armëve edhe me ligje të tjera pak a shumë është e rregulluar, këtu, siç ka munguar deri tash, edhe në Ligjin bazik, çështja e amnistisë, edhe pse nga paslufta dhe me urdhëresa administrative e me vendime të veçanta është provuar diçka e tillë, por s'ka pasur efekt.

Shpresoj se deri në leximin e dytë ne do ta plotësojmë këtë ligj dhe me shpresë se situata politike e sigurisë do të jetë e favorshme që qytetarët pastaj të kenë motiv për ta respektuar këtë ligj, të vetëdijshëm gjithmonë se armët, veçanërisht të dëmit në masë, që gjenden te qytetarët si shkas i luftës së armatosur, që ka qenë në Kosovë e rajon, mendoj se duhet të kalojnë në duart e institucioneve me idenë se tash nuk ka nevojë qytetari ta mbrojë vetveten, sepse e ka shtetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Tani mbetet të votohet, por edhe pika 7 e rendit të ditës, atëherë kur të kemi kuorum të mjaftueshëm.

Janë 59 deputetë të pranishëm, prandaj nuk mund të votojmë.

8. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë, lidhur me arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë, ka propozuar debat parlamentar lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe ka propozuar një propozim-rezolutë, e cila u është shpërndarë deputetëve.

Edhe për këtë çështje duhet t’ju them se i dini rregullat sa minuta i ka secili deputet, prandaj e përgatitni fjalën në kuadër të dhjetëminutëshit.

(Ndërhyrje)

Duhet të jenë 61 deputetë.

Do të thotë, secili i keni nga 10 minuta, e nëse doni ta zvogëloni, mund të flisni edhe për atë çështje. Unë s’kam ndonjë propozim.

Atëherë, ftoj zotin Glauk Konjufca që në emër të propozuesit ta marrë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Para se të marr fjalën, a mund të paraqes një propozim.

KRYESUESI: Po! Fjalën e ka zoti Konjufca, e ka një propozim procedural.

GLAUK KONJUFCA: Propozoj që ky debat i sotëm të shtyhet për nesër në mëngjes, në orën 10:00, sikur që fillojnë seancat, për dy arsye:

E para, sepse jemi në kufi të kuorumit dhe, edhe nëse bëhen 61, do të thotë pas dy orësh, apo pas një ore e gjysmë, prapë mund të kemi problem sa i përket pranisë së deputetëve.

Dhe, e dyta, nuk është i pranishëm as kryeministri e as ministrja e Drejtësisë, me të cilën ka drejtpërdrejt të bëjë ky debat parlamentar, kështu që kjo do të ishte edhe një arsye shtesë pse ne kërkojmë mirëkuptim nga grupet e tjera parlamentare, sidomos të PDK-së dhe LDK-së, që kjo pikë të shtyhet për nesër në orën 10.

KRYESUESI: Për këtë duhet të votohet, por sidoqoftë kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën sa i përket mocionit tuaj.

Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e do fjalën? Fjalën e ka zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora një kërkesë nga kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” për në gjë të tillë pak më herët. Është kërkesë edhe e deputetëve që, nëse shtyhet për nesër, prandaj edhe nga moti do të kenë vështirësi deputetët të vijnë, kështu që ne jemi për të vazhduar sot seanca, edhe me pika të tjera, e pastaj të votohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqiri e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Zenun, a jeni marrë vesh për ta shtyrë, apo për të mos e shtyrë? Urdhëroni, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ne jemi për të vazhduar debati, jo të shtyhet, sepse debati edhe me 30 vetë bëhet, kurse çështja e votimit është çështje tjetër. Pra, jemi që ky debat të vazhdojë sonte, e jo të shtyhet për nesër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Sa i përket Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrahim iniciuesin që të shtyhet ky debat për nesër në orën 10, meqë tani edhe është vonë dhe për qëllime të caktuara po lihen këto pika që janë me rëndësi të veçantë të diskutohet në Parlament dhe nuk e di pse nuk mund të debatohet nesër, eventualisht edhe të hënën apo që të vihet si pikë e parë e rendit të ditës në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Edhe ne si Grup Parlamentar mendojmë që ky debat më mirë të zhvillohet nesër, gjithmonë me idenë që aktorët për të cilët bëhet fjalë në këtë debat të jenë këtu prezentë, sepse zakonisht kur diskutohen çështje për sektorë të caktuar personat përgjegjës nuk janë këtu dhe në njëfarë forme debati po jetë shterpë dhe i paadresuar si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e kanë kërkuar edhe dy deputetë për këtë çështje, zoti Sabri Hamiti dhe Rexhep Selimi, edhe pse me Rregullore s’është, por do të na ndihmojnë të dytë.

SABRI HAMITI: Mu për Rregullore e kërkova fjalën! Me Rregulloren e Kuvendit pa u bërë 61 deputetë s’mund të marrë leje as prej kryetarëve të grupeve për ta ndërprerë ose shtyrë. Pra, është kjo kështu me Rregullore.

KRYESUESI: Kryetarët mund të diskutojnë, por vendimi nuk mund të merret pa 61 deputetë.

SABRI HAMITI: Ata diskutojnë, por vendim nuk mund të merret.

Dhe, e dyta - ne biseduam gjithë ditën, e patëm një interpelancë, u morëm vesh ta hartojmë një tekst të përbashkët, edhe ta votojmë.

Nuk po më duket bash përgjegjësi e këtij Kuvendi dhe, e të gjithë deputetëve që janë e s'janë sot, që të punojë gjithë ditën dhe të bëhet çështje në momentin e votimit.

Unë mendoj se puna themelore, nën një, e këtij Kuvendi është ligjberja. Dhe, meqë i kemi 3 ligje, plus 1 rekomandim, për të cilin kanë shkuar të gjitha grupet, ju lutem, presim, t'i thirrni 61 deputetë dhe le të vendosin edhe për këtë, edhe për pikën e fundit.

Unë nuk di a janë 61, por le të thirren. S'ka arsye që të mos e kryejmë punën me votime kur i kemi ligjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Rexhep, a deshe të marrësh fjalën? Fjalën e ka zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Po mundohem të kontribuoj edhe unë lidhur me këtë. Unë pajtohem me profesor Hamitin që, në fakt, kur nuk ka kuorum për të vendosur, atëherë edhe nuk do të duhej të kërkohej një gjë e tillë, por mendoj se është në kompetencë të kryesuesit të Kuvendit praktika që punimet e seancës të vazhdojnë nesër, sepse ne nuk po kërkojmë as seancë të re, nuk po kërkojmë as të ndërpritet seanca, në kuptimin që duhet ndërprerë, e as ndryshim të rendit të ditës.

Ne po kërkojmë që punimet e seancës të vazhdojnë nesër, për shkak se edhe është kohë relativisht e pasdites, e mbrëmjes dhe, po ashtu nuk po duket se ka prani të mjaftueshme për ta bërë këtë debat si duhet.

Pra, mendoj se është në fushëveprimin dhe kompetencën tuaj si kryesues i seancës që thjesht të deklarohet se seanca vazhdon punime nesër. Sikurse ne të kishim aq pika, nuk do të vazhdonim deri nesër në orën 8:00 të rrinim bashkë.

Prandaj, unë mendoj se kjo nuk përjashton mundësinë tuaj që seanca të vazhdojë punimet nesër.

KRYESUESI: Atëherë, meqë kemi kuorum, po vazhdojmë dhe po i votojmë ligjet që i kemi miratuar në lexim të parë.

Pra, po vazhdojmë me votim dhe të deklarohemi lidhur me: Shqyrtimin e parë të Projektligjit për automjetet.

Lus deputetë dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tani!

(Ndërrhyrje)

Atëherë, edhe një herë po e përsëris. Kemi debatuar dhe shterur debatin lidhur me pikën 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për automjetet.

Lidhur me këtë ka mbetur vetëm të votojmë, prandaj lus regjinë e deputetët të përgatiten votim. Votojmë tash!

Ju lutem, sa vetë janë pa kartelë? 2.

Albulena, a jeni për?

Atëherë kanë votuar 59 veta me kartelë, 2 pa kartelë - për, dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për automjetet.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime.

Është shterur edhe pika 6 e rendit të ditës: Shqyrtim i parë i Projektligjit për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Ka ngelur vetëm votimi, prandaj kërkoj nga deputetë që të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Edhe për ligjin tjetër, ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime.

Tash në sallë kemi 65 deputetë. E vë në votim edhe një herë Shqyrtimin e parë të Projektligjit për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive. Votojmë tash.

58 janë me kartelë, 3 pa kartelë. 61 veta kanë votuar.

Konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

Kemi 36 amendamente, a doni t’i votoni të gjitha përnjëherë, sepse nuk është asnjë amendament i kontestuar nga askush.

Mirë, atëherë fjalën e ka kërkuar Agim Aliu që në emër të Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

AGIM ALIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes para jush raportin me amendamente për Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Me këtë ligj përcaktohet themelimi, organizimi, funksionet dhe statusi i Akademisë së Drejtësisë, përkatësisht transformimi i Institutit Gjyqësor të Kosovës në Akademi të Drejtësisë. Projektligji për Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës i referohet krijimit të infrastrukturës së përgjithshme për një funksionim të sistemit të drejtësisë, veçmas çështjes së edukimit ligjor. Komisioni për Legjislacion më datën 31 maj 2016 ka formuar grupin punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Si grup kemi punuar kohë të gjatë me të gjithë aktorët që kanë shprehur interes për ta përcjellë punën, veçmas me zbatuesit e këtij ligji. Grupi punues ka mbajtur disa takime, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Integritimit Evropian, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, OSBE-ja dhe Grupi për studime juridike dhe politike.

Bashkarish kemi harmonizuar qëndrimet dhe komisionet më 7. 11. 2016 i kemi propozuar gjithsej 39 amendamente dhe i kemi proceduar në komisionet kryesore për shqyrtim sipas kompetencës. Si komision kemi pranuar vërejtje nga Komisioni për Integritim për heqjen e dy amendamenteve, është fjala për amendamentet 12 dhe 22, për të cilat Komisioni për Legjislacion ka debatuar në mbledhjen e mbajtur më 16. 12. 2016. Si komision patëm shqetësimet tona për faktin se Komisioni për Integritim me vërejtjet e adresuara kishte dalë jashtë fushëveprimit të tij, megjithatë me qëllim të shmangies së keqkuptimeve në opinion, por edhe në Kuvend, komisioni në këtë takim vendosi të heqë amendamentet 12 dhe 22.

Po ashtu, Komisioni për Legjislacion, për shkak të rëndësisë që ka ky ligj dhe transformimit që parasheh nga Instituti Gjyqësor në Akademi të Drejtësisë, rishqyrtoi edhe njëherë raportin final në komision më 28. 12. 2016 dhe vendosi të heqë edhe amendamentin 37, për shkak se ky amendament ka humbur logjikën për shkak të kohës së gjatë që kemi kaluar gjatë procesit të

amendamentimit dhe mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës natyrshëm do të përfundojë këtë vit.

Prandaj, me konsensus të plotë sot Kuvendit i kemi paraqitur në miratim 36 amendamente, për të cilat kemi vlerësuar se plotësojnë përmbajtjen e ligjit në realizimin e objektivave dhe qëllimeve që do t'i ketë në të ardhmen Akademia e Drejtësisë. Andaj, kërkoj nga ju, të nderuar deputetë të Kuvendit, që t'i votoni amendamentet e propozuara dhe vlerësoj që nuk është e nevojshme t'i arsyetoj një nga një sepse tashmë i keni para vetes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka kërkuar fjalën, sa i përket çështjes së amendamenteve.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm po dua ta theksoj një problem, duke lexuar raportin përfundimtar të Komisionit për Legjislacion hasa në shumë vërejtje gjuhësore, sidomos te neni 12, paragrafi 5, 16 paragrafi 1.5 dhe neni 23, paragrafi 2.

Kësisoj mendoj që Kuvendi duke e ditur që nëse votohet ky projektligj nuk kemi të drejtë ta prekim tutje, mendoj që duhet ta autorizojmë lekturën e Kuvendit që t'i përmirësojë këto gabime gjuhësore, sepse dalim goxha joseriozë nëse i lëmë si të tilla.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne kemi diskutuar shumë herë sa i përket kësaj dhe unë mendoj që Administrata nuk ka të drejtë pasi ta miratojmë ligjin të ndërhyjë, por s'e di. Shpresoj që do të kalojë pa gabime gjuhësore.

Atëherë, a jeni për t'i votuar të gjitha në bllok, apo një nga një?

Kemi në sallë 64 deputetë. I hedh në votim 36 amendamentet e propozuara dhe të miratuara nga Komisioni Funkcional për t'u votuar.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohen.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani!

Kanë votuar 64 veta. Janë 52 vota për.

12 abstenime.

Asnjë kundër.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Tani e kemi projektrezolutën. Atëherë, e ftoj zotin Kurteshi që ta lexojë tekstin e harmonizuar lidhur me projektrezolutën.

ISMAJL KURTESHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në takimin konsultativ që e kanë pasur përfaqësuesit e grupeve parlamentare “Vetëvendosje”, PDK, LDK, Aleanca, “Nisma” dhe nga “6+” ka qenë zoti Kujtim Paqaku, ne jemi pajtuar që ta procedojmë këtë rezolutë me 12 pika, të cilën përfaqësuesit e grupeve parlamentare janë pajtuar dhe bashkarish kemi kontribuar që të bëhet, domethënë të plotësohet rezoluta e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Unë po i lexoj pikat me radhë dhe pastaj ju takon juve të deklaroheni.

R E Z O L U T Ë

1. Arsimit të shpallet interes nacional, ndërsa në funksion të kësaj të rritet buxheti për këtë sektor.
2. Të rritet llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i performancës së të gjithë mësimdhënësve në nivel vendi dhe të bëhet kategorizimi i tyre sipas rezultateve të vlerësimit dhe sidomos sipas rezultateve të testimit të jashtëm të nxënësve të tyre.
3. Qeveria e Kosovës ta krijojë një fond të veçantë për ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve dhe një fond tjetër për arsimin parashkollor, me qëllim të sigurimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme.
4. Të bëhet rishikimi i Kurrikulës, i planprogrameve dhe teksteve shkollore në përputhje me kushtet dhe rrethanat në Kosovë.
5. Të ndalohet përdorimi i teksteve shkollore me përmbajtje antikushtetuese.
6. MASHT-i ta iniciojë themelimin e një forumi gjithëpërfshirës nga deputetët, nga ekspertët e fushës së arsimit dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për analizën e situatës në arsim dhe të propozojë rekomandime.
7. Të rikonceptohen tekstet shkollore dhe të bëhet unifikimi i lëndëve shkencore.
8. MASHT-i të krijojë kushte të volitshme për organizimin e mësimit fakultativ.

9. Të zbatohet në plotëni Kontrata Kolektive.

10. Të rishikohet dhe të amendamentohet infrastrukture ligjore në fushën e arsimit.

11. Në rast të mospërbushjes së kritereve për licencim, institucionet shkollore jashtë sistemit publik të mbyllen.

12. Ministri i Arsimit të raportojë para Kuvendit të Kosovës në çdo tre muaj për gjendjen në arsim.

Këto janë pikat e rezolutës të kësaj interpelance të iniciuar nga “Vetëvendosja” dhe të harmonizuara nga të gjitha grupet parlamentare. Thashë nga “6+” ka qenë Kujtim Paqaku, kurse po e shoh reagimin e deputetes, e cila nuk po pajtohet me këtë, por ajo nuk ka marrë pjesë në konsultim. Unë ju lus të gjithëve që ta votoni këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë të hap diskutim për këtë çështje, a? Jo, s’kemi diskutim më! Rezoluta është, kush do e voton, kush s’do, s’e voton...

Atëherë, 64 deputetë janë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe njëherë, e nxjerr në votim. E kemi kryer debatin! Në sallë janë 64 deputetë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Pa kartelë kush është? Një.

Atëherë, kanë votuar 58 vetë me kartelë, një pa kartelë. Nuk keni votuar të gjithë, s’mund ta kalojë. Edhe unë nuk po e kuptoj, kur harmonizohet diçka mes të gjitha palëve, pse të mos votohet!

Edhe njëherë e hedh në votim. Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Nuk po votohet. E votojmë radhën tjetër.

Kalojmë në pikën e tetë:

8. Debat parlamentare sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga nëntë deputetë të tjerë, lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Atëherë, siç thamë, por e hedh në votim edhe këtë sipas kërkesës së zotit Glauk Konjufca në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar si mocion për të cilin diskutuan edhe kryetarët e grupeve të tjera parlamentare që debati i paraparë për sot të shtyhet për nesër.

E hedh në votim, votojmë tash!

Kush është për? Sikur të ishte me vota kush më shumë, kush më pak, do të kalonte, por sidoqoftë ky është rezultati.

Edhe njëherë e hedh në votim propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për ta shtyrë debatin për nesër në orën 10:00. Lus regjinë dhe deputetët përgatituni për votim. Votojmë tash!

Jo, jo unë e kam shtyrë, po tash problemi është që s’po pajtohen, se sikur të ishin pajtuar këta, unë s’e kam problem. Realisht s’i kemi të rregulluara mirë, se në qoftë se ministri ka të drejtë ta tërheqë ligjin kur të dojë, edhe parashtruesi i mocionit ose i kërkesës mundet ose do të duhej ta ketë mundësinë, por ne s’e kemi të rregulluar kështu me rregullore dhe s’ke çka. Ne vazhdojmë debatin tani, në qoftë se s’mund të diskutojmë të gjithë, e vazhdojmë nesër.

Atëherë, e vazhdojmë debatin. Domethënë, po e përsëris: kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, i mbështetur dhe nga nëntë deputetë të tjerë ka propozuar debat parlamentar lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe ka propozuar një Propozim-rezolutë, e cila u është shpërndarë deputetëve.

E ftoj zotin Glauk Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar, që në emër të propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ky është një diskutim i munguar në Parlamentin e Kosovës, mirëpo atë e ka vonuar edhe vullneti i Qeverisë, pra ka pasur një përcaktim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta shtyrë këtë diskutim, për arsye se, me sa po e shoh, edhe në kërkesën, mocionin përmbajtjesor që është dorëzuar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë kaluar dy muaj e gjysmë, prej momentit kur kjo është dorëzuar, është shumë që të vonohet një diskutim parlamentar për dy muaj e gjysmë.

Pra, vërehet këtu që Qeveria ka qenë në siklet dhe ka pasur një përcaktim me shumë përpjekje për ta sabotuar mbajtjen e këtij diskutimi aq të rëndësishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Tema për të cilën po flasim ka, le të themi, përmbajtje të vërtetë politike, meqenëse po

flitet për një projekt të pushtetit. Unë mendoj që ekziston në Republikën e Kosovës një projekt shumë i qartë i pushtetit, i Qeverisë së Kosovës, në raport me subjektin më të madh opozitar në këtë vend. Dhe, ky projekt i Qeverisë së Kosovës, ky projekt i pushtetit, është që Lëvizja “Vetëvendosje” të përjashtohet prej politikës.

E qysh bëhet kjo? Kjo bëhet nëpërmjet shpalljes të Lëvizjes “Vetëvendosje” si organizatë terroriste. Kjo ka qenë një përpjekje e vazhdueshme dhe e cila, edhe sot e kësaj dite po vazhdon, e pushtetit që Lëvizjen “Vetëvendosje” ta diskualifikojë nga politika nëpërmjet kategorizimit si organizatë terroriste. Kjo përpjekje e Qeverisë është kristalizuar më qartë, pra ka marrë formë konkrete më 28 nëntor të vitit 2015, kur dikush nga Qeveria, nuk e di bash saktë kush, duhet të dalë e të tregojë kush, ai që është përgjegjësi kryesor, ka marrë vendim që zyrat e subjektit më të madh opozitar në vend të thyhen nëpërmjet aktivizimit të njësitit antiterrorist, i përbërë prej 36 vetëve, i cili ka hyrë në Lëvizjen “Vetëvendosje” me një brutalitet dhe dhunë, e cila nuk është parë në Kosovë moti, duke shkaktuar lëndime, përplasje dhe rrahje të jashtëzakonshme, duke filluar prej aktivistëve, siç është, për shembull, Sami Kurteshi, i cili ka qenë edhe Avokat i Popullit, e deri te plot aktivistë, të cilëve u janë shkaktuar lëndime të mëdha.

Ky njësit antiterror përdoret vetëm në situata terroriste, që kategorizohen si situata terroriste. Pra, zyra e Lëvizjes “Vetëvendosje” është kategorizuar si një çerdhe e terrorizmit, të cilës duhet t’i qasemi me brutalitetin më të pashembullt të përdorimit të njësive “FIT” antiterroriste nga ana e Policisë së Kosovës. Ato njësite nuk përdoren gjithkund, ato njësite përdoren vetëm në raste të veçanta. A e keni dëgjuar njësitin “FIT” deri para se të hynte në Lëvizjen “Vetëvendosje”? Nuk besoj që e keni dëgjuar që është përdorur përpara. E keni dëgjuar më së shumti, unë për shumicën po flas, kur ka hyrë në Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Pra, pse ndodhi kjo me Lëvizjen “Vetëvendosje” në përgjithësi? Sepse, unë mendoj që rezistenca jonë kundër demarkacionit edhe kundër krijimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, që është projekt i Beogradit dhe bashkimi i opozitës që çonte drejt protestave gjithnjë e më masive, edhe siç ishte ajo e 28 nëntorit, e bindëm pushtetin që duhet të ndërmarrë masa të jashtëzakonshme dhe nëpërmjet një loje të ndytë, do të thosha, politike, që ta zhvendosë Lëvizjen “Vetëvendosje” përtej rrafshit politik, që ta diskualifikojë, ta përjashtojë prej politikës dhe unë konsideroj që gjithçka që na ka ndodhur prej vitit 2015, unë e shpjegoj brenda këtij konteksti dhe kësaj përpjekje të Qeverisë.

Pra, prej atëherë me dhjetëra arrestime ka pasur dhe burgosje të shumë aktivistëve të “Vetëvendosjes”, edhe deputetëve, qe besa. Ne kemi mbajtur, nëse mblidhet krejt muajt sa kemi qenë nëpër burgje, janë bërë me siguri më shumë se 5 apo 6 vjet që kemi mbajtur burgim, edhe në përgjithësi edhe deputetët e tjerë nga opozita, apo arreste shtëpiake kur ne jemi bllokuar nëpër shtëpitë tona dhe na është ndaluar zhvillimi i aktivitetit politik.

Dhe, kështu tash kronologjikisht vijmë tek 4 gushti, një sulm i papranueshëm që i ka ndodhur Kuvendit të Republikës së Kosovës, një sulm me predhë i drejtuar kundër Republikës së Kosovës, kundër institucioneve të shtetit tonë dhe të cilin krejt bashkërisht e kemi konsideruar të papranueshëm dhe e kemi dënuar. Mirëpo, pushteti te ky sulm e ka parë një rast të jashtëzakonshëm, një rast të përkryer që t'ia mveshë Lëvizjes “Vetëvendosje”, dhe më 30 gusht, menjëherë pas tri javësh ka ndodhur... ia ka nisur kjo fushatë e pushtetit, që t'ia mëveshti Lëvizjes “Vetëvendosje” këtë sulm dhe Policia e Kosovës i ka arrestuar gjashtë aktivistë, që janë: Astrit Dehari tashmë i ndjerë, i cili e gjeti vdekjen në Burgun e Prizrenit; Frashër Krasniqi; Adea Batusha; Egzon Haliti; Atdhe Arifi, si dhe Petrit Ademi.

Që prej atij momenti Prokuroria, e cila merret me rastin e tyre, tash do të shpjegoj dhe do ta dekonstruktoj rastin pikë për pikë, ka dështuar në aktakuzën e saj dhe ka dështuar që të argumentojë se këta vërtet janë njerëzit të cilët qëndrojnë prapa sulmit të Kuvendit të Kosovës më 4 gusht të vitit të kaluar.

Po ia nis prej rezultatit të fundit, Forenzika. Forenzika tregon që nuk ka asnjë lidhje në mes këtyre deputetëve të akuzuar dhe të gjitha gjetjeve të çdo gjëje që është konfiskuar, edhe nëpër shtëpitë e tyre, edhe në vendin e ngjarjes, edhe çdo provë që është ofruar nuk ka lidhje... edhe ADN-ja, edhe duke filluar prej flokëve që janë gjetur në vendin e ngjarjes, apo në çdo provë të sekuestruar, e deri te provat tjera nuk është gjetur asnjë përputhshmëri nga Forenzika në mes aktivistëve dhe pretendimit se këto prova i kanë bërë këta emra, të cilët unë i lexova. Pra, ky është dështimi i parë.

Dështimi i dytë, me kërkesë të Prokurorisë janë marrë vendndodhjet e gjashtë aktivistëve nga Postë-Telekomi i Kosovës. Postë-Telekomi i Kosovës nëpërmjet antenave të tyre, nëse Prokuroria, nëse Policia hetuese i kërkon i ka marrë ato, në ditën e sulmit, në minutën e saktë të sulmit, flitet diku për ora 11:00 ndoshta të natës, diku pas orës njëmbëdhjetë, në atë moment ku kanë qenë këta gjashtë aktivistë, të cilët pretendohet dhe të cilëve u mvishet sulmi për terrorizëm. Asnjëri prej tyre, të identifikuar me antena të PTK-së, nuk ka qenë në vendin e ngjarjes për të cilin pretendon Prokuroria dhe në të cilin është kryer sulmi kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lokacionet e aktivistëve tanë, ku kanë qenë këta gjashtë njerëz, në të vërtetë përpurthen plotësisht me lokacionet të cilat ne i kemi prezantuar, sipas dëshmimeve të vetë të të akuzuarve, të cilët kanë treguar se ku kanë qenë saktësisht atë natë në orën 11:00, në momentin kur ka ndodhur sulmi kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dështimi i dytë i madh i Prokurorisë.

Dështimi i tretë, Prokuroria pretendon se një e-mail i cili është dërguar dhe i cili e ka marrë përgjegjësinë për këtë sulm qenka dërguar diku përreth shtëpisë apo në lagjen, ku banon Frashër Krasniqi. Pas shqyrtimit të pronësisë së IP-adresave kanë ardhur në përfundim, që asnjëri prej

gjashtë aktivistëve nuk është pronar i këtyre IP-adresave, që Prokuroria ua ka mveshur se kanë të bëjnë me aktivistët e akuzuar dhe prej të cilëve është dërguar e-mail-i që e merr përsipër sulmin që ka ndodhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pra, qëllimi i aktakuzës që është ngritur më 29 dhjetor të vitit që sapo e lamë pas nuk ka qenë gjetja e fajtorit, faktikisht identifikimi konkret i sulmuesit, cili ka qenë sulmuesi prej këtyre gjashtë aktivistëve apo sa prej tyre kanë qenë sulmuesi i drejtpërdrejtë apo sido që ta mendojë Prokuroria, bile prokurori po na tregon që as nuk e ka për qëllim ta gjejë fajtorin edhe sulmuesin konkret. Po del, se aktakuza është për t'ia mveshur dhe për t'i mbetur një etiketë "Vetëvendosjes" si subjekt terrorist. Ky është qëllimi final i kësaj drejtësie të manipuluar.

Shtrohet pyetja pastaj, këtu kanë ndodhur edhe disa sulme të tjera pastaj, pas 4 gushtit, diku më 23 gusht më duket apo atyre ditëve përreth, 3-4 javë pas apo një muaj eventualisht, pas pati ndodhur edhe sulmi në RTK dhe në shtëpinë e drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës. Policia dhe Prokuroria nuk është nisur, nëse do të duhej t'i trajtonim rastet e njëjta, pse nuk e ka arrestuar askënd Policia, apo pse nuk e ka gjetur hetuesia kurrkënd për këto dy raste, kur ka qenë shumë më kollaj të binte në gjurmë të tyre, duke qenë se një sulm paska ndodhur më herët, dy javë apo tri më herët, që është Kuvendi i Kosovës dhe këto sulmet tjera pastaj që kanë ndodhur, policia ka qenë shumë më vigjilente me siguri, ka pasur mobilizim të kapaciteteve shtesë, që nëse ndodhë ndonjë rast, ndonjë sulm tjetër, të mund t'i zënë kryerësit, kriminelët, në këtë rast.

Tjetra, këtu në Kosovë kemi një problem shumë të madh, kësaj që po i themi ne shteti i kapur, kjo përmbysë relacionin në mes Qeverisë, drejtësisë dhe Policisë. Faktikisht, në shtetet perëndimore, në shtetet demokratike, aty ku sundon ligji dhe ka kushtetutshmëri, drejtësia është e para, drejtësia vendos çka është aktakuza, kujt duhet t'i ngritët aktakuzë pas provave të ofruara. Qeveria është jashtë lojës, kurse Policia është shërbëtore e Drejtësisë. Te ne ka ndodhur një përmbysje e tmerrshme do të thosha dhe kjo shpjegon esencën e kapjes së shtetit. A di si shkon te ne? Qeveria bën projekt, Policia, sidomos komponenti hetues, ku shteti i kapur aty funksionon më së miri, në policinë, në komponentin hetues të policisë, ata të fabrikojnë prova si të duan edhe shkojnë e terrorizojnë ë prokurorin, e terrorizojnë prokurorinë, drejtësinë e terrorizojnë. Edhe prokurori detyrohet të zbatojë urdhra politik edhe të marrë në konsideratë një pako provash të paqëndrueshme dhe ngre aktakuzë për terrorizëm. Kështu ka shkuar në rastin e "Vetëvendosjes".

Ne kemi edhe fakte nga burime të brendshme në drejtësi, që kështu ndodhë shpesh. A e dini ju, që policia hetuese i hyn në zyrë prokurorit? Policia hetuese i hyn në zyrë edhe i thotë: ti duhet me e shty përpara këtë rast, ose e shantazhojnë. Ka edhe kërcënime. Kështu ka qenë me këtë Abdurahim Islamin. Me këtë prokurorin, që i shkreti ka qenë në pushim atje dhe kur kanë ardhur, atëherë veç e kanë futur shpejt e shpejt në sistem për ta marrë këtë lëndë, për të cilën ai as nuk e ka pasur idenë, as nuk e ka ditur qartë se për çka është puna. Duhet me marrë duhet me e krye këtë punë. Kështu funksionon raporti në mes Policisë Hetuese, të cilët pretendojnë që kanë prova

edhe prokurori. Edhe tash çka ndodhë? Prokurori zihet në pozitë të keqe edhe diskreditohet. Nuk e ka asnjë provë. Shikojeni, ju lus ta shikoni, ka qenë në Televizionin 21, deklarata e Abdurrahim Islamit e dhënë para një muaji e gjysmë. Deklarata e tij në Televizionin 21 është kështu, do ta shfaqim ne në ditët në vijim, ai thotë, po e citoj: “Varet prej konstatimeve të Forenzikës a do t’u ngremë 6 aktivistëve të “Vetëvendosjes” aktakuzë apo jo.” Ai u ka ngritur aktakuzë gjashtë aktivistëve të “Vetëvendosjes” për terrorizëm para se të dalë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën, në emër të grupit parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Tashmë nuk është hera e parë, që në këtë Kuvend bëjmë debate për çështje të cilat në fakt, janë apriori të institucioneve të drejtësisë. Kemi pasur edhe disa raste tjera, për të cilat ne e kemi pasur njëfarë konsensusi politik për t’i bërë ato debate, për shkak se kemi pasur të bëjmë në njëfarë mënyre me njëfarë sulmi në vlerat tona kombëtare me pjesëtarët e UÇK-së, kemi pasur edhe rastin me zotin Haradinaj, kur padrejtësisht kemi pasur ndalimin e tij dhe raste të tjera.

Tash, në anën legale ne s’mund t’i ikim, është kërkesë e deputetëve dhe ne jemi në situatën e tillë, kur ne duhet të bëjmë këto debate, ose të marrim pjesë.

Glauk, derisa ju i dhatë disa nga të dhënat tuaja këtu, është krejt i njëanshëm ky debat nëse ne nuk i kemi të dhënat e tilla të ngjashme të Policisë së Kosovës, atyre që kanë pasur dhe e kanë këtë rast, ose të institucioneve të drejtësisë. Në një rast të tillë ne kemi pasur rast t’i dëgjojmë në medie, unë mendoj as unë s’jam marrë personalisht, as deputetët, nuk mendoj se ne duhet të merremi me to, përderisa institucionet e drejtësisë ta japin fjalën e tyre përfundimtare.

Ajo që dëshiroj pak më shkurt, tash të mos hyjmë në krejt këto, nëse kemi qëndrimin që duhet t’ua lëmë organeve të drejtësisë dhe të kërkojmë nga ato që paanshëm t’i trajtojnë këto raste, sidomos arrestimet e aktivistëve politikë, unë mendoj dhe ju ftoj që të mos paragjykoni. Edhe në këtë dokument, të cilin ju e keni bërë publik dhe në bazë të të cilit ne po e bëjmë debatin. Ajo që është fjali kryesore thuhet, përmenden përndjekje, akuza, arrestime politike, e tjera... Ne të gjithë që jemi këtu kemi një të kaluar të hidhur nga regjimet e kaluara, ku disa prej këtu edhe kanë vuajtje prej vitesh burgjesh nga vendime politike të një regjimi totalitar dhe nuk mendoj, se ne me vetëdije do t’i shërbenim, ose do ta provonim në njëfarë mënyre veprime të tilla të arrestimeve politike e të tjera. Nuk mendoj se duhet të paragjykoni. Duhet të punojmë të gjithë për institucione sa më të mira të drejtësisë dhe t’ua lëmë fjalën atyre.

Po, edhe në përshkrimin që e keni bërë të krejt rastit, të situatës, që është një përshkrim pak i njëanshëm. Në njëfarë mënyre paragjykoni edhe lidhjen e atyre që janë burgosur me sulmet në Kuvend e me, me vetë mënyra që janë ranguar, janë radhitë me një varg veprimesh politike të “Vetëvendosjes”, që unë nuk mendoj se duhet të paragjykoni. Duhet t’i lëmë njerëzit të mendojnë lirshëm, që në fakt të shpresojnë dhe të presin vendimet e institucioneve të drejtësisë. Po, pse të mos mendoj unë që veprimet e tilla të turpshme të sulmeve mbi institucionin e Kuvendit të Kosovës, kanë mundur të jenë të orkestruara nga dikush që është jashtë nesh, me qëllime krejt tjera, për ta destabilizuar skenën politike. Po, këto janë veç qëndrime, ose mendime, ose opinione që mund t’i shfaqim.

Institucionet e drejtësisë, që janë marrë dhe po merren me rastin, duhet ta japin fjalën e fundit, po edhe pas përfundimit unë nuk do dëshiroja që askush nga ne, që këtu të kishim ndonjë lidhje politike me ju, ose ndonjë parti tjetër.

Edhe pas kësaj, më shumë se kaq, mund t’i sqarojmë vetëm relacionet politike, ose... nëse ka pasur ose mund të kishte ndonjë urdhër politik për veprime të tilla. Por, këto duhet t’i lëmë që institucionet e drejtësisë ta japin fjalën dhe më pastaj mund të debatojmë për të gjitha këto.

Është për të ardhur keq, që kemi pasur një rast të tillë të sulmeve mbi institucionet tona dhe po ashtu për të ardhur keq, që kemi raste të arrestimeve të veprimtarëve, të aktivistëve politikë. Por, është për të ardhur keq që kemi pasur, po ashtu një vit seanca këtu në këtë Parlament me dhunë. Ju nuk i keni përmendur dhe është... kemi pasur edhe raste tragjike pastaj, të vdekjes së aktivistit në burg, por kemi pasur sulme mbi ministra, kemi pasur... ka edhe akuza, ose trajtime në gjyq për veprime që janë bërë këtu në Kuvend.

Me sa di unë, ka edhe gjyqe që po bëhen, nëse s’gaboju për çështje të tilla. Është për të ardhur keq, se çfarë mesazhi i kemi dhënë dhe çfarë pamje kemi krijuar, pavarësisht çështjeve për të cilat janë bërë ato veprime. Përfundimisht, mendoj që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, mendoj se duhet bashkërisht këtu të bëjmë thirrje unike, që institucionet e drejtësisë ta kryejnë punën e vet të pavarur, që institucionet e drejtësisë të bëjnë të gjitha veprimet e mundshme që këto raste të sqarohen sa më shpejt.

Ne duhet ta dimë sa më shpejt, se kush ishin aktorët e sulmit të turpshëm mbi Kuvendin e Kosovës, por po ashtu nëse dikush ka të dhëna që veprimet e organeve të drejtësisë janë të motivuara, ose të dirigjuara nga politika, po ashtu duhet të jepni këto fakte dhe duhet t’i bëni këto fakte publike.

Edhe një herë, në emër të Grupit Parlamentar ftoj të gjithë deputetët, që tu japin mbështetje institucioneve të drejtësisë, në mënyrë që ato në mënyrë të pavarur të japin gjykimet e tyre dhe

për të gjitha veprimet e jashtëligjshme, që kanë ndodhur në vendin tonë dhe për rastin konkret. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetare!

Unë që në fillim po e them se ne si grup parlamentar konsiderojmë dhe vlerësojmë, që edhe ky debat është në vazhden, fatkeqësisht, një vazhdim i ndërhyrjes në punën e organeve të pavarura, në këtë rast Policisë, Prokurorisë dhe të drejtësisë, gjegjësisht gjyqësisë, sepse nëse vazhdohet me këtë logjikë që rastet, posaçërisht që janë nën hetim, t'i diskutojmë çdoherë pa pritur vendimet e organeve kompetente, sikur pushon nevoja që të kemi institucione të pavarura, institucione të drejtësisë... dhe këtë punë ta bëjmë në Kuvendi, ta bëjmë në partitë politike, secili nga këndi dhe nga momenti për çfarë edhe i ftojme këto debate.

Edhe unë mendoj që paraqitja e mocionit është një e drejtë, por edhe paraqitja edhe teksti që e kemi lexuar është tejet i njëanshëm, është ana e një medaljeje, por nuk është ana tjetër, që duhet me e thënë. Viti 2015 ku edhe thirren, konkretisht prej shtatorit të këtij viti deri në marsin e vitit 2016, ka qenë periudhë e rëndë për të gjithë në këtu në Kuvend, për Kosovën, për qytetarët jashtë Kuvendit, sepse deputetët e Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe qytetarët në forma të ndryshme e veçmas edhe Policia, kanë qenë të rrezikuar nga veprimet që kanë ndodhur. Krejt kjo falë një sjelljeje të paparë asnjëherë më parë në Kuvendin e Kosovës, dhunës fishkëllimave, pse jo kacafytjeve dhe gazit lotsjellës, të gjitha këto në emër të së drejtës së atyre që vepronin, “të veprimit politik” siç thuhet, në mbrojtje të kauzave që i thonin dhe i mbronin. Sikur kjo nuk mjaftoi dhe sigurisht, të gjithë jemi dëshmitarë, në një mënyrë inspiruar nga sjelljet e tilla në Kuvend dhe me organizimin e partive opozitare një kohë bashkë e pastaj vetëm nga VV-ja u organizuan protesta, që është një e drejtë, e drejtë e garantuar, e drejtë ligjore, por deri këtu, sepse protestat pastaj ishin shumë të dhunshme. U sulmuan institucionet e vendit, Qeveria.

Nuk mund ta mohojmë faktin, se Qeveria e Kosovës është djegur, është djegur me koktej mollotovi nga militantët, nga protestuesit, u sulmua disa herë edhe Kuvendi. Kur e them Kuvendi, në asnjë rrethanë nuk nënkuptoj, as nuk paragjykoj fajësinë, sepse është rasti nën hetim, veçmas për rastin që kemi thënë disa herë, dhe për këtë duhet sa më shpejt të marrin vendimin edhe organet e drejtësisë dhe të sqarohet edhe kjo çështje.

Pastaj, disa herë u sulmua kryeministri i vendit, u sulmua në Kuvend në mënyrë, siç thuhet, “demokratike” sipas këtyre eskorta. U fut logjika totalisht e papranueshme, atë që kurrë në si shqiptarë nuk e kemi pasur, as nuk ka qenë traditë, të sulmohet shtëpia, të sulmohet familja, tu

shkohet njerëzve në shtëpi, të tentohet të protestohet para shtëpisë. Dhe, ju e dini që është sulmuar, po ashtu me koktej molotov, shtëpia e kryeministrit, janë filmimet, nuk po i them unë. U sulmuan zëvendësministra, ministra, u dogjën makina të zyrtarëve. Po ashtu, ju e dini që për mua është po ashtu e papranueshme, është shkuar për tjetër qëllim të protestohet para shtëpisë së kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Është e papranueshme tu shkohet njerëzve te shtëpia për të protestuar. Dhe, këtu duhet të jemi korrekt, të jemi të sinqertë, nëse na vjen keq dhe është e papranueshme me shkua në shtëpi, me i protestua kryetarit të Komunës për çështje tjetër, jo pse mos me shkua sepse pastaj kanë qenë reagimet, se si po më stresohen familja... stresohen të gjithë familjarët, kur sulmohet shtëpia e dikujt. Ju e keni rastin konkret, unë po e përmendi, me përjashtim të zotit Driton, që unë e kam parë një prononcim. Unë po e personalizoj, në oborr të shtëpisë, para banesës më është djegur edhe imja zyrtare që është, zyrtare, është sulm. Edhe mua sikur fëmijëve, meqenëse po reagon Albulena, që po e them përsëri është e papranueshme me i shkua në shtëpi kryetarit të komunës me protestua, sepse komuna ose institucioni është për të protestuar jo për ta dhunuar, sepse të njëjtat gjë, domethënë kur është reaguuar, edhe unë jam i pakënaqur, pse në mars bëhet një vit, s'është zbuluar kush e dogj? Unë kam të drejtë të dyshoj, kam të drejtë edhe të besoj, është e drejtë imja, se kush e ka bërë këtë, se nuk po ndodh, po nuk jam ai që e bëj gjykimin. Dhe, për këta kam heshtur dhe s'kam reaguuar kurrë më, edhe familja ime, sepse në 4 e gjysmë të mëngjesit nga banditë të caktuar është djegur makina. Dhe, ai është akt terrorist, kushdo që e ka bërë.

Pastaj, janë sulmuar edhe pronat private, që e dimë të gjithë, lokalet afariste, u demolua dhe u shkatërrua qyteti i Prishtinës, fatkeqësisht pjesëmarrës në protesta të tilla kanë qenë njerëz që duhet me, pjesëmarrës po them, nuk po them ata që kanë gjuajtur, ata që duhet me e ndërtua qytetin dhe jo me u solidarizua me shkatërrimin, që e kemi parë po ashtu, që të gjithë.

Të nderua kolegë deputetë,

Tërë atë që e kemi përjetuar me muaj, është vështirë ta përshkruajmë për kohë të shkurtë dhe, as nuk e kam qëllimin ta bëj këtë, por për hir të së vërtetës, i thash disa shkurt nga ato që kanë ndodhur, që i dinë edhe qytetarët.

Shembulli i sjelljes së tillë të opozitës, veçmas të deputetëve, ka qenë shembulli më i keq për qytetarët, për të rinjtë tanë. Dhe, unë mendoj se sikur këto veprime të tilla i dhanë një... jo mendoj, po jam i bindur që i dhanë një imazh shumë të keq shtetit të Kosovës. U dënuan, u kritikuan nga institucionet vendore, ndërkombëtare, brenda, jashtë vendit, miqtë tanë... po, kjo për disa as që ju ka bërë punë. Asnjëherë nuk e kemi kontestuar dhe, as sot nuk e kontestojmë të drejtën e protestave, të drejtën për të reaguuar, për të realizuar një të drejtë, por asnjëherë nuk e kemi pranuar dhe nuk e pranojmë dhunën, sulmet, djegiet.

Nuk mund të pranojmë që të sulmohet dhe të rrezikohet edhe jeta e policëve tanë, djemve dhe vajzave që 24 orë kujdesen dhe janë në shërbim të qytetarëve tanë. Nuk mund të kuptoj, se si në një parti politike mund të gjendet gjithë ai arsenal i maskave, i koktejeve të molotovit, i bombolave e mjeteve të tjera, që është realisht arsenal i rrezikshëm luftarak. Nuk mund ta kuptojmë!

Nëse për të tjerët është normale të ndodhë kjo, unë po ju siguroj se tek ne në LDK gjeni vetëm letra, gjeni kompjuterë dhe gjeni... po ky është ai mjerimi, sepse ju rrenën dhe të pavërtetën mendoni ta impononi gjithmonë, të tjerët s'keni durim t'i dëgjoni. Unë ju dëgjova, po sidoqoftë, le të mbetet në ndërgjegjen tuaj.

Asnjëherë, nuk e kam marrë rolin, as nuk e marrim, rolin e policit e të prokurorit dhe të gjykatësit, siç ju e merrni, jemi që të ketë efikasitet të organeve tona të drejtësisë, të prokurorisë, jemi që të punohet më shpejtë, të identifikohen kryerësit e veprave të tilla antiligjore, konform punës së tyre, argumenteve, të bëhen veprimet, të dënohen apo lëshohen të dyshuarit, por edhe kjo të mos bëhet nga presioni, të mos veprohet nën presion të kohës, për njëjërën apo tjetrën, të dënimit apo lirimit, po të bëhet mbi bazën e argumenteve dhe dëshmive nga organet kompetente.

Sigurisht, na vjen mirë që dy partitë opozitare, AAK dhe "Nisma" u shkëputën, u ndanë nga organizimet dhe të qenët pjesë e sjelljeve dhe veprimeve të tilla të dhunshme, e shkatërruese. Kjo tregon se ata u bindën që kjo nuk është mënyra për të mbrojtur interesat e vendit. E them këtë sepse AAK dhe "Nisma", edhe më vonë kanë organizuar protesta, të cilat kanë kaluar tërësisht në mënyrë paqësore.

Nuk mund ta pranojmë logjikën dhe tendencën e paraqitjes së viktimës të atyre që ishin pjesë apo ishin inspirues të tërë kësaj që e thashë më lart.

Ne jemi deputetë, e kemi votën dhe me votën tonë duhet të marrim vendime përkatëse, për apo kundër. Pra, ne jemi deputetë me votë të qytetarëve dhe ne kemi pasur e edhe e kemi bindjen tonë politike - institucionale që po punojmë në interes të vendit, në mbrojtjen e vendit, kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, sovranitetit dhe pavarësisë së vendit.

Dhe, së fundi, ne si Grup Parlamentar, i japim mbështetje punës së institucioneve tona të pavarura dhe, po e them po ashtu, ne si Grup Parlamentar pikat e propozuara të rezolutës nuk i votojmë e as s'i përkrahim, sepse konsiderojmë që janë ndërhyrje drejtpërdrejt në punën, përkatësisht pavarësinë e organeve tona shtetërore. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, znj. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar,
Kolegë deputetë,

Fillimisht më duhet të them se emërtimi i këtij debati është mjaft i ngushtë, sepse në Kosovë gjatë një periudhe kohore njëvjeçare kanë ndodhur përndjekje e arrestime të gjithsecilit që ka guxuar ta kundërshtojë këtë Qeveri.

Pra, ka ndodhur arrestimi i shumë qytetarëve, duke përfshirë edhe aktivistët e Lëvizjes dhe sidomos e kemi edhe një humbje të një djali të ri, një vdekje që vërtet çdonjëri nga ne duhet të ndiejë dhembjen, sepse ka ndodhur në shekullin XXI kur askush s'e ka pritur, e sidomos shteti i Kosovës.

Kanë ndodhur përndjekje edhe të deputetëve të këtij Kuvendi. Me një fjalë ka qenë një luftë e hapur duke e përdorur Policinë kundër qytetarëve të këtij vendi, të cilët të vetmen "fjalë" që e kanë bërë ka qenë kundërshtimi i marrëveshjeve të dëmshme që Qeveria ka tentuar t'i imponojë në këtë Kuvend dhe në kurriz të Kosovës.

Është e papranueshme që të përdoret Policia kundër kundërshtarëve politikë. Kosova e ka larguar nga këtu që moti regjimin, i cili na ka përndjekur e burgosur, dhe është tërësisht irelevante që edhe pas kaq vitesh pavarësie të kemi skena kur arrestohet opozita.

Jemi për atë që të respektohet ligji, por ai të jetë i barabartë, e jo për dikë nënë e dikë njerë.

Edhe sot kemi mjaft politikbërës e udhëheqës në institucione që kanë dosje për korrupsion e krim të organizuar, por me ta askush s'po merret, gjithë aparatit shtetëror po e përdorin kundër opozitës, e kjo është e papranueshme.

Nëse vazhdoni me tendenca që ta impononi të papranueshmen për Kosovën, ta dini se prapë do të jemi në situatë kur ju, në vend të mungesës së argumentit politik, do të duhej ta përdorni Policinë, e kjo situatë nuk na dërgon askund, prandaj njëherë e përgjithmonë ta lëmë anash Policinë dhe strukturat tjera të sigurisë kur kemi mosmarrëveshje politike këtu.

Kurseni djemtë e vajzat e Policisë dhe mos i nxirrni në përballje po me ata djem e vajza e baballarë të tyre që janë të këtij vendi, vetëm pse e kundërshtojnë një qeverisje në emër të një kauze.

Duke mos dashur ta zgjas më shumë, dëshiroj të them se nuk ndalemi pse ju na përndiqni, por ndalemi vetëm atëherë kur ju ndaleni nga këto dëme që po ia bëni Kosovës dhe në të njëjtën

kohë kërkoj që t'i lironi të gjithë ata njerëz që janë në arrest apo burg për shkak të veprimeve të tyre politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, në emër të “Nismës”, e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit zoti kryesues!

Është një temë bukur shqetësuese dhe preokupuese që nuk ndodh veç kohëve të fundit.

Edhe pse është thirrur nga VV, unë konsideroj se ka përmasa edhe më të gjëra dhe që e tejkalon vetëm një subjekt politik dhe për këtë unë do t'i them dy-tri fjalë, por para se t'i them, dua t'i them zotit Beqiri se nuk është ashtu sikur që thotë për “Nismën”, e besoj edhe për Aleancën.

Të gjitha veprimet i kemi bërë me vetëdije, prandaj atëherë kur kemi punuar bashkë kemi punuar bashkë dhe nuk pa kurrfarë dallimi.

Se në emër të drejtësisë është bërë padrejtësi, kjo më nuk do koment, dhe nuk janë vetëm rastet që i apostrofoi Glauku, por ka dhjetëra e qindra raste të anëtarëve të subjekteve politike, por edhe të qytetarëve pa parti.

Se ka montime e inskenime të proceseve ndaj njerëzve të caktuar me ndikim, kjo nuk do koment dhe për këtë çështje shpesh organet e drejtësisë dhe të sigurisë janë përdorur nga parapolitika e partive në pushtet për t'i eliminuar njerëzit.

Raste të tilla kemi edhe në “Nisma”, edhe në subjekte tjera, por edhe në AAK, dhe nuk dua shumë e t'i përmend me emra, sepse opinioni i di.

Megjithatë, unë këtë debat të kërkuar për këtë çështje mendoj ta shfrytëzoj në formën e apelit që organet e drejtësisë dhe të sigurisë së vendit përfundimisht të shkapen nga parapolitika dhe mos të punojnë për llogari të grupe të caktuara, që përfundimisht ato grupe e tejkalojnë edhe organizimin normal të partive dhe janë organizata kriminale për të cilat besoj se koha do të dëshmojë.

Se kapja e organeve të drejtësisë dhe të sigurisë është evidente, këtë e ka dëshmuar edhe një aferë publike tashmë e njohur e përgjimeve ku personazhe të caktuara, me emër e mbiemër, lakojnë edhe emra të njerëzve të caktuar që në këta mekanizma duhet të jenë të pavarur dhe këto përgjime natyrisht se na bëjnë më të fuqishëm në qëndrimet dhe mendimet tona se sektori i drejtësisë dhe sigurisë së vendit po përdoret për llogari të individëve e grupeve parapolitike, siç edhe e thashë.

Unë mendoj që Kosova i ka kaluar fazat kur njeriu politikisht është dashur të mendojë si pushteti. Është bërë një përpjekje e të gjithë qytetarëve që ta kemi një demokraci dhe në demokraci ndërhyrja në subjekte politike, siç ka ndodhur ajo me 28 nëntor 2015 në selinë e “Vetëvendosjes” ka qenë më shumë se skandaloze.

E kam thënë edhe atëherë, qëndroj edhe tash, se një ndërhyrje e tillë na ka rikthyer në kohët e vështira të sistemeve moniste dhe regjimeve totalitare që i kemi përjetuar në Kosovë.

Sido që të jetë, mungesa e kryeministrit dhe e ministres së Drejtësisë në kohën kur po zhvillohet një debat që lidhet shumë ngushtë me pozicionet politike dhe përgjegjësitë e tyre, e bën edhe këtë debat jo shumë të rëndësishëm, edhe pse Lëvizja “Vetëvendosje” i ka në fund edhe disa pika si propozim, mendoj se edhe kjo rezolutë dhe sugjerimet e tyre do të jenë si të gjitha më herët, sepse ne aktualisht kemi një Qeveri të papërgjegjshme, e cila për të mbijetuar në politikë dhe për të mbijetuar në pozicionet që i kanë marrë në emër të diçkaje tjetër, janë në gjendje të bëjnë gjithçka, të inskenojnë edhe procese gjyqësore.

Unë si qytetar, por edhe si deputet, i di disa raste, kur njerëzit janë atakuar drejtpërdrejt, që nuk ka të bëjë me Lëvizjen “Vetëvendosje” me këtë rast. Pra, drejtpërdrejt, do të thotë për shkak të qëndrimit dhe mendimit të tij politik janë shantazhuar, janë inskenuar raste dhe dënua besa vetëm e vetëm që ta heqin konkurrencën politike në lokalitete të caktuara.

Përfundimisht, duke përfunduar këtë qëndrim timin publik, mendoj se është momenti i fundit të thirrëmi në ndërgjegjen tonë dhe për t’i ndarë pozicionet politike nga pozicionet tjera ekzekutive, siç janë në këtë rast organet e sigurisë dhe drejtësia e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zoti Hyseni.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar, kryesues i kësaj seance!

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Është ky institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës që ka vendosur rregullat dhe e ka përcaktuar kornizën ligjore të funksionimit dhe sjelljes së institucioneve për rend dhe ligj.

Dhe, në të njëjtën, edhe pse është ky institucion që i ka dhënë ingerencat me ligje të aprovuara secilit institucion për rend e ligj, është e drejtë e këtij institucioni po ashtu të vendosë nëse do të debatohet ose hamendësojë, ose vendos pikëpyetje në atë që vetë e ka përcaktuar ose institucione e pavarura për rend dhe ligj.

Ky debat dhe debatet si ky kanë mundur të zhvillohen edhe në tetor, kur është bërë kërkesa për herë të parë. Sa më përket mua, mund të organizohet dhe të bëhet debat i tillë çdo ditë.

Këtu u fol për shumë dikastere, për shumë aspekte, për shumë institucione në zinxhirin e rendit dhe ligjit, dhe natyrisht se unë nuk mund të flas në emër të gjitha hallkave me rend.

Por, e kam pritur këtë debat që të dal në foltore dhe të them me zë të qartë dhe të lartë: Do të tmerroheshja skajshëm po të më shkonte mendja se në çfarëdo mënyre, si ministër i Brendshëm, jo si qytetar i këtij vendi, të jem pjesë e inskenimeve ose konstruksioneve që mua personalisht më tingëllojnë fantastikë shkencore.

Gjithnjë po flas nga pozicioni im si ministër i Brendshëm i Republikës së Kosovës.

Kujtoj se ajo që e ka parim fundamental sublim kjo shtëpi, që është shtëpia ligjvënese e Republikës së Kosovës, duhet ta mbroj me fanatizmin më të madh të mundshëm mosndërhyrjen në punët e institucioneve të drejtësisë.

Është çështje e Kuvendit çfarë vendimesh merr, çfarë rezolutash aprovon, çfarë debatesh zhvillon, dhe unë nga pozicioni im nuk mund të them as më pak as më shumë që të ju siguroj që do ta respektoj ama bash çdo shkronjë të vendimeve, konkludimeve, çfarëdo që ju në fund i merrni.

Mirëpo, asnjëherë, as ky debat, as edhe njëmijë debate tjera dhe veprime të ndryshme që ndodhin nuk do të më detyrojnë që ta braktis parimin fundamental që unë e kam të shenjtë, të mos jap urdhra politikë, për hir të tjerëve, dhe më pak ta manipuloj, qoftë edhe një të vetmin polic për qëllime politike, edhe më pak për qëllime personale të ministrit të Brendshëm, ose të Skender Hysenit.

A beson dikush a jo që është e mundshme kjo në Republikën e Kosovës, le të gjykojë secili për vete. Secili për vete le të gjykojë! Edhe unë gjykoj për veten time, dhe e di që edhe po të jem jo tash 2 vjet, por edhe 200 vjet tjera ministër i brendshëm, asnjëherë nuk do të jap urdhra politikë, larg qoftë të arrestohet dikush pse mua më është tekur që të arrestohet dikush. Përkundrazi!

Nga funksioni im si ministër i Brendshëm i kam kërkuar me këmbëngulje Inspektoratit Policor që ta hetojë çdo pandehmë nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Dhe, ju e dini që Inspektorati Policor e ka dorëzuar një raport, i cili do të trajtohet nga instancat tjera të Prokurorisë dhe gjyqësisë.

Mirëpo, në të njëjtën kohë, më lejoni të them se unë jam aty që të kujdesem që ndonjë polic i papërgjegjshëm asnjëherë të mos bëhet shkas ose shkak që të përbaltet, të përdhohet e gjithë Policia e Kosovës, e cila është një Polici e shkëlqyeshme. Po e theksoj - Polici e shkëlqyeshme, të cilën duhet ta ndihmojmë drejt përsosjes. Përsosja dhe perfeksionimi nuk ka fund.

Po hajde veç për një sekondë të besojmë se më në fund po përpiqemi me këmbëngulje që t'ua japim krejt pavarësinë e duhur atyre institucioneve. As nuk kam paragjykuar, as nuk e kam ndërmend të paragjykoj. As nuk e kam ndërmend ta braktis parimin tim fundamental, që të ngatërrohem qoftë në punën e Policisë, edhe më pak në Prokurori dhe gjyqësi.

Po e them për herë të parë, ndonëse me shumë hezitim, në kohën time të lirë duke shkuar te mjeku për të bërë analiza rutinore, në veturën time private ka ndodhur një diçka tejmase e pakëndshme. Fatbardhësisht ka rezultuar pa asnjë pasojë. Ka mundur të ketë pasoja, sepse errësimi i xhamit të veturës ka bërë që unë t'i godas dy vetura tjera, e ka mundur shumë lehtë ta shtyp dikë. E të jetë fatkeqësia dhe keqardhja edhe më e madhe, kam mundur ta shtyp ndonjë fëmijë, ndonjë foshnjë në kalim e sipër.

Për habinë time të madhe, pas një ore, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka marrë përgjegjësinë për atë sulm.

Jam takuar pastaj me njerëz të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Po e shoh se Albulenës po i qeshet. Shumë mirë!

(Ndërhyrje)

Jo! E ke shumë gabim, prandaj thashë!

(Ndërhyrje)

Jo! Nuk pyeta kurrgjë! Nuk kam pyetur bash kurrgjë, Glauk! Vetëm e përdora si shembull, sepse t'i the - pse s'ke kërkuar, pse s'e ke bërë veprë penale. Pikërisht për shkak të parimit tim të egër që të mos përzihem në punët e hetimit...

(Ndërhyrje)

Çka? Po nuk ka pasur nevojë ta lajmëroj, sepse Policia...

(Ndërhyrje)

Nëse ka mundësi ta mbaroj! Unë e përmenda... Nëse më lejoni, do ta përmbyll...

KRYESUESI: Zotëri ministër, kështu e kanë deputetët, ti vazhdoje diskutimin tënd. S'ke nevojë të hysh në debat me ta... Mbaje fjalën tënde, e pastaj ata kanë të drejtë të reagojnë.

MINISTRI SKENDER HYSNI: Edhe një minutë të lutem! Dhe, esenca është kjo: Është pikërisht për shkak të parimit, mospërzierjes në punët e Policisë, të hetuesisë, të gjyqësisë, nuk e kam bërë asnjë lëvizje të vetme. Dhe, të ju them të drejtën, e vetmja gjë për të cilën kam ndier keqardhje ka qenë komunikata e “Vetëvendosjes”. Për asgjë tjetër! Dhe këtu po e mbyll. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Gjeneratat e reja në rrugë për t'i realizuar dëshirat dhe ëndrrat e tyre kanë nevojë për motivim, sepse ai i udhëheq drejt qëllimit.

Në shumë raste të rinjtë e kanë një model të personit, të cilin e adhurojnë, e duan dhe e respektojnë. Ata mundohen t'i ngjajnë sa më shumë në shprehje, lëvizje, qëndrime e tjera. Ndonjëherë mundohen edhe t'ia kalojnë modelit për t'u dukur se janë lojalë, të vlefshëm dhe meritore. Modeli mund të jetë këngëtar, sportist, shkrimtar, por edhe politikan.

Të nderuar deputetë,

Çdonjëri prej nesh është model për ndonjë qytetar të vendit tonë. Shumë qytetarë përcjellin, dëgjojnë dhe absorbojnë nga sjelljet dhe qëndrimet tona, e posaçërisht të rinjtë e të rejat. Ata mundohen ta shohin veten në paraqitjet tona.

Vitin e kaluar ne përjetuam momente të rënda që nga fyerjet, shtyrjet, fishkëllimet, gazi, britmat e tjera. Dhe, aspak nuk u dëgjua zëri i arsyes. Nuk pati ballafaqime të ideve, mendimeve, qëndrimeve dhe zgjidhjeve.

Ky ambient, me gjithë tensionet, ofendimet, kërcënimet, goditjet, helmimet nuk i ngjante Kuvendit të një populli të qytetëruar. Më shumë i ngjante një teatri me shfaqje tragjikomike.

Kur të zgjedhurit e popullit - deputetët hedhin vezë, ujë e gaz në kryeministrin e tyre dhe nuk e lejojnë atë të flasë, atëherë edhe një i ri do ta ndjekë shembullin e modelit të tij. Kryeministrit i vënë pritë, ia kërcënojnë familjen, duke e kërcënuar edhe me djegie të shtëpisë, e akte tjera si këto.

Në rastin kur deputeti shtyn, ofendon dhe kacafytet me policin, i riu në rrugë, sipas shembullit të deputetit, do ta godasë policin me kubëza betoni, do ta lyejë me benzinë, do ta djegë dhe do të kalojë sipër tij.

E kur deputeti hedh gaz lotsjellës kundër kolegëve të vet, pa e pasur fare në konsideratë të moshuarin, gratë shtatzëna, njerëzit me probleme të frymëmarrjes, alergjitë në kimikalie të tjera.

Atëherë, është shumë normale që dikush sipas shembullit të deputetit apo i porositur do ta godasë ndërtesën e Parlamentit me armë antitank.

Të nderuar, arma antitank me efektin e saj të plotë e shkrin çelikon, djeg hapësirën dhe i karbonizon njerëzit. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur as gjatë luftës kur këto objekte ruheshin nga forcat serbe. E kur një gjë e tillë ndodh, është e natyrshme që duhet të shqetësohemi, jo vetëm ne, por të gjithë, pozitë dhe opozitë, të gjitha institucionet, organet e ndjekjes dhe të drejtësisë, shërbimi inteligjent, por edhe prindërit dhe familjarët e të rinjve. Ky akt do të duhej të vendosej nën llupë dhe t'u nënshtrohet mirë studimeve dhe analizave nga të gjitha fushat dhe dimensionet.

Mua më intereson, kush ishin ata djem që e shkrepën predhën antitank? Çka i motivoi? Çka kishin për qëllim? Kujt i japin llogari? Kush u dha instruksione? Kush i mbështeti? Çfarë profili psikologjik janë? Çfarë edukate dhe arsimimi kanë? Çfarë është gjendja sociale e tyre? E shumë, e shumë pyetje të tjera do të duhej të kishin përgjigje. Dhe, përgjigje mund të japin vetëm institucionet, organizatat dhe agjencitë profesionale. Kurse, të gjithë ne duhet të vihemi në shërbim dhe mbështetje të tyre për t'u zbardhur dhe shpjeguar rasti deri në detaje.

Po e njëjta gjë për mbështetje vlen edhe për opozitën. Paraqitja e dhunshme në Parlament ka qenë model për dhjetëfishimin e dhunës nga ana e të rinjve jashtë Parlamentit. Kur dhuna bëhet standard dhe normë, si në institucione, ashtu edhe në rrugë, atëherë e ardhmja e kombit dhe e shtetit është e zymtë. Të ardhmen e zymtë na e dëshirojnë vetëm armiqtë tanë, ata nuk zgjedhin mjete dhe forma për të na parë të tillë. Të mos ua krijojmë këtë kënaqësi! Rinia jonë ka nevojë për ambient të shëndoshë politik dhe social. Shumë shpejt do të marrim përgjegjësi familjare, shoqërore dhe shtetërore dhe kanë nevojë për model të mirë edhe të politikanit.

Të gjithë ne e kemi mundësinë të jemi model i dikujt. Urdhëroni, këtu është vendi ku shtrohen faktet dhe argumentet. Unë do t'ju dëgjoj me vëmendje, qëndrimin e ndërtoj në bazë të fakteve dhe argumenteve, jo me presion, as nga frika, por vetëm me ndërgjegje para qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës!

Në këtë debat, i cili është goxha i përqendruar në një temë jashtëzakonisht të qartë, por kemi edhe, si të them, ndërhyrje të deputetëve, por qe besa, në këtë rast edhe të ministrit që s'kanë fare të bëjnë me temën dhe të cilët përqendrohen pastaj te disa përjetime të tyre personale, për të cilat pajtohem që mbase kanë qenë të vështira, por që nuk po i shoh të lidhura fare me temën, përveçse nëse duan të thonë që këtu ka njëfarë lidhshmërie, e cila është saktësisht paragjykimi për të cilën është akuzuar më herët Lëvizja "Vetëvendosje" nga dy kryetarët e grupeve më të mëdha parlamentare këtu.

Sepse, pse po paragjykon, tha njëherë Zenun Pajaziti, pastaj në njëfarë mënyre implicite e tha edhe Ismet Beqiri. Por, nuk është paragjykim fare, për rastin për të cilën po flasim këto janë fakte. Pra, është fakt që njësitet antiterror të policisë janë futur në zyrën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, kjo është e faktuar, është fakt që kanë përdorur dhunë në atë zyrë, është fakt që janë futur me armë të zhveshura, me armë të gjata drejtuar karshi të rinjve aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, është fakt që kanë përdorur plumba gome brenda ndërtesës, është fakt që kanë qenë mbi 1 mijë policë, të cilët thoshin se kemi ardhur të arrestojmë një njeri, Albin Kurtin.

Është po ashtu fakt që “Amnesty International” e ka konstatuar që ka pasur përdorim abuziv të dhunës nga policia në këtë rast dhe është fakt që ministria, të paktën sa e dimë ne, asnjëherë nuk iu është përgjigjur “Amnesty International” për atë se çfarë kanë bërë me hetimin e këtij rasti. S’janë paragjykime, janë fakte. Nëse ju nuk doni t’i pranoni si fakte, atëherë ky është problemi juaj, nuk është problemi i fakteve. Në anën tjetër, është fakt që 6 aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje” janë arrestuar në mënyrë të njëjtë nga njësitet policore në 5 të mëngjesit. Është fakt që shtëpitë e tyre janë rrethuar nga forca të mëdha policore dhe familjet e tyre janë terrorizuar nga këto forca, është fakt që këta gjashtë të rinj studentë janë terrorizuar vazhdimisht, siç është terrorizuar edhe opinioni publik, siç janë terrorizuar edhe familjet e tyre se këta qenkan personat që paskan kryer një sulm terrorist dhe është fakt që kjo aktakuzë e ngritur sot nga prokuroria nuk ka asnjë provë të vetme për asnjërin prej tyre.

Këto janë fakte, prokuroria vetë e ka pranuar që nuk ka asnjë provë të vetme që i lidh këta gjashtë persona, tash fatkeqësisht pesë, me sulmin ndaj objektit të Kuvendit. Siç e përmendi edhe kryetari i grupit, Glauk Konjufca, nuk ka kurrfarë përputhshmërie në mes të të dhënave të ADN-së që janë gjetur në vendin e ngjarjes dhe të dhënave të ADN-së që janë marrë nga të pandehurit dhe këtë nuk po e themi ne, po e thotë prokuroria, prokurori që e ka dorëzuar rastin.

Po ashtu, Agjencia e Forenzikës thotë që nuk ka asnjë lidhje në mes të pajisjeve elektronike të sekuestruara nga aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” nëpër shtëpitë e tyre, që janë telefona mobilë, kompjuterë lap-topë dhe të tjerë që janë marrë nga ata dhe rastet te sulmi mbi Kuvendin dhe kërkon nga organet e shtetit që të gjitha këto mjete t’u kthehen pronarëve të tyre të vërtetë, sepse janë sekuestruar pa pikë nevojë, ky është fakt. Është po ashtu fakt që është dëshmuar, tashmë dhe prokuroria e di që asnjëri prej gjashtë aktivistëve nuk ka qenë as afër vendit të ngjarjes në momentin e sulmit. Këtë prokurori e di, e di edhe policia hetuese, është po ashtu fakt që Astrit Dehari jo që s’ka kurrfarë lidhje, pra në bazë të këtyre që i përmenda, por as nuk është identifikuar kur i janë treguar njërit prej dëshmitarëve dhjetë fotografi me persona të ndryshëm, prej të cilëve kanë kërkuar që t’i identifikojnë personat që ai pretendon se ua ka shitur një motoçikletë.

Aty Astrit Dehari ka qenë në fotografi, e personi nuk e identifikon. Dhe, është fakt që Astrit Dehari është mbajtur në burg pa asnjë provë të vetme, as të fabrikuar nga hetuesia. Ju po thoni,

pse po paragjykoni?! Po, mirë kush do të na japë neve përgjigje pse është arrestuar Astriti? Pse është mbajtur Astriti në burg? Se Astriti në burg e ka humbur jetën, u tha këtu edhe më herët. Pse është arrestuar Astrit Dehari? A e di dikush? Nuk e di kurrkush! Edhe po thonë që nuk duhet ta diskutojnë këtë çështje në Kuvend, edhe po çuditëni pse ne jemi të shqetësuar. Jo, jo, çudia këtu është qysh ju nuk shqetësoheni, sepse tek e fundit, të abstraktojmë njëherë faktin që këta janë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Këta janë qytetarë të Republikës së Kosovës, këta kanë qenë studentë të Universitetit të Prishtinës, dikush prej juve që ligjëroni aty ka mundur t’i ketë edhe studentë. Dhe, këta gjashtë të rinj janë terrorizuar nga një grup i organizuar, rrjet i cili e lidh Prokurorinë, Policinë, mediet e kapura, edhe eksponentë të Qeverisë duke i quajtur “terroristë” këto ditë, prej 29 gushtit.

Ky është element i rrëshqitjes së shtetit të Kosovës nga një qeverisje autoritare, ku policia me vendim politik, me urdhër politik që ministri tha se nuk e ka dhënë, e mbase nuk e ka dhënë, por dikush e ka dhënë, arreston të rinj dhe i mban ata në burg për sa të kenë dëshirë ata, pa kurrfarë prove, pa kurrfarë fakti dhe një moment vendos ta ngrejë një aktakuzë, megjithatë. Pra, a po flasim këtu për drejtësi, si mund të jetë kjo drejtësi, e cila është në shpërputhje dhe shkelje absolute me procedurat që do ta garantonin sadopak formalisht një proces të drejtë, karshi gjashtë të akuzuarve, aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Mirëpo, Glauku e shtroi një pyetje shumë të mirë, mendoj unë dhe të cilën në mënyrë implicite besoj që pak u përgjigjët. Se Glauku tha mirë, kush e ka orkestruar këtë?! Pra, tërë këtë proces, se për që është i orkestruar, për që është i montuar, kjo tashmë është e dëshmuar edhe nga vetë prokurori. Pra, personi i fundit që thotë tashmë diçka të tillë e ka dëshmuar një gjë të tillë në aktakuzën që e ka dorëzuar në gjykatë. Kush janë ata, pra, që e paskan bërë këtë lidhje? Kush është ai, ajo mendje ose ato mendje, nëse janë më shumë se një, që janë zgjuar në ditën e nesërme pas sulmit në objektin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kanë thënë: “Po, po, dihet që kjo është veprë e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe ne e dimë kush janë gjashtë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje” që e kanë kryer këtë”.

Dhe, këtu pak a shumë një përgjigje u mor. Pra, edhe zoti Pajaziti, edhe zoti Beqiri thanë se veç aktivistët tuaj i kanë gjuajtur me vezë ministrat, aktivistët tuaj kanë dalë në protesta që po i bie tash, çka, se po hakmerreni. Pra, po i akuzoni për terrorizëm, po i mbani në burg pa kurrfarë prove, sepse doni të hakmerreni për vezët ndaj ministrave, a është kjo arsyeja pse mbahen këta gjashtë në burg, tash pesë, po e përsëris, pra, fatkeqësisht.

Pra, ju treguat se, në fakt, ju e keni nxitur një arrestim të tillë, ju po e mbronit sot një arrestim të tillë, kur nuk do të duhej ta mbronit, sepse tek e fundit, pavarësisht çfarë mospajtimi, e qe besa nganjëherë edhe urrejtje keni karshi Lëvizjes “Vetëvendosje”, nuk do të duhej të pajtoheshit me një polici që silltet kështu me qytetarët e Kosovës, nuk do të duhej të pajtoheshit me organet shtetërore që kidnapojnë njerëz, që arrestojnë njerëz pa kurrfarë baze, që i mbajnë ata në burg

dhe të cilëve u vdes njëri prej tyre. Mos u pajtoni me këtë, se sot po i bëhet “Vetëvendosjes”, nesër mund t’ju bëhet juve. Mos u pajtoni me këtë mënyrë të funksionimit të shtetit, pra nëse po mendoni dhe nëse e keni seriozisht që Republika e Kosovës duhet të jetë republikë demokratike, e cila e respekton të drejtën e protestës dhe e cila ka procedura demokratike që garantojnë paanshmërinë në gjykim dhe që i garantojnë të drejta edhe të pandehurit, edhe të akuzuarit, atëherë mos u pajtoni me këtë!

Aktivistët tanë edhe sot janë në arrest shtëpiak, do të jenë edhe nesër, më 25 janar e kanë seancën e parë. Asnjëherë nuk janë marrë në pyetje, përveç pas vdekjes së Astritit, kur u bë shumë e madhe që s’i kanë marrë kurrë në pyetje, prokurori tha: “Hajt se po i marr në pyetje”. Pra, prej fillimit e ka ditur prokurori që nuk janë këta gjashtë persona, të cilët e kanë sulmuar Kuvendin. Prej fillimit policia e ka ditur që nuk janë këta gjashtë persona që e kanë sulmuar Kuvendin. Atëherë kush duhet të na përgjigjet pse u arrestuan këta persona? A janë arrestuar se kanë gjuajtur me vezë? A janë arrestuar për ndonjë rast tjetër? Pse? Se në aktakuzë këta akuzohen për sulm terrorist, ta keni parasysh dhe kështu organet shtetërore, po e them prapë, fatkeqësisht e terrorizuan qytetarin e Republikës së Kosovës për gjithë këta muaj, se ky është terrorizim që u bëhet jo vetëm aktivistëve, familjeve tyre, të gjithë neve që i kemi shokë aktivistët, por qe besa, secilin qytetar të Kosovës, i cili e vrojton këtë situatë dhe i cili në lëkurën e vet e ndjen rrezikun që po iu kanoset që të jetojë në Kosovë.

Pra, kjo është një prej faktorëve që po e bën Kosovën të pajetueshme dhe që po e bën qytetarin e Kosovës përherë e më të interesuar ta lëshojë këtë vend, ta keni parasysh. Dhe, po e mbrojtët këtë mënyrë të funksionimit të shtetit, atëherë ju po e mbroni një krim marramendës që ndodh brenda organeve shtetërore, brenda policisë. Natyrisht që nuk është krejt policia e tillë, po ka një rrjet të organizuar kriminal brenda...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë kanë Zenun Pajaziti dhe Ismet Beqiri.

ZENUN PAJAZITI: Po mendoj që nuk është mirë të interpretohet ndryshe, unë e pata një qëndrim, të cilin e thashë në foltore dhe, isha shumë i qartë. U dhashë mbështetje, përgjegjësi të plotë institucioneve të drejtësisë dhe kërkojmë që ata ta japin fjalën e fundit. Nuk aludova, përveç policisë, me provat që i ka bërë publike dhe që aludon në fajtorët dhe këto drejtësia duhet t’i vërtetojë a janë ata fajtorë, mendoj që më së shumti ju po aludoni, më së shumti ju po e përzieni rastin e tillë me burgosjen dhe po na detyroni të flasim për ato që nuk është e drejtë. Nuk u ndihmojmë as atyre, as mos mendoni që u ndihmoni, as i lehtësoni te familjet, askënd që e bëni.

Unë personalisht po them nuk e besoj që ka një adresë politike shqiptare që kishte për të orkestruar një sulm që është i vonuar ndoshta 2-3 dekada, edhe atëherë bile do të ishte kur është suprimuar autonomia e Kosovës. Edhe atëherë një sulm i tillë do të ishte dashur të mendohej nëse do ta dëmtonte ndonjë civil. Prandaj, nuk jam i prirë që të besoj që dikush në mënyrë normale do të mund të orkestronte një sulm të tillë mbi institucionin e Kuvendit. Prandaj, ju lus, mos i keqinterpretoni këto, ne do të kemi rast pas verdiktit final të drejtësisë të flasim dhe do të ishte mirë, sepse atëherë dalin të gjitha faktet, bëhen publike. Besoj që ata që do të merren me to do të jenë sa më profesionalë dhe ne duhet të shprehim besimin tonë dhe duhet të kërkojmë që ata të jenë pa ndikime politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A do kundër-replikë, Visar?

VISAR YMERI: Këto deklarime siç i bëri tash Zenun Pajaziti, janë të mbushura me atë që quhen “lot krokodili”, e që kemi parë shpesh të mbahen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Unë i përmenda disa fakte, të cilat janë fakte që s’po i them unë, por i ka thënë prokuroria në aktakuzë. Janë të shkruara e zeza në të bardhë dhe nëse për Zenun Pajazitin dhe të tjerët që mendojnë si ky këto nuk janë fakte të mjaftueshme që thonë që këta gjashtë aktivistë nuk kanë qenë fare të përfshirë e as afër vendit të ngjarjes kur ka ndodhur ky sulm, atëherë unë s’di çfarë fakti tjetër kërkohet. Ky po thotë: “T’u besojmë organeve të drejtësisë”. Po cilave organe? Kësaj policie që i ka arrestuar dhe i ka tmerruar këta të rinj pa kurrfarë prove, si t’i besohet kësaj policie? Si t’i besohet një prokurori i cili deklaroi më herët që Forenzika do të na tregojë nëse ka lidhshmëri në mes të të pandehurve dhe aktakuzës dhe nëse nuk ka lidhshmëri, nuk ngremë aktakuzë, përkundrazi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, e keni fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Së pari, po dua t’jua rikujtoj që vetë mocioni juaj datën e ka prej shtatorit 2015 e këtej, e nuk e ka prej gushtit, kur janë arrestuar për atë që vazhdimisht po e përmendni e që keni thënë për të arrestuarit që ka të bëjë me sulmin ndaj Kuvendit.

Vetë e keni kërkuar dhe unë kam folur edhe për këtë fazë kohore, meqenëse zoti Ymeri e përmendi, është fakt kjo e kjo, po e pyes, a është fakt kjo, zoti Ymeri, që është sulmuar dhe djegur ndërtesa e Qeverisë së Kosovës? A është fakt që është sulmuar ministri i Punëve të Brendshme dhe ju e keni pranuar me komunikatë? Domethënë, është fakt. A është fakt që është sulmuar shtëpia e kryeministrit? Është fakt, e argumentuar. Po ashtu, a është fakt që ju vazhdimisht kërkonit që për këto të gjitha ta themi ne fjalën. Këtu në Kuvend verdiktin s’mund ta japim, unë po ju them, e thatë se ju i keni nxitur arrestimet, kjo është totalisht e paqëndrueshme,

sepse po e përsëris, po flasim për një periudhë më të gjatë kohore dhe jo vetëm për fazën për të cilën po flitni ju dhe po koncentrohemi vetëm për këtë që ka të bëjë me gjashtë të arrestuarit, fatkeqësisht tash pesë.

Dhe, përgjigja për të gjitha këto që i thatë si fakte është në fund e gjykatës, ata duhen t'ua japim përgjigjen. Nuk mund ta jap unë as kurrkush prej deputetëve për të gjitha ato që pretendoni si fakte: qëndrim të paargumentuar, arrestime të paargumentuara, të pabazuara, pa fakte. Keni për t'i marrë, por prej gjykatës këto argumente. Por, edhe ju, këto që i thashë, a janë të gjitha këto fakte? Edhe shumë fakte të tjera që janë bërë dhe janë pranuar në komunikata nga Lëvizja "Vetëvendosje"...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Kështu, së pari edhe njëherë duhet ta përmend që ka pasur raste, për shembull, që po i përmend Ismet Beqiri më herët, një prej aktivistëve të Lëvizjes "Vetëvendosje", Trim Gashi, siç e dini, është mbajtur 5 muaj në burg nën pretendimin se paska organizuar atentat kundër kryeministrit. Kështu e ka pasur aktakuzën dhe në fund është lëshuar nga gjykata i lirë se nuk ka pasur kurrfarë prove, kurrfarë prove, ky është fakt. Tash, kush ka dalë prej shtetit që t'i thotë Trim Gashit: "Na falni, të kemi mbajtur pesë muaj në burg". Një i ri po ashtu, më i ri se këta që janë tash në burg. Kurrkush, por unë Ismetin e kisha pyetur një gjë tjetër: Ismet, a është shteti i kapur? A është shteti i Kosovës i kapur? A janë organet e rendit, e veçanërisht policia, të kapura nga strukturat e krimit? Të lidhura me politikën të kapur nga strukturat e krimit? Se këtë fakt e keni evidentuar edhe ju LDK-ja, apo jo.

Dhe, ky shtet i kapur a mund...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj. Ju lutem!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Tash fatkeqësisht ministri u largua, ministri i Punëve të Brendshme, por megjithatë shpresoj që televizionin është duke e shikuar, domethënë ai e ka marrë një letër prej "Amnesty International", e cila kërkon shpjegimin se a ka pasur ndërhyrje dhe tejkallim të kompetencave të policisë në rastin e 28 nëntorit në selinë e "Vetëvendosjes", e para.

E dyta, e di që nuk është përgjigjur, por kjo vlen edhe për "Vetëvendosjen", po ashtu Rexha nuk e di a është këtu... Eja, ministër! Ne edhe si komision, ku janë të përfshirë të gjitha partitë

politike, kemi kërkuar edhe prej drejtorit të policisë, prej kryeinspektorit, prej të gjitha mekanizmave, të cilët janë përgjegjës për të hetuar institucionet e sigurisë a i kanë tejkaluar kompetencat. Do të thotë, a ka pasur dhunë të tepruar.

E vërteta është e pamohuar, se kemi parë edhe fotografi, ka qenë “live”, për shembull, në televizion, kemi parë ish-Avokatë të Popullit të përgjakur, Ismet, edhe ajo është dhunë. E dyta, Ismet, në të njëjtën kohë po thua nuk interferoj në drejtësi, nuk ndërhyj në drejtësi, nuk është mirë deputetët që ta bëjnë drejtësinë. Vazhdimisht po përdor raste, raste. Unë dua të them vetëm një gjë, gjithmonë motivi edhe e arsyeton veprimin, ju asnjëri deri tash nuk treguat se cili ka qenë motivi që deputetët e Parlamentit të Kosovës kanë përdorur gaz, e për rikujtim të të gjithëve ka qenë rasti i parë Trepça, kur u tentua njëfarë forme që të negociohet në Bruksel edhe t’i japim kompetenca drejtpërdrejt nëpërmjet një marrëveshjeje të radhës që vinte pak më vonë, e që ne po i themi “Zajednicë”, dikush “Asociacion”.

Ishte rasti “Jablanoviq”, i cili i fyeu nënat gjakovare, ishte rasti i “Zajednicës”, e cila u vërtetua, Zenun. E keni parë Gjykata Kushtetuese ka thënë në plot 23 nene ka shkelje ose bie ndesh dhe duhet të japë përgjegjësinë dikush pse e ka realizuar një marrëveshje, e cila marrëveshje doli që bie ndesh me Gjykatën Kushtetuese. Por, tash po ju them edhe një gjë tjetër, vazhdojmë me demarkacionin pikërisht një ditë më vonë në Vjenë dhe askush prej deputetëve, të cilët janë thirrur e po thonë se e përfaqësojnë zërin e popullit, nuk ishin në gjendje t’i thonë: “Kryeministër, nuk mund të informosh deputetin për marrëveshjet që i ke arritur”. Po zoti kryeministër, është dashur ta diskutosh në Parlament para se të arrihen ato marrëveshje, e pastaj të vihet te një marrëveshje, e cila deri diku edhe ishte arsyetuar.

Kur i shikojmë krejt këto veprime dhe kur i shohim dëmet, të cilat janë shkaktuar me këto marrëveshje dhe kur sot thuhet që, për shembull, e dëgjova një deputet i cili tha: “Kur u gjuajt gazi nuk u mor parasysh mosha, nuk u mor parasysh gjinia etj., etj.” Unë po ju them që asnjë deputet që e gjuajti gazin nuk u largua, por këtu qëndruan. Kjo i bie domethënë që s’i paditët për vetësulm, se e vetësulmuan vetveten, dhe e fundit që është shumë me rëndësi edhe për drejtësinë, se nuk po hyj në rastin e Astrit Deharit që, për besë, le që shkoi një djalë, po na e ka qitur zërin e zi. Qysh ka mundësi organet e njëjta të drejtësisë e marrin një vendim për një qytetar serb, i cili në supermarket, ku janë përfaqësuar rreth 60 anëtarë, nëna me fëmijë hidhet një gaz lotsjellës dhe i njëjti qytetar serb dënohet me 300 euro, ministër, si rast kundërvajtje.

Në rastin e deputetëve është një rast krejt e kundërta, konstatohet që mjeti i përdorur në sallë, në këtë rast gazi lotsjellës, është armë, është armë eksplozive. E pse nuk e konstatoi edhe për serbin mekanizimi i drejtësisë? Domethënë, mos bëni drejtësi me kutitë dyfishtë, e para. Dhe, tjetra domethënë që unë po ju them për t’i parandaluar ato veprime që ne i kemi konsideruar të dëmshme për Kosovën, ne e kemi përdorur mjetin për të cilin ndjehemi krenarë që e kemi bërë. Edhe në rast se ne i kemi amnistuar serbët në veri, marre të qoftë, nëse i ke amnistuar serbët që

t'i kanë djegur 'karauilat' kufitare, nëse i keni amnistuar ata paramilitarë në veri që e terrorizojnë popullin atje që 17 vjet, të mos u hyjë mendja që mund të bëni zgjedhje e që t'jua pamundësoni deputetëve, secilit, për t'i kundërshtuar këto veprime. Unë mendoj që deputetët kanë bërë mirë, por u kanë dhënë edhe një mësim të gjithë atyre që shkojnë në Bruksel se nuk guxojnë më të arrijnë marrëveshje pa e dëgjuar zërin e qytetarëve.

Në rast se dikush mendon, domethënë që duhet ta trajtojë komunitetin serb me prioritet, që t'i trajtojnë ata si të përkëdhelurit, ndërsa deputetin e vet, që është i zgjedhuri i popullit, të trajtohet në mënyrë skandaloze, të quhet deri në "akte terroriste", por paramendojeni, akt terrorist dhe lirohet në mbrojtje në liri, në shtëpi! Domethënë, kjo është çmenduri. Ai nuk guxon të jetë i lirë, nëse ka bërë akt terrorist, po qysh është kjo punë, ku keni dëgjuar a ku keni parë? Ai rrezikon të dënohet 20 vjet, këta e lëshojnë e dërgojnë në shtëpi i thonë: "Hajt tash, shko rri në shtëpi, prit derisa t'i bëjmë ne hetimet e veprimet", e ku di unë.

Po këto janë hajgare, nëse doni thoni po bëjmë humor, lëshoni njerëzit të shkojnë në shtëpitë e veta, ta qesim në votim, ta bëjmë një nen të veçantë, t'i amnistojmë këto raste, t'ia nisim prej të nesërmit të mos bëjmë veprime të ngjashme.

KRYESUESI: Zoti Pajaziti, replikë.

ZENUN PAJAZITI: Dauti më dha rastin që të adresohem unë për këto, për këtë arsyetimin e veprimeve të dhunshme në Kuvend.

Nëse arsyetohesh Daut që një veprim i tillë legjitimohet me mosikjen, kur e bën një veprim, e s'po ik nga salla, nuk e di pse duhet të përgjigjem. Veprimet e dhunshme në Kuvend i kanë bërë hije të keqe secilit prej nesh, po më së shumti atyre që i kanë bërë ato veprime. Nëse ne kishim mundur të bisedojmë në mënyrë normale, të debatojmë, që të vendosim ose të mos vendosim pa dhunë, kjo do të ishte një mënyrë më e mirë dhe mendoj që nuk e kishim ulur kaq poshtë autoritetin e krejt institucioneve dhe politikës në këtë vend, pozitë e opozitë.

Dhe, mendoj që kurrkush nuk ka të drejtë me dhunë të imponojë vendimin e vet, cilido qoftë ai. Secili prej nesh kemi një mbështetje politike a qytetare që jemi këtu dhe askush nuk ka të drejtë të interpretojë ose ta sforcojë me mënyra të tjera atë mbështetje. Ne duhet të jemi të gatshëm të debatojmë pafund për të marrë vendime të përbashkëta, aq më tepër kur është fjala për çështje kaq të rëndësishme për sovranitetin e vendit tonë, të cilat ne do të kemi prapë rast t'i kemi në agjendën tonë të bisedimeve, siç e dini ju.

Unë kërkoj që të kemi pjekurinë e duhur, të jemi të gatshëm të bisedojmë dhe të vendosim drejt, sa më drejt që të jetë e mundur, për vendin tonë, për të gjitha temat që do t'i kemi së shpejti në agjendën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj, kundër-replikë!

DAUT HARADINAJ: Shef i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Zenun Pajaziti, me gjithë respektin, ju e dini që ne kemi nxjerrë një rezolutë, nëse të kujtohet. Ne nuk jemi duke thënë që nuk duhet të debatojmë, nuk duhet të diskutojmë, pikërisht edhe atë jemi duke e bërë edhe sot, por unë mendoj që duhet të diskutojmë dhe të debatojmë para se të merren vendimet. Domethënë, të shtirren mundësitë e fundit para se të merren vendime dhe jo që t'i marrin vendimet edhe pastaj thoni se do ta informojmë Parlamentin.

Do të thotë, ndaje pak, e para. Dhe, e dyta, ta kesh parasysh se ato dy marrëveshje edhe nipat tanë do t'i trashëgojnë, fatkeqësisht, e gazi lotsjellës kurrgjë s'na ka bërë hiq, bile veç na i ka hequr viruset e gripat.

KRYESUESI: Ismet, a deshe ti fjalën? Zoti Beqiri e ka fjalën për replikë.

ISMET BEQIRI: Kjo që u tha, bash sivjet kemi pasur shumë gripa, shumëkush prej nesh, po zoti Haradinaj, unë s'e kuptova, ok-eh, është e drejtë juaja që ta thoni. Unë i përmenda rastet, sepse po të pyetshim ne, fare nuk e kishim mbajtur këtë debat, për arsye se duhet t'ua lëmë organeve kompetente, por kur kërkohet debati, normalisht që edhe ne i përmendim rastet, por jo veç një periudhë kohore kur dikujt i konvenon, por prej asaj çka është thënë këtu, po edhe të mos ishte shkruar prej shtatorit 2015, i kisha thënë, sepse edhe nëse unë s'i them, qytetarët i kanë parë të gjitha këto veprime. Dhe, po ashtu po e them, me gjithë respektin, të gjitha ato vendime që kanë qenë edhe nëse është vlerësuar nga dikush që janë të dhunshme dhe jo të drejta, jo në interes të vendit, sipas atyre që kështu e mendojnë, përsëri kjo nuk e arsyeton përdorimin e dhunës brenda dhe as jashtë Kuvendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Shala. Dauti, kundër-replikë!

DAUT HARADINAJ: Unë për Ismetin edhe njëherë veç po ia përsëris fjalët. Unë iu referova Ismetit kur i përmendi disa raste konkrete dhe që i paragjykojnë aktorët në këtë aspekt të thashë. Ndoshta ti ke informata më shumë se ne të tjerët, por po supozojmë, për shembull, a është në rregull të mbahen aq gjatë ata aktivistë, sepse po përmenden vetëm të "Vetëvendosjes", nuk qëndron, ka edhe të partive të tjera, kur as një intervistë, domethënë në intervistim nuk merren, Ismet, ndërsa asnjëherë kurrkush nuk është pajtuar për sulmin që iu ka bërë Kuvendit të Kosovës, por nëse për shembull, është në pyetje ajo që tha më parë ministri i Punëve të Brendshme në kerr, nuk e di, nuk është fundi i botës, të mos e teprojmë shumë.

Domethënë, nuk pajtohem që të sulmojnë askënd në familje se nuk është mirë, por në fund të fundit, krejt ky debat është si rezultat i veprim pas veprimi që kanë ndodhur dhe po ndodhin dhe,

fatkeqësisht edhe ju po e shihni fare mirë domethënë që edhe treni, muri edhe shumë veprime të tjera...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse kjo seancë është thirrur për të debatuar për burgosjen e të rinjve tanë, ose të studentëve tanë në Kosovë, për shkaqet që dihen, edhe aktakuza, gjoja për terrorizëm, sepse ende nuk e kanë dëshmuar se me të vërtetë janë veprime terroriste ose janë këta të cilët i kanë bërë ato veprime, por debati i deputetëve të dy partive më të mëdha, shefat e dy grupeve dhe kolegu im, Anton, më nxiti që me të vërtetë të debatoj.

Pajtohem me fjalimin e Antonit kur thotë se nxjerr fakte se kanë qenë veprime të dëmshme ose të këqija, të cilat kanë ndodhur në Parlamentin e Kosovës. Por zoti Anton duhet të mos e lërë në gjysmë ose të mos e akuzojë vetëm një pjesë të pozitës për veprimet, të cilat kanë ndodhur në Parlamentin e Kosovës, por të thuash saktë... duhet ta drejtosh gishtin nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila nuk ka qenë aspak transparente në bisedime, të cilat i ka zhvilluar atë kohë, në kohën e pushimeve, me Serbinë, ose arritja e dy marrëveshjeve që ende nuk po gjejnë ose nuk po guxojnë të sillen në Parlament nga Qeveria, as marrëveshja e demarkacionit e sa për Asociacion e ka thënë edhe fjalën e vet Gjykata Kushtetuese, e cila ka vërtetuar se ka qenë një marrëveshje jashtëzakonisht e dëmshme që ka shkelur Kushtetutën në 43 nene.

Ato veprime tona dhe dy marrëveshjet e arritura nga Qeveria e Republikës së Kosovës i kanë sjellë jashtëzakonisht dëme vendit tonë si në arenën e brendshme, njëkohësisht edhe në arenën ndërkombëtare, sepse e kanë vërtetuar edhe kryetari i shtetit tash, edhe kryeministri, se janë marrëveshje të dëmshme dhe nuk po guxojnë dhe nuk po merr guximin që ta sjellë në Parlament dhe të shihet me të vërtetë çka është dhe çfarë dëmi ka.

Sot kryeministri, edhe ju vetë çdo ditë në çdo debat, debatoni që opozita është duke penguar liberalizimin e vizave për mosvotimin e marrëveshjeve të dëmshme. Ju numrat i keni, pse nuk e sillni në Parlament? Pse nuk i votoni ato marrëveshje? Pse e akuzoni opozitën për veprime? Pse e detyruat opozitën të marrë veprime të tilla? Pse i detyruat 205 mijë qytetarë të Kosovës të nënshkruajnë petitionin kundër atyre marrëveshjeve? Pse i detyruat qytetarët e Kosovës të protestojnë kundër këtyre dy marrëveshjeve? Si rezultat i të gjitha këtyre, më në fund ndodhi arrestimi i disa aktivistëve dhe t'i akuzoni për terrorizëm dhe, siç tha Haradinaj, t'i lironi në shtëpi. Në qoftë se me të vërtetë kanë qenë terroristë, mbajini në burg. Edhe unë jam për t'i dënuar, në qoftë se me të vërtetë ata i kanë bërë ato akte, por jo të ngrihet aktakuzë për terrorizëm dhe të lirohen në shtëpi, pa fakte.

Edhe ju, të nderuar deputetë,... mësohu edhe ti të dëgjosh, se ty të dëgjova boll mirë, mos reago, se marre është, po i ndërhyt edhe Dautit, edhe ne, edhe të gjithëve.
Po e lëmë Besën, jepja fjalën Besës dhe ta shohim çfarë po thotë Besa, zoti Xhavit. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari e kam një propozim për Grupin Parlamentar të PDK-së dhe LDK-së. Pse s'po e bëni një kërkesë për debat parlamentar dhe kur të doni ju flasim për aksionet që i kemi bërë si opozitë përbrenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe për ato që kanë ndodhur jashtë Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kundërshtim të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi dhe atë për "Zajednicën". Kur të doni, kur të doni vendosni që të diskutojmë për këto veprime dhe, natyrisht, ne do të jemi dhe do të kontribuojmë në debatin parlamentar që do ta thërrisni ju për veprimet dhe aksionet tona në mbrojtje të Republikës së Kosovës.

Sepse, me deklaratat në foltoren e Kuvendit, duke përmendur, edhe gazin lotsjellës, edhe aksionet tjera jashtë Kuvendit të Republikës së Kosovës po mundoheni ta zbehni skandalin më të madh që ka ndodhur në vendin tonë, arrestimin e gjashtë aktivistëve të Lëvizjes "Vetëvendosje", të cilët pa prova i akuzuat me veprën më të rëndë që njihet e legjislacioni penal, atë të terrorizmit.

Po e nis debatin, në ndërkohë po i ftoj edhe kolegët e Grupit Parlamentar, që nëpërmjet një aksioni simbolik të vërtetohen edhe personat përgjegjës për orkestrimin e këtij rasti.

Në fund të muajit gusht 2016, saktësisht para pesë muajve, ose dy ditë para protestës së 1 shtatorit, protestë e cila ishte organizuar kundër demarkacionit me Malin e Zi, në orët e hershme të mëngjesit u arrestuan 6 aktivistë të Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe të njëjtit, ky sistem i kapur i drejtësisë, pa asnjë provë i ngarkoi me veprën më të rëndë që njihet legjislacioni penal, atë të terrorizmit.

Koha e arrestimit, mënyra e arrestimit, ekspozimi i provave që s'kishin të bënin fare me aktivistët tanë flasin shumë për qëllimin e arrestimit të aktivistëve tanë, pra një nga qëllimet ishte që duke i arrestuar aktivistët për veprën e terrorizmit, ta shpallin Lëvizjen "Vetëvendosje" organizatë terroriste.

Glauku, nëpërmjet diskutimeve i shpjegoi në detaje të gjitha provat që janë siguruar nga vetë Hetuesia dhe Prokuroria, e që asnjëra prej tyre nuk e ngarkon asnjërin prej aktivistëve tanë për sulmin ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë këtu do të flas për personat që i keni para vetes, që kanë qenë pjesë e orkestrimit të gjithë këtij procesi.

Pra, shtrohet pyetja se cilët janë ata që janë marrë që nga fillimi me propagandë, me montimin e provave për aktivistët tanë, e deri tek ata që kinse po merren me hetimet për vdekjen e dhunshme të aktivistit tonë, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Sa herë që këtij pushteti i rrezikohet mandati i shfrytëzon njerëzit që janë servilë të të njëjtit për ta luftuar Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Po e nis me Televizionin Publik RTK-në, ose më saktë me eksponentët përbrenda RTK-së që janë të kapur nga “Klani Pronto”, e që janë Mentor Shala e Ridvan Berisha. Mentor Shala e Ridvan Berisha ende pa u arrestuar aktivistët tanë, nëpërmjet propagandës së tyre, u munduan ta përgatisin terrenin që aktivistëve tanë t’u mvishet vepra e terrorizmit, pra të njëjtit e bën përgjegjëse Lëvizjen “Vetëvendosje” për sulmin ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Po vazhdoj me Shpend Maxhunin, të cilit iu vazhdua mandati në mënyrë të kundërligjshme dhe sot askush nuk mund ta kontestojë faktin se ky njeri është i kontrolluar nga pushteti, më saktësisht nga “Klani Pronto”. Kjo lehtësisht vërtetohet edhe në përgjimet e fundit apo ato të “Pronto 2”-shit, të cilit Adem Grabovci i dërgon listë me emra familjarësh e militantësh për t’u punësuar në Polici.

Pra, sa herë që “Klani Pronto” i ka kërkuar Shpend Maxhunit që ta luftojë Lëvizjen “Vetëvendosje”, ai e ka bërë këtë pa asnjë hezitim. Njësoj ka ndodhur edhe me arrestimin e dy aktivistëve tjerë, Trim Gashin dhe Kushtrim Avdimetaj, dhe zoti Beqiri, njëri është shpallur i pafajshëm, është Trim Gashi, që është shpallur i pafajshëm. Jo, jo! Ka qëndruar pesë muaj në paraburgim. Ka qëndruar pesë muaj në paraburgim për shkak se kryeministri yt e ka akuzuar që ka bërë atentat ndaj tij, dhe për Kushtrim Avdimetajn prokurori ka hequr dorë nga aktakuza.

Kështu ka ndodhur edhe me bastisjen e zyrave tona dhe kështu po vazhdon edhe me aksionin për arrestimin e gjashtë aktivistëve tanë. Fatos Makolli apo drejtori i Njësisë Kundër Terrorizmit në Policinë e Kosovës, i cili në paraqitjet e tij publike e provoi mashtrimin e opinionit publik, duke thënë se është i bindur që aktivistët e Lëvizjes e kanë kryer sulmin ndaj Kuvendit të Republikës, e sot po del krejt e kundërta, sepse të gjitha provat e siguruara nga vetë Policia e Prokuroria po e dëshmojnë pafajësinë e aktivistëve tanë.

Luan Keka, i cili është i angazhuar në Drejtorinë e Antiterrorizmit në Policinë e Kosovës dhe i cili ka qenë udhëheqës i aksionit në arrestimin e gjashtë aktivistëve tanë, i njëjti është bashkëshort i Miranda Kekës, e cila ka qenë kandidate e PDK-së për zgjedhjet e fundit, por edhe e kemi parë të shoqëruar me Ridvan Berishën dhe Zenun Pajazitin, i cili në këtë seancë po derdh lot krokodili.

Avdurrahim Islami, prokuror, i cili dha urdhër për arrestimin e aktivistëve tanë pa e parë dosjen, sepse e përmendi edhe Glauku, sepse ishte në pushim, dhe pa asnjë fakt propozoi paraburgosjen

dhe arreste shtëpiake për aktivistët tanë. I njëjti për më shumë se shtatëdhjetë ditë rresht nuk i kishte marrë në pyetje aktivistët, por ama i kishte lënë në paraburgim dhe në arrest shtëpiake. Pra, tek pas vdekjes së Astritit ka filluar marrjen në pyetje të aktivistëve tanë. I njëjti po ashtu ngriti para disa ditësh aktakuzë pa asnjë provë. Lexojeni aktakuzën e prokurorit Islami dhe vërtetojeni këtë.

Vehbi Kashtanjeva është gjyqtar i procedurës paraprake, që është marrë edhe me rastin, apo përndjekjen, apo persekutimin politik të deputetëve të opozitës për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Republikës, është po ashtu çuditërisht i njëjti, i cili e miratoi propozimin e prokurorit Islami dhe vendosi për masa të ndryshme të padrejta sigurie. Po të mos i zbatonte ky gjyqtar urdhrat e regjimit, Astriti sot do të ishte i gjallë dhe në mes nesh.

Nexhmi Krasniqi apo komandanti i policisë për rajonin e Mitrovicës dha deklarim publik se Astriti kishte vdekur nga mbidoza me medikamente dhe kjo ishte një shpifje, për të cilën i njëjti asnjëherë nuk dha përgjegjësi. Po ashtu, i njëjti bart përgjegjësinë për mënyrën e rrjedhës së provave në opinionin publik, duke u munduar ta drejtojë opinionin publik drejt propagandës së tyre, e kështu larg të së vërtetës.

Sylë Hoxha, jo rrallëherë e kemi parë në rolin e shërbëtorit të zellshëm ndaj pushtetit, që buron nga “Klani Pronto”, këtë e dëshmon edhe përgjimi. Prokurori Sylë Hoxha është marrë kinse me hetimin e vdekjes së dhunshme të Astrit Deharit. Ai në vijimësi u përkujdes në kontaminimin e provave dhe vdekjen e Astritit e shpalli vetëvrasje ende pa përfunduar hetimet, sepse ashtu u porosit prej “Pronto pushtetit” dhe për këtë ky njeri u shpërblye me avancim në pozitën e prokurorit special.

Metush Biraj, apo dora e djathtë e Sylë Hoxhës, është prokurori që po ashtu po merret kinse me zbardhjen e vdekjes së Astritit, pra është një prokuror që s’e ka asnjë kredibilitet, as moral, as profesional, po e bazoj me deklarin tim, për shkak se jo rrallëherë është hetuar nga zyra e prokurorit disiplinor, por edhe është hetuar për konflikt interesi për shkak se i njëjti ka kërkuar që vëllait të Sylë Hoxhës t’i zbutet dënimi, i cili ishte në burg për ryshfet.

Dhe, në fund, dy njerëz që bartin poste politike ekzekutive në Qeveri është Skender Hyseni, që nuk e kemi dëgjuar të flasë shumë për rastin e vdekjes së Astritit, por as për arrestimin e aktivistëve tanë. Sot e pati një diskutim krejtësisht patetik dhe natyrisht se u mundua që ta heqë përgjegjësinë nga vetja. Nuk e di, zoti Hyseni, a e keni dëgjuar Shoqërinë Civile, qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë kërkuar dorëheqjen tënde pikërisht për shkak të mosveprimit të atyre që kanë montuar prova dhe për shkak të deklaratave të rreme të njerëzve përbrenda Policisë së Kosovës; dhe Dhurata Hoxha, e cila menjëherë pas vdekjes së dhunshme të Astritit u mundua nëpërmjet konferencave të dukej se po bën diçka, por në fakt ishte penguesja më e madhe për

zbardhjen e të së vërtetës dhe, e cila, njësoj sikur Sylë Hoxha, vdekjen e dhunshme të Astritit e shpalli vetëvrasje ende pa përfunduar hetimet.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Këta dymbëdhjetë persona, herët apo vonë do të bartin përgjegjësi morale, penale dhe politike për arrestimin e aktivistëve tanë dhe për vdekjen e dhunshme të Astritit, sepse ne si subjekt politik nuk do të ndalemi asnjëherë, derisa drejtësia të shkojë në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, sinqerisht, kur diskutohen tema të tilla, të cilat kanë implikim të drejtpërdrejtë në drejtësi dhe në sigurinë e vendit, ndërhyrje nga Kuvendi, nuk kam debatuar, as s'kam dëshirë të debatoj. Megjithatë, sot po e pranoj se u nxitova dhe prapë po pranoj se gabova që e mora fjalën, por megjithatë po i them disa fjalë, sepse tema të tilla nuk e vlen të diskutohen në Kuvend, aq më shumë, me keqardhje po them, me kolegët çfarë ne i kemi sot këtu në Kuvend, të cilët, sinqerisht, pas fjalës së kolegut tim, zotit Anton Quni, që e tha shumë mirë, ne jemi model i të rinjve, të cilët mendojnë të angazhohen në politikë. Ju jeni një model që vërtet lini shumë për të dëshiruar.

Kolegë deputetë,

Ne e kemi pas bërë një rezolutë të përbashkët, të gjitha partitë politike të këtij Kuvendi për sulmin terrorist... *(dëgjohet debat nga salla...)* Mbylle moriii! Boll më, boll se bezerite, boll...! Po, po, po qysh jo! Ashtu... Tash a je e kënaqur ti?! Veç, djali im nuk është deputet! Ne tash... nuk ka gjë më mëkat se të jesh ti ulur në ulësen e deputetes edhe për mua s'ka gjë më të ulët se të merrem me ty çka je kah thua ti. Por, megjithatë, unë po vazhdoj, zoti kryesues!

Unë po them shumë sinqerisht, ne si parti politike e patëm bërë këtu të gjithë bashkë një rezolutë për sulmet terroriste ndaj institucionit të Kuvendit. Edhe sot po them shumë sinqerisht, uroj nga zemra që të mos jenë shqiptarë, as aktivistë, as anëtarë të asnjë partie politike ata që e kanë gjuajtur atë ditë Kuvendin. Por, kolegë deputetë, sikur çdo shtet në botën demokratike, edhe Republika e Kosovës i ka organet e drejtësisë që janë duke u marrë me rastin. Dhe, ju këtu, që sillni këso temash, nuk mund t'i zgjidhni. A do të vendosë gjykata, a ka të drejtë Prokuroria, a s'ka të drejtë, a janë ata, a s'janë ata...? Por, shtrohet pyetja, kur të dalin këtu kolegët deputetë dhe flasin si deputetë përpara, që thonë "ne ndihemi krenarë për mjetin që e kemi përdorur kundër kauzave të rrejshme që i keni ngrehur ju". Po, s'ka më turp, kurrëgjë më turp nuk ka! Unë po ju them sinqerisht, vepra terroriste e gjuajtjes së institucioneve të Republikës së Kosovës është shumë e rëndë, por shumë më e rëndë është sjellja juaj, meqë botërisht keni gjuajtur gaz lotsjellës dhe gjithë bota ka folur për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo është më e rëndë se vetë akti atje që është bërë. Dhe, unë s'po dua ta gjykoj kush e ka bërë, unë juve po ju gjykoj.

Ju, jeni ata që publikisht sillni gaz, ju jeni ata që gjuani mollotov, ju jeni ata që mi mbani maskat, ju s'keni çka të diskutoni më shumë.

Dhe, unë po ju them, veç po jua bëj një pyetje për fund: A bën të na tregoni ku është qëllimi juaj për këtë seancë? Çka po doni prej kësaj seance?

KRYESUESI: Zonja Besa Baftija është në radhë.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Me të vërtetë është për keqardhje kur nga deputetët e këtij Kuvendi, përkatësisht tash në fjalimin e fundit, nga zonja Besa Gaxherri, me një fjalor të tillë tani paraqitet, kur e dimë shumë mirë se kjo më 1 shtator na ka akuzuar si organizatë terroriste.

Kryesues...!

KRYESUESI: Më fal, të lutem!

BESA BAFTIJA: Në cilindo shtet normal demokratik, kjo që ka ndodhur me aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, e që rezultoi me humbjen e jetës së Astrit Deharit, do të duhej të ishin përgjegjës prej hetuesit policor e deri te kryeministri. Fatkeqësisht, kjo nuk po ndodh, sepse është vetë ky pushtet që i akuzoi këta të rinj, aktivistët tanë, studentët shembullorë, me akuza të montuara për sulmin ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës, vetëm e vetëm që ta shpallin Lëvizjen “Vetëvendosje” organizatë terroriste. Pra, këtyre të rinjve ua mvëshën titullin më të rëndë “terroristë”.

Vetë fakti se si ka rrjedhë procesi prej momentit të arrestimit të aktivistëve e deri më sot duket qartë se është proces i montuar politik, e të tilla procese kemi përjetuar si popull në sistemin komunist të ish-Jugosllavisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Fatkeqësisht, proceset e tilla të montuara politike po i përjetojmë edhe sot në shtetin tonë. Ne ishim të bindur dhe kemi thënë qysh në fillim se aktivistët tanë janë të pafajshëm dhe nuk kanë të bëjnë asgjë me sulmin ndaj Kuvendit, sepse Lëvizja “Vetëvendosje” çdo aktivitet tonin e bën hapur dhe jo tinëz, madje ne bëjmë incizime dhe ato i bëjmë publike. Një gjë të tillë po e dëshmojnë edhe provat që tanimë janë publike, e që janë të dala nga institucionet relevante. Një ndër to është edhe prova e ADN-së, që është shumë e besueshme, e në raportin e Agjencisë Kosovare për Forenzikë thuhet se ADN-ja e gjetur në materialin në vendngjarje nuk ka përputhje me ADN-në e marrë nga aktivistët.

Në rastet kur vërtetohet se profili i ADN-së të të dyshuarve është i ndryshëm nga ai i gjetur në vendngjarje, atëherë është i arsyeshëm dhe i pakontestueshëm përfundimi se kjo provë është shumë e saktë, që vërteton se aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk ishin pjesë e sulmit ndaj Kuvendit. ADN-ja është unike dhe kjo gjë e bën armën më të fuqishme për identifikim. Për ju përfaqësues të institucioneve, që tanimë qartë dihet se jeni përgjegjës për burgosjen e aktivistëve dhe vdekjen e Astrit Deharit, tashmë dorëheqja nuk mjafton, sepse ju duhet të përgjigjeni penalisht.

Prandaj, ne sot këtu shprehim mllefin tonë dhe në të njëjtën kohë kërkojmë drejtësi për vdekjen misterioze të shokut, studentit, aktivistit, e mbi të gjitha qytetarit të Republikës së Kosovës, Astrit Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Maja e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë është politika, ndërsa atë e mban gjallë sistemi i drejtësisë.

Besimi i qytetarëve në institucionet publike ka rënë dhe numri i ankesave në institucionet e drejtësisë vazhdimisht ka shënuar rritje. Maja e korrupsionit është politika, jo politika në bazë të ligjeve, por në bazë të fuqisë që ka, kurse gjallë po e mbajnë gjykatat dhe prokuroritë.

Baza e korrupsionit është te shërbyesit civilë. Ky nuk është vetëm konstatimi im, por sistemi i drejtësisë në Kosovë ka dështuar. Ka shumë lëndë që presin vite me radhë dhe që barten nga një zyrë në zyrën tjetër. Shqetësim vazhdon të mbetet pavarësia e Gjyqësorit, llogaridhënia e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndikimet politike në Gjyqësor. Vazhdojnë të qëndrojnë shqetësime të fuqishme për deklaratat publike të zyrtarëve të lartë për rastet që janë në vazhdim e sipër si ndërhyrje në Gjyqësor. Ka shumë akuza për korrupsion, ku janë të përfshirë edhe pjesëtarët e Gjyqësorit dhe të Prokurorisë.

Kritikat janë të shumta, duke nisur nga lëndët e pazgjidhura, numri i vogël i gjyqtarëve, buxheti i kufizuar e deri te ndikimi politik në rastet gjyqësore. Pak progres përmendet se është arritur vetëm me miratimin e një pakete të ligjeve.

Llogaritet se në Kosovë për 100 000 banorë punojnë rreth 19 gjyqtarë. Sistemi i drejtësisë në Kosovë në vazhdimësi është kritikuar nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si njëri nga sistemet me probleme të shumta në funksionim, përfshirë këtu edhe dukurinë e korrupsionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë të Kosovës, pas publikimit të Raportit të Progresit, kanë deklaruar se pavarësisht përparimeve në fusha të caktuara, Kosova nuk ka kohë për të humbur, sepse duhet të punojë shumë e shumë për të arritur aty ku synon.

Drejtësia në Kosovë ka dështuar tërësisht. Nuk ka drejtësi për ata që kanë vrarë, që kanë dhunuar e keqtrajtuar, që kanë shkatërruar gjithçka gjatë luftës në Kosovë. Nuk ka drejtësi për 1 800 të pagjetur në Kosovë, por kemi shumë lëndë të patrajuara për shkak të neglizhencës së gjykatave. Krimi dhe korrupsioni nuk po luftohen dhe atë korrupsioni në nivel të lartë, kërkesë edhe nga faktori ndërkombëtar, si njëri ndër kriteret për liberalizim të vizave.

Ndërsa, në këtë kohë shteti ka qenë shumë efikas në arrestimin e shumë qytetarëve dhe të deputetëve të opozitës për veprime politike, të cilët edhe sot po përballem me burgje dhe nëpër gjykata, arsyeja e vetme - sepse mbrojtën sovranitetin dhe integritetin e shtetit.

Të gjithë ata që nuk kanë bazë ligjore për mbajtje në burg duhet të lirohen, se gjithë këto arrestime nuk i bëjnë nder shtetit dhe nuk e bëjnë shtetin funksional, që po i respekton ligjet, se e thamë edhe më herët se sistemi i drejtësisë është i dështuar dhe i tillë do të mbetet, derisa të mos funksionalizohet si duhet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Edhe pse shumë shkuan, disa që preferojnë të na thërrasin që të mos diskutojmë për padrejtësitë që po u bëhen tani e 143 ditë të plota aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” ishin ata që të parët, më 1 shtator, në ditën kur deputetët e opozitës dhe aktivistët u organizuan që ta mbrojnë territorin nga “Zajednica” e nënshkruar nga këta vetë, na quajtën “fundërrina”, “të sëmurë psikikë” dhe “terroristë”. Ky ishte një konstatim që vinte nga deputetët e pushtetit, të cilët sot po thërrasin që të kemi konsideratë dhe të mos diskutojmë për këtë çështje.

Pra, i dënuan aktivistët, në mesin e tyre edhe Astrit Deharin, në ditën kur ata u arrestuan padrejtësisht. Sot bëhen 143 ditë të plota nga arrestimi i gjashtë aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Sot bëhen 76 ditë nga vdekja e dyshimtë e Astrit Deharit në Burgun e Prizrenit. Pra, ai qëndroi i pafajshëm në paraburgim 68 ditë, i akuzuar sepse në Facebook ishte shok me aktivistët që, sipas këtij pushteti, me çdo kusht dhe pa asnjë provë duhej akuzuar. Pra, Astriti u arrestua, u mbajt në burg dhe vdiq atje për shkak se në Facebook-un e tij personal ishte mik me Atdheun, me Egzonin dhe me të tjerët.

Dy ditë në mbajtje në Polici, Frashër Krasniqi dhe Adea Batusha, ndërsa sot bëhen edhe për ta 141 ditë ende në arrest shtëpiak, ndërsa për Petrit Ademin pushojnë hetimet për mungesë provash. Sa ndërrime të vendimeve e rrethana të procesit gjyqësor kanë mbetur të njëjta? Plot dëshmi publike, plot prova të mjaftueshme për të mos shkuar më tej. Një jetë e humbur e Astritit dhe shumë padrejtësi ndaj të tjerëve, mirëpo po shihet edhe nga qëndrimet tuaja sot që keni shumë zell nga pushteti, që me çdo kusht e pavarësisht çmimit ta shkatërroni bazën e rezistencës

kundër së keqes, t'i frikësoni sa më shumë përmes përndjekjes ata që guxuan të mobilizohen në një betejë kundër së keqes, e cila nisi në vitin e kaluar, më 25 gusht.

Arrestimi skandaloz i aktivistëve, studentëve e qytetarëve besnikë të këtij vendi, vetëm pse e kundërshtojnë servilitetin, nepotizmin, korrupsionin, krimin dhe tradhtinë politike të bartësve të “Klanit Pronto”, nuk është perspektivë dhe as substancë e asnjë politike.

Kjo qeveri tentoi të kontrabandojë falje tokash me fqinj tonë perëndimor, Malin e Zi, dhe tentoi krijimin e një etniteti me fuqi politike, ushtarake e juridike për fqinjin verior, Serbinë. Deputetët e opozitës dhe aktivistët e saj persekutohen prej se kundërshtohen këto marrëveshje të dëmshme për shtetin. Pra, rezultatet kulminante të këtij persekutimi të montuar politikisht u arritën pikërisht më 30 gusht 2016, dy ditë para se të përgatitej protesta e madhe për kundërshtimin e tradhtisë për faljen e tokës.

Gjasthtë të rinj, entuziastë, aktivistë politikë, studentë të dalluar u arrestuan me njësitet më elitare, u traumatizuan familjet e tyre dhe çfarë është më e rëndësishmja - u tentua që një organizatë, si forca më e madhe politike opozitare në vend, të shpallet si organizatë terroriste.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Lëvizja “Vetëvendosje” nëpërmjet konferencave të shumta për shtyp i ka prezantuar dëshmitë për pafajësinë e aktivistëve tonë. Këto dëshmi do t'i lexoj qëllimisht edhe sot këtu në Kuvend, që të mbeten të transkriptuara.

Bëhet fjalë për videon e parë, e cila tregon se Astrit Dehari dhe Adea Batusha kishin qenë në banesën e Astritit, nga ku dalin dhe shkojnë në marketin A&B. Atdhe Arifi gjendej në lokalin ABA duke u ushqyer, për çfarë janë dëshmitarë edhe Januz Shatri dhe Valon Hoti. Egzon Haliti ndodhej në banesën e së dashurës së tij, ndërkaq Petrit Ademi ishte duke darkuar në rrugën “Hajrullah Abdullahu”, në Bregun e Diellit, kurse Frashër Krasniqi tri orë para sulmit kishte shkuar në shtëpinë e prindërve, prej nga nuk ka dalë deri të nesërmen. Për të gjitha këto ekzistojnë kamerat e sigurisë, pamjet e shumicës prej të cilave i ka vetë Policia.

Ministri i Punëve të Brendshme shkoi, sepse ai e di të vërtetën, është përgjegjës për të gjitha këto persekutime politike dhe nuk ka guxim të ballafaqohet me prova përtej përpjekjeve që duke u provuar të kthehet në viktimë, që nuk është, në njëfarë forme t'i amnistojë të gjitha këto veprime të tij dhe të pushtetit kriminel.

Telefoni i secilit prej nesh, në çdo minutë, çon sinjal në linjë dhe me antenë dhe këto ruhen për vite të tëra. Dhe, nëse kamera e sigurisë tregon që Atdhe Arifi ka qenë te ABA dhe nëse telefoni i Atdhe Arifit ka qenë po në të njëjtin vend dhe nëse po ashtu antena në atë zonë tregon se telefoni i tij ka qenë i kyçur në atë, sepse këto regjistrohen për çdo minutë, ne i bëjmë thirrje

Policisë, le ta kërkojnë këtë historik për të parë nëse përputhen kamerat e sigurisë, domethënë vendndodhja fizike e tyre dhe e telefonatave të tyre. Ata e dinë që nuk përputhen, e dinë që është montuar, sepse e montuan vetë.

Faktet që i mohojnë pretendimet e Policisë për e-mail-in kërcënues: një nga provat, në të cilat është thirrur Policia, Prokuroria dhe disa medie të afërta me pushtetin ka qenë se gjoja e-mail-i kërcënues që e merr përgjegjësinë për sulmin në Kuvend është dërguar nga lokacioni ku banon Frashër Krasniqi dhe nga IP-adresa e tij, ose e atij lokacioni. Madje Policia, siç do ta shihni, deklaroi publikisht që e-mail-i është dërguar nga Frashër Krasniqi dhe Adea Batusha. Nuk e kanë asnjë provë për këtë, përkundrazi e demantojnë veten dhe kjo hidhet poshtë nga vetë dosja e Prokurorisë. Aty thuhet qartë, që e-mail adresa është dërguar nga Rruga B, pra ky nuk është lokacioni ku banon Frashër Krasniqi - banesat e Tregtisë, si dhe IP-të nga të cilat është dërguar e-mail-i janë të numrave të telefonit, abonentë të të cilëve, dhe këtu kërkoj vëmendje, janë Fatmir Tahiri dhe Mentor Krasniqi. Pra, nuk janë Adea Batusha dhe Frashër Krasniqi.

Në anën tjetër, në kohën kur është dërguar e-mail-i, sipas vetë dosjes së Prokurorisë, as Adea dhe as Frashëri nuk kanë qenë në vendin nga ku është dërguar e-mail-i, pra nga Rruga B. Analiza e pajisjeve të sekuestruara, po ashtu Agjencia Kosovare e Forenzikës nga analizimi i të gjitha pajisjeve që u janë sekuestruar aktivistëve të akuzuar për terrorizëm nuk ka gjetur asnjë provë të vetme që do të dëshmonte lidhjen e tyre me sulmin në Kuvend.

Prandaj, deputetë, ju s'keni të drejtë të paragjykoni këtu. Është e turpshme që po paragjykoni! Po e lidhni me gazin lotsjellës, ne s'jemi fshehur asnjëherë prej gazit lotsjellës, përkundrazi e kemi pranuar publikisht, kemi vepruar publikisht, ashtu sikur të gjitha aksionet e Lëvizjes "Vetëvendosje" kanë qenë publike. Prandaj, mos provoni t'i lidhni këto veprime njëren me tjetrën.

Po ashtu, dokumenti tregon se ADN-të e aktivistëve tanë nuk përputhen me ato që janë gjetur në vendin e ngjarjes.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Qysh po na ndodh shpesh përgjatë historisë, e shumë rrallë po mësojmë prej gabimeve, në momentet më vendimtare për vendin persekutohen më të mirët. Ata të cilët u rritën duke e pritur lirinë e prindërve nga burgjet e Serbisë, siç është rasti i Atdheut, dhe ata që dhanë krejt çka patën dhe i edukuan fëmijët në frymën e atdhedashurisë, siç bëri axha Avni, pra babai i Astritit.

Po ashtu, është tepër e dhembshme se si të njëjtit persekutohen nga njerëz ose familjarë e trashëgimtarë të atyre që dikur në pushtetin shovinist të Serbisë ia bënë argatin armikut, e shumica e të cilëve, çuditërisht, sot janë instaluar në institucionet më të larta të Policisë, të Prokurorisë dhe të gjykatave.

Pyetja që duhet të bëhet në rastin konkret të aktivistëve tonë është: Pse në trinomin Polici-Prokurori-Gjykatë, të angazhuarit apo gjahtarët e kundërshtarëve politikë, zyrtarë me pozita kyçe, kryesisht kanë të kaluar të dyshimtë? Unë nuk i paragjykoj njerëzit nga veprimet e të afërmeve të tyre, por nganjëherë, fatkeqësisht, rimohimi po ndodh pikërisht nëpërmjet tyre. Dhe, një vijë e UDB-së po e vazhdon gjahun e vet dhe përndjekjen e shqiptarëve më patriotë e atdhetarë nëpërmjet atyre që njësoj, si në të kaluarën jo shumë të largët, vepronin brenda llojit.

A ju kujtohen pamjet e Bacës Gani, Gani Krasniqit, më 28 nëntor, për këtë po flas. Ju e dini kush është Gani Krasniqi dhe e dini se çfarë FIT-i dhe me urdhër të kujt i bë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues Haliti!

Kjo është seanca e parë e këtij sesiioni të Parlamentit dhe unë kisha paraparë diku në një pikë tjetër, që të bisedoj diçka për këtë Parlament në këtë fillim seance.

Tash jemi në pikën e fundit, nuk dua t'i ik kësaj pike, por edhe do t'i them megjithatë tri-katër fjali të asaj që e prisja se do ta them dhe do të kishte një reagim.

Edhe sot e kemi një gjuhë të komunikimit këtu, që mua po më duket se s'ka ndodhur, që ka ndonjë ndryshim, ndonjë nuancë. Nuk më pëlqen shumë, sepse e kemi një transformim të çuditshëm, herë prej muskujve të gjuhës te gjuha e muskujve, e herë prej gjuhës së muskujve te muskujt e gjuhës. Unë nuk po them se kjo është specifike veç për një grup, por ju garantoj, që nëse i analizoni e dëgjoni mirë, këtë e gjen te të gjitha grupet.

Kjo nuk është mirë, aq më tepër ky konversion ndodh çuditshëm, sidomos kur ne bisedojmë ndërmjet vetes edhe kur bisedojmë me të tjerët. Dhe, ma merr mendja që është moment për reflektim individual të secilit se, fundi i fundit, pa marrë parasysh veprimet politike kolektive që i kanë partitë këtu dhe jemi individë, për ata që s'janë individë pak si vështirë e kanë edhe të ndjekin programe të sistemuara.

Ju e dini që përvoja thotë, ne s'kemi si t'i ikim, që ekzistojnë mësimet ose doktrinat, dhe ekziston edhe historia, ose ndodhjet. E para krijon parime, por historia tregon që nuk ndiqen parimet.

E dimë që jo kundër të keqes me dhunë, është një postulat që pak a shumë e rezymon krishterimin. Në anën tjetër, islam, do të thotë 'paqe'.

Këto janë doktrinat, por po ta shihni sot e dikur, në histori, këto dy paqe duke komunikuar gjoja për paqen me njëra-tjetrën, kanë krijuar lufta dhe kryqëzata.

Kjo është përvoja e njerëzimit dhe jona.

Po ne e kemi edhe atë kulturën tonë tradicionale, nacionale, që sublimohet me Kanunin, edhe aty ka çka të mëshohet për ndodhitë dhe përparimet, çka është trimëri, ballafaqimi me këto që i ke, ose edhe më i madh. Po njerëzi, që është më e vështirë, të mbrohet i vogli.

E tash këto parime, çdo njeri që e ka jetuar jetën bashkë me ne i di, i ka të sendimentuara si mësim personal ose kujtesë, është mirë ne t'i vëmë në përdorim në këto situata kur po bisedojmë për probleme, të të gjitha këtyre natyrave që i përmenda më shumë si figura se sa si specifike, por të gjitha janë në situatat e sotme, te ne, rreth nesh dhe përtej nesh. Dhe, janë situata të cilave nuk mund t'u ikim ne, dhe do të ballafaqohemi përditë e më shumë: a kemi trimëri dhe a kemi nder? Edhe brenda në Kosovë, edhe rreth Kosovës.

Tash po vijmë te problemi i kësaj. Krejt çka po bisedojmë ne, në të vërtetë është shumë interesant dhe desha ta artikuloj në këtë mënyrë, është për Parlamentin, ose ndodhitë këtu në Parlament, në sallë, ose ndodhitë në mure përtej sallës.

Këto ashikare që kanë shkak e pasojë, aktorët a janë të njëjtë, unë nuk e di, nuk mund të them, por ashikare perceptimi popullor, por edhe ajo që po ndodh në diskutim këtu, po thotë se ka shkak e pasojë.

U tha, e u përsërit edhe këtu se të gjithë janë kundër sulmit të Parlamentit, me s'di çka e kanë gjuajtur, por me diçka nga jashtë. Unë nuk i di këto armët mirë t'i specifikoj.

E dëgjova edhe këtu. Po e dëgjova një artikulum këtu që “mirë ia kemi bërë”, pak a shumë, çka kemi bërë. Jo të gjithë, nuk u tha me shprehjen time, por ashtu interpretohet. Do të thosha: Jo. Jo, sepse sulmi mund të ndodhë edhe brenda, jo sulm klasik nëse dikush i bie dikujt.

Po sulm në kuptimin e imazhit krejt të asaj që e bëmë ne është, duhet ta pranojmë.

Ju e dini, krejt ajo e ka prodhuar një super fotografi që u konkurren fotografive më të mira të vitit. Domethënë është ngjarje, absolutisht është botërore si ngjarje, ka prodhuar një fotografi, një nga më të mirat. Përtej kësaj, unë nuk po interpretoj.

E pra, tash është puna e formulimit që e ka bërë “Vetëvendosja”. Kjo thotë, “përndjekjet, akuzat dhe arrestimet politike të aktivistëve”. Më lejoni të mos pajtohem unë me këtë formulim, sepse është paracaktues.

Vetvetiu, unë nuk e di, nuk po them sot, po mund të ndodhë ndonjëherë vjen puna që drejtësia tregon se unë s'e kam ditur e kanë qenë përndjekje, akuza dhe arrestime politike. Unë abstenoj këtu. Pra, formulimi sot nuk më pëlqen, nuk është adekuat dhe e kufizon mënyrën e të menduarit.

Nëse janë përndjekje, edhe politike, ju garantoj, për hatër të atij të ndjerit kanunor, që ju thashë, do të jem mbrojtës publik i atyre. Përtej kësaj nuk po shkoj.

Veçse, problemi i kapjes së shtetit, i diskutimit për drejtësi, drejtësia e padrejtë e kapur, më lejoni që të them se nuk jam i zoti këtu të jap mendime, po indiciet i shoh.

Për shembull, e dëgjova ministrin e Brendshëm, i cili foli 10 minuta, po ai ka qenë 3 herë ministër, ka qenë edhe ministër i Jashtëm, e pak edhe bën diplomaci. Ne jemi në Kuvend dhe unë mendoj se nuk duhet të bëhet shumë diplomaci, duhet të flitet direkt.

S'e përkthej atë, por unë e kuptova nga të dhënat e tij se ai është sulmuar, ekziston, sipas tij, një grup i cili e pranon që e ka sulmuar, mirëpo prokurori nuk ka ngritur akuzë, tha ministri, unë qysh e dëgjova. E, pra, ai u ankua, për hesap timin, dhe do të ishte, po të flasim me gjuhë pak morale, gjynah, mëkat, t'i thuhet atij çka po bën ti? Sepse ai, i bie, që as që mund t'i afrohet prokurorit kund.

Në anën tjetër, e dëgjova më duket të "Vetëvendosjes", Visarin, sepse ndoshta e dëgjoi specifikisht, nuk e di, por që e tha se ka dështuar prokuroria. Shumë mirë, bravo që ka dështuar. Nëse ka dështuar prokuroria, e vërteta do të dalë në shesh, gjyqi s'i dënon ata që s'kanë bërë gjë dhe Kosova dëshmon për çudi që është shtet juridik, edhe i së drejtës. Le të bëhet drejtësia!

Po deklarimi është i kapur nga të dy anët. Mos ekziston një formacion! Mos, po them unë, nuk e di, nëse opozita ankohet që është drejtësia e kapur dhe pozita me një funksion të lartë shtetëror ankohet në Kuvend, atëherë mos është një organizim informal që është përtej pozitës dhe opozitës, unë nuk e di.

Dhe, në fund, kolegë të mi të nderuar. Mendoj se është mirë të kemi më shumë skrupujpër njëri-tjetrin, kujdes. S'fitojmë kurrëgjë që ne e çojmë zërin ndaj njëri-tjetrit duke përdorur zhargon të autenticitetit, po e quaj, mos t'i them emër tjetër, për njëri-tjetrin s'është mirë. Nuk është mirë! Sepse, dikush tha: jo, na marrin shembull. Jo, se s'na merr shembull kurrkush kështu! Çfarë, shembuj të këqij s'merr kurrkush, që ka mend! Merr shembuj të mirë.

Pra, kisha thënë, unë këtu nuk dua t'i personalizoj sendet dhe përpiqem, bile argumentin kurrë. Po mua më ka ndodhur, për shembull, grupe parlamentare që, kur e kanë kryer krejt diskursin e vet, mua dy herë ma kanë ndalur fjalën në foltore. I kam datat. Nuk është korrekte!

Unë jam prej atyre që ju dëgjoj gjithë ditën! Bile edhe shënime mbaj.

Ju thoni, pse mban shënime? Po mbaj shënime, se po harroni shumë të gjithë. Tash këtu flitet për ato marrëveshje, mua më mbajnë ligjëratë njerëzit që e kanë votuar atë marrëveshje. Dhe, unë i dëgjoj, me durim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ia mundësoni ta vazhdojë diskutimin!

SABRI HAMITI: ...Kjo ishte porosia e fundit. Në këtë Kuvend kam dashur të them që me konstitucion ne na sundon pakica. Dhe, këtu tash ka ardhur koha të bëhet mbrojtja e shumicës, të interesit të shumicës, përnjëmend.

Interesin e shumicës, zonja e zotërinj, e kanë shqiptarët. Këtu janë 100 deputetë shqiptarë, të mos ankohen, s'po merremi vesh, po na pengon filan grupi. Pasi të gjithë punojnë për interes të Kosovës, për tema të mëdha nuk është problem, ia ngjitni emrin qysh të doni, grupet shqipe të Parlamentit, a liga independentiste, a qysh doni ia ngjitni, por nuk ka më arsye të mos merremi vesh, ta votojmë, siç ndodhi, pak më parë një mocion që e kanë hartuar të gjithë bashkë, dhe të ankoheni se qenka njëfarë grupi që po na pengon.

Me 100 vota, për çkado qoftë në Parlamentin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh të drejtën e padrejtë kushtetuese që pakica të bllokojë ose të bëjë veto, çdo propozim i votuar me 100 vota është propozim që merret parasysh kudo e gjithëherë. E pra, ka mundësi marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Visar, replikë apo çka? Po, për replikë paraqitet zotëri Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Po e shfrytëzoj të drejtën që ma jep Rregullorja që të reagoj karshi asaj që tha profesor Hamiti, meqenëse m'u përmend emri dhe iu referua çështjes drejtpërsëdrejti. Po edhe e shtroi si pyetje që e bon edhe më të arsyeshme reagimin tim.

Pra, kur foli për kapjen e shtetit, e shtroi si një tip dileme, që meqenëse opozita po thotë se është shteti i kapur, e në njëfarë mënyre edhe Qeveria, pra, po e pranon ose eksponentë brenda Qeverisë që është shteti i kapur, atëherë qenka një i tretë, pra një strukturë të cilën ne nuk po e njohim.

Në fakt, ne strukturën e njohim. Këtu edhe është problemi. Ne i kemi thënë vazhdimisht: po është SHIK-u, strukturat e SHIK-ut, të drejtuara nga Kadri Veseli, i cili tash është bërë kryetar

Kuvendi, ata që e kanë dizajnuar, kapur dhe mirëmbajnë shtetin. Dhe, pastaj LDK-ja, me nënshkrimin e marrëveshjes së koalicionit në fund të vitit 2014, është bërë pjesë përbërëse, është bërë hisedar i kapjes së shtetit, të një pjese në këtë kapje.

Pra, janë futur brenda ombrellës së kapjes së shtetit dhe e shfrytëzojnë pastaj të njëjtin mekanizëm për qëllime të caktuara.

Mendoj që një gjë ne duhet ta kemi të qartë këtu, se po flitet shumë për Kuvendin dhe shpeshherë keqkuptohet, e kam vërejtur nga deputetët, e këtu nuk po them profesor Hamiti, por të tjerët, që Kuvendin e keqkuptojnë si godina e Kuvendit. Pra, si objekt i Kuvendit, ku këto të dyja bëhen bashkë, bëhen njëjtë. Pra, kur thua objekt i Kuvendit, është një gjë tjetër, është lehtësia që e mundëson Kuvendin.

Sulme ndaj Kuvendit ka shumë. Jam dakord! Atë ditë është sulmuar objekti i Kuvendit, por sulme ndaj Kuvendit ka gati në secilën seancë, sepse Kuvendi si institucion është një tërësi rregullash, procedurash dhe normash, sipas të cilave veprohet. Dhe, nuk është drejtpërsëdrejti i lidhur dhe ekskluzivisht me objektin. Sulme ndaj këtyre rregullave, normave dhe procedurave ka në Kuvend gati se në çdo seancë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Për kundër-replikë paraqitet zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Mirë është, e drejta e kryetarit, po i them me funksion sepse s'di si t' i them ndryshe kryetarit të Lëvizjes "Vetëvendosje" t'i recitojë qëndrimet e veta dhe të mos ia ndalë kurrë, sa herë t'i jepet rasti, është e drejta e tij.

Po unë kur fola, ai besoj se është inteligjent, është për mua djalë i ri, është burrë i mençur, por mua është djalë i ri, sepse ai e di pse e di që është djalë i ri. Ai duhet t'i kuptojë këto çështje. Duhet t'i kuptoj pse s'po personalizoj. Mos i keqpërdor, s'ke shans të më futësh në zhargonin për të cilin fola. Se nuk e pranoj unë.

Unë thashë, keni skrupull, ju lutem! Ti je kryetar partie, thuaj çka të duash, është e drejta jote. Udhëheq parti.

Por, jo, mos më interpreto gabim, sepse nëse unë s'e di çka është Kuvendi, atëherë s'po them...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Sot gjatë diskutimit brenda kësaj pike shumë diskutues, sidomos të koalicionit qeverisës në fillim të fjalës së tyre thanë se nuk do të paragjykojmë, por pothuajse shumica e tyre nuk mund të liroheshin nga paragjykimet, prandaj edhe përmendnin shumë akte terroriste që në një mënyrë ose tjetër mundoheshin t'i ndërlidhin për pikën për të cilën sot po diskutojmë. Mendoj që është edhe e padrejtë, edhe gabim, edhe nuk është asnjë lloj kontributi, por vetëm një dëm i madh që po i shkaktojmë këtij vendi dhe kësaj shoqërie.

Në këtë debat u tha se veprimet e opozitës, mendohej në kohën kur është hedhur gazi lotsjellës, ishin veprimet më të dëmshme që i kanë ndodhur këtij vendi, e që po ashtu nuk është aspak e vërtetë, sepse ky vend, nëse e ka humbur imazhin për të cilin shpesh po flasim, e ka humbur për shkak të korrupsionit, krimit të organizuar, marrëveshjeve të dëmshme për këtë vend, siç është demarkacioni dhe “Zajednica”, bisedimet pa parime me Serbinë, rezultatet e të cilave po i shohim të gjithë dhe tani, 6 vjet pas atyre kërkesave të “Vetëvendosjes” që hasnin në veshë të shurdhër që bisedimet pa parime nuk do të duhej të fillonin. Tani u ka rënë ndërmend edhe atyre që janë aktorët kryesorë në bisedime, edhe ministres Tahiri që të kërkojë që këto bisedime të rikonceptohen, të ridizajnohen, sepse kështu siç janë ato vetëm sa po i shkaktojnë dëme Kosovës dhe Serbisë po i japin hise pa të drejtë që të marrë vendime për çështje të brendshme dhe, në fund, si falënderim po sjell trena, po ndërton mure, po kërcënon e dërgon ultimatumë për asociacione, e kështu me radhë.

Mendoj se është shumë me rëndësi të kuptojmë në të gjithë se sot do të duhej të gjithë të brengosemi që nuk kemi arritur të ndërtojmë një shtet ligjor dhe do të duhej të punojmë të gjithë së bashku që ta ndërtojmë një shtet ligjor, ku qëndrimet, masat dhe veprimet merren në bazë të fakteve dhe argumenteve.

Po e lidhi këtë edhe me një pjesë të fjalës së zotit Anton Çuni, i cili tha se qëndrimet duhet të ndërtohen bazuar në faktet e argumentuara dhe pikërisht ky është angazhimi edhe i Lëvizjes “Vetëvendosje”, e cila po ofron dokumente zyrtare, të cilat po dëshmojnë se ajo çka ka ndodhur me këta aktivistë nuk janë bazuar në fakte të argumentuara, por bazuar në montime të çështjeve.

Dhe, krejt për fund, prapë po lidhem edhe me një çështje që e tha zoti Çuni. E përmendi çështjen e modelit dhe ai elaboroi se gjeneratat e reja i marrin model ata të vjetrit, pararendësit.

Unë shpresoj dhe jam shumë i bindur se këtij vendi nuk i duhet një model, e ai është që kur “Vetëvendosja” të vijë në pushtet të mos e marrë kurrë për model mënyrën e qeverisjes së qeverive të pasluftës, të cilat i kanë shkaktuar dëm këtij vendi në të gjitha fushat dhe se një model i tillë nuk i duhet këtij vendi dhe askujt tjetër, prandaj shpresoj se këto farë metoda të marrjes së modeleve nga të rinjtë në të vjetrit të ketë përjashtime dhe të merren vetëm modele të

mira, atëherë kur një gjeneratë, një organizim angazhohet për të mirën e përgjithshme, siç ka qenë angazhimi i deputetëve të opozitës gjatë kësaj kohe që i ka penguar dy të këqija të mëdha, të cilat nuk i kanë ndodhur vendit vetëm e vetëm për shkak të një angazhimi parimor, për të cilin natyrisht se askush s'ka mundur deri sot të na bindë se ky angazhim ka qenë i dëmshëm.

Mendoj se është momenti të reflektojë pozita dhe t'i bashkohet opozitës, t'i tejkalojmë këto dy çështje të dëmshme, ashtu sikur është interesi i vendit, pra të tejkalohet çështja e demarkacionit duke e aprovuar ashtu siç duhet, në pikat e kufirit atje, ku në të vërtetë janë dhe jo ku i përcakton gabimisht Komisioni shtetëror dhe po ashtu Asociacioni i komunave, të cilën kushtetuesja e ka shpallur antikushtetuese, të bëhet me modelin që ne e kemi në Asociacionin e komunave me shumicë shqiptare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës!

Deputetë të Kuvendit,

Shteti i së drejtës në Kosovë nuk është askund. Kemi padrejtësi gjithkund. Meqë shteti është i kapur, në shënjestër është opozita.

Çuditërisht opozita ballafaqohet jo thjesht me Qeverinë, por me shtetin, për shkak se shteti i kapur nga pushteti ndërsehet kundër opozitës.

Para disa javëve, në fund të vitit të kaluar, kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Reshat Millaku, ka thënë se për hir të liberalizimit të vizave për Kosovën i ka ngritur 23 aktakuza për krime të autorizuara dhe për keqpërdorim të detyrës së zyrtarëve të lartë, si kryetarë komunash, ministra e zëvendësministra.

Pra, për hir të liberalizimit të vizave i ka ngritur nja 23 aktakuza së fundi. Kjo është një dëshmi që aktakuza ngrihen për të bërë përmirësimin e gjendjes drejt liberalizimit të vizave, jo për drejtësi e për shtet, sepse për këto dyja nuk ia vlen.

Vetë prokurori thotë që ngritjen e aktakuzave nuk e bën për drejtësi e për shtet, por e bën për liberalizimin e vizave.

Pra, një konfirmim që ligji në Kosovë nuk është në korrelacion kuptimor me të drejtën për qytetarë dhe drejtësinë për qytetarë, por me një dobi tjetër shtesë të nevojshme, e cila nëse nuk ndodhet aty, nuk ka as pse të zbatohet ligji.

Njësia FIT e Policisë së Kosovës sot quhet Njësia Speciale Intervenuese, ndërkaq ROSU quhet Njësia Speciale Operacionale.

Më 28 nëntor të vitit 2015, me rreth 1 000 policë, policia e ka rrethuar selinë e subjektit kryesor dhe më të madh opozitar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, me ç’rast ka ndërhyrë me FIT-in, me Njësinë Speciale Intervenuese.

Me këtë njësi nuk ka ndërhyrë tash në veri, kur thuhej se po vjen treni ruso-serb. Pra, ndaj “Vetëvendosjes” është përdorur njësi antiterror, njësi i intervenimit të shpejtë që nuk është përdorur në veri të Kosovës.

Kjo tregon se çfarë qëndrimesh politike ka Policia në territorin Republikës sonë që është shpallur shtet i pavarur.

Dhe, jo vetëm kaq. Mbaj në mend që më arrestuan me njësitë antiterror, më dërguan në burgun e sigurisë së lartë në Gërdoc të Llapit, ku më mbajtën 3 javë e gjysmë dhe më liruan. Është absurde që më dërguan në burgun e sigurisë së lartë, të ndërhyjnë me njësi antiterror dhe të më mbajnë vetëm 3 javë e gjysmë. Unë u bëra gati për një burg së paku disamujor, e ndoshta disavjeçar.

Si u bë që më liruan për 3 javë e gjysmë?! U çudita shumë! Çka po ndodh kështu? Unë besoj se edhe arrestimi ka qenë politik, por edhe lirimi ka qenë politik. S’ka kuptim të më lëshonin për tri javë e gjysmë.

Po arsyeja pse më kanë lëshuar është kjo: Më 21 dhjetor unë jam liruar pas dite. A e dini pse jam liruar më 21 dhjetor? Sepse, disa orë para se të lirohem unë, e ka marrë vendimin Gjykata Kushtetuese që “Zajednica” e Serbisë e shkel në 23 nene Kushtetutën e Kosovës. Dhe, ky vendim bëhet publik më 23 dhjetor. Disa orë pasi që merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese, mua më lëshuan për në shtëpi.

A po e kuptoni që gjithçka është politikë, edhe arrestimi, edhe lirimi! Pra, s’ mund të thuhet mos i politizoni këto procese, kur, në fakt, ato rrënjët dhe ecjen e kanë politikë.

Sulmi mbi Kuvendin e Kosovës, atëherë kur ka ndodhur, nuk është quajtur ‘akt terrorist’. Është quajtur sulm me mjet shpërthyes.

Më 30 gusht të vitit 2016, një ditë pasi që u arrestuan 6 aktivistë tanë, u quajt ‘sulm terrorist’.

Tash, më thoni ju mua, çfarë procedurash ne të respektojmë: t’i presim hetimet, t’i presim vendimet, e tjera e tjera?

Pse nuk u quajt ‘sulm terrorist’ kur ndodhi në fillim të gushtit, por në fund të gushtit, një ditë pasi u arrestuan aktivistët e “Vetëvendosjes”.

Pra, kur i zunë aktivistët e “Vetëvendosjes” dhe i futën në burg, duke shkuar në gjysmë të natës nëpër shtëpitë e tyre me njësitë speciale, atëherë thanë: e ky është akt terrorist. Pra, akti u bë terrorist pse i burgosën të “Vetëvendosjes”. Jo pse predha e goditi Kuvendin. Shumë interesante!

Meqenëse predha e goditi Kuvendin, kjo edhe më tutje nuk ishte akt terrorist. Kur u kap “Vetëvendosja”, padrejtësisht, në gjysmë të natës 6 aktivistë të rinj, në të njëzetët e tyre të hershme, atëherë thanë është ‘akt terrorist’. Kjo është përplot politikë.

Pra, nuk kam se si ta respektoj këtë polici dhe këto procedura.

Sa për t’ jua përkujtuar, as vrasja e Selver Hardinajt, as ajo e Enver Zymberit nuk u quajtën ‘sulme terroriste’. Janë vrrarë njerëzit. Nuk janë quajtur nga kjo Qeveri që mungon këtu, prapa meje, nuk janë quajtur ‘sulme terroriste’.

Dhe, as sulmi në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës në veri, para më pak se 2 javësh, me granatë dore, nuk është quajtur ‘sulum terrorist’.

Pra, shumë ka rëndësi si po quhen gjërat, me çfarë emrash, sepse këto kanë reperkusione pastaj në veprimet e mëtutjeshme.

Dy dhoma të Policisë së Kosovës, të sigurisë së lartë të provave, janë vjedhur. Askush nuk është gjykuar ose dënuar për këtë gjë. S’i t’i besojmë kësaj Policie, kur dy herë vidhen dhomat e dëshmimeve dhe absolutisht askush s’ gjykohet a të dënohet për këtë gjë!

Kryepolici nga rajoni i Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, më 5 nëntor, pak orë pasi kishte vdekur Astrit Dehari, tha se ka vdekur nga doza e tepërt e medikamenteve. Gënjeu! Ai ka qenë në burg, ai s’ka vdekur në rrugë, as në stacion të policisë.

Ose, kryeprokurori i Gjykatës Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, konstatoi se Astriti është vetëvrrarë ende pa u kryer hetimet. Si t’i besojmë këtij prokurori?

Krejt këto janë deklarata politike. Kjo edhe është arsyeja pse po diskutojmë në Kuvend.

11 vjet burgim, 9 policë të Kosovës janë dënuar për keqtrajtim të truprojave të Vulinit. 11 vjet burgim, 9 policë për keqtrajtim të truprojave të Vulinit.

5 policë e rrahin përtokë një demonstrues më 27 janar të vitit 2015, sepse protestonte kundër ministrit Jablanoviq. Asnjëri prej atyre 5 policëve nuk është suspenduar, lëre më gjykuar ose dënuar.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qytetarë të Republikës,

Edhe Policia, edhe gjyqësia, edhe prokuroria e dinë që Atdheu, Egzoni, Adea dhe Frashëri nuk kanë të bëjnë me sulmin mbi Kuvendin e Kosovës.

Po ta dinin këta se këta sadopak kanë të bëjnë, kurrë s'i kishin liruar. Këta janë liruar në shtëpi, se edhe vetë Policia, e prokuroria, e gjyqësia e dinë që s'kanë të bëjnë me këtë rast. Nuk i kishin liruar po të kishin pasur ndonjë lidhje. Ata vetë nuk janë të bindur, prandaj i kanë liruar.

Të gjithë aktivistët e arrestuar, unë jam i bindur se do të dalin edhe nga arresti shtëpiak e do të shpallen të pafajshëm.

Edhe Trim Gashi, e Kushtrim Avdimetaj, kështu u patën akuzuar, por qëllimi i këtij regjimi është që ta fajësojë publikisht Lëvizjen "Vetëvendosje". Gjykimi nuk ndodh në sistemin e drejtësisë, por në studiot televizive dhe në portalet e regjimit.

Në një dramë të Gëtes është një fjali që e përshkruan situatën aktuale në Kosovë: "Vendimi u paraprin hetimeve, kurse ndëshkimi i paraprin gjykimin". Pra, vendimi i paraprin hetimeve, kurse ndëshkimi i paraprin gjykimin.

Radiotelevizioni i Kosovës është një ndërmarrje publike që nuk u privatizua, sepse tashmë është privatizuar. Është privatizuar së brendshmi. Ajo nuk privatizohet së jashtmi, sepse privatizimi përbrenda tashmë ka ndodhur.

Shtrohet pyetja pse nuk ka gaz lotsjellës sot në Kuvend të Kosovës? Çka po ua merr mendja, pse s'ka gaz lotsjellës sot? Nuk ka gaz lotsjellës se ka vdekur "Zajednica", nuk ka lotsjellës se ka vdekur demarkacioni.

Dikush mund të thotë që duhet t'i falënderohemi opozitës që s'ka gaz lotsjellës sot. Nuk është e vërtetë. Duhet t'ju falënderohemi juve që nuk po e sillni "Zajednicën" dhe demarkacionin. Është në dorën tuaj a do të ketë gaz lotsjellës apo jo. Nuk është në dorën tonë. Është krejtësisht në dorën tuaj.

Ato gratë shtatzënë, ata pleq a do të kenë gaz lotsjellës ose jo, nuk varet prej nesh, varet prej juve. Mos e sillni "Zajednicën", mos e sillni demarkacionin, çdo grua shtatzënë, çdo i moshuar s'do të kenë asnjëherë problem.

Pra, është tërësisht në dorën tuaj se a do të kenë vështirësi gratë shtatzëna dhe të moshuarit. Jo në dorën tonë.

Kjo Qeveri, si politikë dhe kjo Qeveri si polici, është ajo që merr vendimin a do të ketë gaz lotsjellës në këtë sallë. Mos të na hedhë policia neve gaz lotsjellës në rrugë, s'kam ku të marr unë gaz lotsjellës, sepse për të blerë gaz lotsjellës nuk ka. Duhet të merret në protesta, atë që nuk shpërthen.

Dhe të mos na e sjellë politikisht këtu demarkacionin dhe “Zajednicën”, nuk ka gaz lotsjellës. Prej juve varet a do të ketë gaz lotsjellës. Absolutisht jo pre neve. Ju e keni në dorë.

KRYESUESI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Si? Askujt! Është anëtar i Kryesisë, nënkryetar i Kuvendit.

(Ndërhyrje: Edhe për një minutë!)

ALBIN KURTI: Nuk është në rregull akti politik të dekontekstualizohet dhe të depolitizohet. Kjo është taktikë e vjetër kriminalizuese, ta zhveshësh prej synimit, ta zhveshësh prej qëllimit dhe prej arsyes. Të flasësh me një lloj humanizmi vajtues duke e depolitizuar aktin tonë.

Ne nuk hedhim gaz lotsjellës pa e sjell ju “Zajednicën” dhe demarkacionin. Edhe Skender Hyseni e ka nënshkruar demarkacionin, pse s'po e bie. Ky duhet të japë dorëheqje, e ka nënshkruar para krejt botës dhe s'po e bie tash këtu.

Isa Mustafa, në shtator, kur e kanë gjuajtur “Vetëvendosja”, AAK dhe “Nisma” për herë të parë me vezë të prishura, pati thënë se Kushtetuta është në rregull, me marrëveshje. Ai ka gënjyer. Pse s'po jap dorëheqje?

Dhe, krejtësisht në fund, nuk na marrin të rinjtë model neve për të na imituar, por e kundërshtojnë servilitetin.

KRYESUESI: Faleminderit, Albin! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë nuk desha të flas, por meqë devijimi i informacioneve po bëhet për qëllime të faturës publike, të subjektit “Vetëvendosje” lidhur me demarkacionin.

Demarkacionin, për njohuri të publikut, po e them dhe e kam thënë edhe nëpër media, nuk e ka ndalur gazi lotsjellës, por e kanë ndalur deputetët e pozitës. Dhe, jo pse ju keni bërë rezistencë, por ne kemi fakte të cilat i kemi vërejtur se ka shkelje para juve. Dhe, falë reagimit të zotit

Ramush Haradinaj, ju keni përdorur edhe fakte të cilat me sjelljet që janë bërë, sot kemi krijuar një situatë që nuk i beson më kurrkush, as pozitës, as opozitës, as kryeministrit e as kurrkujt për vërtetësinë.

Edhe ta zbresin nga qielli dikë, demarkacionin me metodën qysh e kemi interpretuar ne, askush nuk e do. Secili ka të vërteta dhe secili ka kundërshtime të vërteta për situatën e demarkacionit.

Prandaj, mos u mundoni ta përdorni një alibi për diçka që nuk ju bën nder, por e cila na ka turpëruar krejt Parlamentin, ndërsa demarkacionin edhe sonte, po ju pyetëm nga bina këtu, nuk dini ta mbron. Dhe, unë e kam dhënë zyrtarisht, e ju asnjëherë s'e keni komentuar propozimin tim, për të dalë nga kriza dhe për t'i dhënë problemit drejtim.

As ju s'i keni dhënë, as Qeveria, as Kryesia, as Parlamenti nuk ka denjuar për t'i dhënë interpretim atij propozimi që ju e keni zyrtarisht në zyrë, secili deputet e ka atë material.

Nëse unë dhe njerëzit që më kanë konsultuar kanë bërë gabim, së paku duhet të më demantoni shkencërisht. Ju nuk keni mundur dhe nuk doni. Pse s'doni? Sepse doni ta mbani situatën të tensionuar si fakt.

Nëse ne mendojmë ta mbajmë si fakt situatën e tensionuar, atëherë kujt po i bëjmë dobi? Askujt. As Kosovës s'po i ndihmojmë dhe po sjellim vetëm tension, ndërsa po i marrim në qafë njerëzit, të cilët sot po i vajtojmë, me demokrishtë po i vajtojmë, a de fakto i kemi përdorur.

Prandaj, mos përdorni fakte, të cilat sot nuk janë as për qëllimin që e keni thirrur si grup, sepse ka fakte, ka çështje të cilat duhet biseduar, por nuk janë duke i bërë nder asnjërës palë.

Pra, demarkacionin mos e përdorni, sepse s'e keni ndalur ju, por e kanë ndalur deputetët e kësaj pozite, këtu që janë ulur, të cilët nuk janë të bindur dhe që kërkojnë qartësi të plotë, pavarësisht presioneve publike që i bën edhe kryeministri, pavarësisht shantazheve që i bënë edhe sharlatanët e mediave dhe disa analistë, prandaj edhe nuk kanë fakte, por vetëm ia futin, ndërsa ju e keni përdorur si fakt për t'i arritur qëllimet tuaja dhe t'i arsyetoni hedhjen e gazit dhe zhurmat e tjera që i keni bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka më të paraqitur për të marrë fjalën! Këtu janë përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare. I kemi dy opsione: të thërrasim për nesër seancë për të vazhduar në orën 12, ose 11, vetëm sa për të votuar, ose e lëmë për seancën e ardhshme. Pra, e mbyllim këtë seancë, e pastaj Kryesia e cakton se kur do të mbahet mbledhja.

Pra, sipas Rregullores, propozuesi ka të drejtë të flasë në fund, nëse do, mundet tash dhe mundet në momentin para votimit, kurdo që votohet. Glauk, deklaro vetë, kur po do të marrësh fjalën?

GLAUK KONJUFCA: Unë bisedova më herët edhe me përfaqësuesit, shefat e grupeve parlamentare të PDK-së e LDK-së dhe, siç duket, aty mbizotëron mendimi dhe shpjegimi që nesër shumica e deputetëve nuk do të jenë këtu. Do të thotë, nesër është e premtë dhe ikin nëpër shtëpitë e tyre.

Atëherë, meqë është kështu, le të jetë, të themi për seancën e ardhshme si pikë e parë e rendit të ditës, e pastaj të vazhdojmë me seancën tjetër.

KRYESUESI: Në rregull! Pra, e mbyllim këtë seancë të sotme dhe Kryesia do të caktojë kur do të mbahet seanca e ardhshme, ku si pikë në fillim të seancës do të votohet edhe kjo pikë, edhe pika për të cilën mbetëm pa kuorum, por edhe formimi i Komisionit ad hoc për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*